



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

RRETH FRAZELOGJISË SË
SHQIPES KRAHASUAR ME
GREQISHTEN

Punoi

Ma. Harallamb MIÇONI

Udhëhoqi

Prof. Dr. Thoma DHIMA

TIRANË, 2013



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE**

**RRETH FRAZELOGJISË SE SHQIPES KRAHASUAR
ME GREQISHTEN**

Doktorant

Ma. Harallamb MIÇONI

Udhëheqës shkencor

Prof. Dr. Thoma DHIMA

TIRANË, 2013

DISERTACION

Përgatitur nga:

Harallamb MIÇONI

Për marrjen e gradës shkencore:

“DOKTOR”

Shkolla doktorale

Kërkime Gjuhësore

RRETH FRAZELOGJISË SE SHQIPES KRAHASUAR ME GREQISHTEN

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Thoma DHIMA

Mbrohet në dt. ____ . ____ . 2013 përpara jurisë së përbërë nga:

1. _____ **Kryetar**
2. _____ **Anëtar**
3. _____ **Anëtar (oponent)**
4. _____ **Anëtar (oponent)**
5. _____ **Anëtar**

TIRANË, 2013

PASQYRA E LËNDËS

DEDIKIM	III
PARATHËNIE	IV
HYRJE	V
SHKURTIME	IX
KREU I	
FRAZELOGJIA NË KUPTIMIN E GJERË	1
1. 1. Historiku i frazeologjisë	1
1. 2. Frazeologjia në kuptimin e ngushtë. Kushte dhe kritere.....	4
1. 3. Frazeologjia në kuptimin e gjerë.....	6
1. 4. Kufiri dhe vëllimi i frazeologjisë shqipe në kuptimin e gjerë.....	6
1. 5. Kolokacionet e kufizuara frazeologjike si pjesë e frazeologjisë në kuptimin e gjerë.....	8
KREU II	
STRUKTURA SHUMËFJALËSHE E OBJEKTIT TË FRAZELOGJISË NË KUPTIMIN E GJERË	10
2. 1. Frazema me strukturë sintagme.....	10
2. 1. 1. Sintagma kundrejt togfjalëshit.....	10
2. 1. 2. Rëndësia e sintagmës në sintaksë.....	11
2. 1. 3. Rëndësia e sintagmës në frazeologji.....	11
2. 1. 4. Sintagmat e qëndrueshme dhe kushtet e formimit të tyre.....	12
2. 2. Frazema me strukturë fjalie.....	12
KREU III	
NGUROSJA DHE KRITERET E NGUROSJES	14
3. 1. Ngurosja si dukuri bazë e frazeologjisë.....	14
3. 2. Kriteret e ngurosjes.....	15
3. 3. Kriteret e ngurosjes dhe kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme.....	17
3. 4. Shkalla e ngurosjes.....	19
KREU IV	
TERMINOLOGJIA DHE NJËSIA BAZË E FRAZELOGJISË NË KUPTIMIN E GJERË	20
KREU V	
PËRKUFIZIMI I NJËSISË BAZË DHE I FRAZELOGJISË NË KUPTIMIN E GJERË	23

KREU VI	
TIPOLOGJIA E FRAZEMAVE	26
6. 1. Idiomat.....	31
6. 2. Perifrazat me folje të desemantizuar.....	78
6. 3. Frazetermat.....	97
6. 4. Binomet e pakthyeshme frazeologjike.....	104
6. 5. Lokucionet gramatikore.....	112
6. 6. Proverbat.....	119
6. 7. Formulatat frazeologjike të bashkëbisedimit.....	141
6. 8. Kolokacionet e kufizuara frazeologjike.....	145
KREU VII	
KRAHASIM I IDIOMAVE TË FUSHAVE KRYESORE LEKSIKORE TË SHQIPES DHE TË GREQISHTES	165
7. 1. Idiomat greko-shqiptare në kuadrin e paraleleve idiomatike ballkanike.....	165
7. 2. Prejardhja e idiomave greko-shqiptare.....	166
7. 3. Niveli i përkimeve të idiomave greko-shqiptare.....	157
7. 3. 1. Idiomat me emra të pjesëve dhe të organeve të trupit të njeriut në shqipe dhe në greqishte.....	168
7. 3. 2. Idiomat me emra kafshësh në shqipe dhe greqishte.....	169
7. 3. 3. Idiomat me emra frutash dhe perimesh në shqipe dhe greqishte.....	170
7. 4. Arsye përputhjeje dhe mospërputhjeje së idiomave greko-shqiptare.....	174
KREU VIII	
FRAZELOGJIA SI DISIPLINË MË VETE DHE KUFIJTË E SHTRIRJES SE SAJ	176
KREU IX	
LIDHJA E FRAZELOGJISË ME DISIPLINAT E TJERA	179
PËRFUNDIME	181
PROPOZIME	185
BIBLIOGRAFI	186

DEDIKIM

Ky punim u dedikohet mësuesve të mi të gjuhës:

- | | | |
|------------|-----------|---------------|
| -Harallamb | Kallojeri | (Delvinë) |
| -Vasil | Ristani | (Gjirokastrë) |
| -Eli | Thimjo | (Gjirokastrë) |
| -Shezai | Rrokaj | (Tiranë) |
| -Nonda | Varfi | (Tiranë) |
| -Ethem | Likaj | (Tiranë) |

PARATHËNIE

Gjatë përdorimit të gjuhës dhe kryesisht gjatë përpjekjeve përkthimore kemi vënë re se me njësitë e vëllimit frazeologjik të cilat jemi mësuar të pranojmë, si p.sh., i kthej krahët, i fërkoj krahët, vret miza, s'e mbyll gojën etj., ngjajnë edhe shumë njësi të tjera shumëfjalëshe të cilat janë po aq të vështira sa të parat për t'u kuptuar nga të huajt dhe për t'u përkthyer në gjuhë të huaja. Këtu kemi parasysh shprehje të tilla si pas shpine, në tym, në drejtim të, duke qenë se, jetë qeni, thyej rekordin, çelës anglez, qesh më mirë kush qesh i fundit etj. Edhe përbërësit e këtyre njësive dalin me kuptime të mbartura, të ndryshme nga ato literale. Për më tepër këto kuptime janë të kushtëzuara në përdorim nga një ose shumë pak fjalë të tjera. Kjo na ka bërë të mendojmë se edhe në këto raste kemi të bëjmë me frazeologjizma. Kjo ndjesi na ka shtyrë të kërkojmë se ku fillon dhe ku mbaron vëllimi frazeologjik, se çfarë na pengon që ta pranojmë dhe ta studiojmë si një tërësi me natyrë të njëjtë.

Ndërsa duke iu drejtuar Fjalorit frazeologjik ballkanik për nevojat e përkthimit të frazeologjizmave midis shqipes dhe greqishtes, si gjegjëse të shumë frazeologjizmave shqipe aty kemi hasur kalke frazeologjike greke të painstitucionalizuara në gjuhën letrare greke. Kjo na ka bërë të mendojmë për numrin e përkimeve frazeologjike greko-shqiptare.

E kemi zgjedhur këtë temë duke qenë të ndërgjegjshëm se kjo fushë studimi do të na japë mundësi të gjera trajtimi dhe interpretimi. Në këtë ndërmarrje kemi pasur edhe nxitjen dhe përkrahjen e udhëheqësit shkencor, Prof. Thoma Dhimës, i cili me kurajën shkencore që e karakterizon nuk ka nguruar të mbështesë idenë tonë dhe të na ndihmojë me mendimet e tij si dhe me materiale shkrimore që përbëjnë një pjesë të bibliografisë sonë. Gjejmë këtu rastin ta falënderojmë për mbështetjen, por edhe për durimin me të cilin na ka dëgjuar gjatë shpalosjes së ideve në lidhje me studimin e ndërmarrë.

Falënderojmë gjithashtu gjithë kolegët dhe miqtë brenda dhe jashtë Shqipërisë, nëpër konferenca shkencore ose në biseda të lira dhe spontane, të cilët na kanë ndihmuar me materiale shkrimore, por edhe me vërejtjet e tyre të çmuara.

HYRJE

Qëllimi i punimit

Nëpërmjet punimit të ndërmarrë synojmë:

Të studiojmë teorinë e ndryshme në lidhje me llojet e frazeologjisë.

Të zbulojmë dallimin midis frazeologjisë në kuptimin e ngushtë dhe frazeologjisë në kuptimin e gjerë.

Të analizojmë arsyet e kalimit në frazeologjinë në kuptimin e gjerë duke u nisur nga konstatimi i një vëllimi më të larmishëm shprehjesh të qëndrueshme me kuptim të mbartur.

Të zbulojmë kriteret përcaktuese të frazeologjisë në kuptimin e gjerë.

Të ndalemi në natyrën e strukturës shumëfjalëshe të njësive që studion frazeologjia.

Të grupojmë strukturat frazeologjike në kategori të ndryshme sipas kriterëve dhe tipareve të përbashkëta që ato kanë.

Të emërtojmë njësinë bazë dhe kategoritë e veçanta të frazeologjisë në kuptimin e gjerë.

Të vëmë në dukje dallimet midis kategorive të ndryshme frazeologjike.

Të ilustrojmë me shembuj praktikë gjetjet e ndryshme teorike për ta kthyer teorinë nga një qëllim në diçka që sjell ndikim praktik.

Të matim përputhshmërinë midis idiomave të shqipes dhe atyre të greqishtes si gjuhë fqinje, me kulturë të ngjashme dhe me marrëdhënie shumëshekullore në kuadrin e ballkanizmave frazeologjike, duke sjellë shembuj konkretë nga tri fusha leksikore të studiuar si dhe të japim një model krahasimi për të vazhduar kërkime të ngjashme edhe në fushat e tjera leksikore.

Metodologjia e kërkimit

Fillimisht studimi ynë mbështetet në një analizë përshkruese të frazeologjisë. Për këtë bëhen hulumtime teorike në shqipe dhe në gjuhë të tjera. Pas grumbullimit të materialeve teorike procedojmë me zbatimin e tyre në vëllimin konkret frazeologjik të shqipes. Puna jonë konkrete konsiston në përzgjedhjen e grupeve të ndryshme të lidhjeve të qëndrueshme me ngjashmëri të dukshme, në justifikimin e natyrës frazeologjike të këtyre lidhjeve në bazë të kriterëve të përzgjedhura dhe në vijim bëhet klasifikimi i tyre në kategoritë konkrete përfshirëse. Më tej jepen tiparet e tyre frazeologjike, bëhet ndarja në tipa apo nëntipa dhe në fund jepet përkufizimi i kategorisë frazeologjike ku ato bëjnë pjesë.

Në lidhje me pjesën e krahasimit frazeologjik midis shqipes dhe greqishtes bëhet krahasimi i idiomave të fushave kryesore leksikore të shqipes dhe greqishtes, dhe konkretisht të idiomave të ndërtuara me emra të pjesëve dhe të organeve të trupit të njeriut, të idiomave të ndërtuara me emra kafshësh dhe të idiomave të ndërtuara me emra frutash dhe perimesh. Synimi i këtij krahasimi është të vlerësohet niveli i përkimeve idiomatike greko-shqiptare.

Literatura bazë shkencore

Literatura shkencore në të cilën jemi mbështetur për trajtimin e çështjeve teorike që kanë të bëjnë me frazeologjinë përfshin autorë shqiptarë e të huaj. Referencat e

para mbi frazeologjinë lidhen me autorë të huaj, themelues të frazeologjisë, si p.sh., Bally me “Traité de stylistique française” (1909), Saussure me “Cours de linguistique générale” (1916), Breal me “Essai de sémantique” (1897), Vinogradov me “Ob osnovnyx tipach frazeologičeskix edijic v sovremennom russkom jazyke” (1947) etj., por edhe të tjerë, të mëvonshëm apo bashkëkohorë, si p.sh., Cowie (1981, 1983, 1998 etj), Chernuisheva (1964), Smirnitsky (1959), Granger & Meunier (2008), Granger & Paquot (2008), Burger (1998), Burger et al. (2007), Lamiroy (2008), Kleiber (1989, 2000, 2005), Piirainen (2008), Mel’čuk (1998, 2003), Svensson (2004), Coulmas (1981), Gläser (1980, 1986), Jespersen (1924), Connena (2000), Lakoff & Johnson (1980), Gibbs (1980, 1993), Symeonidis (Συμεωνίδης, gr.) (2000), Chioti (Χιώτη, gr.) (2010) etj.

Referencat shqipe nisin me studiuesin Jani Thomai, i cili ka nisur lëvrimin e shumë çështjeve dhe problemeve që lidhen me fushën e frazeologjisë që në vitet ’60 të shekullit të kaluar, të cilat vijjnë në një formë më të zgjeruar e të plotë në “Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe” (1981) dhe kurorëzohen me “Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999). Studiues të tjerë të rëndësishëm shqiptarë mbi të cilët jemi mbështetur janë Aleksandër Xhuvani (1921), Stefan Prifti (1962), Ilia Dilo Sheperi (1927), Valter Memisha (2006), Zenun Gjoçaj (2001), Hilmi Agani (1975) etj.

Fjalorët kryesorë të shqipes dhe të huaj që kemi shfrytëzuar janë:

Fjalori i shqipes së sotme (1984), Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980), Fjalori i gjuhës shqipe (1954), Fjalori i shqipes së sotme (2002), OALD: Oxford advanced learner’s dictionary (2000), LDOCE: Longman Dictionary of Contemporary English (2003), Nouveau Petit Robert (2001), Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής (1998), Λεξικό της νέας Ελληνικής γλώσσας (2002) etj.

Kontributi shkencor

Ky punim është një kontribut në fushën e studimeve frazeologjike dhe shërben për të zgjeruar vëllimin frazeologjik të gjuhës shqipe në bazë të kriterëve dhe kushteve më gjithëpërfshirëse si **vlera e fjalisë, sintagma dhe mosreferencialiteti literal**. Ai ndihmon për të zgjidhur problemin teorik të argumentimit të veçimit të frazeologjisë si disiplinë më vete, vendin që duhet të zërë frazeologjia në shkencën gjuhësore si dhe të problemit praktik të përcaktimit të vëllimit frazeologjik të gjuhës shqipe dhe të vendosjes së kufirit midis asaj që është frazeologjike dhe asaj që nuk është frazeologjike.

Punimi kontribuon edhe me futjen e disa nocioneve bashkëkohore në lidhje me kriteret frazeologjike, si p.sh., **moskompozicionaliteti semantik, mosreferencialiteti literal** etj., dhe në lidhje me kategoritë frazeologjike si, si p.sh., **kolokacionet** e kufizuara frazeologjike, **binomet** e pakthyeshme frazeologjike, **formatat** frazeologjike të bashkëbisedimit etj., si dhe në lidhje me përkufizimin për çdo kategori.

Ai kontribuon gjithashtu në një vlerësim më real të përkimeve idiomatike greko-shqiptare, në hartimin e fjalorëve specialë frazeologjikë dygjuhësh (shqip-greqisht dhe anasjelltas) si dhe në krijimin e programeve të veçanta kompjuterike.

Struktura e punimit

Ky punim kërkimor shkencor është ndarë në nëntë krerë, secili prej të cilëve përmban nëndarjet përkatëse

Kreun e parë e nisim me historikun e frazeologjisë si një nga degët e reja të gjuhësisë, e cila e ka nisur jetën e saj në fillimet e shekullit XX me themelues Charles Bally. Ndërsa i pari që e studioi frazeologjinë shqipe nga këndvështrimi disiplinës frazeologjike është Jani Thomai (1981). Në bazë të tipareve dhe të kriterëve si barasvlershmëria me një fjalë të vetme, kuptimi i vetëm tërësor, figurshmëria, ngurosjja e njësive frazeologjike, me të cilat ai operon dhe në bazë të shembujve që ofron, natyra e frazeologjisë që autori trajton është ajo në kuptimin e ngushtë. Në vijim dallojmë frazeologjinë në kuptimin e ngushtë e cila merret me studimin e njësive me vlerë fjale apo të njësive nën nivelin e fjalisë nga frazeologjia në kuptimin e gjerë e cila merret me studimin e njësive deri në nivelin e fjalisë dhe në të cilën përfshihen edhe kategori frazeologjike si proverbat dhe formulat frazeologjike të bashkëbisedimit. Në këtë kapitull trajtojmë gjithashtu edhe arsyet e përzgjedhjes së frazeologjisë në kuptimin e gjerë kundrejt frazeologjisë në kuptimin e ngushtë.

Në kreun e dytë merremi me studimin e natyrës së strukturës shumëfjalëshe të objektit të frazeologjisë në kuptimin e gjerë, të cilin e quajmë frazemë. Në përbërje të frazemave dallojmë sintagma dhe fjali, si p.sh., *pemë pa kokrra, i hurit dhe i litarit, fut hundët, ngul këmbë, ku ha pula strall, qesh më mirë kush qesh i fundit, kush i bën gropën shokut bie vetë brenda etj.*

Në këtë kapitull trajtojmë gjithashtu edhe arsyet e përzgjedhjes së sintagmës (së qëndrueshme) kundrejt togfjalëshit (të qëndrueshëm).

Në kreun e tretë i kushtojmë rëndësi ngurosjes si dukuri bazë e frazeologjisë, e cila prek jo vetëm anën gramatikore të frazemave, por edhe anën leksikore dhe kuptimore. Në këtë kapitull analizojmë edhe kriteret e ngurosjes të cilat i grupojmë në kushte të nevojshme dhe në kushte të mjaftueshme të ngurosjes. Së fundi merremi me studimin e shkallës së ngurosjes së frazemave.

Në kreun e katërt analizojmë terminologjinë e përdorur në fushën e frazeologjisë si dhe termin që propozojmë për njësinë bazë të frazeologjisë në kuptimin e gjerë.

Në kreun e pestë japim përkufizimin e njësisë bazë të frazeologjisë si dhe të vetë frazeologjisë në kuptimin e gjerë.

Kreu i gjashtë i kushtohet tipologjisë së frazemave. Në fillim japim disa klasifikime sipas motivimit semantik të frazeologjisë në kuptimin e ngushtë të cilat lidhen me trajtimin tradicional të frazeologjisë dhe të cilat u detyrohen shumë kërkuesve rusë, ndërsa në vazhdim japim klasifikimet më të njohura të frazeologjisë në kuptimin e gjerë në kuadër të së cilës japim edhe klasifikimin e frazemave të gjuhës shqipe. Në klasifikimin tonë gjejmë emërtimin e njësisë bazë të frazeologjisë (frazemë), nëndarjet e gjera të frazemave sipas vlerës që ato kanë (frazema me vlerë fjale, frazema me vlerë sintagme dhe frazema me vlerë fjalie, dhe tetë kategoritë e veçanta frazeologjike: idiomat, perifrizat me folje të desemantizuar, frazeotermat, binomet e pakthyeshme frazeologjike, lokucionet gramatikore, proverbat, formulat frazeologjike të bashkëbisedimit dhe kolokacionet e kufizuara frazeologjike. Në vijim analizojmë secilën prej këtyre kategorive duke analizuar kriteret përcaktuese të natyrës së tyre frazeologjike, arsyet e përzgjedhjes së termave emërtuese të këtyre

kategorive, për të mbërritur në përkufizimin dhe në tiparet frazeologjike të secilës prej tyre si dhe në dallimet e mundshme midis tyre.

Në kreun e shtatë ndërmarrim krahasimin e idiomave të fushave kryesore leksikore të shqipes dhe të greqishtes, si p.sh., të idiomave me emra të pjesëve dhe të organeve të trupit të njeriut, të idiomave me emra kafshësh dhe të idiomave me emra frutash dhe perimesh në shqipe dhe në greqishte. Së pari japim arsyet e kufizimit të krahasimit vetëm të idiomat si pjesa e figurshme qendrore e frazemave dhe së dyti japim arsyet e përqendrimit të krahasimit vetëm midis idiomave të shqipes dhe të greqishtes si dy gjuhë fqinje dhe me kulturë të ngjashme, vëllimi idiomatik i të cilave përfshihet edhe në paralelet idiomatike ballkanike të kurorezuara në “Fjalori frazeologjik ballkanik”. Duke u mbështetur në shumë **përkime të pasakta** të idiomave greko-shqiptare të fushave leksikore të mësipërme të paraqitura në Fjalorin frazeologjik ballkanik si dhe në **mospërkimet** e konstatuara në një masë dërrmuese midis idiomave greko-shqiptare të fushës leksikore me emra të fruta-perimeve, bëjmë disa hamendësime për nivelin real të përkimeve idiomatike greko-shqiptare.

Kreu i tetë i kushtohet frazeologjisë si disiplinë më vete e shkëputur nga leksikologjia në kuadër të së cilës është studiuar për një kohë të gjatë. Si shkencë gjuhësore e pavarur frazeologjia u përvijua për herë të parë në shekullin XX nga shkencëtari rus Vinogradov i cili përcaktoi objektin, strukturën dhe vëllimin e shkencës frazeologjike. Analizojmë gjithashtu arsyen e studimit të frazeologjisë në kuadrin e leksikologjisë, por edhe arsyet e ndarjeje të frazeologjisë nga leksikologjia dhe të përvijimit të saj si disiplinë më vete.

Në kreun e nëntë flitet për lidhjen e disiplinës së frazeologjisë me të gjitha disiplinat e tjera gjuhësore, por edhe me disiplinat e tjera fqinje të gjuhësisë si p.sh., me folklorin, me etnografinë, por edhe me informatikën etj.

Në mbyllje të punimit jepen disa përfundime si dhe disa propozime për perspektivën e kërkimeve të mëtejshme frazeologjike, për unifikimin e terminologjisë jo vetëm brenda një gjuhe por edhe midis gjuhëve si dhe për perspektivën e ndërmarrjes së studimeve krahasuese frazeologjike me natyrë etnolinguistike ku të përfshihen jo vetëm idiomat por edhe proverbat si një njësi tjetër qendrore e frazeologjisë së figurshme.

SHKURTIME

angl.	anglisht
fr.	frëngjisht
gr.	greqisht
turq.	turqisht
krhs.	krahaso
lit.	literal, literalisht, me kuptim të drejtpërdrejtë
vs	versus, kundrejt

KREU I

FRAZEOLOGJIA NË KUPTIMIN E GJERË

1. 1. Historiku i frazeologjisë

Kanë kaluar vetëm 100 vjet nga koha që frazeologjia nisi të përbëjë objekt studimi të njëjësive shumëfjalëshe të ngurosura të gjuhës dhe kjo lidhet me emërtimin që Charles Bally (1909) u ka bërë si lokucione frazeologjike. Bally konsiderohet si themelues i frazeologjisë dhe ka frymëzuar gjerësisht studimet frazeologjike të rusishtes, të gjermanishtes, të hungarishtes, të spanjishtes, por edhe të shqipes.

Por interesimi për këto njësi shumëfjalëshe të ngurosura nuk është aq i vonë. Në të gjitha gjuhët e botës, prej kohësh njerëzit janë interesuar për këto dukuri gjuhësore, shumë shpesh unike, që kuptohen me vështirësi dhe që ripërdoren nga folësit e gjuhës dhe ky interesim ka pësuar një evolucion të veçantë. Mund të vëmë re se kërkimet e para në frëngjishte kufizohen në një përmbledhje lokucionesh që përfshihen në veprat leksikografike. Midis punimeve të cilave u referohet Hausmann (1989), disa janë përmbledhje shprehjesh apo lokucionesh latine ose greke të nxjerra nga tekste autorësh si Ciceroni. Kjo përmbledhje, si shumë fjalorë të periudhës klasike, nuk bën asnjë dallim midis metaforës, lokucionit apo proverbit.

Autorë të ndryshëm e vendosin frazeologjinë nën varësinë e fushave të tjera. Kështu, refleksionet e para teorike mbi lokucionet u bënë në semantikë. Bréal (1897) deklaroi: “Në qoftë se ai që është duke bërë historinë e ndryshimit të kuptimeve, do të studionte vetëm fjalët, do të rrezikonte mosngërthimin e një pjese të fakteve, ose do të rrezikonte t’i shpjegonte gabim. Gjuha nuk përbëhet vetëm nga fjalë: ajo përbëhet nga grupe fjalësh dhe nga fjali”.

Bally e përfshin frazeologjinë në një përjasje stilistike të gjuhës. Në “Traité de stylistique”, Bally (1909) u kushton një kapitull të tërë atyre që ai i quan lokucione frazeologjike. Nxënësi i Saussure-it, Bally është i pari që studion veçoritë sintaksore, leksikore dhe semantike të këtyre të fundit. Në këto “grupe të afirmuara nga përdorimi”, Bally dallon dy nëngrupe lokucionesh të cilat i përcakton në bazë të shkallës së kohezionit: “Do të quajmë seri ato ku kohezioni i termave nuk është veçse relativ, dhe njësi ato ku kohezioni është absolut”.

Bazuar në veprën e Bally, në vitet 30 filloi të zhvillohet një drejtim kërkimor i pavarur në gjuhësinë ruse, i cili, pas daljes së punimeve të para të Vinogradov-it (1947), shënoi një përparim të dukshëm. Klasifikimi i frazeologjizmave në tri kategori që propozoi Vinogradov mbizotëroi për një periudhë të gjatë kohore. Disa nga përfaqësuesit më të shquar të shkollës ruse punuan për gjuhët jo sllave, si p.sh., N. Amosova (1963) dhe A. Kunin (1970) për anglishten.

Gläser (1986) përcakton një nivel frazeo-stilistik në gji të stilistikës e cila, edhe ajo vetë, është një disiplinë më vete e gjuhësisë. Për F. J. Hausmann (1979) dhe G. Corpas Pastor (1996), frazeologjia rrjedh nga leksikologjia: meqë këto njësi bëjnë pjesë në fjalor, depozitohen në memorie si njësi të thjeshta të leksikut. Së fundi, për një numër të caktuar frazeologjesh, vendi i ndërmjetëm që zë frazeologjia midis shumë fushave i jep asaj një pozitë ndërdisiplinore. Frazeologjia mund të trajtohet jo vetëm nga pikëpamja e brendshme, nga përjasje të ndryshme (studime gjuhësore në diakroni, në sinkroni, në përkthim, në tipologji, në didaktikë etj.), por edhe nga

pikëpamja e jashtme, nga fusha të tjera (nga psikolinguistika, nga sociolinguistika, nga informatika etj.).

Edhe në gjuhësinë shqipe, “sido që togfjalëshat frazeologjikë dëshmohen që me librat më të parë, pasqyrimi i tyre në gramatikat e shqipes ose në studimet e veçanta është mjaft i vonë”¹. Teoria frazeologjike e shqipes nisi pas gjysmës së dytë të shekullit të 20. Që nga ajo periudhë, ajo ka arritur rezultate të rëndësishme teorike dhe praktike (leksikografike). Objekti që ajo studion paraqitet me emërtime të ndryshme si “shprehje”, “frazë”, “njësi frazeologjike” etj. Duke hedhur një vështrim në historinë e frazeologjisë shqipe, hasim vazhdimisht emrin e themeluesit të saj, Jani Thomait (1981).

Por sa e gjerë është frazeologjia shqipe? Cilat njësi shumëfjalëshe duhet të studiojë frazeologjia në kuptimin e gjerë? Cilat janë kriteret e përcaktimit të vëllimit të saj? Këto janë disa prej pyetjeve të cilave do t’u përgjigjemi në punimin tonë.

Për objektivat që synojmë të arrijmë në materialin tonë nuk na intereson aq shumë historiku i frazeologjisë shqiptare sesa këndvështrimi i studimit -gramatikor apo leksikor-, kushtet e klasifikimit të tyre, tiparet e tyre dalluese, vëllimi dhe lloji i frazeologjisë gjuhësore të trajtuar deri tani.

Shumica e gjuhëtarëve shqiptarë kanë trajtuar një aspekt- gramatikor apo leksikor-, apo një lloj të caktuar të shprehjeve të ngurosur (kryesisht togfjalëshat e qëndrueshëm me funksionin sintaksor të kallëzuesit foljor). Ajo që i bashkon të gjithë këta gjuhëtarë është fakti se të gjithë flasin për qëndrueshmëri të njëjësive shumëfjalëshe që studiojnë, dhe do të quajnë frazeologjike vetëm njësitë shumëfjalëshe të qëndrueshme që janë të barasvlershëm me një fjalë të vetme, që kanë kuptim tërësor, që janë të figurshme.

Shumica e studiuesve të togfjalëshave të qëndrueshëm të shqipes janë gramaticienë të fushës së sintaksës. Ata trajtojnë tiparin e funksionit dhe të qëndrueshmërisë së këtyre strukturave shumëfjalëshe. Por këto tipare nuk janë veçse pasoja të përdorimit të fjalëve: të kushtëzimit dhe të kufizimit të aftësive kombinuere të fjalëve. Duke i trajtuar kryesisht nga aspekti funksional dhe duke mos u kushtuar rëndësi kushteve të formimit të tyre, në ndonjë rast kanë përfshirë në togfjalëshat e qëndrueshëm frazeologjikë edhe togfjalëshat lidhjet e të cilave nuk janë të qëndrueshme, por të lira, si p.sh., *ish e pamundur, është mirë, hynte e dilte, Biblioteka Kombëtare, që sot e kësaj dite, bashkë me etj.*

Si togfjalësha të qëndrueshëm frazeologjikë J. Rrota (1942) veçon ato që i quan “verba frazeologjikë” që përbëjnë struktura me marrëdhënie kryesisht objektore apo rrethore, si p.sh., *kam gisht, baj ball, bie në sy, bie në gjunjë etj.* dhe që luajnë rolin e kallëzuesit foljor.

Disa nga togfjalëshat e qëndrueshëm të studiuar prej tij, K. Cipo (1949) i quan “lokusione pavetore”, si p.sh., *bën vapë, u bë ditë etj.* disa të tjera “folje në aorist që tregojnë fillimin e një pune a të një mënyre së qeni, me idenë e aspektivitetit”, si p.sh., *ra i sëmurë, më zunë etjet etj.* Autori i kushton rëndësi funksionit gramatikor të njëjësive që studion si kallëzues.

¹ Thomai, J. (1981). Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe. Tiranë.

M. Domi (1985) trajton togfjalëshat e qëndrueshëm me funksionin e kallzuesit foljor, të formuara nga një folje e një emër, të shoqëruara ose jo me parafjalë dhe i quan “shprehje”, si p.sh., *kam frikë, mbaj mend, ngul këmbë etj.*

Togfjalëshat frazeologjikë që studion S. Prifti (1962) i quan “shprehje ndajfoljore” dhe nënkupton ato që përbëhen nga një folje dhe nga një ndajfolje dhe që luajnë funksionin e kallzuesit foljor, si p.sh., *u bënë afër, u bëra vonë etj.*

M. Celiku (1962) flet për togfjalëshat të qëndrueshëm të gramatikalizuar, si p.sh., *kam për t’punu, jam për t’u vra etj.* dhe për togfjalëshat të qëndrueshëm të leksikalizuar. Autori përmend si veçori dalluese të këtyre togfjalëshave ndërtimin e tyre prej me më shumë se dy fjalësh shënuese. Togfjalëshat e qëndrueshëm të leksikalizuar i ndan në togfjalëshat të qëndrueshëm të leksikalizuar të tipit të zakonshëm, si p.sh., *baj punë, baj luftë etj.* dhe të tipit frazeologjik, si p.sh., *vras mendjen, e mur vesht etj.*, “që së bashku kanë një kuptim figurativ”. Për togfjalëshat e tipit frazeologjik thotë se kuptimisht janë të barasvlershëm me një fjalë të vetme.

I. D. Sheperi (1927) shprehjet frazeologjikë i përfshin nën termin “lokusione” dhe i ndan në lokusione emërore, mbiemërore, foljore, si p.sh., *marr vesh, parafjalore*, si p.sh., *në vend të etj.* Ndryshe nga gramaticienët e mësipërm, ai përipiqet të japë edhe anën kuptimore të tyre kur thotë se “ndonëse të ndara, përbëjnë të dyja një kuptim të veçantë”. Koncepti i tij për ato që ai i quan “lokucione” nuk kufizohet te përbërja strukturore me dy fjalë shënuese, prandaj në to ai përfshin edhe shprehje me strukturë sintagme (*në vend të etj.*)

Nga gjithë ky rreshtim shembujsh dhe emërtime del se togfjalëshat frazeologjikë, sipas qëllimeve të autorëve dhe të natyrës së teksteve, janë studiuar kryesisht për funksionin e tyre sintaksor si një gjymtyrë e vetme e fjalisë.

Padyshim, nuk mund të pritët që zgjidhjet teorike frazeologjia gjuhësore t’i gjejë në gramatikë, kjo është detyrë e studimeve të veçanta, në përgjithësi e studimeve komplekse, por me drejtim kryesor leksikologjik.

Vetëm A. Xhuvani (1921) i trajton në fushën e leksikologjisë. Si bashkëkohës i Bally-së, ai dallon dy lloje të objektit të frazeologjisë: “lokucionet” që janë “mënyrë të të foluri, domethanëja e të cilave ka rrjedhë jo nga fjalët që i formojnë lokucionet, por nga përdorimi i ktyne fjalëve, një përdorim si me thanë i brendshuem që u ka dhanë ktyneve, të marrun si një grumbull, një kuptim mbë vehte...; p.sh: *me kallzuem diçka për pe, me i ardhun ndokujt tjegulla për qark*” dhe “frazat” që janë “mënyrë të folurit që e kanë marrë kuptimin jo prej përdorimit, por prej fjalëve veçan, p.sh: *me i dalun zot*” Por, ndryshe nga Bally, ai i emërton me terma të ndryshëm dhe nuk përcakton kriteret të qarta të dallimit dhe të njohjes së tyre. Ndryshe nga gjuhëtarët që i studiovan në sintaksë, ai i quan thjesht mënyra të të folurit.

I pari që i studioi nga këndvështrimi disiplinës frazeologjike është Jani Thomai. Në “Cështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe” (1981), Thomai frazeologjinë gjuhësore e përkufizon si “tërësia e atyre bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve, që janë formuar historikisht e janë kristalizuar si njësi të pandashme dhe që nga ana e kuptimit kategorial janë të barasvlershme me një fjalë të vetme”. Ndërsa në “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999), për njësitë frazeologjike autori thekson se “Në fushën e shqipes si tipare të përgjithshme të njësisë frazeologjike janë njohur struktura togfjalëshore, njësia kuptimore, qëndrueshmëria, figurshmëria, neutralizimi i raporteve të brendshme sintaksore, njëvlerësia me fjalën nga ana e kuptimit kategorial

dhe e funksionit në ligjërim”. Autori flet për tipare të njësive frazeologjike të cilat nënkuptojnë edhe kriteret e formimit të tyre. Në bazë të tipareve dhe të kriterëve si barasvlershmëria me një fjalë të vetme, kuptimi i vetëm tërësor, figurshmëria, qëndrueshmëria etj., me të cilat ai operon dhe në bazë të shembujve që ofron, natyra e frazeologjisë që autori trajton është ajo në kuptimin e ngushtë.

Ka edhe gjuhëtarë të tjerë që e studiojnë frazeologjinë në kuptimin e saj të ngushtë:

Kështu, Vinogradov i kufizon njësitë frazeologjike në njësitë më metaforike të gjuhës². Ai dhe Amosova janë themeluesit e një këndvështrimi të frazeologjisë që kufizon objektin e fushës në një nënklasë specifike të njësive shumëfjalëshe³.

Ndërsa për Gledhill (2008), objekti qendror i frazeologjisë tradicionale është një shprehje idiomatike që dallohet nga ndërtimet e tjera të gjuhës nga qëndrueshmëria e saj në planin leksiko-gramatikor, nga domethënia e saj kryesisht e figurshme dhe e paparashikueshme në planin semantik. Frazeologjia tradicionale merret me përkufizimin dhe klasifikimin e shprehjeve frazeologjike, si dhe me problemin e “motivimit”: shkalla e vështirësisë me të cilën vëzhguesi arrin të lidhë “burimin” e një shprehjeje (domethënien e saj metaforike apo të mundshme, jashtë kontekstit) me “objektivin” (domethënien aktuale, në kontekst).

1. 2. Frazeologjia në kuptimin e ngushtë. Kushte dhe kriterë

Përcaktimi i frazeologjisë në kuptimin e ngushtë lidhet me kushte dhe kriterë të veçanta karakteristike për këtë lloj frazeologjie.

Me frazeologji në kuptimin e ngushtë Burger (2007) kupton studimin nga frazeologjia të njësive “më të shkurtra se fjalia”. Këtij cilësimi i përshtatet më së miri frazeologjia vinogradoviane ku përfshihen edhe “kombinimet frazeologjike” si frazema⁴ me vlerë sintagme (të njohura ndryshe si kolokacione të kufizuara frazeologjike⁵). Sipas përcaktimit të Burger, edhe frazeologjia shqipe e përfaqësuar nga Thomai është frazeologji në kuptimin e ngushtë, madje më e ngushtë se frazeologjia vinogradoviane, sepse ajo ka si objekt studimi vetëm strukturat e qëndrueshme shumëfjalëshe të barasvlershme me fjalën dhe jo thjesht më të shkurtra se fjalia.

Autorë të ndryshëm e trajtojnë frazeologjinë pa përcaktuar nëse operojnë në fushën e frazeologjisë në kuptimin e gjerë apo në fushën e frazeologjisë në kuptimin e ngushtë, por vetëm duke përcaktuar kriteret nga të cilat udhëhiqen në studimet e tyre, ndërsa të tjerë bëjnë dallimin midis dy llojeve të frazeologjisë duke përcaktuar edhe kriteret respektive.

² Moon, R. (1998). Fixed Expressions and Idioms in English. A Corpus-based Approach. Oxford: Clarendon Press.

³ Granger, S. & Paquot, M. (2008). Disentangling the phraseological web, Granger, S. & Meunier, F. Phraseology -An interdisciplinary perspective. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia

⁴ Termi *frazemë* është termi i njësive bazë apo ombrellë i propozuar dhe i sanksionuar nga ne për frazeologjinë në kuptimin e gjerë. Krahas termit frazemë dhe si sinonim të tij ne përdorim edhe termat shprehje frazeologjike, shprehje të ngurosura (të gjuhës) etj., të cilat i referohen përdorimit nga autorë të ndryshëm ose përdorimit të deritanishëm në gjuhë. Për më tepër, shih në kreun “*Terminologjia dhe njësia bazë e frazeologjisë në kuptimin e gjerë*”.

⁵ Termi *kolokacion i kufizuar frazeologjik* është termi i përdorur nga ne për një nga kategoritë e frazeologjisë në kuptimin e gjerë. Për më tepër, shih në kreun e kategorisë përkatëse.

Ajo që vihet re është se kriteri i frazeologjisë në kuptimin e ngushtë është i ndryshëm te autorë apo te rryma të ndryshme:

Disa prej gjuhëtarëve aplikojnë kriterin e moskompozicionalitetit⁶ për të përcaktuar frazeologjinë në kuptimin e ngushtë.

Kriterin e moskompozicionalitetit për përcaktimin e frazeologjisë në kuptimin e ngushtë e gjejmë te Bally (1909) në rastin kur ai flet për njësitë frazeologjike të cilat i përkufizon kështu: “Thuhet që një grup formon një njësi kur fjalët që e përbëjnë humbasin çdo kuptim dhe se vetëm tërësia ka kuptim; përveç kësaj duhet që ky kuptim të jetë i ri dhe të mos jetë thjesht i barasvlershëm me shumën e përbërësve”.

Jean-Pierre Colson (2008), për shembull, bën një përcaktim konçiz të kushteve mbi ndarjen e frazeologjisë në kuptimin e ngushtë dhe në kuptimin e gjerë: “Frazeologjia në kuptimin e gjerë plotëson kriterin e polileksikalitetit dhe të qëndrueshmërisë, ndërsa frazeologjia në kuptimin e ngushtë kërkon kriterin plotësues të moskompozicionalitetit”.

Disa gjuhëtarë të tjerë aplikojnë kriterin e figurshmërisë për të përcaktuar frazeologjinë në kuptimin e ngushtë

Kështu, siç thekson Moon (1998), “Vinogradov i kufizon njësitë frazeologjike te njësitë më të figurshme të gjuhës”.

Disa gjuhëtarë të tjerë aplikojnë kriterin e barasvlershmërisë me fjalën (shih Thomai, 1981; Smirnitsky, 1959) për të përcaktuar frazeologjinë në kuptimin e ngushtë

Kështu, J. Thomai (1981) frazeologjinë e përkufizon si “tërësia e atyre bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve, që janë formuar historikisht e janë kristalizuar si njësi të pandashme dhe që nga ana e kuptimit kategorial janë të barasvlershme me një fjalë të vetme”.

Enciklopedia e madhe ruse (1979) është një ndër veprat e para që flet për dy lloje të frazeologjisë si dhe për kritere: Sipas kësaj enciklopedie, objekti i frazeologjisë është i ngushtë kur shprehjet frazeologjike përcaktohen nga kriteret e njësisë semantike të kuptimit të togfjalëshit dhe të ekuivalencës të togfjalëshit me një fjalë të vetme nga pikëpamja e funksionit emërtues. Ndërsa frazeologjia në kuptimin e gjerë përcaktohet nga kriteri i përdorimit të rregullt në një formë të qëndrueshme, pavarësisht nga njësia semantike e togfjalëshit apo nga ndarja e togfjalëshit në kuptimet e fjalëve përbërëse.

Për dy lloje frazeologjish flet edhe Symeonidis (Συμεωνίδης, gr.) (2000). Sipas tij frazeologjia në kuptimin e ngushtë “është degë e gjuhësisë që studion kombinimet e qëndrueshme të fjalëve të gjuhës që kanë funksionin dhe vlerën e një fjale të vetme në fjali” dhe përcaktohet në bazë të kritereve të moskompozicionalitetit dhe të figurshmërisë, ndërsa frazeologjinë në kuptimin e gjerë e përcakton në bazë të kritereve të qëndrueshmërisë dhe pjesërisht të moskompozicionalitetit.

⁶ Termi *moskompozicionalitet (semantik)* është term i përdorur si një nga kriteret e ngurosjes frazeologjike për kuptimin e njësive shumëfjalëshe i cili është i ndryshëm nga shumta e kuptimeve të përbërësve. Për më tepër, shih te kreu “Ngurosjja dhe kriteret e ngurosjes”.

1. 3. Frazeologjia në kuptimin e gjerë

Pak më lart theksuam se me frazeologji në kuptimin e ngushtë kuptojmë studimin nga frazeologjia të njëjësive me vlerë fjale (shih Smirnitsky, 1959; Thomai, 1981) ose të njëjësive nën nivelin e fjalisë për të cilat Burger (2007) shprehet se “janë më të shkurtra se fjalia”.

Me frazeologji në kuptimin e gjerë kuptojmë përfshirjen në frazeologji edhe të njëjësive me vlerë fjalie, si p.sh., proverbat dhe formulat frazeologjike të bashkëbisedimit. Për këtë lloj frazeologjie Burger (2007) pohon se “kanë karakteristikat e fjalisë” dhe në të ai përfshin “kolokacionet, proverbat dhe formulat”, ndërsa Piirainen (2008) pohon se është “një konceptim për të cilin sot bien dakord shumica e frazeologëve europianë”.

Por, edhe këtë dallim midis njëjësive nën nivelin e fjalës apo me vlerë fjale dhe njëjësive me vlerë fjalie të parët e bënë Rusët. “Një nga frazeologët e para ruse që iu referua këtij dallimi është Chernuisheva (1964) njësitë me vlerë fjalie (të quajtura “shprehje frazeologjike”) të së cilës përfshinin thënie dhe citate familjare”⁷.

Disa studiues postvinogradovianë mendojnë se proverbat duhet të studiohen së bashku me njësitë frazeologjike. Disa të tjerë, midis të tjerëve edhe J. Casares (1950), N. N. Amosova (1963), J. Thomai (1981) etj. mendojnë se në qoftë se njësitë që nuk përbëjnë pjesë të fjalisë është e gabuar të përfshihen në sistemin e gjuhës, sepse janë njësi të pavarura të komunikimit.

Dallimi i mësipërm u njoh dhe u ndoq nga specialistët e fushës, si p.sh., Cowie (1988), Mel’čuk (1988), Gläser (1988) dhe Burger (1988) dhe më vonë nga Granger & Paquot (2008) etj.

Si në çdo fushë të re studimi, edhe në fushën e frazeologjisë ka pikëpamje të ndryshme, madje për vetë objektin e studimit, që lidhet me pikëpamjet për njësinë themelore të kësaj fushe. Mendimi ynë për njësinë themelore dhe për objektin e frazeologjisë del edhe jashtë lidhjeve me fjalën, por nuk i kalon kufijtë e fjalisë për nga vlera e funksioni (shih Piirainen, 2008; krhs. Thomai, 1981), sepse, siç do të shohim te kapitulli i studimit të proverbove si kategori e veçantë frazeologjike, para se proverbat të jenë njësi të folklorit, ato janë njësi të gjuhës me vlerë fjalie.

1. 4. Kufiri dhe vëllimi i frazeologjisë shqipe në kuptimin e gjerë

Në lidhje me frazeologjinë në kuptimin e ngushtë, disa gjuhëtarë kanë një koncept akoma më të ngushtë për frazeologjinë e gjuhës, duke përfshirë këtu disa fjalë me kuptim të figurshëm, ose shumë të ngushtë, vetëm për strukturat idiomatike (të pamotivueshme)⁸.

Ndërsa në lidhje me frazeologjinë në kuptimin e gjerë, disa gjuhëtarë kanë një koncept më të gjerë. Përveç bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve të formuara historikisht, të leksikalizuara dhe të barasvlershme nga kuptimi me një fjalë të vetme, ata përfshijnë edhe lëndën e folklorit-proverbat, fjalët e urta, gjëzat etj⁹.

Disa të tjerë vendosin për fatin e qëndrueshmërisë frazeologjike së disa njëjësive shumëfjalëshe nëpërmjet analizës së gjuhës me bazë korpusin tekstoral elektronik.

⁷ Cowie, A. P. (1998). *Phraseology: Theory, Analysis, and Applications*, (Oxford Studies in Lexicography and Lexicology) Oxford: Oxford University Press.

⁸ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁹ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

Kështu, frazeologjia nis të analizohet mbi bazën e korpusit tekstor elektronik me Halliday (1966), ka si përfaqësues kryesor Sinclair (1991) dhe pasohet edhe nga të tjerë, si p.sh., Wray (2002). Ajo përmendet si trajtim mbi bazën statistikore dhe të shpeshtësisë dhe përdor korpusin tekstor për të identifikuar asociacionet leksikore. Ky trajtim induktiv sjell një gamë të gjerë kombinime fjalësh që nuk u përshtaten kategorive gjuhësore të parapërkufizuara¹⁰.

Përfaqësuesit e këtij trajtimi nuk merren me dallimin midis kategorive dhe të nënkatëgorive të kombinimeve të fjalëve. Për ta shprehjet frazeologjike kanë përparësi mbi fjalët. Madje, për ta, edhe kombinimet e lira të fjalëve kanë vend në frazeologji. Slogani i fundit i Sinclair është: “The phrase, only the phrase, nothing but the phrase”¹¹ (sintagma, vetëm sintagma, asgjë përveç sintagmës). Kjo pikëpamje shumë e gjerë lidhet me trajtimin e frazeologjisë duke u mbështetur në korpusin tekstor mbi bazën e shpeshtësisë e cila, siç do ta shohim më poshtë, nuk përbën kusht formimi të shprehjeve frazeologjike apo të frazemave. Ne pajtohemi me Gaatone (1997) i cili e kritikon këtë pikëpamje radikale të Sinclair-it dhe i cili paralajmëron se jo çdo gjë mund të konsiderohet frazeologjike.

Mospërqaftimi i këtij qëndrimi gjithëpërfshirës lidhet me qëllimin e studimit të frazemave nga frazeologjia i cili nuk ka të bëjë vetëm me lidhjen e tyre të veçantë të qëndrueshme sintaksore. Po të studioheshin vetëm për llogari të lidhjes së veçantë sintaksore atëherë s’do të ishte e nevojshme t’i studionte një degë tjetër, si p.sh., frazeologjia, por do t’i studionte vetë sintaksa, sepse, siç thekson Thomai (2006) në lidhje me njësitë frazeologjike të shqipës, ato janë togfjalësha “që kanë lidhje gramatikore të njëjta me togfjalëshat e lirë (përcaktuese, objektore, rrethanore, etj.)”, pavarësisht se “te njësitë frazeologjike lidhjet sintaksore nuk janë gjithnjë aq të qarta sa te togjet e lira të fjalëve”.

Studimi i frazemave nga një degë e veçantë siç është frazeologjia bëhet për arsye të kuptimit të mbartur (të ri) të të gjithë lidhjes të veçantë të qëndrueshme apo të të paktën njërit prej përbërësve të lidhjes së qëndrueshme, por të kushtëzuar dhe të kufizuar brenda kësaj lidhjeje. Kjo ka qenë edhe arsyeja që frazemat fillimisht janë studiuar në fushën e leksikologjisë dhe konkretisht nga Bréal (1897) për aspektin e tyre semantik dhe nga Bally (1909) për aspektin e tyre stilistikor. Sipas Bally (1909, i cituar te Symeonidis, 2000) “thelbi i frazeologjizmit qëndron në natyrën e tij semantike”.

Për këtë arsye, frazeologjia jonë në kuptimin e gjerë, jo vetëm që nuk konsideron si të qëndrueshme lidhjet që mbështeten në shpeshtësinë e bashkëpërdorimit të fjalëve¹², por nuk konsideron si frazeologjike as të gjitha lidhjet e qëndrueshme, si p.sh. *pus artezian*, *macja mjaullin*, *zjarr bubulak*¹³ pavarësisht se lidhja asociative unike e fjalës *artezian* e kufizuar vetëm me fjalën *pus* te *pus artezian* nuk ndryshon nga ajo e fjalës *bretku* që kufizohet vetëm me fjalën *bie* te

¹⁰ Moon, R. (1998). vep. e cit.

¹¹ Sinclair, J. (2008). The phrase, the whole phrase, and nothing but the phrase. Granger, S. & Meunier, F. *Phraseology -An interdisciplinary perspective*. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia.

¹² Sinclair, J. (1991). *Corpus, Concordance, Collocation*. Oxford: Oxford University Press.

¹³ Mel’čuk, I. (1998). *Collocations and Lexical Functions*. In: A.P. Cowie (ed.), *Phraseology. Theory, Analysis, and Applications*, Oxford: Clarendon Press.

idioma¹⁴ *më bie bretku*, por vetëm ato lidhje të qëndrueshme që lidhen me një kuptim të mbartur (të ri) i cili përbën edhe thelbin e frazemës.

Në bazë të kushtit të vlerës së fjalisë dhe të kriterit të mbartjes kuptimore që ne propozojmë për frazeologjinë shqipe në kuptimin e gjerë, kjo frazeologji nuk studion vetëm njësitë shumëfjalëshe më të ngurosurat dhe më opake¹⁵, por mbulon një gamë më të gjerë njësisish, disa prej të cilave paraqesin një shkallë të lartë ndryshueshmërie gramatikore dhe kompozicionaliteti semantik. Flitet jo vetëm për proverbat dhe formulat frazeologjike të bashkëbisedimit, por edhe për kolokacionet e kufizuara frazeologjike¹⁶, madje edhe për binomet e pakthyeshme frazeologjike, lokucionet gramatikore, frazeotermat, si p.sh., *gënjeshtra i ka këmbët të shkurtra, qesh më mirë kush qesh i fundit, dyllë i verdhë, mjaltë i ëmbël, shëndoshë e mirë, mirë e bukur, në drejtim të, duke qenë se, dërrasë e zezë, zorrë e hollë, çelës anglez, thyej rekordin etj.* Për rrjedhojë, frazeologjia në kuptimin e gjerë “përbën një përshkrim adekuat dhe realist të shtrirjes frazeologjike”¹⁷. Shumë nga këto kategori përfshihen edhe në punimet e shumë frazeologëve të shquar të kohës, si p.sh., te Burger, 1998; Gläser, 1986a; Fiedler, 2007; Moon, 1998; Symeonidis, 2000 etj. Në bazë të konceptimit të frazeologjisë në kuptimin e gjerë, konstatojmë se frazeologjia përbën një kontinuum përgjatë të cilit kombinimet e fjalëve vendosen nga më opaket dhe më të ngurosurat nga një anë deri te më transparentet dhe më të ndryshueshmet në anën tjetër¹⁸.

1. 5. Kolokacionet e kufizuara frazeologjike si pjesë e frazeologjisë në kuptimin e gjerë

Këtu është momenti për të përmendur edhe një çështje tjetër, kolokacionet e kufizuara frazeologjike të cilat do të trajtohen më tej gjerësisht si kategori e veçantë frazeologjike. Përfshirja apo jo e kolokacioneve në frazeologji përbën pikën më të dobët dhe më të diskutueshme për të dy llojet e frazeologjive.

Sanksionimi i moskompozicionalitetit dhe sidomos i barasvlershmërisë me fjalën si tipare qendrore të frazeologjisë, ka bërë që frazeologjia në kuptimin e ngushtë ta përqendrojë vëmendjen te idiomat, ndërsa frazeologjia në kuptimin e gjerë te proverbat në kurriz të këtyre kombinimeve më të ndryshueshme të cilat, meqë konsiderohen si më pak “qendrore”, kanë tendencë të trajtohen më pak.

Këto struktura, të konsideruara si periferike apo të lëna jashtë kufijve të frazeologjisë nga autorë të ndryshëm, qoftë të frazeologjisë në kuptimin e ngushtë, si p.sh., nga Smirnitsky, 1995; Thomai, 1981 ose nga autorë të frazeologjisë në kuptimin e gjerë, si p.sh., nga Alexander, 1978, po përfshihen gjithnjë e më shumë në vëllimin frazeologjik të autorëve si Vinogradov, Cowie, Moon, Granger, Burger etj.

¹⁴ Termi *idiomë* është termi i përdorur nga ne në vend të termit njësi frazeologjike si një nga kategoritë e frazeologjisë në kuptimin e gjerë. Krahas termit *idiomë* dhe si sinonim të përafërt me të ne përdorim edhe termin njësi frazeologjike për t’iu referuar përdorimit nga autorë të ndryshëm ose përdorimit të deritanishëm në gjuhë. Për më tepër, shih në kreun e kategorisë së idiomave.

¹⁵ Granger, S. & Paquot, M. (2008). vep. e cit.

¹⁶ Cowie, A. P. (1981). The treatment of collocations and idioms in learners’ dictionaries. Applied Linguistics 2(3).

¹⁷ Häcki-Buhof, A. (2007). Psycholinguistic aspects of phraseology: European tradition Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) Phraseology: An International Handbook of Contemporary Research, vols 1 & 2. Berlin: Mouton de Gruyter.

¹⁸ Cowie, A. P. (1981). vep. e cit.

Në varësi të përfshirjes apo jo të kolokacioneve të kufizuara në frazeologjinë në kuptimin e ngushtë, mund të themi se lidhjet e qëndrueshme të kësaj frazeologjie lëvizin nga vlera e fjalës (shih Smirnotsky, Thomai) deri te vlera e sintagmës (shih Vinogradov), ndërsa frazeologjia në kuptimin e gjerë në shumicën e rasteve i përfshin të dyja llojet e lidhjeve të mësipërme, por, përveç tyre, përfshin edhe lidhjet e qëndrueshme me vlerë fjalie që janë objekt i studimit të saj par excellence.

KREU II

STRUKTURA SHUMËFJALËSHE E OBJEKTIT TË FRAZELOGJISË NË KUPTIMIN E GJERË

Struktura shumëfjalëshe e objektit të studimit të frazeologjisë në kuptimin e gjerë, dmth., e frazemave, janë sintagma dhe fjali, si p.sh., *pemë pa kokrra, i hurit dhe i litarit, fut hundët, ngul këmbë, ku ha pula strall, qesh më mirë kush qesh i fundit, kush i bën gropën shokut bie vetë brenda etj.*

2.1. Frazema me strukturë sintagme

2.1.1. Sintagma kundrejt togfjalëshit

Para se të flasim për sintagmën (e qëndrueshme), duhet të dallojmë sintagmën nga togfjalëshi. Për sa i përket njësive shumëfjalëshe që studion frazeologjia, në frazeologjinë shqipe deri më sot ato njihen me emrin togfjalësha (të qëndrueshëm) dhe në përbërjen e tyre ka të paktën dy fjalë shënuese¹⁹. Kështu, në tekstin “Leksikologjia e gjuhës shqipe” (2006), theksohet se “njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, që riprodhohet e funksionon në ligjërim si njësi e gatshme dhe e pandashme”, ndërsa në “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999) theksohet se “në fushën e shqipes si tipare të përgjithshme të njësisë frazeologjike janë njohur struktura togfjalëshore, njësia kuptimore, qëndrueshmëria, figurshmëria, neutralizimi i raporteve të brendshme sintaksore, njëvlerësia me fjalën nga ana e kuptimit kategorial dhe e funksionit në ligjërim”.

Edhe S. Floqi (1968), kur pohon se “togfjalëshet e qëndrueshme, frazeologjike, si ekuivalente të një fjale të vetme, [.....] nuk studiohen nga sintaksa, por nga leksikologjia (më saktë nga frazeologjia)”, pranon, me të drejtë, se frazeologjia studion togfjalëshat e qëndrueshëm, por e ngushton vëllimin frazeologjik të togfjalëshave të qëndrueshëm vetëm në ata që janë të barasvlerëshëm me një fjalë të vetme.

Deri më sot modeli strukturor me të cilin operojnë gjuhëtarët shqiptarë në frazeologji, dhe jo vetëm në frazeologji, është togfjalëshi me të paktën dy fjalë shënuese.

A është struktura togfjalëshore e mjaftueshme për identifikimin e njësive shumëfjalëshe me natyrë frazeologjike? Cili është dallimi midis togfjalëshit dhe sintagmës? A duhet përdorur termi sintagmë në vend të termit togfjalësh? Këto janë disa prej pyetjeve të cilave do t’u përgjigjemi në vijim të punimit tonë.

Termi gjuhësor togfjalësh është krijuar për t’iu përgjigjur termave të ndryshëm gjuhësorë të huaj midis të cilëve edhe termi “syntagme” (sintagmë) të Saussure-it²⁰, por përbërja nocionore që i është dhënë është e ndryshme nga ajo e sintagmës. Për rrjedhojë, për lidhjen, grupin apo kombinimin e fjalëve shqipja rezulton me dy terma gjuhësorë, por me përmbajtje të ndryshme.

¹⁹ Floqi, S. (1968). Cështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme, Studime filologjike nr.1, Tiranë.

²⁰ Floqi, S. (1968). vep. e cit.

Çështja e nocionit të togfjalëshit paraqet dy aspekte: aspekti i parë lidhet me sasinë minimale të fjalëve ndërsa aspekti i dytë lidhet me llojin e fjalëve që e përbëjnë. Ai përbëhet së paku prej dy fjalësh, por jo prej fjalësh çfarëdo, por prej dy fjalësh shënuese²¹. Për sasinë e fjalëve të gjithë studiuesit shqiptarë deri vonë kanë qenë të mendimit se togfjalëshi është njësi sintaksore që karakterizohet nga “dygjymtyrësja”²². H. Agani (1975) e kundërshton dygjymtyrësinë duke i hapur rrugë kështu teorisë së sintagmës për të cilën Th. Dhima (2007) thekson se “nuk ka sasi të caktuar fjalësh që përbëjnë vëllimin e saj”. Për rrjedhojë, sintagma mund të jetë një- apo shumëgjymtyrëshe dhe në përbërjen e saj mund të përfshihen si përbërës edhe përemrat, numërorët dhe parafjalët edhe pse nuk janë fjalë shënuese.

2 .1. 2. Rëndësia e sintagmës në sintaksë

Për rëndësinë e sintagmës në sintaksë do t’u referohemi vlerësimeve të Th. Dhimes (2007) i cili thekson se “analiza në sintagma zbulon vendosjen hierarkike të fjalëve në mënyrë më të hollësishme, më të qartë, duke zbuluar kombinimet reale të mundshme të tyre...”, ndërsa për ndërtimet parafjalore ai thekson se “... janë struktura të dallueshme që hyjnë brenda strukturave të tjera më të zgjeruara dhe që kryejnë një funksion sintaksor”, sepse parafjalët “në çdo rast kanë kuptim, i cili mund të jetë herë më i dalluar e konkret, herë më i përgjithshëm e abstrakt”.

2 .1. 3. Rëndësia e sintagmës në frazeologji

Qëndrimet e reja në lidhje me sintagmën si njësi sintaksore minimale janë me interes edhe për fushën e frazeologjisë. Në këtë kuadër, përqafojmë teorinë e sintagmës së qëndrueshme për strukturën shumëfjalëshe mbi të cilën duhet të bazohet frazeologjia, meqenëse ajo është më përfshirëse se struktura togfjalëshore. Rëndësinë e sintagmës në hulumtimet tona frazeologjike e shohim në zbulimin e shumë rasteve të tjera njësisht shumëfjalëshe të qëndrueshme, si p.sh., *në tym, me spec, me bisht etj.* të shprehura me sintagmë parafjalore ose *e piu, e qau, i dhashë një (në kokë) etj.* të shprehura me sintagma njëri përbërës i së cilave është përemër ose numëror dhe që duhen pranuar si njësi frazeologjike.

Rëndësinë e sintagmës e shohim edhe në justifikimin e disa rasteve që pranohen si njësi frazeologjike, si p.sh., njësitë frazeologjike *vret e pret, varg e vistër, zhyt e mbyt, keq e keq, flakë e flakë etj.* të cilat shprehen me marrëdhënie bashkërenditëse dhe të cilat, për rrjedhojë, nuk justifikohen me teorinë e togfjalëshit i cili përkufizohet si lidhje nënrenditëse fjalësh emërtuese²³.

Edhe njësitë frazeologjike, si p.sh., *me kuç e me maç, fol e qesh etj.* nuk mund të justifikohen me teorinë e togfjalëshit, sepse ato shprehen jo vetëm me marrëdhënie bashkërenditëse, por edhe me sintagmë parafjalore, pra me dy sintagma paralele dhe jo me togfjalësh.

Edhe rastet (*u zhduk) sa hap a mbyll sytë, (bërtet) me sa ka në kokë etj.* shpjegohen më saktë me teorinë e sintagmës (foljore) sesa si strukturë fjalie.

²¹ Floqi, S. (1968). vep. e cit.

²² Përnaska, R. (1972). Diketim për kumtesën e S. Floqit, Studime filologjike nr.1, Tiranë.

²³ Memushi, R. (2004). Hyrje në gjuhësi. Dituria, Tiranë.

Teoria e sintagmës kontribuon edhe në njohjen e lokucioneve gramatikore si njësi shumëfjalëshe me natyrë frazeologjike si rezultat i strukturës shumëfjalëshe sintagmore dhe i kufizimit leksikor, si p.sh., *në drejtim të, duke qenë se etj.*

2.1.4. Sintagmat e qëndrueshme dhe kushtet e formimit të tyre

Për të kuptuar se çfarë është sintagma e qëndrueshme duhet të kuptojmë se çfarë është sintagma e lirë. Sintagma e lirë është një bashkim fjalësh i cili “...shpërbëhet menjëherë pas formimit dhe fjalët që e përbëjnë rifitojnë lirinë e tyre për t’u grupuar ndryshe”²⁴, në një numër pothuajse të pakufizuar lidhjesh të tjera me kuptimin që janë përdorur brenda kësaj lidhjeje. Janë kombinime, si p.sh., *një veprim i mirë*, përbërësi *veprim* i të cilit mund të kombinohet me të njëjtin kuptim edhe jashtë kësaj lidhjeje me elemente të tjera të gjuhës që përputhen me natyrën e kësaj kategorie si dhe mund të zëvendësohet me elemente të tjera të së njëjtës kategori në mënyrë pothuajse të pakufizuar me kushtin e përputhjes gramatikore dhe të përputhjes semantike për të krijuar fjali të sakta nga pikëpamja semantike dhe pragmatike, si p.sh., *një veprim i keq/ i drejtë/ i menduar/ i kritikueshëm/ i çiltër/ i djallëzuar; kryej/ shpjegoj/ shpreh/ shënoj një veprim; veprim që synon/ që shpreh/ që bie ndesh me; veprim prej kapadaiu, prej budallai, prej rrugaçi, prej modernisti; ose përbërësi i mirë*, si p.sh., *djalë/ vajzë/ fëmijë/ nxënës/lajm/ rezultat i mirë; është/ duket/ u bë i mirë; shumë/ mjaft/ goxha i mirë etj.*, por jo **një veprim i pijshëm* apo **një veprimesh të drejtë*. Në këto grupe fjalësh, secili prej përbërësve përzgjidhet në mënyrë të pavarur njëri nga tjetri. Sintagmat e lira formohen në momentin e të folurit dhe varen vetëm nga ideja që folësi kërkon të shprehë.

Por disa fjalë nuk përzgjidhen në mënyrë të pavarur njëra nga tjetra në çastin e ligjërit, por hyjnë në ligjërim vetëm në përbërje të një strukture të dhënë dhe, për rrjedhojë, struktura nuk mund të shpërbëhet dhe fjalët që e përbëjnë nuk rifitojnë lirinë e tyre për t’u grupuar ndryshe²⁵. Këto kombinime fjalësh hyjnë në ligjërim si njësi të gatshme dhe quhen sintagma të qëndrueshme. Në sintagmat e qëndrueshme të paktën një përbërës zgjidhet në mënyrë të varur dhe në funksion të përbërësit tjetër dhe lidhet vetëm me këtë përbërës apo me shumë pak fjalë të tjera, si p.sh., *i mbush mendjen dikujt, vras mendjen, jetë qeni, mjaltë i ëmbël, thyej rekordin, kthej krahët/shpinën etj.* Në këtë mënyrë, të paktën një nga përbërësit e sintagmës kufizohet vetëm brenda kësaj apo shumë pak lidhjesh dhe sintagma e qëndrueshme përbën kontekst (kuazi-)unik. Sintagmat e qëndrueshme nuk krijohen kurrë në momentin e të folurit, ato riprodhohen si të tilla në mënyrë tërësore. Në sintagmat e qëndrueshme “lidhja midis mendimit dhe faktit gjuhësor mbetet e gdhendur në kujtesë dhe tenton të riprodhohet në ligjërim”²⁶.

2.2. Frazema me strukturë fjalie

A janë vetëm sintagma të qëndrueshme të gjitha njësitë shumëfjalëshe të qëndrueshme ku mbështetet frazeologjia? Jo. Njësitë shumëfjalëshe të qëndrueshme të gjuhës nuk janë vetëm sintagma të qëndrueshme (emërore, mbiemërore, parafjalore, foljore), por edhe fjali të qëndrueshme (shih Thomai, 1981; V.Bardosi, 1999; Gazdiç-

²⁴ Bally, Ch. (1909). *Traité de stylistique française*. Paris : Klincksieck.

²⁵ Bally, Ch. (1909). vep. e cit.

²⁶ Bally, Ch. (1909). vep. e cit.

Aleriç, 2009) me strukturë dykryegjymtyrëshe me kryefjalë të detyruar (shkurt, fjali të qëndrueshme). Pra, do të quajmë strukturë fjalie atë strukturë shumëfjalëshe që përmban kallëzues dhe kryefjalë njëkohësisht, si p.sh., *ashtu i do mushka drutë, ku ha pula gurë, ç'i sheh syri ia bën dora*, ndërsa struktura shumëfjalëshe vetëm me kallëzues do të përbëjë sintagmë foljore të kallëzuesit, sipas ndarjes së parë të fjalisë në sintagmë emërore dhe në sintagmë foljore.

Fjalitë e qëndrueshme me strukturë dykryegjymtyrëshe me kryefjalë të detyruar është “një grup fjalësh që përbën një njësi gramatikore e cila përmban kryefjalë edhe folje në formë të shtjelluar”²⁷ me kryefjalët detyruar, ndërkohë që sintagma e qëndrueshme nuk ka strukturë kryefjalë-kallëzues me kryefjalë të detyruar.

Në gjuhën shqipe fjalitë e qëndrueshme e gjejmë në tre tipa fjalish:

Në fjali të thjeshtë, si p.sh., *ashtu i do mushka drutë, i ka pjellë lopa, i pjell edhe këndesi, më polli belaja (me dikë)*.

Në fjali të varur, si p.sh., *ku ha pula gurë, kur të pjellë mushka, kur të hipë gomari në fik, sa të hajë dreqi*.

Në periudhë me dy sintagma foljore, si p.sh., *ç'i sheh syri ia bën dora*.

Këtu është momenti për të (ri)theksuar se ajo që e dallon frazeologjinë në kuptimin e gjerë nga frazeologjia në kuptimin e ngushtë nuk është struktura e lidhjeve të qëndrueshme, por vlera e këtyre strukturave.

²⁷ Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics, (2002). Person Education.

KREU III NGUROSJA DHE KRITERET E NGUROSJES

3. 1. Ngurosja si dukuri bazë e frazeologjisë

Dukuria bazë me të cilën frazeologjia është e lidhur pazgjidhshmërisht është ngurosja, dmth., pamundësia referenciale e përbërësve, pamundësia apo reduktimi i ndjeshëm i mundësive të zëvendësimit të fjalëve në aksin paradigmatic, të ndryshimit të trajtave të tyre morfologjike, të modifikimit të tyre, të transformimeve sintaksore etj.

Saussure (1916) është nga gjuhëtarët e parë që përdor konceptin e ngurosjes gjuhësore: “Në fillim hasim një numër të madh shprehjesh që i takojnë gjuhës; janë lokucione të gatshme të cilave përdorimi nuk u lejon të ndryshojnë asgjë. [.....] Karakteri i tyre i zakonshëm del nga veçoritë e kuptimit ose të sintaksës së tyre. Këto shprehje nuk mund të improvizohen, ato ofrohen nga tradita”, shkruan autori.

Duke trajtuar dukurinë e ngurosjes, Jespersen (1924) dallon dy parime në gjuhë: lirinë e lidhjeve të lira dhe ngurosjen.

Ngurosja është një dukuri gjuhësore komplekse dhe, për këtë arsye, prej kohësh është konsideruar si çrregullsi në gjuhë, madje edhe si “ves i gjuhës”²⁸, gjë që i ka dhënë një karakter anësor në gjuhë. Megjithatë, M. Gross (1985) ka treguar në punimet e tij se nga pikëpamja statistikore këto ndjenja të çrregullsisë dhe të përjashtimit nuk justifikohen. M. Gross thekson se “të mos njohësh këto struktura do të thotë të mos njohësh një pjesë të mirë të gjuhës”. Edhe Weinrich (1969) u ka kushtuar një rëndësi të veçantë këtyre strukturave. Në lidhje me ngurosjen, ai thekson: “Ajo që për një kohë të gjatë është konsideruar si një dukuri anësore, si një seri përjashtimesh, në fakt zbulohet si karakteristikë e gjuhëve natyrore të njerëzve”. Kjo provohet edhe në gjuhën shqipe në të cilën ekzistojnë rreth 12.000 idioma²⁹ dhe rreth 14.000 proverba³⁰.

Kërkuesit që studiojnë ngurosjen kanë rënë në një konsensus në lidhje me disa pika. Kështu, ata bien dakord se ngurosja përbën një dukuri qendrore të gjuhës (M. Gross, 1988; Hausmann, 1997; Klein, 2007). Një pikë tjetër unanime për specialistët është se ngurosja përbën një dukuri polifaktoriale, komplekse. Kështu, në shprehjet e ngurosura të gjuhës dallojmë karakteristika të ndryshme, si p.sh., pamundësinë referenciale të përbërësve apo të strukturës, moskompozicionalitetin semantik, figurshmërinë, kufizimin leksikor, kufizimin gramatikor, gjurmë të gramatikës arkaike, pamundësinë e përkthimit në gjuhë të tjera etj.

Në qoftë se disa shprehje janë më tipike se të tjerat, kjo i detyrohet faktit se veçoritë e ndryshme të ngurosjes kanë një shpërndarje të pabarabartë në tërësinë e shprehjeve. P.sh., kufizimi morfo-sintaksor që prek shumicën e sekuencave të ngurosura, nuk vlen për të gjitha frazemat.

²⁸ Xhuvani, A. (1980 [1921]). Mbi thjeshtësinë e gjuhës. Aleksandër Xhuvani, vepra 1. Tiranë.

²⁹ Thomai, J. (1999). Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe, Shkencë, Tiranë.

³⁰ A.Sh.Sh.(Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë). (1983). Fjalë të urta të popullit shqiptar. Tiranë. Tiranë.

3. 2. Kriteret e ngurosjes

Mbi bazën e këtyre veçorive do të caktojmë kriteret përcaktuese të ngurosjes së frazemave. Kriteret e ngurosjes janë të shumta, por specialistët e fushës vërtiten rreth një serie nocionesh qendrore si: polileksikaliteti, figurshmëria, kufizimi morfo-sintaksor, moskompozicionaliteti, kufizimi leksikor, mosreferencialiteti literal, memorizimi, konvencionalizimi dhe institucionalizimi midis të cilave ne do të veçonim si parësore polileksikalitetin, figurshmërinë, kufizimin morfo-sintaksor, moskompozicionalitetin, kufizimin leksikor dhe mosreferencialitetin literal me të cilat edhe do të operojmë. Ka edhe kritere të tjera ndihmëse, më pak të përgjithshme si: gjurmë të gramatikës së vjetër, pamundësia e përkthimit në gjuhë të tjera, barasvlershmëria me fjalën, leksikalizimi etj.

Le t'i shohim më nga afër kriteret qendrore parësore:

Polileksikaliteti

Kriteri i parë që na jep mundësinë të flasim për ngurosje është kriteri i polileksikalitetit i cili nënkupton qenien e më shumë se një fjale me ekzistencë autonome në gjuhë. Kjo përjashton formimet gjuhësore me parashtesa dhe prapashtesa që lidhen me prejardhjen. Në bazë të këtij kriteri, frazemat mund të përfshijnë një kombinim të shkurtër fjalësh, por edhe një fjali apo fjali të përbëra, si p.sh. *në tym, e hëngri, me një dallëndyshe s'vjen pranvera, qesh më mirë kush qesh i fundit*. Në lidhje me polileksikalitetin, Bally (1909) shkruan se “njësia frazeologjike mund të njihet nga fakti se grupi përbëhet nga shumë fjalë të ndara nëpërmjet shkrimit”.

Figurshmëria

Një nga kriteret që përmendet shpesh është edhe figurshmëria. Siç e shohim në punimin tonë, shumica e shprehjeve të ngurosura janë të figurshme. “Figurshmëria është burimi nëpërmjet të cilit kuptimet e fjalëve ndryshojnë nga kuptimet origjinale, gjë që krijon një mospërputhje midis kuptimit origjinal dhe kuptimit të ri”³¹, si p.sh., te *sy magjik* nuk kemi as kuptimin origjinal literal të fjalës *sy* as kuptimin e fjalës *magjik*, por nëpërmjet pamundësisë së tyre referenciale, nëpërmjet mbartjes së kuptimeve të tyre kemi lindjen e një kuptimi të figurshëm “*vimë në derë që mundëson për të parë nga brenda jashtë*”.

Kufizimi morfo-sintaksor

Ndryshe nga lidhjet e lira të gjuhës, sekuencat e ngurosura karakterizohen nga Kufizimi morfo-sintaksor i cili lidhet me pamundësinë për të ndryshuar fjalët apo ndërtimin e shprehjeve, si p.sh., numrin dhe trajtën e emrave, rendin dhe numrin e përbërësve etj., apo me pamundësinë për të kryer disa transformime, si p.sh., pronominalizimi, pasivizimi, relativizimi etj., si dhe modifikimin e përbërësve.

Moskompozicionaliteti

Tradicionalisht nocioni i gramatikës mbështetet te koncepti i kompozicionalitetit, dmth., se kuptimi i një sekuence është produkt i kuptimeve të elementeve përbërëse. Kështu kuptimi i *Nxënësi lexon një libër* përbëhet nga kombinimi i kuptimeve të fjalëve të ndryshme të thënies. Parimi i kompozicionalitetit

³¹ Charteris-Black, J. (2002). Secondlanguage proficiency: a comparative study of Malay and English. *Applied Linguistics* 23/1.

është quajtur edhe parimi i Frege-es (1982) i cili përgjithësisht konsiderohet si i pari që ka shpallur qartë nocionin modern të kompozicionalitetit. Sipas parimit të kompozicionalitetit, në qoftë se zëvendësojmë një fjalë të thënies me një fjalë me të njëjtën vlerë, e tëra nuk ndryshon.

Ndryshe ndodh me kuptimin e shumë frazemave kuptimi i të cilave nuk mund të rrjedhë nga shuma e kuptimeve të përbërësve. Kjo veçori e frazemave u shkakton shumë probleme nxënësve të gjuhës së huaj, të cilët zakonisht i dinë kuptimet e të gjitha fjalëve të shprehjes p.sh., *kthej krahët*, por nuk janë në gjendje të nxjerrin kuptimin “*braktis*”, sepse shprehja nuk është koduar mbi bazën e kuptimeve literale të përbërësve dhe rrjedhimisht nuk mund të çkodohet mbi bazën e tyre. Në këtë rast flasim për moskompozicionalitet të kuptimit. Në përgjithësi kuptimi i një frazeme është i ndryshëm nga shuma e përbërësve, si p.sh., *i vë kapakun* = “*përfundoj*”, apo më shumë se përbërësit, si p.sh., *zorrë e hollë* = *zorrë* + *e hollë* + *organ*.

Disa struktura gjuhësore mund të kenë dy interpretime: një kompozicional dhe një jokompozicional, si p.sh., *Agroni e ktheu fletën* në interpretimin kompozicional ka kuptimin që Agroni bëri lëvizjen e faqes së librit me dorë, p.sh., për të parë një figurë në faqen tjetër, por në interpretimin jokompozicional shprehja ka kuptimin se Agroni ka tradhtuar. Ky kuptim i fundit nuk mund të nxirret nga kuptimet literale të fjalëve që marrin pjesë në shprehje.

Jokompozicionale mund të konsiderohen edhe disa sekuenca të cilat janë formuar sipas rregullave të vjetra të gramatikës, si p.sh., *marr mësysh, luajti mendsh* ose të cilat përmbajnë fjalë me përdorim unik vetëm në këtë sekuencë, si p.sh., *vë re, i jap dum*.

Një rast i veçantë i moskompozicionalitetit përfshin atë që mund të quhet moskompozicionalitet pragmatik. Sekuenca është e çkodueshme kompozicionalisht, por ka një funksion të veçantë ligjërimit³². Shembuj të këtij lloji të moskompozicionalitetit përfshijnë proverbat literale dhe formulat frazeologjike të bashkëbisedimit, si p.sh., *shoku-shokun ta ndihmojmë në rrezik e në nevojë, natën e mirë etj.*

Kufizimi leksikor

Kriteri i kufizimit leksikor lidhet me të gjitha frazemat e gjuhës dhe nënkupton pamundësinë për të zëvendësuar një fjalë me një fjalë tjetër (kuazi-) sinonime në aksin paradigmatic. Për sa i përket aksit paradigmatic, në lidhjet e lira një element leksikor mund të zëvendësohet nga një tjetër i cili ka të njëjtin kuptim dhe të njëjtin funksion në lidhje me elementet e tjera të strukturës. Kështu, në lidhjen e lirë lexoj *gazetën*, fjalën gazetë mund ta zëvendësojmë dhe në vend të saj mund të vendosim gjithë grupin e shtypit të shkruar dhe jo vetëm fjalën gazetë. Por përbërësit e frazemave nuk mund të zëvendësohen nga fjalë sinonime apo hiperonime në aksin paradigmatic. P.sh., në shprehjen *vajti si cjapi te kasapi*, fjala *cjapi* nuk mund të zëvendësohet nga fjala sinonime *dhia*, as nga hiperonimi *bagëti*.

Kjo nuk mund të ndodhë për tri arsye:

³² Moon, R. (1998). vep. e cit.

Shprehja e re nuk ka kuptim kur një fjalë zëvendësohet me një tjetër, si p.sh., në idiomën *ha fjalët "flas mbyturazi"*, nuk mund të zëvendësojmë fjalën *fjalët* me *llafet* pa humbur kuptimin idiomatik (**ha llafet*)

Shprehja e re nuk përdoret si idiomë, por ka kuptim si strukturë literale, si p.sh., sipas modelit *ia shtyp kokën dikujt*, nuk mund të formohet idiomë tjetër, si p.sh., *i shtyp këmbën dikujt*, por kjo e fundit ka kuptim si strukturë literale.

Shprehja e re merr kuptim tjetër idiomatik, si p.sh., *uli kokën* ka kuptimin idiomatik "*u nënshtrua*", ndërsa shprehja *vari kokën* ku *vari* është sinonim kontekstual i "*uli*", ka një kuptim tjetër idiomatik "*u mërzit*".

Mosreferencialiteti literal apo kuptimi i mbartur i përbërësve ose i strukturës

Një nga kriteret që përmendet më rrallë është mosreferencialiteti literal apo kuptimi i mbartur i përbërësve ose i strukturës të frazemave.

Mosreferencialiteti literal është termi i përdorur për të përshkruar faktin se frazemat karakterizohen nga kuptimi i mbartur i përbërësve, i cili ndryshon nga kuptimi i tyre origjinal literal.

Mosreferencialiteti literal është më i gjerë se kriteri i figurshmërisë dhe i moskompozionalitetit, është, si të thuash, burim i të dyja këtyre kriterëve, si p.sh., te *korr fitore, jetë qeni* kemi kuptim të mbartur të figurshëm, por kompozicional, ndërsa te *dritat e kuqe, tru i vogël*, kemi kuptim të mbartur jo të figurshëm, por edhe jokompozicional.

3. 3. Kriteret e ngurosjes dhe kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme

Ajo që do të vijojë tani është nëse këto gjashtë kriterë përbëjnë kushte të përgjithshme, të nevojshme apo të mjaftueshme, për të përcaktuar gjithë vëllimin frazeologjik të gjuhës shqipe.

Një kriter quhet kusht i nevojshëm që një shprehje të përfshihet në frazema kur është i detyrueshëm për të përcaktuar frazemën në fjalë. Një kriter quhet kusht i mjaftueshëm kur mjafton për të përfshirë një shprehje në kategorinë e frazemave.

Polileksikaliteti

Polileksikaliteti është një kusht i nevojshëm për frazemat, por, përkundrazi, nuk është kusht i mjaftueshëm, sepse shumëfjalëshe janë edhe sintagmat e lira të gjuhës.

Figurshmëria

Është e vërtetë se shumica e frazemave janë të figurshme, por figurshmëria nuk është e nevojshme për të përcaktuar apo për të identifikuar një frazemë, sepse ekzistojnë edhe frazema që nuk janë të figurshme, si p.sh., *rreth e rrotull, natën e mirë, ku hyn dielli nuk hyn mjeku*, ose që e kanë humbur ose e kanë të zbehur figurshmërinë, si p.sh., *kafe turke, çelës anglez*. Figurshmëria nuk përbën as kusht të mjaftueshëm, sepse gjuha e figurshme përdoret edhe jashtë frazemave të gjuhës, si në poema ose në rastet kur fjalë të caktuara përdoren figurativisht në lidhje të pakufizuara, si p.sh., *qëndis (një letër/ një mesazh/ një fjalim/ një artikull/ një pusullë/ një telegram etj)*.

Kufizimi morfo-sintaksor

Kufizimi morfo-sintaksor nuk është i nevojshëm për të përcaktuar një frazemë, sepse nuk karakterizon veçse një tip të caktuar frazemash, si p.sh., *mbylli sytë, mbyll një sy, natën e mirë, duke qenë se*, sepse ka edhe frazema që nuk paraqesin kufizim

morfo-sintaksor, si p.sh., *korr fitore, fshat i thellë, pres ditën e dasmës*. Megjithatë, kufizimi morfo-sintaksor është kusht i mjaftueshëm, sepse të gjitha shprehjet me kufizim morfo-sintaksor janë frazeologjike.

Moskompozicionaliteti

Moskompozicionaliteti nuk është i nevojshëm për të përcaktuar një frazemë, sepse nuk karakterizon veçse një tip të caktuar frazemash, si p.sh., *kthej krahët, vras mendjen, bëj durim, në drejtim të, zorrë e hollë* etj., sepse ka edhe frazema që janë kompozicionale, si p.sh., *korr fitore, vras kohën, jetë qeni*. Megjithatë, kompozicionaliteti është kusht i mjaftueshëm, sepse të gjitha shprehjet me kuptim jokompozicional janë frazeologjike.

Mosreferencialiteti literal

Mosreferencialiteti literal përbën një kusht të nevojshëm për frazemat, sepse të gjitha frazemat përdoren në një kuptim tërësisht apo pjesërisht të mbartur, por, përkundrazi nuk është kusht i mjaftueshëm, sepse shumë sekuenca të ndryshme fjalësh me kuptim të mbartur mund të mos jenë frazema, si metafora të ndryshme që nuk janë konvencionalizuar apo shumë fjalë me kuptim të mbartur të figurshëm që hyjnë në lidhje të pakufizuara, si p.sh., *qëndis (një letër, një pusullë, nja dy fjalë, një mesazh etj.)*.

Kufizimi leksikor

Kufizimi leksikor përbën kusht të nevojshëm, sepse përbërësit e frazemave përdoren në kontekste (kuazi-) unike, ndryshe nga përbërësit e lidhjeve të lira që përdoren në mënyrë të pakufizuar, por, përkundrazi nuk është kusht i mjaftueshëm, sepse në shumë sekuenca fjalësh si *pus artezian, macja mjaullin etj.*, ku kemi kufizim leksikor, nuk kemi ngulosje frazeologjike, sepse nuk ka mbartje të kuptimit.

Midis tyre ka kriteret që kanë vlerë të përgjithshme për të gjitha frazemat, ndërsa disa janë karakteristike për kategori të caktuara frazemash. Nëpërmjet analizës sonë arrijmë në konkluzionin se vetëm kriteret e polileksikalitetit, të kufizimit leksikor dhe të mosreferencialitetit literal përbëjnë kushte të nevojshme kur duam të përcaktojmë të gjitha frazemat, ndërsa kriteret e moskompozicionalitetit dhe të kufizimit morfo-sintaksor përbëjnë kushte të mjaftueshme për të gjitha frazemat. Së fundi mund të themi se kriteret e figurshmërisë, të moskompozicionalitetit dhe të kufizimit morfo-sintaksor përbëjnë edhe kushte të nevojshme për kategori të veçanta frazeologjike, siç do ta shohim analitikisht gjatë studimit të çdo kategorie frazeologjike.

Tabela 3.1. Kriteret dhe kushtet e ngulosjes të frazemave

Kriteret	Kushte të nevojshme	Kushte të mjaftueshme
Polileksikaliteti	+	-
Figurshmëria	-	-
Kufizimi morfo-sintaksor	-	+
Moskompozicionaliteti	-	+
Mosreferencialiteti literal	+	-
Kufizimi leksikor	+	-

3. 4. Shkalla e ngurosjes

Një aspekt tjetër thelbësor i ngurosjes për të cilin ekspertët e fushës bien dakord është karakteri i saj gradual. Ky konkluzion është rrjedhojë e konstatimit se frazemat nuk janë aq të ngurosura sa mendohej³³. Në gjuhë, disa frazema janë më pak të ngurosura, disa janë më shumë, ashtu siç ka edhe frazema plotësisht të ngurosura, si p.sh., *me kuç e me maç, gjallë a vdekur, kur të pjellë mushka, natën e mirë*.

Kjo mungesë ngurosjeje lidhet jo vetëm me aspektin e kufizimit morfo-sintaksor, si p.sh., *korr, fitore, fshat i thellë, brumë i ardhur* ku nuk kemi kufizim morfo-sintaksor, por edhe me aspektin e kufizimit leksikor, si p.sh., *e nxori/ e qiti në shteg, i fërkon krahët/ shpatullat/ shpinën/ kurrizin* si variante sinonimike, si dhe me aspektin e kohezionit semantik, si p.sh., *korr fitore, fshat i thellë, çelës anglez, kafe turke, jetë qeni* ku mbartja e kuptimit është e pjesshme.

Disa janë më pak të ngurosura në një aspekt të caktuar, disa në një aspekt tjetër. Në disa raste mund të shfaqet një apo disa kriteret e caktuara, në të tjerat kriteret të tjera. Idiomat dhe proverbat janë kategoritë kryesore ku shënohet ngurosja më e lartë.

Rastet më të komplikuar janë shprehjet ku ngurosja është më pak e dukshme dhe kjo nuk lidhet me kufirin e sipërm, por me kufirin e poshtëm të ngurosjes, dmth., jo me frazema që nuk i vë në dyshim asnjë, por me shprehjet pak të ngurosura, ato që karakterizohen vetëm nga kompozicionaliteti semantik, si p.sh., *korr, fitore, fshat i thellë, brumë i ardhur*.

Shkalla e ngurosjes do të diskutohet më gjerësisht në kategorinë e veçanta frazeologjike, si p.sh., te idiomat, proverbat etj.

³³ Moon, R. (1998). vep. e cit.

KREU IV

TERMINOLOGJIA DHE NJËSIA BAZË E FRAZELOGJISE NË KUPTIMIN E GJERË

Ashtu si çdo disiplinë edhe frazeologjia ka objektin e saj të studimit. Që nga periudha e themelimit të frazeologjisë deri më sot objekti i saj është emërtuar me terma nga më të ndryshëm. Këtu është vendi për të rikujtuar se edhe vetë frazeologjia është konceptuar herë në kuptimin e ngushtë si tërësi e frazemave të figurshme të gjuhës (Vinogradov, 1947) ose si tërësi e frazemave të barsvlershme me fjalën (Thomai, 1981) dhe herë në kuptimin e gjerë si “tërësi e njësive shumëfjalëshe të qëndrueshme të një gjuhe [...] që shkojnë matanë nivelit të fjalës, por që nuk shkojnë matanë nivelit të fjalisë”³⁴, “një konceptim për të cilin sot bien dakord shumica e studiuesve të frazeologjisë”³⁵.

Çështja e terminologjisë në frazeologji është problematike, sepse frazeologjia është një fushë e re studimi me kontribute nga disiplina të ndryshme.

Kështu, në shqipe termi më i përdorur është njësi frazeologjike (Stefi, 1970; Thomai, 1981 etj.). Përveç tij, janë përdorur edhe terma të tjerë, si p.sh., lokucion (Xhuvani, 1921) apo lokusion (Sheperi, 1927) apo lokusione pavetore (Cipo, 1949) apo lokucione gramatikore (Thomai, 1981), perifrazë (Prifti, 1962), frazë (Xhuvani, 1921), idhiozizëm (Xhuvani, 1921). Përmenden gjithashtu edhe termat: frazeologjizëm, shprehje, shprehje frazeologjike, shprehje e ngurosur, shprehje stereotipa, idiomë, lidhje fjalësh, kombinim fjalësh, grup fjalësh, togfjalësh i qëndrueshëm etj.

Në literaturën angleze termi më i zakonshëm është idiom (idiomë) (Burger, 1998). Termat e tjerë që gjenden në literaturën angleze janë: bound expressions (shprehje të lidhura), set expressions (shprehje të qëndrueshme), prefabricated expressions (shprehje të parafabrikuara), stereotyped expressions (shprehje stereotipa), phraseological units (njësi frazeologjike), phraseologisms (frazeologjizma), lexicalised phrases (sintagma të leksikalizuara), fixed phrases (sintagma të qëndrueshme), fixed expressions (shprehje të ngurosura), conventional collocation (kolokacion konvencional), colligation (koligacion), formulae (formula), irreversible binomial (binome të pakthyeshme), quotation (citate), proverbs (proverba) simile (idioma me strukturë krahasuese), binomials (binome), multi-word units (njësi shumëfjalëshe), multi-word lexemes (leksema shumëfjalëshe), multi-word expressions (shprehje shumëfjalëshe), word combinations (kombinime fjalësh) etj.

Në terminologjinë frënge gjejmë termat phrases idiomaticques (frazë idiomatike), expressions idiomaticques shprehje idiomatike), idiomes (idioma), mots composés (fjalë të përbëra), locutions (lokucione), expressions figees (shprehje të ngurosura), unites phraseologiques (njësi frazeologjike), series phraseologiques (seri frazeologjike), expressions phraséologiques (shprehje frazeologjike), collocations

³⁴ Piirainen, E. (2008). Figurative phraseology and culture. In: Granger, S. & Meunier, F. Phraseology -An interdisciplinary perspective. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia

³⁵ Piirainen, E. (2008). vep. e cit.

(kolokacione), groupe binaire (grupe binare), clichés (klishe), proverbes (proverba), dictons (diktone) etj.

Terma të ndryshëm për njësinë bazë të frazeologjisë përdoren edhe në greqishte, si p.sh., ιδιωτισμοί (idioma) φρασεολογισμοί (frazologjizma), τυποποιημένες εκφράσεις (shprehje standarde), στερεότυπες εκφράσεις (shprehje stereotipa), φράσεις (frazë), συνδυασμός λέξεων (kombinime fjalësh), ένωση λέξεων (lidhje fjalësh), κλισέ (klishe), παροιμιακές φράσεις (frazë proverbiale) etj.

Disa prej tyre përdoren për të emërtuar njësinë bazë të frazeologjisë, si p.sh., lokucione te Bally etj., njësi frazeologjike te Vinogradov, Thomai, Gläser, Burger etj., idioma te Hocket, Makkai etj., kombinime fjalësh te Cowie, Howarth, frazema te Mel'čuk, Granger etj., shprehje të ngurosura te Svensson, Alexander, Moon, Chiotti, apo shprehje stereotipa, njësi shumëfjalësh etj. Terma të tjerë përdoren për të emërtuar kategori të veçanta frazeologjike, si p.sh., idioma opake, perifraza, binome, proverba etj. Por ajo që është për t'u theksuar është fakti se shumica prej atyre që përdoren për të emërtuar njësinë bazë të frazeologjisë, përdoren edhe për të shënuar një kategori të caktuar frazeologjike, si p.sh., idiomat për kategori të veçantë te Cowie, Moon, Svensson, apo njësi frazeologjike për kategori të veçantë te Bally. Disa terma të tjerë përdoren për njësinë bazë edhe në frazeologjinë në kuptimin e ngushtë, edhe në frazeologjinë në kuptimin e gjerë, si p.sh., njësi frazeologjike (ngushtë te Vinogradov, Thomai, por gjerë te Gläser, Burger, Fiedler), frazema (gjerë te Mel'čuk, Granger, por ngushtë te Náráy-Szabó), shprehje të ngurosura (gjerë te, Svensson, Moon, Alexander, por ngushtë te Lamiroy, Chiotti), lokucion (gjerë te Bally, Caws, Leroi, por më ngushtë, vetëm lokucionet gramatikore, te gjuhësia shqiptare).

Termet e mësipërme e kanë prejardhjen nga autorë të ndryshëm dhe nga vende të ndryshme. Cowie (1998a) shpreh keqardhje për këtë situatë dhe për këtë arsye frazeologjinë e quan si “një fushë të ndërlikuar nga bollëku i termave dhe nga përdorimi konfliktues i të njëjtit term”.

Për frazeologjinë shqipe në kuptimin e gjerë të cilën po studiojmë ne propozojmë termin frazemë për arsyet e mëposhtme:

Termin frazemë e propozojmë për analogji me termat e tjerë gjuhësorë fonemë, monemë, morfemë, leksemë etj.

Propozojmë termin frazemë, sepse ai përdoret gjithnjë e më shpesh në literaturën frazeologjike ndërkombëtare. Edhe pse është një term relativisht i ri, termi frazemë po shtrihet gjithnjë e më shumë (shih Burger, 2007; Proost, 2007; Piirainen, 2007; Sabban, 2007).

Për më tepër, po të përdornim termin njësi frazeologjike për frazeologjinë në kuptimin e gjerë, do të ndodhte një hallakatje midis objektit të deritanishëm të studimit të frazeologjisë dhe objektit tonë (të ri), sepse njësitë frazeologjike, siç njihen deri tani në shqipe, karakterizohen kryesisht për barasvlershmërinë e tyre me fjalën nga studiuesit e gjuhës dhe identifikohen me figurshmërinë e tyre nga përdoruesit e thjeshtë të gjuhës, veçori të cilat nuk karakterizojnë detyrimisht frazemat tona.

Së fundi mund të themi se termi frazemë është më i ri dhe me më pak devijime në përdorim.

Por as ky term, edhe pse relativisht më i ri se të tjerët, nuk u ka shpëtuar kuptimeve apo përdorimeve të ndryshme nga frazeologë të ndryshëm. Kështu:

Mel'čuk³⁶ e shikon fillimisht nga pikëpamja e qëndrueshmërisë dhe e quan sintagmë të qëndrueshme.

Taraseviç³⁷ e shikon nga pikëpamja e kompleksitetit semantik dhe e kufizon vetëm në një kategori frazeologjike, në atë të frazeotermave apo togjeve frazeologjike nominale. Sipas saj "Frazemat karakterizohen nga shkalla minimale e kompleksitetit semantik. Veçanësia e këtyre njësive është se ruajnë kuptimin literal të përbërësve të tyre, por struktura si një e tërë ka një element semantik ekstra, të shtuar, i cili i shtohet shumës së kuptimeve të përbërësve, p.sh., *fletët e verdha* që ka kuptimin e shtuar "të një pjese të një libri telefonik".

Te Thomai (1999) termi frazemë na del si përdorim në frazeologji në vend të fjalës strukturë apo si njësi themelore e fjalorit frazeologjik³⁸.

Autorë të tjerë, jo vetëm që e konsiderojnë frazemën si term të përgjithshëm të frazeologjisë, por edhe vetë frazeologjinë e trajtojnë në kuptimin e gjerë. Kështu, sipas Bardosi-t (1999), "Termi frazeologji identifikon pak a shumë qartë në frëngjishte me fushën e gjuhës dhe të gjuhësisë që merret me studimin kompleks të frazemave", ndërsa sipas Burger et al. (2007), frazema "përfshin të gjitha shprehjet e qëndrueshme të një gjuhe, si p.sh., kolokacionet, idiomat, kuaziidiomat, sentencat, shprehjet e rutinës, proverbat".

Bashkohemi me autorët e fundit si në përqaftimin e frazeologjisë në kuptimin e gjerë, ashtu edhe në përqaftimin e frazemës si term të përgjithshëm për frazeologjinë e gjuhës shqipe në kuptimin e gjerë.

Termi frazemë do të mund të përdorej edhe në vend të termit njësi frazeologjike për frazeologjinë në kuptimin e ngushtë.

Pas përzgjedhjes së termit ombrellë për frazeologjinë në kuptimin e gjerë, na del për detyrë të përcaktojmë edhe nënndarjet apo kategoritë e veçanta frazeologjike të cilat do të jenë: idiomat, perifrazat me folje të desemantizuar, frazeotermat, lokucionet gramatikore, binomet e pakthyeshme frazeologjike, proverbat, formulat frazeologjike të bashkëbisedimit dhe kolokacionet e kufizuara frazeologjike, të cilat do të sqarohen në vijim të punimit tonë.

³⁶ Mel'čuk, I. (1998). vep. e cit.

³⁷ Tarasevitch, M. (1991) Soviet phraseology: Problems in the analysis and teaching of idioms. Linguistics and language pedagogy: the state of the art. Georgetown University Press, USA.

³⁸ Thomai, J. (1999). vep. e cit.

KREU V

PËRKUFIZIMI I NJËSISË BAZË DHE I FRAZELOGJISË NË KUPTIMIN E GJERË

Në një shkencë kaq të re të gjuhësisë studiuesit e së cilës ishin jo të shumtë para viteve 60, janë bërë disa tentativa për të përkufizuar dhe “ripërkufizuar” frazeologjinë duke shtuar modifikimet përkatëse.

Studimi ynë mbështetet në një konceptim të gjerë për frazeologjinë. Frazeologjinë ne e kuptojmë si tërësinë e strukturave shumëfjalëshe të gjuhës që shkojnë edhe matanë vlerës së fjalës, por që nuk e kalojnë vlerën e fjalisë (krhs. Piirainen, 2008). Ne bashkohemi me mendimin se “kategoria e gjerë e frazeologjisë përfshin idiomat, kolokacionet, similitë (simile, angl.)³⁹, proverbat dhe formulat e rutinës”⁴⁰ etj., dhe jo vetëm strukturat që janë nën vlerën e fjalisë. Të gjitha këto kombinime kanë veçanësinë semantike të idiomaticitetit, që nënkupton se kuptimi i strukturës nuk mund të nxirret nga shuma e kuptimeve literale të përbërësve.

Tri kushtet e nevojshme për përcaktimin e frazemave për të cilat kemi folur te kriteret e ngurosjes: polileksikaliteti, mosreferencialiteti literal apo kuptimi i mbartur dhe kufizimi leksikor, janë të nevojshme për një përkufizim logjik të frazemes. Në bazë të këtyre kriterëve, frazemat mund t’i përkufizojmë si lidhje shumëfjalëshe (sintagma apo fjali) të qëndrueshme kuptimi i të cilave është i ndryshëm nga shuma e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse ose të cilat karakterizohen nga mbartja e plotë apo e pjesshme e kuptimit.

Për sa i përket përkufizimit të frazeologjisë si fushë e studimit të frazemave, në vijim po japim disa përkufizime të termit frazeologji nëpër fjalorë të ndryshëm:

Në “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954) frazeologjia përkufizohet si tërësia e mënyrave të të folurit dhe të shprehjeve që janë karakteristike të një gjuhe ose të një shkrimtari.

Në “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) frazeologjia përkufizohet si:

1)gjuh. Tërësia e togjeve dhe e tipave a e shprehjeve të qëndrueshme të një gjuhe, të cilat janë të pandashme nga ana leksikore, kanë kuptim tërësor, të njësisishëm, të mëvetësishëm e gjithnjë të figurshëm, riprodhohen në ligjërim si njësi të gatshme dhe kryejnë funksionin e një fjale a të një fjalie të vetme.

2)gjuh. Pjesë e leksikologjisë që studion njësitë e tilla të një gjuhe a të një grupi gjuhësor.

3)keq. Fjalë a shprehje që duken të bukura, por fshehin a shtrembërojnë të vërtetën ose janë të zbrazëta e pa vlerë.

Në OALD (2000) frazeologjia përkufizohet si një mënyrë e veçantë sipas së cilës renditen fjalët dhe sintagmat në të folur apo në të shkruar.

Në LDOCE (2003) frazeologjia përkufizohet si mënyra sipas së cilës zgjidhen fjalët dhe sintagmat në një gjuhë të veçantë.

³⁹ Ky term i korrespondon *idiomave me strukturë krahasuese* të cilat ne i konsiderojmë si pjesë apo nëngrup të idiomave. Për më tepër, shih në kreun e idiomave.

⁴⁰ Pazos Bretaña, J-M. & Pamies Bertrán, A. (2008). Combined statistical and grammatical criteria for the retrieval of phraseological units in an electronic corpus. Granger, S. & Meunier, F. Phraseology - An interdisciplinary perspective. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia.

Në “Nouveau Petit Robert” (2001) frazeologjia përkufizohet si:

1. Tërësi e shprehjeve tipike për një përdorim, një ambient, një epokë, një shkrimtar.

2. Përdorim i fjalive, i fjalëve të mëdha të zbrazura nga kuptimi.

3.gjuh. Tërësi e shprehjeve, lokucioneve, kolokacioneve dhe fjalive të koduara në gjuhën e përgjithshme.

Në “Fjalori i gjuhës së re greke” (Λεξικό της νέας Ελληνικής γλώσσας, gr.) (2002) frazeologjia përkufizohet si strukturat që zgjedh dikush për t’u shprehur, mënyra me të cilën dikush shprehet.

Në “Fjalori i greqishtes së re standarde” (Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής, gr.) (1998) frazeologjia përkufizohet si tërësia e mënyrave sipas të cilave lidhen fjalët, përbëhen sintagmat ose ndërlidhen fjalitë në ligjërim.

Në “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954) gjejmë një kuptim të vetëm për frazeologjinë, atë të “tërësisë së mënyrave të të folurit dhe të shprehjeve që janë karakteristike të një gjuhe ose të një shkrimtari”, dmth., atë të “stilit”, kuptimi i cili nuk figuron në fjalorët pasardhës të shqipes (1980, 1984, 2002), por i cili gjendet dhe përbën kuptim të vetëm në fjalorët e gjuhëve të tjera OALD, LDOCE, Fjalori i gjuhës së re greke, Fjalori i greqishtes së re standarde ose qëndron krahas kuptimeve të tjera në fjalorin e frëngjishtes Nouveau Petit Robert.

Në “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” nuk e gjejmë kuptimin e “Fjalori i gjuhës shqipe”, por gjejmë kuptime të tjera siç është kuptimi që lidhet me lindjen dhe zhvillimin e shkencës së re të frazeologjisë si “tërësia e togjeve dhe e tipave a e shprehjeve të qëndrueshme të një gjuhe, të cilat janë të pandashme nga ana leksikore, kanë kuptim tërësor, të njësisishëm, të mëvetësishëm e gjithnjë të figurshëm, riprodhohen në ligjërim si njësi të gatshme dhe kryejnë funksionin e një fjale a të një fjalie të vetme” apo si studim i këtyre “togjeve”, kuptim i cili figuron edhe në punimet e Nouveau Petit Robert dhe kryesisht në punimet e mirëfillta gjuhësore.

Kështu, sipas Thomait (1981) “frazeologjia është tërësia e atyre bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve, që janë formuar historikisht e janë kristalizuar si njësi të pandashme dhe që nga ana e kuptimit kategorial janë të barasvlershme me fjalë të vetme”.

Sipas Granger & Paquot (2008), frazeologjia mund të përkufizohet me afërsi si “studimi i strukturës, kuptimit dhe përdorimit të kombinimit të fjalëve”⁴¹.

Sipas Arsentyeva (2005), “frazeologjia është dega e gjuhësisë që merret me kombinimet e qëndrueshme të fjalëve, të karakterizuara nga një farë mbartje e kuptimit”.

Përkufizimi për frazeologjinë në kuptimin e gjerë i propozuar nga ne do të jetë:

1)Frazeologjia merret me studimin e frazemave, dmth., të lidhjeve shumëfjalëshe (sintagma apo fjali) të qëndrueshme kuptimi i të cilave është i ndryshëm nga shumica e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse ose të cilat karakterizohen nga mbartja e plotë apo e pjesshme e kuptimit.

⁴¹ Cowie, A. P. (1994). Phraseology. In Asher, R. E. (ed.). The Encyclopedia of Language and Linguistics, Oxford: Oxford University Press.

2)Frazeologjia është tërësia e frazemave apo e shprehjeve të ngurosurat të gjuhës.

KREU XIV TIPOLOGJIA E FRAZEMAVE

Klasifikimi i frazemave nënkupton identifikimin e njësive gjuhësore që paraqesin tipare të përbashkëta, sepse frazeologjia lidhet me entitete shumë heterogjene dhe zakonisht studiuesit i ndajnë ato në entitete më të vogla, në nëntipa relativisht homogjene. Por klasifikimi i frazemave nuk është një ndërmarrje e thjeshtë. Ndryshe nga elementet gjuhësore të niveleve më të ulëta se frazemat, si p.sh., fonemat, morfemat dhe leksemat, që njohin klasifikime themelore të pranuar nga e gjithë bashkësia gjuhësore, grumbulli i frazemave ka nevojë për analiza gjuhësore të thella që të mund të organizohen nëpër kategori.

Në fakt frazemat formojnë një tërësi shumë komplekse dhe shumë pak homogjene dhe është pikërisht kjo pabarazi që e bën klasifikimin e tyre problematik. E thënë ndryshe, vështirësia e klasifikimit të frazemave shikohet shpesh si dëshmia e kompleksitetit të natyrës së tyre.

Para se të paraqesim disa prej klasifikimeve të propozuara nga gjuhëtarët e ndryshëm, do të rikujtojmë se parametrat që përcaktojnë natyrën dhe funksionimin e njësive shumëfjalëshe janë të ndryshme dhe ajo që do të modelojë klasifikimin është prioriteti që i jepet njërit apo shumë prej këtyre parametrave.

Klasifikimi i frazeologjisë në kuptimin e ngushtë lidhet me trajtimin tradicional të frazeologjisë dhe i detyrohet shumë kërkuesve rusë. Në thelb kërkuesit rusë si Vinogradov dhe Amosova janë të pikëpamjes frazeologjike që e kufizon fushën frazeologjike në një nënbashkësi strukturash shumëfjalëshe. Sipas Toffol (2001), midis shumë termave ekzistues për të përshkruar kategorinë e përgjithshme të “njësive me vlerë fjale” apo të “njësive semantike, më të ndërlikuara se fjala”, Vinogradov zgjedh të emërtojë këtë kategori si “njësi frazeologjike” dhe i përkufizon si objektin bazë të frazeologjisë. Që atëherë, njësitë frazeologjike konsiderohen si kategoria më përfshirëse dhe më e gjerë në frazeologjinë ruse. Përveç kësaj ai e shikon frazeologjinë si një kontinuum përgjatë të cilit kombinimet e fjalëve vendosen me më të ngurosurat në njërin anë dhe më transparentet dhe më të ndryshueshmet në anën tjetër. Sipas klasifikimit të Vinogradov-it, njësitë frazeologjike ndahen në tri grupe të mëdha: në shkrirje frazeologjike, në bashkime frazeologjike dhe në kombinime frazeologjike. Vinogradov (1947) ka bërë një dallim midis “shkrirjeve frazeologjike” (të quajtura gjithashtu idioma), “bashkimeve frazeologjike” dhe kombinimeve frazeologjike”. Nënkatëgoria e parë përbëhet nga kombinime që janë të pamotivueshme” (ose semantikisht opake) dhe në përgjithësi të ngurosurat strukturalisht. Përveç shkrirjeve, Vinogradov nje një tip pjesërisht të motivueshëm, kuptimi i të cilit mund të shihet si një shtrirje metaforike e kuptimit origjinal neutral. Kufiri midis bashkimeve dhe shkrirjeve nuk është i prerë qartësisht, por ndryshon sipas përvojës gjuhësore dhe kulturore të individit. Nënkatëgoria e tretë e Vinogradov-it, kombinimet frazeologjike, është grupi më interesant, sepse në praktikë përbën grupin më të vështirë për t’u delimituar. Kombinimet frazeologjike kanë një përbërës të përdorur në kuptim literal, ndërsa përbërësi tjetër (këtu folja) përdoret figurativisht. Megjithatë, duhet theksuar se ky kuptim specifik përcaktohet nga konteksti. Sipas Vinogradov-it, ky kuptim është “i lidhur frazeologjiksht”.

Emërtimin njësi frazeologjike përdor edhe Thomai (1981) për njësinë bazë të frazeologjisë shqipe, por fusha e tij frazeologjike është pak më e kufizuar se ajo e Vinogradov-it. Thomai dallon njësitë frazeologjike të pamotivueshme dhe njësitë frazeologjike të motivueshme dhe brenda këtyre të fundit veçon edhe një nëngrup njësisish frazeologjike të përbërë nga një fjalë me kuptim literal dhe një fjalë me kuptim të figurshëm, nëngrup që i afrohet nënkategorisë së “kombinimeve frazeologjike” vinogradoviane, dmth., kolokacioneve frazeologjike, por në të cilin kuptimi i figurshëm shkon deri në desemantizim, si. p.sh., në *bëj durim*. Këtë nëngrup ne e përfshijmë te kategoria e *perifrazave me folje të desemantizuar*.

Në kuadrin e frazeologjisë së ngushtë vinogradoviane ku objekti i frazeologjisë kufizohet te kategoria e kombinimeve me vlerë fjale, gjejmë edhe këndvështrimin e Cowie-t, Gläser -it, Mel’čuk-ut dhe të Howarth-it për këtë kategori të frazemave. Të përmbledhura dhe të shprehura në një tabelë të përbashkët, këto qëndrime në lidhje me kombinimet me vlerë fjale do t’i paraqisim si më poshtë (krhs. Cowie, 1998):

Tabela 14. 1. Nënkatëgoritë e kombinimesh me vlerë fjale

Autori	Kategoria e përgjithshme	Njësi të pamotivueshme	Njësi pjesërisht të motivueshme	Njësi të lidhura frazeologjike
Vinogradov (1947)	Njësi frazeologjike	Shkrirje frazeologjike	Bashkime frazeologjike	Kombinime frazeologjike
Amosova (1963)	Njësi frazeologjike	Idioma	Idioma (pa dallim)	a)Frazema b)Frazeloide
Thomai (1981)	Njësi frazeologjike	Njësi frazeologjike të pamotivueshme	Njësi frazeologjike të motivueshme	-----
Cowie (1981)	Kompozita	Idioma të pastra	Idioma të figurshme	Kolokacione të kufizuara
Mel’čuk (1988)	Frazema semantike	Idioma	Idioma (pa dallim)	kolokacione
Gläser (1988)	Emërtime	Idioma	Idioma (pa dallim)	Kolokacione të kufizuara
Howarth (1996)	Njësi të përbëra	Idioma të pastra	Idioma të figurshme	Kolokacione të kufizuara

Siç tregohet nga tabela 14. 1., bashku me termin e kategorisë së përgjithshme *njësi frazeologjike*, autorë nga vende të ndryshme, kryesisht perëndimore, përdorin terma të tjerë përgjithësisht të pranuar, si p.sh., kompozita, frazema semantike, emërtime dhe njësi të përbëra.

Shumica e kategorizimeve dhe modifikimeve postvinogradoviane lidhen me frazeologjinë në kuptimin e gjerë, sepse njohin një dallim qendror midis “njësive me vlerë fjale” të cilat funksionojnë sintaktikisht nën nivelin e fjalisë dhe “njësive me vlerë fjalie” të cilat funksionojnë në nivel fjalie.

Edhe këtë dallim midis njësive me vlerë fjale të cilat funksionojnë nën nivelin e fjalisë dhe njësive me vlerë fjalie të parët e bënë Rusët. “ Një nga frazeologjet e para ruse cila iu referua këtij dallimi është Chernuisheva (1964) njësitë me vlerë fjalie (të quajtura “shprehje frazeologjike”) të së cilës përfshinin thënie dhe citate familjare”⁴². Disa studiues postvinogradovianë mendojnë se proverbat duhet të studiohen së bashku me njësitë frazeologjike. Disa të tjerë, midis të tjerëve edhe J. Casares (1950), N. N. Amosova (1963), J. Thomai (1981) etj mendojnë se në qoftë se njësitë që nuk përbëjnë pjesë të fjalisë është e gabuar të përfshihen në sistemin e gjuhës, sepse janë njësi të pavarura të komunikimit.

Dallimi i mësipërm u njoh dhe u ndoq nga specialistët e fushës, si p.sh., Cowie (1988), Mel’čuk (1988), Gläser (1988) dhe Burger (1988) dhe më vonë nga Granger & Paquot (2008) etj.

Cowie (1988) dallon “kompozitat” nga “formulat” – një kategorizim që ecën krahas traditës ruse- të parat si kombinime fjalësh nën nivelin e fjalisë dhe të dytat si kombinime fjalësh në nivel fjalie. Të parat Cowie i ndan më tej në:

a)Idioma të pastra të cilat janë plotësisht opake dhe të pandryshueshme.

b)Idioma të figurshme të cilat janë pak të ndryshueshme dhe kanë një interpretim të figurshëm dhe një interpretim literal.

c)Kolokacione të kufizuara të cilat kanë një përbërës literal dhe një përbërës të figurshëm i cili është i kufizuar brenda kësaj lidhjeje.

Më vonë Cowie (2001) e ndan kategorinë e formulave në formula të rutinës, si p.sh., *ditën e mirë* etj. të cilat kryejnë funksione në aktin e të folurit, dhe në formula të të folurit, si p.sh., *e kupton ç’dua të them* etj. të cilat përdoren për të organizuar mesazhet dhe për të treguar qëndrimet e folësve.

Duke ndjekur modelin e klasifikimit rus postvinogradovian, edhe Mel’čuk (1988) dallon njësitë nën nivel fjalie dhe njësitë në nivel fjalie.

Njësitë nën nivelin e fjalisë Mel’čuk i emërton frazema semantike dhe i ndan në tri nëngrupe: në idioma, në kuazi-idioma apo kuazi-frazema dhe në kolokacione apo gjysmë-frazema, ndërsa njësitë në nivel fjalie i quan frazema pragmatike apo pragmatema të cilat janë shumë afër formulave të Cowie-t.

Një klasifikim tjetër i njohur është ai i Gläser-it (1988) e cila, duke ndjekur traditën ruse, e bazon tipologjinë e saj të njësive frazeologjike në dallimin midis njësive të tipit fjalë dhe njësive të tipit fjali. Njësitë me vlerë fjale ajo i përkufizon si “*emërtime*”, sepse tregojnë një dukuri, një objekt, një veprim, një proces ose një gjendje, një tipar apo një marrëdhënie në botën e jashtme. Njësitë me vlerë fjalie ajo i përkufizon si “*fjalë*”, sepse tregojnë një gjendje të plotë në botën e jashtme.

Gläser ka studiuar frazeologjinë duke e bazuar klasifikimin e saj në nocionin e “qendrës” dhe të “periferisë”.

Qendra përfshin njësitë frazeologjike që funksionojnë si fjalë të thjeshta si emra, si p.sh., *blind alley (rrugë qorre)*, folje, si p.sh., *make assumptions (bëj supozime)* etj; fjalë gramatikore që tregojnë lidhje midis dukurive apo objekteve (parafjalë, si p.sh.,

⁴² Cowie, A. P. (1998). vep. e cit.

in terms of (nga pikëpamja e); lidhëze, si p.sh., in order to (me qëllim që) si dhe disa njësi bileksemike, si p.sh., blanket cover (lit. mbulesë krevati).

Zona kalimtare përfshin binomet e pakthyeshme, similitë, aludimet letrare, kolokacionet etj.

Zona periferike përfshin proverbat, truizmat, maksimat, citatet, sloganet dhe formulat e rutinës.

Të përmbledhura dhe të shprehura në një tabelë të përbashkët, këto qëndrime do t'i paraqesim si më poshtë (krhs. Cowie, 1998).

Tabela 14. 2. Termat e përdorur për kombinimet me vlerë fjale dhe me vlerë fjalie.

Autori	Kategoria e përgjithshme	Njësi me vlerë fjale	Njësi me vlerë fjalie
Mel'čuk (1988)	Frazema	Frazema semantike	Frazema pragmatike (apo pragmatema)
Gläser (1988)	Njësi frazeologjike	Emërtime	Fjali
Cowie (1988)	Kombinim fjalësh	Kompozita	Formula

Burger dhe Granger & Paquot krijojnë një kategori të tretë strukturash frazeologjike, por që nuk e ndryshojnë ndarjen mbi bazën e vlerës së fjalës apo të fjalisë.

Kështu, ndryshe nga tipologjitë e Cowie-t dhe të Mel'čuk-ut, tipologjia e Burger-it (1998) bazohet kryesisht në funksionin e njësive frazeologjike në ligjërim. Nënndarja e strukturave të tij frazeologjike dallon tri kategoritë funksionale të mëposhtme: njësitë referenciale, njësitë komunikative dhe njësitë strukturore.

Njësitë frazeologjike referenciale ndahen në dy nënkategori sipas kriterit sintakso-semantik.

E para janë njësitë frazeologjike emërtuese të cilat janë përbërës të fjalisë dhe të cilat u referohen objekteve, dukurive ose fakteve të jetës. Kjo kategori i korrespondon gjerësisht “kompozitave” të Cowie-t dhe “emërtimeve” të Gläser-it. Duke ndjekur traditën ruse dhe frazeologët si Cowie dhe Mel'čuk, njësitë frazeologjike emërtuese ndahen në idioma, idioma të pjesshme dhe në kolokacione.

E dyta janë njësitë frazeologjike fjali të cilat funksionojnë në nivel fjalie. Ato i referohen një thënieje dhe përfshijnë proverbat etj.

Njësitë frazeologjike komunikative përfshijnë formulat e rutinës dhe kryejnë një funksion ndërveprues: karakteristikë e tyre është të nisin, të mbajnë dhe të mbyllin bashkëbisedimin ose të tregojnë qëndrimin e folësit.

Njësitë frazeologjike strukturore përfshijnë kombinime fjalësh që vendosin lidhje gramatikore, si p.sh., *Bezug auf* (për sa i përket) dhe *sowohl ... als auch* (si edhe). Megjithatë, njësitë frazeologjike strukturore autori i konsideron si kategorinë më të vogël dhe më pak interesante dhe nuk jep më shumë hollësi.

Edhe Granger & Paquot (2008) propozojnë një version të zgjeruar të klasifikimit të Burger-it. Autorët i ndajnë frazemat në tri kategori të mëdha: në frazemat referenciale, në frazemat textore (një shtrirje e kategorisë së frazemave strukturore të Burger-it) dhe në frazema komunikative.

Frazemat referenciale përdoren për të përcjellë një mesazh me përmbajtje dhe u referohen objekteve, dukurive apo fakteve nga bota e jashtme. Autorët përfshijnë kolokacione leksikore dhe gramatikore, idioma, simili, binome të pakthyeshme frazeologjike, fjalë të përbëra dhe folje frazale.

Frazemat tekstore përdoren për të strukturuar dhe organizuar kontekstin e një teksti ose çdo lloj ligjërimi dhe përfshijnë parafjalë komplekse, lidhëze komplekse, ndajfolje lidhëzore etj

Frazemat komunikative përdoren për të shprehur ndjenjat, për t'iu drejtuar qartë bashkëfolësit, për t'i tërhequr vëmendjen ose për të ndikuar mbi të. Ato përfshijnë formulat e aktit të ligjërimin, proverbat, sloganet etj.

Mund të konkludojmë se ka klasifikime të shumta dhe të ndryshme të frazemave (në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë), të cilat bazohen në kriteret e ndryshme. Sipas Toffol (2001), në përgjithësi, shumica e përpjekjeve klasifikuese rezultojnë nga një perspektivë e gjerë e frazeologjisë dhe i ndajnë frazemat në dy grupime të mëdha, njësi me vlerë fjale që janë ato njësi që mund të zëvendësohen nga një fjalë e vetme, dhe njësi me vlerë fjalie që janë ato njësi që kanë nevojë për një fjali të tërë për t'u zëvendësuar.

Autorët e përfshirë në tabelat e mësipërme si Cowie, Mel'čuk, Gläser, Burger, Granger, por edhe të tjerë duke filluar që nga Bally, Vinogradov, e duke vazhduar me Svensson, Moon etj flasin edhe për njësi që në fakt janë me vlerë sintagme (kryesisht kolokacionet) të cilat i konstatoam edhe në vëllimin tonë frazeologjik, gjë që do t'i përmbledhte kategoritë e mësipërme në tri grupime më të gjera në bazë të vlerës së njesisë gjuhësore që ato përfaqësojnë dhe që do të ishin: frazema me vlerë fjale, frazema me vlerë sintagme, frazema me vlerë fjalie. Për rrjedhojë, ne propozojmë një klasifikim të frazemave në tri grupime: në njësi me vlerë fjale, në njësi me vlerë sintagme dhe në njësi me vlerë fjalie.

Interpretimi ynë shprehet nëpërmjet tabelës së mëposhtme brenda së cilës gjejmë emërtimin e njesisë bazë të frazeologjisë (frazemë), nëndarjet e gjera të frazemave sipas vlerës që ato kanë (frazema me vlerë fjale, frazema me vlerë sintagme dhe frazema me vlerë fjalie, dhe kategoritë e veçanta frazeologjike të grupuara edhe sipas grupimeve më të gjera.

Tabela 14. 3. Kombinimet me vlerë fjale, me vlerë sintagme dhe me vlerë fjalie dhe kategoritë e përfshira në to

Termi i përgjithshëm	Njësi me vlerë fjale	Njësi me vlerë sintagme	Njësi me vlerë fjalie
Frazema	Idiomat Perifrazat me folje të desemantizuar Binomet e pakthyeshme frazeologjike Frazetermat Lokucionet gramatikore	Kolokacionet e kufizuara frazeologjike Disa idioma Disa frazeoterma	Proverbat Formulat frazeologjike të bashkëbisedimit

Kjo panoramë e klasifikimeve të ndryshme të frazemave tregon se në bazë të çdo klasifikimi të frazemave gjendet një numër i caktuar kriteresh që nënkuptojnë klasifikimin e bërë. Në fakt, frazemat u nënshtrohen kritereve të shumta dhe klasifikimet e ndryshme lindin sipas zbatimit të këtij apo të atij kriteri i cili privilegohet kundrejt kritereve të tjera.

Disa probleme klasifikimi mund të lindin nga fakti i thjeshtë se frazema të caktuara mund të klasifikohen dhe të përfshihen në kategori të ndryshme. P.sh., frazema *shkel e shko* strukturalisht u takon binomeve të pakthyeshme frazeologjike, por për sa i përket figurshmërisë së plotë që përbën kriter dallues të shumicës së idiomave duhet të llogaritet si idiomë. Siç vëren edhe Gabrovsek (2003), shumica e tipologjive frazeologjike ekzistuese e njohin faktin se ka përkime të pjeshme midis kategorive dhe se ka pak kategori qartësisht të dallueshme.

Klasifikimi i fakteve të vëzhguara mund të shihet si një metodë pune paraprake dhe e nevojshme për çdo analizë të mëtejshme të dukurisë frazeologjike. Ai përbën gjithashtu edhe një metodë të nevojshme për të trajtuar njësitë shumëfjalëshe si në kuadër e përvetësimit të tyre, ashtu edhe në kuadër të përkthimit.

6. 1. Idiomat

Rrugëtimi i termave njësi frazeologjike dhe idiomë

Objekt i këtij kapitulli janë njësitë frazeologjike (apo idiomat, siç njihen më shumë në literaturën anglo-amerikane). Çështjet kryesore mbi të cilat do të përqendrohet studimi ynë lidhen me terminologjinë, me klasifikimin, me kriteret që përcaktojnë se çfarë përfshihet në njësitë frazeologjike dhe me veçoritë e njësive frazeologjike të gjuhës shqipe, si p.sh. *heq të zitë e ullirit, i kthej krahët, i fërkoj krahët, vret miza, s'e mbyll gojën, s'le dy gurë bashkë, s'bëhet i gjallë, nuk i mbushet koka, nuk e vret mendjen, ku ha pula strall, kur të pjellë këndesi, (është) karafil nga mendja, ia dogji letrat në dorë, i fshehu letrat, kartë e djegur, (mbeti) si sëpata pa bisht, vajti si cjapi te kasapi, i jap dum, vë re, (flet) si e ëma e Zeqos majë thanës, i bëj ballë, i bën bisht, (është) pushkë e shkrehur, i vete pas oreksit, lëng pas lëngu, as të lidh as të zgjidh, (e pyes) rrënjë më rrënjë, ia tregoi qejfin, (vret) pas shpine, (flet) në tym, (punon) pas perdes, (punon) nën rrogoz, nuk ia pret, e piu, e hëngri, jetë qeni, fjalë burri, uri ujku, pallë ariu, sjellje kalamajsh etj.*

Termin *njësi frazeologjike* Bally (1909) e përdor për një nga kategoritë e frazemave të cilat të gjitha së bashku me *seritë frazeologjike* i emërton me termin e përgjithshëm apo ombrellë *lokucione*. Sipas Bally-së, njësitë frazeologjike kanë rend të pandryshueshëm, nuk mund të ndahen nga fjalë të tjera, fjalët përbërëse nuk mund të zëvendësohen me fjalë tjetër dhe se e gjithë struktura është e barasvlershme me një fjalë të vetme. Bally thekson konkretisht: “Thuhet që një grup formon një njësi kur fjalët që e përbëjnë humbasin çdo kuptim dhe se vetëm tërësia ka kuptim; përveç kësaj duhet që ky kuptim të jetë i ri dhe të mos jetë thjesht i barasvlershëm me shumën e përbërësve”, siç është shprehja shqipe *e theu qafën* e cila shërben për të transmetuar kuptimin “*iku*”. Këtë kuptim nuk e ka as folja *theu* as emri *qafën* veç e veç.

Këtë gjendje na e sqaron Thomai (2006) kur krahason një strukturë të lirë “*rrugë e gjerë*” dhe një strukturë të qëndrueshme “*kokë e madhe*”. Sipas tij, “togfjalëshi i lirë *rrugë e gjerë* përmban dy fjalë që shënojnë dy koncepte të lidhura ndërmjet tyre: për realien (*rrugë*) dhe për

cilësinë e saj (e gjerë). Përkundrazi, te togfjalëshi frazeologjik *kokë e madhe* “njeri i shquar, i zoti dhe i zgjuar” synimi nuk është të shënohet realja *kokë* dhe cilësia e saj e *madhe*, po të emërtohet një njeri sipas një tipari që ka”. Në këtë rast “gjithë togu frazeologjik shënon një koncept të vetëm”.

Ndërkaq, kjo vepër e rëndësishme e Bally-së nuk pati pasues të menjëhershëm në Europë. Atë e shfrytëzuan fillimisht vetëm studimet frazeologjike ruse të cilat e përpunuan në thellësi.

Frazeologu rus Vinogradov (1947) e përdor termin njësi frazeologjike si term ombrellë ku përfshin kategoritë frazeologjike si: *shkrirjet frazeologjike (frazeologjičeskie sraščeniija)* (të quajtura gjithashtu *idioma*), *bashkimet frazeologjike (frazeologjičeskie edinstva)* dhe *kombinimet frazeologjike (frazeologjičeskie sočetanija)*⁴³, midis të cilave bën edhe një dallim. Kategoria e parë, shkrirjet frazeologjike, përbëhet nga njësi të pamotivueshme, dmth., në to nuk ka ndonjë lidhje midis kuptimit të së tërës dhe shumës së kuptimeve të përbërësve. Njësia frazeologjike shqipe *vë re* i përshtatet shumë mirë kësaj kategorie. Përveç kësaj kategorie Vinogradov njih edhe një kategori tjetër pjesërisht të pamotivueshme, bashkimet frazeologjike, kuptimi i të cilave mund të perceptohet si zgjerim metaforik i gjithë shprehjes. Shembull shqip për këtë kategori do të ishte *i kthej krahët*. Kategoria e tretë, kombinimet frazeologjike, përbën një tip të rëndësishëm, sepse autori fut nocionin e përcaktimit kontekstual të kuptimit. Sipas përkufizimit të kësaj kategorie nga Irina Arnold (1986), “kombinimet frazeologjike janë jo vetëm të motivuara, por përmbajnë një përbërës të përdorur në kuptimin e tij literal, ndërsa përbërësi tjetër është i përdorur figurativisht. Shembull shqip i përshtatshëm për këtë kategori do të ishte *pres ditën e dasmës*, ku fjala *pres* është fjala me kuptim të figurshëm, ndërsa përbërësi *ditën e dasmës* përbën kontekstin përcaktues. Në këtë mënyrë, duke i mëshuar kriterit të figurshmërisë, Vinogradov i zgjeron njësitë e tij frazeologjike duke përfshirë në to një grup tjetër, dmth., kombinimet frazeologjike, i cili përbën një pjesë të kategorisë frazeologjike baliante *seri frazeologjike* dhe të cilin autorë të tjerë, si p.sh., Cowie, 1988, do ta përfshijnë më vonë te kategoria e veçantë frazeologjike e *kolokacioneve të kufizuara*.

Termin njësi frazeologjike e përdor si term të përgjithshëm për shprehjet frazeologjike të gjuhës shqipe edhe J. Thomai (1981) i cili dallon dy grupe: njësitë frazeologjike të pamotivueshme, si p.sh., *i jap dum, vë re, (flet) si e ëma e Zeqos majë thanës, i bëj ballë, i bën bisht*, dhe njësitë frazeologjike të motivueshme, si p.sh., *i hedh baltë, i kthej krahët, s’e mbyll gojën, vajti si cjapi te kasapi etj*. Sipas J. Thomait (2006), “njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, që riprodhohet e funksionon në ligjërim si njësi e gatshme dhe e pandashme”. Sipas të njëjtit autor (Thomai, 1999), “si tipare të përgjithshme të njësisë frazeologjike janë njohur struktura togfjalëshore, njësia kuptimore, qëndrueshmëria, figurshmëria, neutralizimi i raporteve të brendshme sintaksore, njëvlerësia me fjalën nga ana e kuptimit kategorial dhe e funksionit në ligjërim”. Duke i mëshuar kriterit të

⁴³ Cowie, A. P. (1998). vep. e cit.

barasvlershmërisë me fjalën, autori (Thomai, 1981) e ngushton disi vëllimin frazeologjik të njësive frazeologjike të zgjeruar nga Vinogradov. Kategorinë e tretë vinogradoviane ku një përbërës është folje e përdorur figurativisht, J. Thomai e kufizon te foljet e figurshme të cilat kuptimi shkon drejt desemantizimit, si p.sh., *bëj durim*, raste të cilat i përfshin në nëngrupin e dytë të njësive frazeologjike të motivueshme.

Edhe Gläser (1986a, 1988a) përdor termin njësi frazeologjike si term ombrellë për njësitë e ngurosura të gjuhës që ajo studion. Gläser e shikon frazeologjinë në kuptimin e gjerë dhe, për rrjedhojë, njësitë e saj frazeologjike i zgjeron edhe me kategori të tjera frazeologjike, si p.sh., me proverbat dhe kolokacionet e kufizuara frazeologjike.

Sipas Pazos Bretana & Pamies Bertran (2008), “Leksikologjia moderne quan “njësi frazeologjike” një grup të gjerë dhe heterogjen kombinimesh fjalësh të cilat koincidojnë me “shprehjet e ngurosura” siç janë përshkruar nga Moon (1998)” apo me frazemat tona. “Kjo kategori e gjerë përfshin idiomat, kolokacionet, similitë, proverbat dhe formulat e bashkëbisedimit”.

Në kërkimet angleze termi i përdorur tradicionalisht për më shumë se një shekull për t’iu referuar frazemave të gjuhës është *idiomë* (*idiom*, angl.), siç ilustron edhe nga titujt e veprave të shquara mbi këtë çështje (“*Idiom formation*” i Charles Hocket-it (1956); “*Idiom structure in English*” i Adam Makkai-t (1972); “*Longman Dictionary of English Idioms*” (1979).

Një shembull i parë i përkufizimit të termit *idiomë* është përkufizimi i Henry Sweet-it (1899) sipas të cilit “kuptimi i çdo idiome është një fakt i izoluar i cili nuk mund të nxirret nga kuptimi i fjalëve prej të cilave ajo përbëhet”, i cili shihet si përkufizim standard i idiomave.

Ky përkufizimi si dhe përkufizimet e mëvonshme të idiomave reduktohen në dy gjëra të njëjta: a) idiomat janë shprehje të cilat përmbajnë të paktën dy njësi leksikore dhe b) kuptimi i idiomës nuk është rezultati kombinues i kuptimit të elementeve leksikore të shprehjes. Një shembull i mëvonshëm i një përkufizimi të tillë është ai i Fraser (1970) i cili e shikon idiomën si “një përbërës apo seri përbërësish interpretimi semantik i së cilës nuk është funksioni kompozicional i elementeve (formatives) prej të cilëve ajo përbëhet”.

Hocket (1956) që ndër gjuhëtarët e parë që zbatoi konceptin e njësive frazeologjike të përpunuar shkencërisht në fillim nga Bally dhe më vonë nga Vinogradov në termin korrespondues *idiomë* të anglishtes kuptimi i së cilës “nuk del nga struktura e saj”, por në të autori përfshinte çdo njësi gjuhësore pavarësisht se sa e gjatë ishte, mjafton që kuptimi i saj të “mos dilte nga struktura”, duke filluar nga fjalët e përbëra deri te tekstet e plota.

Më vonë, Cowie (1988) i shikon idiomat më ngushtë. Ndryshe nga Vinogradov i cili përfshin në njësitë e tij frazeologjike edhe “*kombinimet e fjalëve*”, Cowie nuk përfshin te idiomat “*kombinimet e tij të fjalëve*” të cilat i quan kolokacione, por i konsideron si kategori më vete frazeologjike.

Po kështu edhe Moon (1998) i shikon idiomat ngushtë, të veçuara nga shprehjet e tjera frazeologjike.

Në tabelën e mëposhtme do të shohim rrugëtimin e termave njësi frazeologjike dhe *idiomë*.

Tabela 6.1. Rrugëtimi i termit njësi frazeologjike

Njësi frazeologjike	Ngushtë si kategori frazeologjike e veçantë.	Ngushtë, por si term ombrellë.	Më gjerë se të Bally dhe si term ombrellë ku përfshihen edhe "kombinimet e fjalëve", dmth., kolokacionet .	Akoma më gjerë si term ombrellë ku përfshihen edhe kolokacionet, proverbat etj.
	Bally (1909)	Thomai (1981)	Vinogradov (1947)	Gläser (1998), Fiedler (2007)

Tabela 6.2. Rrugëtimi i termit idiomë

Idiomë	Gjerë si term ombrellë ku përfshihen edhe proverbat, formulat, si dhe fjalët e përbëra.	Ngushtë si kategori frazeologjike më vetë përkrah kolokacioneve, proverbase, formulave etj.
	Hocket (1956), Makkai (1972)	Cowie(1988), Moon(1998), Burger (1998), Mel'cuk, (1998), Svensson (2004), Granger & Paquot (2008), Piirainen (2008) etj

Nga kjo paraqitje shohim se përmbajtja fillestare e (kuptimit të ngushtë të) termit njësi frazeologjike përputhet me përmbajtjen e fundit të termit idiomë.

Termi idiomë në vend të termit njësi frazeologjike

Siç e pamë edhe më lart, në literaturën botërore të dy termat njësi frazeologjike dhe idiomë i gjejmë të përdorur krahas për krahas, me pothuajse të njëjtin kuptim. Të njëjtën gjë vërejmë edhe në fjalorët shpjegues të shqipes (1980, 2002).

Çështja jonë e tanishme do të përqendrohet në sinoniminë njësi frazeologjike-idiomë në kuadrin e frazeologjisë në kuptimin e gjerë të cilën ne studiojmë dhe në kuadër të së cilës do të propozojmë zëvendësimin e termin njësi frazeologjike, qoftë si term ombrellë, qoftë si term për një kategori të veçantë frazeologjike:

Termi njësi frazeologjike do të mund të përshtatej si njësi ombrellë për frazeologjinë në kuptimin e gjerë, por në frazeologjinë në kuptimin e gjerë termi njësi frazeologjike si term ombrellë bashkëpërdoret apo konkurren me terma të tjerë si *shprehje të ngurosura*, *frazemë* etj., nga të cilat ne kemi zgjedhur dhe propozuar termin frazemë si term më teknik për arsyt e shpjeguara më lart.

Termin njësi frazeologjike do ta zëvendësojmë me termin idiomë edhe si term për kategori të veçantë të frazeologjisë në kuptimin e gjerë për arsyt e mëposhtme:

-Vëllimi idiomatik i propozuar prej nesh nuk është plotësisht i njëjtë me vëllimin frazeologjik që mbulojnë njësitë frazeologjike të njohura deri tani në shqipe, si p.sh., *rreth e rrotull, fund e krye, ditë për ditë etj.*, të cilat nuk kanë figurshmëri dhe të cilat ne i përfshijmë në një kategori tjetër frazeologjike, binomet e pakthyeshme frazeologjike, ose *bëj durim, jap shpresë etj* të cilat, edhe pse kanë një farë figurshmërie, ne i përfshijmë te perifrazat me folje të desemantizuar, sepse nuk karakterizohen nga kufizimi morfo-sintaksor që karakterizon idiomat. Megjithatë, vëllimi idiomatik që mbulojnë idiomat dhe vëllimi frazeologjik që mbulojnë njësitë frazeologjike përputhet në pjesën më të madhe, dhe kjo është një nga arsyet që shpeshherë gjatë punimit tonë ne nuk bëjmë dallim midis tyre dhe themi idiomat apo njësitë frazeologjike.

-Propozojmë termin idiomë për unifikim të terminologjisë, sepse termi idiomë përdoret në frazeologjinë anglo-amerikane dhe, rrjedhimisht, në sajë edhe të gjuhës angleze, ka shtrirje gjithnjë e më të madhe.

-Termi idiomë është term i përdorur në shumë gjuhë dhe pothuajse në çdo përkthim të materialeve frazeologjike në anglishte.

-Termi idiomë është i njohur edhe në frazeologjinë e shqipes, sepse një nga nëngrupet e njësive frazeologjike të shqipes etj., njësitë frazeologjike të pamotivueshme, quhen ndryshe idioma. Por kjo nuk mund të na pengojë të quajmë të gjitha njësitë frazeologjike idioma.

-Termi idiomë përbën edhe alternativë sinonimike në fjalorët e shqipes, por edhe të gjuhëve të tjera, midis të cilave edhe në fjalorin enciklopedik të rusishtes.

-Termi idiomë është më i njohur se njësi frazeologjike në sajë të anglishtes si gjuhë e huaj për folësit e gjuhëve të ndryshme, dmth., edhe të anglishtfolësve shqiptarë, sepse idiomat janë shumë të përhapura në anglishte dhe hasen që në hapat e para të mësimin të kësaj gjuhe. Shumë folës të shqipes sot e njohin termin idiomë nga mësimi i anglishtes, madje para se të njohin termin njësi frazeologjike.

-Fjala njësi përdoret edhe më gjerësisht, jashtë kufijve të frazeologjisë si njësia bazë, e përgjithshme e objektit të studimit të çdo shkence.

-Përveç të tjerave, termi idiomë do të përbente term të preferuar, sepse është fjalë më e shkurtër.

Prejardhja e termit idiomë dhe kuptime të tjera të tij

Termi idiomë e ka prejardhjen nga fjala greke *idiōma* që do të thotë “*tipar i veçantë*” dhe vetë kjo e fundit e ka prejardhjen po nga greqishtja *idios* që do të thotë “*i veçantë*”.

Në strukturën kuptimore të fjalës *idiom* në fjalorin e anglishtes “*Oxford English Dictionary*” (1989), shohim se termi idiom ka shumë kuptime midis të cilave përmendet 1) përdorimi i përgjithshëm jo gjuhësor si “*Formë ose veçori e veçantë; natyrë e veçantë; veçanësi*” 2) përdorimi i përgjithshëm gjuhësor si “*Formë e së folurës tipike për një popull apo në shtet; vetë gjuha*”, apo 3) më ngushtë si “*Lloj gjuhe tipike për një zonë të kufizuar apo klasë njerëzish, dialekt*” dhe 4) përdorimit i veçantë gjuhësor (frazeologjik) si “*Veçanësi e frazeologjisë e aprovuar nga përdorimi i një gjuhe dhe që shpesh ka një kuptim të ndryshëm nga ai gramatikor apo logjik*”.

Në fjalorët shpjegues të shqipes (1980 dhe 2002) fjala idiomë përmendet si term gjuhësor me dy kuptime. Në kuptimin e parë është sinonim i termit njësi

frazeologjike si “shprehje me ndërtim të veçantë, tërësisht a pjesërisht të ngurosur, që përdoret në një gjuhë prej kohësh me kuptim të njësishtëm”, ndërsa në kuptimin e dytë ka domethënien “fjalë e veçantë që përdoret në kuptim të figurshëm vetëm në një gjuhë e që nuk mund të përkthehet drejtpërdrejt në gjuhë të tjera (p.sh. pikë në kuptimin “mes”: në pikë të dimrit; gojëlidhuri euf. ujku etj.)”.

Në fjalorin e greqishtes “Fjalori i greqishtes së re standarde” (1998) gjejmë këto kuptime të fjalës idiomë (ιδιωτισμός, gr.): 1a. Dialekt 1b. Veçori (e një shkrintari) 2. Zakon i veçantë.

Termet idiomë dhe idiotizëm

Përveç termin idiomë në literaturën gjuhësore haset edhe termi idiotizëm apo, sipas Xhuvanit (1921), “idhioizëm”. Ky term ka dy kuptime: një të ngushtë dhe një të gjerë.

Në kuptimin e ngushtë tregon një shprehje të veçantë, veçanërisht atë kuptimi i së cilës nuk parashikohet nga kuptimet e përbërësve, dmth., ka kuptimin “idiomë”. Në këtë kuptim përdoret termi idhioizëm sot në greqisht: Fjalori i greqishtes “Fjalori i gjuhës së re greke” (2002) jep këtë përkufizim për idhioizmin “çdo sintagmë leksikore e greqishtes moderne, që përbën shprehje të veçantë zakonisht me kuptim të figurshëm”, ndërsa fjalori i greqishtes “Fjalori i greqishtes së re standarde” (1998) jep këtë përkufizim “shprehje me kuptim ose sintaksë të veçantë që thuhet në një gjuhë”.

Në kuptimin e gjerë termi idhioizëm tregon atë dukuri gjuhësore që është tipike për një gjuhë të dhënë. Në bazë të këtij kriteri shprehjet tipike për një gjuhë të dhënë, p.sh., për frëngjishten quhen *galicizma*, për greqishten quhen *greqizma*, për shqipen quhen *albanizma* etj. Por, në qoftë se një shprehje është tipike për një gjuhë të dhënë, mund të mos jetë e tillë për një tjetër. Një shembull të tillë për shqipen na e jep Xhuvani (1921) i cili dallon rastet e “a)të përdorunit e foljeve me parafjalën po; po shkruaj, po këndoj etj.; b)të përrishtit t’objektivit me përemnat vektorë: j’a dhashë librin nxansit; përrallat u pëlqejnë djelmëvet etj.; c)të përdorunit të foljes me qenë bashkë me mënyrën përcjellore të foljevet: p.sh. *jam, isha, kam qenë etj*”.

Në këtë nivel të analizës, vetëm një faktor mund të ndërhyjë për dallimin midis përkufizimit të ngushtë dhe përkufizimit më të gjerë të idhioizmit, ai i gramatikalitetit të shprehjes. Idhioizmat në kuptimin e gjerë zbulohen vetëm në sajë të krahasimit të gjuhëve, sepse përbëjnë model produktiv në gjuhë, ndërsa idhioizmat në kuptimin e ngushtë mund të zbulohen edhe brenda gjuhës, sepse janë kryesisht jokompozicionale dhe nuk përbëjnë model produktiv në gjuhë.

Kritere të përcaktimit të idiomave

Autorë të ndryshëm kanë përqafuar kritere të ndryshme për përcaktimin e idiomave apo të njësisive frazeologjike. Sipas Moon (1998), Vinogradov “i kufizon njësitë frazeologjike në elemente sa më metaforike”, dmth., Vinogradov përdor kriterin e figurshmërisë si kriterin më gjithëpërfshirës në studimet e tij frazeologjike. Kjo duket edhe në kategorinë e tij të tretë frazeologjike në përbërje të së cilës kemi një folje me kuptim të figurshëm dhe një emër me kuptim literal⁴⁴, si p.sh., *pres ditën*

⁴⁴ Cowie, A. P. (1998). vep. e cit.

e *dasmës*, ku *pres* përdoret në kuptim të figurshëm, ndërsa *ditën e dasmës* në kuptim literal.

Smirnitsky (1959) dhe Thomai (1981) kanë përqafuar kriterin e barasvlershmërisë me fjalën. Sipas Smirnitsky-t, kombinimet frazeologjike të Vinogradov-it nuk janë njësi frazeologjike, sepse nuk janë barasvlerës me një fjalë të vetme. Të njëjtin mendim ka edhe Gjocaj (2001) sipas të cilit “te njësitë frazeologjike uniteti semantik është veçori themelore”.

Në studimet tradicionale perëndimore, kriteri parësor i përcaktimit të idiomave ka qenë moskompozicionaliteti semantik. Kjo do të thotë se kuptimi i këtyre strukturave nuk është i barabartë me shumën e kuptimeve të përbërësve, apo, siç shprehen Katz & Postal(1963), “tipari thelbësor i idiomës nuk është funksioni kompozicional i kuptimit të elementeve përbërës të idiomës”. Në këtë mënyrë, idioma karakterizohet nga humbja e kuptimit të veçantë të elementeve që e përbëjnë dhe, për rrjedhojë, paraqitet si një njësi e re dhe e pavarur leksikore, me kuptim të përfunduar dhe të pavarur nga përbërësit e saj (Dubois, Giacomo, Guespin, Marcellesi, Marcellesi & Mével, 1973).

Moskompozicionalitetin dhe, rrjedhimisht, edhe barasvlershmërinë me fjalën nuk e pranon Kunin (1970) i cili në vijim të kriterit të figurshmërisë të propozuar nga Vinogradov, shton edhe idenë e figurshmërisë së pjesëshme të idiomat përveç figurshmërisë së plotë. Sipas tij, “njësitë frazeologjike janë togje të qëndrueshme fjalësh me kuptime pjesërisht apo plotësisht të mbartura”, si p.sh., *to kick the bucket* (*vdes*; lit. *shkelmoj kovën*) (me kuptim plotësisht të mbartur) dhe *Greek gift* (*dhuratë hileqare*; lit. *dhuratë greke*) (me kuptim pjesërisht të mbartur, dmth., vetëm të fjalës *Greek*), që janë disa nga shembujt e propozuar prej tij. Fjalët me kuptim të mbartur apo të figurshëm e fitojnë këtë kuptim vetëm si pjesë e idiomave, dhe, për këtë arsye do t’i quajmë “fjalë idiomatike”⁴⁵.

Nga shembujt e sapopërmendur zbulojmë se jo të gjitha fjalët në përbërje të idiomave mund dhe duhet të jenë fjalë idiomatike. Siç shprehet edhe Riehemann, (2001), “fjala *miss* (*humbas*) në *miss the boat* (lit. *humbas anijen*) ka të njëjtin kuptim që mund të ketë në lidhje të tjera, prandaj nuk është fjalë idiomatike, ndërsa *miss the boat* përbën idiomë”. Ato që nuk janë fjalë idiomatike, kanë kuptim literal të cilin e ruajnë edhe në idiomë. Ky kuptim literal luan një rol në idiomë, ai ka rol përzgjedhës, kolokacionor⁴⁶ pa të cilin nuk do të kishte idiomë.

Për rrjedhojë, për të realizuar kuptimin e idiomës, mjafton që të kemi edhe një fjalë të vetme idiomatike e cila nuk ka kuptimin që mund të ketë jashtë idiomës. Këtë idiomë do ta quajmë idiomë me figurshmëri të pjesëshme dhe kuptimi i saj nxirret nga kuptimi i përbërësve.

Duke ndjekur gjurmët e Kunin dhe të Riehemann, mund ta zgjerojmë grupin frazeologjik të idiomave të shqipes me shprehje të tjera që nuk janë të barasvlershme me fjalën, por kuptimi i të cilave mund të nxirret nga kuptimi i përbërësve, si p.sh., jetë *qeni* (=shumë e keqe), sjellje *kalamajsh* (=e papjekur), uri *ujku* (=shumë e madhe), gjellë *qensh* (=shumë e keqe), *humbas trenin* (=shansin), nuk ka zemër (=

⁴⁵ Riehemann, S. (2001), A Constructional Approach to Idioms and Word Formation, PhD thesis, Stanford University.

⁴⁶ Që lidhet me kolokacionet, dmth., me përdorimin e njërit përbërës në varësi të tjetrit. Për më tepër, shih në kreun e kolokacioneve të kufizuara.

kurajo), ndërroi *dorë* (=pronar), i kërkoi *dorën e vajzës* (=vajzën për martesë) etj., dmth., të cilat ndërtohen mbi bazën e kompozicionalitetit semantik si shumë e kuptimeve të përbërësve. Në këto raste njëra fjalë ruan kuptimin e vet literal, ndërsa vetëm tjetra ka fituar një kuptim të figurshëm dhe, për rrjedhojë, të dyja dalin me kuptim transparent, të paktën në analizë, dhe struktura e tyre është kolokacionore.

Këto idioma mund të shpjegohen sipas strukturës së brendshme semantike gjë që i bën semantikisht të motivuara. Idioma të tilla nuk përbëjnë njësi semantike dhe, për rrjedhojë, mund të përpunohen në mënyrë kompozicionale⁴⁷.

Por jo të gjitha idiomat ndërtohen në këtë mënyrë. Shumica e idiomave duhet të konsiderohen si jokompozicionale. Për rrjedhojë, ato kanë statusin e njësisve leksikore.

Më të diskutueshme do të ishin rastet me foljet *bëj*, *jam* dhe *jap*, si p.sh., *u bë derr*, *u bë pulë*, *u bë bishë*, *u bë shoshë*, *i jap një bojë*, *i jap fytyrë*, *i jap dorën* (*një dorë*), *është e udhës*, *janë të një dore* etj.

Në këto raste nuk mund të ndahet prerazi tipi leksiko-gramatikor i njësisë frazeologjike, nëse, p.sh., idioma *janë të një dore* është njësi frazeologjike foljore, me kuptimin “ngjajnë”, apo ndajfoljore, me kuptimin “janë njëlloj” e në këtë rast folja (*janë*) është përdorur me kuptimin e saj literal.

Le të marrim edhe një shembull me krahasim: struktura *u bë derr* mund të interpretohet si idiomë me kuptimin “*u mërzi shumë*” me vlerë foljore, pra, fjala *u bë* është shkrirë me fjalën *derr* në një njësi të vetme kuptimore; por ajo mund të shihet edhe si e përdorur literalisht (*u bë*), ndërsa *derr*, me kuptimin “*i mërzi*”.

Kjo varet nga qartësia e kuptimit literal të foljeve. Në bazë të qëndrimit të Memishës (2006) në lidhje me strukturat me kufi nistor foljen *bëj* ku “pjesa emërore e ndërtimit nuk është me kuptim literal, por me kuptim të figurshëm., si p.sh., *u bë calik*, *u bë daulle*, *u bë tym*, *u bë flakë në fytyrë*, *u bë bishë*, *u bë kallkan*, *u bë derr*, *u bë gjalmë*, *iu bë dyshek*, *iu bë urë*, *iu bë finjë* etj.”, rezulton se folja *bëj* e ruan të qartë kuptimin literal dhe nuk shkrihet me kuptimin e pjesës emërore. Kjo na bën të vlerësojmë si variantin më të mundshëm tipin ndajfoljor.

Në vijim të trajtimit të njësisve shumëfjalëshe të nisur Vinogradov dhe të vazhduar nga Kunin, do të bëjmë një përmbledhje të shkurtër dhe një rikujtim të qëndrimit tonë të deritanishëm në lidhje me dy çështje:

Çështjen e kriterit të moskompozicionalitetit për idiomat midis të cilave ka edhe idioma kompozicionale të cilat duhen marrë parasysh, dhe për rrjedhojë, moskompozicionaliteti nuk përbën kriter përcaktues të idiomave, por një tipar ndarës të disa idiomave nga të tjerat. Për rrjedhojë, as barasvlershmëria e idiomave me fjalën nuk përbën tipar gjithëpërfshirës që të vlejë edhe si kriter përcaktues.

Kriteret e propozuara për përcaktimin e idiomave si kategori e veçantë frazeologjike:

Tani do të vazhdojmë me kriteret e propozuara nga ne për idiomat (përveç polileksikalitetit, kufizimit leksikor dhe mosreferencialiteti literal që janë kritere të përgjithshme për të gjitha frazemat). Ato janë: figurshmëria dhe kufizimi gramatikor (morfo-sintaksor).

⁴⁷ Langlotz, A. (2006). *Idiomatic Creativity: A Cognitive Linguistic Model of Idiom-Representations and Idiom-Variation in English*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam.

-Figurshmëria

Që dy ose më shumë fjalë të përbëjnë një idiomë dhe të fitojnë një kuptim të ri, duhet që të paktën njëra prej këtyre fjalëve të humbasë fillimisht kuptimin e saj. Në këtë mënyrë fjala apo fjalët që kanë humbur kuptimin e tyre përdoren në idiomë me një kuptim të figurshëm, transparent apo jo transparent. Figurshmëria është rezultat i ndryshimit të kuptimit të fjalëve nga kuptimi i tyre i sanksionuar fillimisht, gjë që krijon një mospërputhje midis kontekstit të parë dhe kontekstit të ri të përdorimit. Këto “kuptime të reja të fjalëve” lidhen me metaforat gjuhësore të cilat, sipas Deignan et al. (1997), janë “shprehje të folura apo të shkruara të një metafore konceptore”.

Metafora gjuhësore dhe mjetet e shprehjes së figurshmërisë

Një nga përkufizimet më të përgjithshme të metaforës është procedurë gjuhësore që konsiston në përdorimin e një termi konkret në një kontekst abstrakt mbi bazën e ngjashmërisë. Nëpërmjet metaforës kuptimi i një fjale zgjerohet, shtrihet edhe në fjalë të tjera të cilat kanë ngjashmëri me të parën. Me fjalë të tjera, kemi metaforë kur i japim diçkaje një emër tjetër. Sipas Aristotelit, që të përçohet një kuptim abstrakt kërkohen dy kushte a) fjala apo shprehja t’i referohet lehtësisht dhe automatikisht imazhit i cili shpreh kuptimin që duam të përçojmë dhe b) imazhi të cilit i referohemi të jetë i njohur për bashkëbiseduesin në mënyrë që ai ta dijë kuptimin e saj dhe të mund të rendisë saktë mesazhin që i kemi dërguar që ta kuptojë pa mundim⁴⁸.

Pikëpamja e Aristotelit mbi metaforën, e cila u përfshi në veprën e Aristotelit “Poetika dhe retorika” (350 vjet para Krishtit), konsiderohet si themeli i kërkimeve retorike dhe metaforike për më shumë se 2000 vjet. Ajo konsiderohet si teoria më e hershme dhe më e përhapur e metaforës deri më sot. Sipas pikëpamjes së tij, metafora funksionon ose si zëvendësim i të figurshmes për literalen, ose si një krahasim i shkurtuar. Më konkretisht, Aristoteli mendonte se metafora rezultonte nga konstatimi i ngjashmërive midis objekteve.

Metafora mund të klasifikohet në disa tipa:

Metafora e gjallë

Kur metafora është krijuar dhe është përdorur nga një individ i caktuar ajo quhet metaforë e gjallë, si p.sh., *Ajo është hëna e prindërve*.

Metafora e zbehur

Metafora e zbehur është metafora e cila e ka humbur risinë e saj për arsye të përdorimit të gjatë dhe është bërë e zakonshme, si p.sh., *Rini e artë*, ose *Ajo është drita e syve të prindërve*. Fjalë ose shprehje si këto njerëzit i përdorin në mënyrë të zakonshme pa qenë të ndërgjegjshëm për faktin se janë metafora.

Metafora e vdekur

Në metaforat e vdekura nuk ndihet kuptimi metaforik. Kuptimi fillestar anashkalohet dhe thënia fiton një kuptim të ri literal të ngjashëm me kuptimin e mëparshëm metaforik. Në këtë rast krahasimi harrohet plotësisht dhe objekti i emërtuar shpesh nuk ka emër tjetër, si p.sh., *këmba (e tavolinës)*, *qafa (e shishes)* etj. të cilat ka të ngjarë të mos shihen më si metaforike për shumicën e folësve shqiptarë.

Për sa i përket metaforës, gjuhëtarët bien dakord se metafora luan një rol të rëndësishëm në formimin dhe ekzistencën e idiomave dhe shumica prej tyre mendojnë

⁴⁸ Παπαζαχαρίου, Ζ. (1999). Λεξικό της Ελληνικής αργκό (Λεξικό της πιάτσας). Αθήνα: Κάκτος.

se idiomat lidhen me metafora të tipit të zbehur. Metaforat e zbehura përçojnë te folësit e gjuhës një pjesë nga freskia e tyre fillestare edhe pse janë bërë të zakonshme.

Metaforat përdoren vazhdimisht dhe në mënyrë krijuese nga folësit e gjuhës dhe, për më tepër, është burimi kryesor i ndryshimeve semantike. “Metafora është mjeti kryesor për krijimin e njësive frazeologjike dhe metaforizimi është më prodhimtari si proces. Janë me mijëra e mijëra njësitë e formuara në shqipen përmes tij”⁴⁹, si p.sh., *u bë baltë (dikush), u bë leckë (rreckë, paçavure) (dikush a diçka), e ka zemrën ahur (dikush), e ka gojën ajkë (dikush), (është) pemë pa kokrra, (është) kockë në fyt (në grykë), daulle e shpuar* etj.

Disa frazema nuk përmbajnë metafora, por metonimi, hiperbola dhe litota.

Metonimia, në të cilën do të përfshihet edhe sinekdoka, është një tjetër mjet i rëndësishëm për krijimin e idiomave. Metonimia, ashtu si dhe metafora, bazohet në lidhjet midis objektit të nënkuptuar dhe objektit të emërtuar, por ndryshe nga metafora, metonimia mbështetet në lidhjet midis pjesës dhe së tërës apo funksionit dhe vepruesit etj., si p.sh., te idiomat *i zë dora, ndërroi dorë, i kërkoj dorën etj.*, fjala *dorë* na çon te zotëruesi i dorës, te njeriu, ose te *i vë syrin diçkaje, hedh një sy etj.*, funksioni i fjalës *sy* na çon te vepruesi, te njeriu.

Ajo që e dallon akoma metoniminë nga metafora është natyra e lidhjes midis dy elementeve. Ndërsa metafora mbështetet te ngjashmëria, metonimia mbështetet te afërsia. Metonimia nënkupton lidhje të drejtpërdrejtë me realitetin ndryshe nga simbolizmi i metaforës.

Hiperbola është një mjet stilistik i bazuar në ndërveprimin midis kuptimeve logjike dhe emocionale të fjalës. Në rastin e hiperbolës, bëhet fjalë për një ekzagjerim të qëllimshëm. Përdorimi i hiperbolës dëshmon për vërshimin e emocioneve nga ana e folësit dhe për rrëmbimin e dëgjuesit nga ky vërshim.

Në vijim do të bëjmë tonat vlerësimet e Memishës (2006), sipas të cilit hiperbola është një tjetër figurë e rëndësishme nëpërmjet së cilës ngrihet kuptimi i shumë njësive frazeologjike. Hiperbola mund të kundrohet si figurë të paktën në formimin e dy grupeve të mëdha njësish frazeologjike:

a. Grupi i njësive që në krye të herës kanë pasur një lidhëz krahasore *sa*. Kjo lidhëz mund të ketë qenë ose jo pjesë e ndërtimit sintagmatik, si në rastet e metaforizimit. Kështu mund të rindërtojmë: *e bën bjeshkë (diçka) / e bën sa një bjeshkë (diçka), e bën vezën deve (dikush) / e bën vezën sa një deve (dikush), e bën qimen tra / e bën qimen sa një tra, e ka fytyrën shtatë hektar (dikush) / e ka fytyrën sa shtatë hektar (dikush), e bën mizën (pleshtin) buall / e bën mizën (pleshtin) sa një buall* etj.

b. Grupi i dytë përfshin njësi që shpërfaqin metafora hiperbolike, si p.sh., *alemi e polemi, sheh përtej bjeshke (dikush), u bë det (diku), kërkoj detin me shkop, shkoi (vajti) prapa diellit (dikush), e fut (e fsheh) minaren në thes (dikush), mori botën (dheun) ndër sy (dikush), rrodhën qiejt, (e fut) shtatë pashë nën dhe (diçka)* etj. Në këtë grup njësish frazeologjike krahasimi është “i fshehur”, ndërtimet frazeologjike

⁴⁹ Memisha, V. (2006). Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike. Në, Studime filologjike. Nr. 3 - 4.

nuk mund të shndërrohen (me transformë) në ndërtime me lidhëz krahasuese, por ideja e krahasimit, edhe pse e mbuluar mund të ndjehet.

Litota nënkupton krahasimin nëpërmjet zvogëlimit tej mase. Grupi i njësive frazeologjike me litotë përfshin njësi të tilla, si: *(është) me dy fije brinjë (dikush); (është) me një kokosh plaçka; s'të jep një pikë ujë (dikush); shpëtoi për një qime (për një fije floku); shpëtoi për një majë gjilpëre (dikush); noton në një (në dy) gisht ujë (dikush); thëngjill i mbuluar* etj. Edhe këtu krahasimi ndjehet, sido që, “i fshehur”.

Metafora konceptore dhe motivimi i idiomave

Pamë pak më lart se nëpërmjet metaforës kuptimi i një fjale zgjerohet, shtrihet edhe në fjalë të tjera të cilat kanë ngjashmëri me të parën. Ky ndryshim semantik i fjalëve që mbështetet në ngjashmërinë e kuptimeve të fjalëve quhet metaforë. Sipas konceptit tradicional metafora nuk i kalon caqet e gjuhës. Një shprehje gjuhësore, p.sh., *hënë*, zgjidhet kundrejt një shprehjeje tjetër gjuhësore, p.sh., *vajzë*, me qëllim që shkrimtari të realizojë efektin poetik. Sipas këtij koncepti, për shumicën e njerëzve metafora është një shpikje e imagjinatës poetike dhe e retorikës, një çështje e gjuhës speciale sesa e gjuhës së përditshme. Kjo është pjesë e teorive që e kanë origjinin në retorikën klasike. Në retorikën klasike, pika e nisjes është se metafora paraqet një veçanësi gjuhësore që duhet përcaktuar. Për këtë arsye shumë njerëz mendojnë se mund të procedojnë shumë mirë edhe pa metafora.

Në lidhje me idiomat, sipas teorisë klasike, nuk ka arsye që një imazh konvencional të mund të lidhet me një metaforë, sepse kuptimi i ri nuk kalon mbi bazën e ngjashmërisë siç ndodh me kuptimet e fjalëve. Për rrjedhojë, sipas teorisë gjuhësore tradicionale, “idiomat kanë kuptime arbitrare, meqë kuptimi i tyre nuk mund të parashikohet mbi bazën e fjalëve të veçanta që e përbëjnë, dhe, në këtë teori, çdo gjë që nuk është e parashikueshme është arbitrare. Sipas teorisë tradicionale të idiomave, fjalët lidhen drejtpërsëdrejti me kuptimet e tyre, pa figura apo metafora”⁵⁰, por, në fakt, ka një lloj tjetër metafore që nuk mbështetet te ngjashmëria e kuptimeve të fjalëve. Ajo është metafora konceptore e cila është rezultat i koncepteve mendore të ndërtuara mbi bazën e përvojës njerëzore. Njeriu bashkëjeton me metaforat konceptore dhe me ndihmën e tyre shpreh gjuhësisht botën që e rrethon.

Këtë qëndrim e ofron gjuhësia konjitive sipas së cilës “metaforat te idiomat janë konceptore”⁵¹. Metaforat te idiomat “përbëjnë një konceptim mendor që ndikon në mënyrën me të cilën mendojmë dhe imagjinojmë në jetë”⁵². Metaforat gjenden në jetën tonë të përditshme, jo vetëm në gjuhë, por edhe në mendje”⁵³. Nuk përbëjnë thjesht një vegël që ndikon stilistikisht në gjuhë dhe në të cilën përfshihen vetëm procedura gjuhësore, por një mjet i fuqishëm komunikues që përbën produkt të trajtimit njohës”⁵⁴.

Lakoff & Johnson në studimin e tyre “Metaphors We Live By” shkruajnë se thelbi i metaforës bazohet në të kuptuarit e një gjëje nga këndvështrimi i një gjëje

⁵⁰ Χιώτη, Α. (2010). Οι παγιωμένες εκφράσεις της νέας Ελληνικής: Ιστορική διάσταση, ταξινόμηση και στερεοτυπικότητα. Διδακτορική διατριβή. Θεσσαλονίκη.

⁵¹ Lakoff, G. (1990). The invariance hypothesis: Is abstract reason based on image schemas? *Cognitive Linguistics* 1(1).

⁵² Lakoff, G. & Johnson, M. (1980). *Metaphors We Live By*, Chicago, London.

⁵³ Lakoff, G. & Johnson, M. (1980). *vep.* e cit.

⁵⁴ Lakoff, G. (1993). *vep.* e cit.

tjetër (1980). Për këtë arsye, çdo metaforë ka një fushë burimore dhe një fushë mbërritëse⁵⁵. Metaforat konceptore realizojnë korrespondimin e këtyre dy fushave të njohjes. Kövecses dhe Szabó (1996) pohojnë se metaforat konceptore funksionojnë si elemente lidhëze midis një fushe abstrakte, (si p.sh., zemërimi, dashuria etj.) dhe një fushe më konkrete dhe më të njohur (siç është, p.sh., zjarri), dhe gjatë kësaj procedure gjuha ka thjesht rol dytësor.

Metaforat konceptore na ndihmojnë të kuptojmë një fushë konceptore nëpërmjet një tjetre, por, siç pohon Lakoff (1987), vetëm nëpërmjet përdorimit të shprehjeve gjuhësore që lidhen me fushën burimore mund të kuptohet plotësisht fusha mbërritëse. P.sh., sipas një analize tashmë klasike të procesit metaforik të formimit të idiomave, në idiomat *e theu këmbën*, *e përdrodhi qafën*, *hëngri dhe*, *e drodhi bishtin*, *e ktheu barkun (nga dielli)*, fusha burimore e vdekjes projektohet në një fushë mbërritëse me të cilën ka lidhje metaforike. Në fushën mbërritëse jeta merr figurën e një këmbe, të qafës, të dheut, të bishtit, të barkut thyerja, përdredhja, të ngrënit, dredhja apo kthimi i të cilëve nënkupton vdekjen e vepruesit.

Për rrjedhojë, sipas gjuhësisë konjitive, idiomat nuk janë arbitrare, ato janë të motivuara. Është motivimi që i bën ato të kenë kuptim, si p.sh., *zemërimi është nxehtësi* konsiderohet si metaforë konceptore në shumë gjuhë, midis të cilave edhe në shqipe, shprehje gjuhësore e së cilës do të ishin *me gjak te ndezur (= me zemërim të madh)*, *vlon përbrenda / zien në kazan (= është shumë i zemëruar)*.

Metafora konceptore, si p.sh., *zemërimi është nxehtësi*, funksionon si element lidhës midis një fushe burimore abstrakte (si p.sh., zemërimit) dhe një fushe mbërritëse më konkrete (si p.sh., zjarrit, zierjes etj). Në këtë mënyrë metafora konceptore motivon konceptualisht përdorimin e fjalëve që lidhen me nxehtësinë, si p.sh., *i ndezur*, *zien* në idiomat të cilat tregojnë zemërim, si p.sh., *me gjak te ndezur*, *zien në kazan*. Kështu, nëpërmjet sistemit njohës të asociimit, metaforat konceptore na lejojnë të përdorim fjalë të një fushe për të folur për një fushë tjetër. Si konkluzion mund të themi se kuptimi i idiomave varet dhe është i pandashëm nga sistemi konceptor, nga mentaliteti i popullit.

Siç vëren edhe Gibbs (1993), folësit e një gjuhe duhet të pranojnë në heshtje një paraqitje metaforike të të dhënave midis dy fushave njohëse në mënyrë që një shprehje të fitojë kuptimin e saj metaforik. Në shembullin e shprehjes angleze *John spilled the beans* (lit. *John derdhi fasulet*, fig. *John nxori sekretin*), imazhi i një personi që përkulet mbi një enë që përmban fasule, transferohet te një person që zbulon një sekret të fshehur. Gibbs mendon se folësit e anglishtes e kuptojnë këtë shprehje të ngurosur, sepse zotërojnë metafora konceptore të tipit MENDJA ESHTË ENE, IDETE JANE OBJEKTE FIZIKE, që strukturojnë perceptimin e tyre për mendjen, sekretet dhe zbulimin.

Edhe pse nuk mund të parashikojmë se përse kjo shprehje lidhet me fasulet, Lakoff përpiket ta shpjegojë këtë proces në lidhje me imazhet konvencionale dhe me njohuritë tona të evokuara nga kjo shprehje: fasulet duhej të mbaheshin në enë. Derdhja është, ose duket se është, aksidentale (1987). Për rrjedhojë, këto detaje

⁵⁵ Lakoff, G. (1987). *Women, fire and dangerous things. What categories tell us about the mind.* Chicago: University of Chicago Press.

përcillen përmes imazhit dhe njohjes konceptore që lidhet me skenën literale dhe jo nëpërmjet kuptimeve të fjalëve individuale: njohja konceptore e kapërcen sasinë e informacionit të dhënë nga kuptimet individuale të përbërësve⁵⁶.

Duke plotësuar Lakoff, Kövecses and Szabó (1996) pohojnë se shumica e shprehjeve të ngurosura janë produkte të sistemit konceptor dhe jo thjesht çështje të gjuhës (dmth., të leksikut). Idioma nuk është thjesht një shprehje me kuptim i cili ka një lidhje të veçantë me kuptimet e përbërësve të idiomës, por rezulton nga njohja e përgjithshme e botës, e cila është e trupëzuar në sistemin tonë konceptor. Me fjalë të tjera, idiomat (ose të paktën shumica e tyre) janë me natyrë konceptore dhe jo gjuhësore.

Gjuhëtarët konjitivistë e shikojnë metaforën jo si sekuençë të gjuhës (fjali, sintagmë ose çfarëdo tjetër), por si “një model të të menduarit të përcaktuar nga një korrespondim sistematik midis një fushe burimore dhe një fushe mbërritëse” (Lakoff 1980, 1987) të shprehur në sekuençë gjuhësore.

Përdorimi i termit metaforë kufizohet në kuadrin konceptor, kështu që realizimi gjuhësor i metaforës konceptore nuk quhet metaforë, por shprehje metaforike⁵⁷.

Po kështu, Roff and Cruse (2004) theksojnë se “metaforat janë struktura konceptore dhe nuk janë thjesht me natyrë gjuhësore, edhe pse, natyrisht, normalisht realizohen gjuhësisht”

Sipas kësaj analize, idiomat konsiderohen si konceptore dhe së dyti si veçori e gjuhës (Kövecses, 2002), sepse kuptimi i tyre nuk bazohet në kuptimin literal të fjalëve që i përbëjnë, por në strukturën njohëse korresponduese⁵⁸.

Por motivimi i idiomave me anë të metaforës konceptore nuk ndodh në të gjitha rastet. Në lidhje me këtë fakt Gibbs (1995) vëren se “prania e metaforave konceptore me anë të të cilave ne i japim kuptim përvojës sonë, siguron një motivim të pjesshëm, pasi shprehje të veçanta përdoren për t’iu referuar ngjarjeve të caktuara”. P.sh., tek idioma (*e pagoi*) si *Frëngu pulën* është e vështirë të përcaktojmë fushën burimore dhe fushën mbërritëse si dhe metaforën konceptore që bën të mundur lidhjen ndërmjet tyre. Ka shumë pak gjasa që njerëzit të kenë njohuri për origjinën historike të kësaj njësie frazeologjike në mënyrë që të jenë në gjendje ta konceptojnë atë dhe t’i referohen situatës konkrete.

Për motivimin e idiomave, përveç metaforës konceptore, na duhet edhe njohja e rrethanave historiko-shoqërore të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në teorinë e organizimit të njohjes njerëzore. Rrethanat historiko-shoqërore lidhen me informacionin e përbashkët që njerëzit në një kulturë të caktuar kanë në lidhje me një fushë konceptore; ato ndihmojnë për motivimin e plotë të idiomave. J. Thomai (2006) thekson se “dihet që motivimi i njësive frazeologjike ka rëndësi të veçantë për zbulimin e plotë të tyre, për shpjegimin e lëvizjeve e të ndryshimeve kuptimore gjatë kalimit nga togfjalëshi i lirë në togfjalësh frazeologjik, për gjetjen e trullit gjuhësor të formimit etj”.

⁵⁶ Langlotz, A. (2006). vep. e cit.

⁵⁷ Lakoff, G. (1993). The contemporary theory of metaphor. In: Ortony, A. (ed.): Metaphor and thought. Cambridge.

⁵⁸ Baranov, A.N & /Dobrovolskij, D. (1996): Cognitive modeling of actual meaning in the field of phraseology. In: Journal of Pragmatics 25.

Nëse metafora konceptore i motivon idiomat semantiki për të kuptuar se pse kanë kuptimin idiomatik që ato kanë, rrethanat historiko-shoqërore na ndihmojnë për të kuptuar se përse idiomat përbëhen nga fjalët nga të cilat përbëhen apo se përse mbështeten te imazhi te i cili mbështeten, dmth., cili është burimi i tyre. Kështu p.sh., idioma *si kofini pas të vjelash* është formuar në lidhje me vreshtarinë, pra në troje ku ka vreshta dhe ku përdoret koshi (kofini), por mund të lidhet edhe me gjithë trojet që kanë të vjela misri dhe që këto të vjela i mbledhin me kosh, dhe shpjegon kuptimin e padobishmërisë sipas rrethanës që e lindi: mbaroi vjelja, kofini s'hyn më në punë, pra është gjë e vonuar që s'na duhet më⁵⁹.

Atëherë mund të themi që këto kushte historiko-shoqërore përbëjnë të dhënat më të domosdoshme për motivimin “kulturore” të idiomës, ndërsa për motivimin kuptimor na vjen në ndihmë metafora konceptore “*padobishmëria është vonesë*”.

Motivimi i idiomave mund të mos bëhet në gjendjen e tanishme të gjuhës. Për këtë çështje J. Thomai (1981) thekson: “Motivimi apo mosmotivimi i idiomave duhet parë në gjendjen e tanishme të zhvillimit të gjuhës shqipe, kur folësi i shqipes nuk e ndien lidhjen e kuptimit të fjalëve me kuptimin e së tërës dhe si rrjedhim ai i përdor idiomat në ligjërim si njësi të vetme e të gatshme me një kuptim të formuar, pa menduar për kujtimin e gjymtyrëve të tyre. E theksojmë këtë se mundësia e idiomave për t'u zberthyer është pasojë e zhvillimit të gjuhës. Idiomat nuk kanë qenë gjithnjë të pazberthueshme. Vetëm historikisht idiomat shqipe mund të motivohen”.

Metonimia konceptore

Ka idioma që nuk ndërtohen mbi bazën e metaforës konceptore, por që ndërtohen mbi bazën e metonimisë konceptore, si p.sh., idioma *mbledh mendjen*, ku mendja, e cila është ena sipas Lakoff (1980), përdoret në vend të përmbajtjes-objekteve që janë idetë, mendimet.

Në gjuhësinë konjitive, metonimia dallohet nga metafora. Sipas Kövecses and Szabó (1996), metonimia nënkupton një fushë konceptore sesa dy të dallueshme si në rastin e metaforës. Metonimia nënkupton një marrëdhënie konceptore “*në vend të*” midis dy entiteteve (brenda një fushe), ndërsa metafora nënkupton një marrëdhënie “*është*” ose “*kuptohet si*” midis dy fushave konceptore.

-Kufizimi morfo-sintaksor

Përbërësit e idiomës as mund të shtohen as mund të hiqen. Ato nuk mund të ndryshojnë as rendin as trajtën ashtu siç ndryshojnë normalisht shprehjet literale. Për më tepër, kur idiomat kanë vlerë foljore, nuk është gjithnjë e mundur që të kthehen në formën pësore etj. Po t'i transformojmë ose t'i modifikojmë, idiomat ose nuk kanë kuptim fare ose bëhen literale. Pra kufizimi te idiomat lidhet si me sintaksën ashtu edhe me morfologjinë. Le të fillojmë me kufizimin sintaksor të idiomave.

Kufizimi sintaksor i idiomave

Ndryshe nga sintagmat e lira, idiomat nuk u nënshtrohen të gjitha transformimeve ose modifikimeve sintaksore, si p.sh.:

Pasivizimit

Themi: *Spiuni e theu qafën*, por jo: **Qafa u thye nga spiuni*.

Veçimit së gjymtyrëve

Themi: *Spiuni e theu qafën*, por jo: **Qafën, spiuni theu*.

⁵⁹ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

Themi: *Spiuni e theu qafën*, por jo: **Ajo që theu spiuni është qafa. *Është qafa ajo që theu spiuni?*

Relativizimit

Themi: *Spiuni e theu qafën*, por jo: **Qafën që spiuni theu.*

Formës pyetëse

Themi: *Spiuni e theu qafën*, por jo: **Çfarë theu spiuni?*

Ndërtimit me kallëzues

Themi: *Pushkë e shkrehur*, por jo: **Kjo pushkë është e shkrehur*, sepse çon në lidhje të lirë. Kjo ndodh sepse përgjithësisht grupi nominal mund të analizohet si i formuar prej dy fjalish logjike, si p.sh., *një shtëpi e zbukuruar*.

-ekziston një shtëpi

-kjo shtëpi është e zbukuruar

Ky rregull nuk zbatohet në analizën e idiomave: një pushkë e shkrehur nuk është një pushkë që është e shkrehur, por një njeri i parrezikshëm.

Pronominalizimit (rimarrja me përemër)

Themi: *I dha rrugë problemit*, por jo: **Ia dha (rrugë) problemit.*

Grupet emërore në idiomën e mësipërme nuk i referohet objektit konkret, prandaj pronominalizimi është i pamundur.

Modifikimit të përbërësve

Nuk mund të përdorim modifikues për *qafë*. Nuk mund të themi: **E theu qafën e bukur*, sepse do të na çonte në lidhje të lirë.

Ndryshimit të rendit të përbërësve

Njësitë frazeologjike janë të qëndrueshme edhe nga rendi i gjymtyrëve i cili është pothuaj i pandryshueshëm. Rendi i fjalëve në njësitë frazeologjike të gjuhës sonë është në përgjithësi i ngulitur. Prishja e rendit fillestar zakonisht e prish fare njësinë frazeologjike. Kështu në idiomat *kodra pas bregut*, *me krahë hapur*, *marr vesh*, *si sytë e ballit*, gjymtyrët nuk mund të ndërrojnë vendet (**breg pas kodrash*, **me hapur krahë*, **vesh marr*, **si të ballit sytë*).

Ndryshimit të numrit të përbërësve

Njësitë frazeologjike janë të qëndrueshme edhe nga numri i gjymtyrëve. Numri i gjymtyrëve është pothuaj i pandryshueshëm. Çdo ndryshim mund të sjellë një njësi të re literale ose mund ta prishë fare njësinë frazeologjike, si p.sh., shtimi i një kundrinori të dytë emëror të bashkërenditur me të parin, si p.sh., **theu qafën dhe krahun e djathtë*.

Mund të supozojmë se ky kufizim i detyrohet faktit se lidhja midis foljes dhe dy emrave nuk është e njëjtë. Emri i parë formon me foljen një të tërë kuptimi i së cilës “iku” nuk analizohet kompozicionalisht. Mirëpo shtimi i një emri tjetër bën që të dy emrat të krijojnë me foljen një lidhje sintaksore identike dhe, për rrjedhojë, grupin foljor ta interpretojmë si sintagmë të lirë.

Edhe heqja e ndonjë fjale nga idioma do ta prishte plotësisht kuptimin e strukturës, ose të paktën kuptimin idiomatik dhe do ta kthente strukturën në lidhje të lirë, si p.sh., *heq të zitë*, në vend të *heq të zitë e ullirit*, e prish plotësisht kuptimin e strukturës, ndërsa *është e rrahur me vaj*, në vend të *është e rrahur me vaj e me uthull*, kthehet në lidhje të lirë kur përdoret për substanca të përpunuara me vaj.

Zëvendësimet të përbërësve

Idiomat nuk lejojnë zëvendësimin e përbërësve të tyre me fjalë tjetër (kuazi-) sinonime.

Themi: *Vret miza*, por jo: **Vret mushkonja* ose **Qëllon miza*, sepse ajo që do të përfitohej do të ishin lidhje të lira.

Kufizimi morfologjik i idiomave

Pikat kryesore të kufizimit morfologjik të idiomave të shqipes janë:

Trajta e (pa)shquarsisë së emrave

Si rregull, së paku një nga gjymtyrët e togfjalëshit frazeologjik, emri, mbetet gjithnjë në një trajtë të caktuar, ose në të shquar, si p.sh., *i bëj sytë katër*, *i ndeu këmbët etj.*, ose në të pashquar, *si p.sh.*, *vret miza*, *s'le dy gurë bashkë*, *kartë e djegur etj.*

Ndonjëherë trajta e emrit luan rol kuptimdallues midis idiomave të ndryshme, si p.sh., *më jep dorë "më leverdis"* dhe *më jep dorën "më ndihmon"*, *i dha rrugë "e zgjidhi"* dhe *i dha rrugët "e përzuri"*

Për shkak të ngurosjes, disa idioma, thekson J. Thomai (1981), përdoren gjithnjë vetëm me një trajtë e me një kuptim: pohues ose mohues.

Vetëm me trajtë e me kuptim pohues përdoren njësi të tilla si: *i hedh një sy*, *i bëri gropën*, *ia ndreqi samarin...*

Vetëm me trajtë e me kuptim mohues përdoren njësi të tilla si: *s' e ha atë kokërr ulliri*, *s'le dy gurë bashkë*.

Gjithnjë njësitë frazeologjike foljore që përdoren vetëm në trajtë mohuese kanë në vetvete përmbytje mohuese edhe kur dalin, p.sh., në fjali pyetëse retorike, si: *"Pse le dy gurë bashkë ai?"*, dmth., *"ai nuk le dy gurë bashkë"*.

Ndonjëherë trajta mohuese me atë pohuese kanë edhe dallime kuptimi, si p.sh., *të ka hije "të rri bukur"* – *s'të ka hije "s'është mirë për ty të veprosh kështu"*, *na çau kokën "na mërzi"* – *nuk e çau kokën "nuk u interesua"*.

Ka edhe ndonjë rast kur mungesa ose prania e kësaj trajte të shkurtër përemërore është shenjë e strukturave të ndryshme (me kuptime të ndryshme), dmth., e njësisë frazeologjike të ndryshme, si p.sh., *i shtrëngoi dorën "e përgëzoi"* dhe *shtrëngoi dorën "kurseu"*, *i bën ballë "e përballon"* dhe *bën ballë "shfaqet së largu"*.

Për shkak të ngurosjes, edhe fjalët sinonime që marrin pjesë në variante idiomatike, paraqiten në një trajtë të ngurosur të caktuar, si p.sh., krahas *hedh pas shpine* me një emër të pashquar kemi *hedh pas kurrizit* me një emër të shquar dhe nuk kemi as *hedh pas shpinës*, as *hedh pas kurrizit*.

Numri i emrave

Si pjesë e trajtës së emrit të ngurosur, nuk është vetëm se emrat mund të jenë vetëm të shquar apo të pashquar, por edhe nëse janë në një numër të caktuar. Kështu një pjesë e emrave të ngurosur në idioma dalin vetëm në numrin njëjës, si p.sh., *i kreh bishtin*, *i vuri ferrën*, *(vret) pas shpine*, (punon) pas perdes, (punon) nën rrogos, të tjerë vetëm në numrin shumës, si p.sh., *i kthej krahët (dikujt)*, *i fërkoj krahët (dikujt)*, *vret miza etj.*

Ndonjëherë numri i emrit luan rol kuptimdallues midis idiomave të ndryshme, si p.sh., *e kam halë në sy (e urrej)*, *mbylli sytë (vdiq)*, *mbylli një sy (nuk kritikoj) etj.*

Mënyra e foljeve

Disa idioma mund të përdoren vetëm në një mënyrë të caktuar foljore (si në urdhërore, dëshirore etj), si p.sh., *i lava duart* mund të përdoret me folje në mënyrën urdhërore (*laji duart*), por s'mund të përdoret me folje në mënyrën dëshirore (**i lafsh duart*); *e vrau buka* nuk përdoret me folje në mënyrën urdhërore.

Më të rralla janë ato idioma që përdoren me foljen vetëm ose kryesisht në mënyrën urdhërore, si p.sh., *mbaj gojën! Hap sytë!*⁶⁰

Koha e foljeve

Thomai (1981) pohon se një kategori gramatikore kufizuese te njësitë frazeologjike foljore të gjuhës shqipe është koha e foljes:

Kështu, një numër njësisish frazeologjike foljore përdoren me foljen vetëm ose kryesisht në të tashmen, si p.sh., *i pjell mendja, s'i hyn në kokë, bën petulla me ujë*.

Një numër njësisish frazeologjike foljore përdoren me foljen vetëm ose kryesisht në të kryerën e thjeshtë, si p.sh., *mbeti pa gojë, i ra në dorë, më ra tavani në kokë*.

Një numër njësisish frazeologjike foljore përdoren me foljen vetëm ose kryesisht në të kryerën, si p.sh., *ia ka vënë synë, i kanë rrjedhur trutë, ka lerë me këmishë, e ka mbushur kupën*,

Në përgjithësi mund të themi se kur përzgjidhet vetëm një kohë, ajo është zakonisht e kryera ose e kryera e thjeshtë për rastet që u referohen veprimeve që kanë ndodhur në të shkuarën. Por, kur idiomat tregojnë konkluzion të përgjithshëm ose diçka që bëhet në çastin e të folurit përdoret e tashmja.

Veta e foljeve

Kufizime morfologjike ka edhe në lidhje me vetën e foljes.

Konkretisht, disa idioma përdoren vetëm në vetën e tretë, sepse nuk mund të kenë kryefjalë një njeri, si p.sh., *nuk i dridhet qepalla, sikur qeni qepën të hajë! u shkon firma, s'u bë nami!*

Në disa idioma foljet përdoren vetëm në vetën e tretë, sepse nuk mund të ndryshojmë formën e foljes sipas vetës, si p.sh., *të dalë ku të dalë! të bëhet ç'të bëhet!*

Disa idioma të tjera, edhe pse përdoren në vetën e dytë, nuk i referohen folësit, por një vete me vlerë të përgjithshme, si p.sh., *s'ke ku të hedhësh majën e gjilpërës, s'ke ku të hedhësh mollën, tërhiq e mos këput, sa çel (sa hap) e mbyll sytë*.

Idiomat paraqesin veçori të tilla gramatikore, sepse përbërësit e tyre ose nuk kanë asnjë kuptim ose një kuptim i tillë nuk mund të aktivizohet në mënyrë të pavarur⁶¹.

Shkallët e ngurosjes së idiomave

Kur flasim për ngurosje të idiomave duhet të kemi parasysh se ato nuk janë aq të ngurosura sa mendohej dikur. Natyrisht, idioma plotësisht të ngurosura ka, por ka edhe idioma që nuk kanë kufizim të plotë sintaksor dhe morfologjik. Këtë e kanë provuar analistët e korpusit të anglishtes (p.sh., Sinclair 1991, Moon 1998) të cilët kanë treguar se “disa shprehje të ngurosura dhe idioma janë më të ngurosura se të tjerat dhe disa nuk ndryshojnë aspak. Megjithatë ndryshueshmëria është shumë e përhapur”⁶²

⁶⁰ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁶¹ Cruse, D.A. (2000). Meaning in Language. An Introduction to Semantics and Pragmatics. Oxford: Oxford University Press.

⁶² Moon, R. (1998). vep. e cit.

Të njëjtën gjë do të provojmë edhe ne për idiomat e shqipes.

Së pari, ashtu si edhe Moon për anglishten, ashtu edhe ne do të provojmë se në shqipe ka idioma plotësisht të ngurosurat, kryesisht me vlerë ndajfoljore, por edhe me vlerë emërore dhe mbiemërore, pavarësisht se përmbajnë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës, si p.sh., *kodra pas bregut, fol e qesh, qesh, me duar kryq, si macja me miun, për pesë para spec, qesh e ngjesh, shkel e shko, për dhjamë qeni, si cjapi te kasapi, kokë e madhe, pushkë e shkrehur etj.*

Të tjerat janë më pak të ngurosurat. Disa prej tyre janë më pak të ngurosurat në një aspekt, disa në një aspekt tjetër. Në disa raste mund të shfaqen një apo disa aspekte të caktuara, në të tjera aspekte të tjera.

Për rrjedhojë, mund të flasim për shkallë të ngurosjes apo të kufizimit morfo-sintaksor.

Le t'i shohim të gjitha transformimet sintaksore dhe kategoritë morfologjike që paraqiten si të kufizuara të idiomat, të cilat do t'i ndajmë në tri grupe:

Aspekte më pak të kufizuara

Aspekte më shumë të kufizuara

Aspekte plotësisht të kufizuara

Në aspektet më pak të kufizuara përfshihen kohët, numrat dhe vetat e foljes. Tipi foljor ku ndryshon zakonisht folja, kurse fjala tjetër jo, përbën tipin e ndryshimeve maksimale që mund të pësojnë idiomat. Mund të konstatojmë lehtësisht se në shumicën dërrmuese të rasteve mundësia e përdorimit të foljeve nuk kufizohet në një kohë, në një numër apo në një vetë të caktuar, si p.sh., *i kthej krahët dikujt/ i kthyen krahët në pleqëri/ do të t'i kthejë krahët një ditë etj.*

Sipas Ifill (2002), fakti që në idioma në shumicën e herëve folja mund të zgjedhohet në kohë, numra dhe veta të ndryshme është një tregues se idiomat nuk janë njësi plotësisht të ngurosurat dhe pa strukturë të brendshme.

Në aspektet më shumë të kufizuara përfshihen pasivizimi, pronominalizimi, modifikimi, rendi, zëvendësueshmëria

Pasivizimi

Ka shumë idioma që nuk janë plotësisht të ngurosurat dhe që mund t'i nënshtrohen pasivizimit, p.sh., nga forma veprorë *i jap dorën dikujt* mund të përftojë formën pësore “*Atij nuk i është dhënë kurrë dora*”, apo nga forma veprorë *i kreh bishtin dikujt*, mund të përftohet forma pësore “*Nuk i krihet bishti një fëmije që s'bën asgjë gjithë ditën*”.

Fakti që disa idioma pranojnë formën pësore dhe disa jo, mund të shpjegohet me transparencën sintaksore në strukturën e idiomave, një ide e sugjeruar nga Jackendoff (1997). Idiomat që e pranojnë pasivizimin duket se ngjajnë shumë sintaktikisht me korresponduesit e tyre jo idiomatikë. Për rrjedhojë, idiomat transparente sintaktikisht, si p.sh., *s'e mbyll gojën, i kreh bishtin, i jap dorën, mbyll një sy* mund të pasivizohen, ndërsa idiomat opake sintaktikisht, si p.sh., *e theu qafën* nuk mund të pasivizohen.

Kështu, përbërësit e idiomës *i jap dorën dikujt* janë një folje kalimtare dhe kundrinori i drejtë. Kjo idiomë ka të njëjtën strukturë me korresponduesen jo idiomatike dmth., strukturat e tyre korrespondojnë sintaktikisht, ndërsa përbërësit e idiomës *e theu qafën* nuk kanë korrespondim një për një me përbërësit e kuptimit

joidiomatik të strukturës. Versioni idiomatik përbëhet nga një folje kalimtare dhe një kundrinor i drejtë, ndërsa versioni joidiomatik është thjesht një folje jokalimtare – *qafa* nuk korrespondon me asgjë, sepse “*iki*” nuk mund të marrë kundrinor të drejtë.

Modifikimi

Një mënyrë tjetër me anë të së cilës idiomat mund të tregojnë ndryshueshmërinë e tyre është modifikimi i përbërësve, i cili mund të ndodhë në shkallë të ndryshme. Idiomat mund të modifikohen si një e tërë, si p.sh., “*Akoma s’e ka thyer qafën ai?*”, apo si përbërës veç e veç, si p.sh., “*besoj se paskëtaj do të verë mjaft mend*”, “*E kthehu shpejt fletën*”, “*Nuk e thyen fare zemrën*”. Në rastin e dytë fjalët modifikuese lidhen herë me njërin herë me tjetrën gjymtyrë. Kategoria leksiko-gramatikore e fjalës që ndërfitet përcaktohet nga gjymtyra prej të cilës varet formalisht. G. Gross (1996) pohon se ndërfitja e elementeve të rinj është e mundshme pikërisht pas fjalës që ka fleksion.

Rendi

Në gjuhën shqipe janë të pakta idiomat që kanë një rend të detyrueshëm fjalësh. Në shumë idioma përbërësit mund të ndërrojnë vendet, si te *s’më bën veshi tërr, e heq nga hunda, vete prapa diellit etj.*, dhe kuptimi idiomatik mos të priset: “*Po Fijes as tërr s’i bëri veshi*”, “*Prapa diellit të venë*”, ose të ndryshojnë disa nuancave shprehëse-emocionale, si te: “*I mori dreqi të tërë në atë shtëpi*”.

Pronominalizimi

Në gjuhën shqipe janë të pakta rastet e idiomave kur kundrinori nuk rimerret nga trajtë e shkurtër e përemrit vetor. Duke qenë se është në natyrën e lidhjeve të lira të gjuhës shqipe rimarrja e kundrinorit me trajtë të shkurtër të përemrit vetor, kjo gjë ka gjetur pasqyrim edhe te shumica e idiomave, si p.sh., *nuk dua t’ia shoh sytë, s’e mbyll gojën, nuk e vret mendjen, i fshehu letrat etj.*

Zëvendësueshmëria

Para se të mbyllim kapitullin mbi ngurosjen e idiomave, është e nevojshme të përmendim se ka disa përjashtime edhe në aspektin e moszëvendësueshmërisë së fjalëve në idioma me fjalë të tjera (kuazi-) sinonime. Duhet theksuar se disa idioma mund të pranojnë zëvendësimin e përbërësve me fjalë të tjera, si p.sh., *e bëri litar/ e bëri tërkuzë, i ktheu kurrizin/ i ktheu shpinën, e nxori në shesh/ e qiti në shesh, e theu qafën/ e theu zverkun, s’ia var torbën/ s’ia var trastën.*, që çon në krijimin e varianteve sinonimike idiomatike në fushën e leksikut të gjuhës.

Kjo ndodh sepse, siç thekson edhe J. Thomai (2006), “dihet që normë nuk do të thotë gjithnjë diçka “e vetme”, pa asnjë dysor a variant” Duke pasur parasysh veçoritë e normës leksikore, e cila nuk është aq “e rreptë” sa ajo fonetike e gramatikore, edhe në frazeologji do të pranohen dysorë a variante, ndonëse në mënyrë më të kufizuar, për shkak të karakterit idiomatik dhe të kufizimeve të tjera të frazeologjisë”.

Variantet leksikore sinonimike janë krijuar ose nëpërmjet gjymtyrës së parë, ose nëpërmjet gjymtyrës së dytë. Foljet apo emrat që hyjnë si variante leksikore në strukturën idiomatike mund të jenë në vetvete sinonime, si p.sh., *përvesh/ përvejël mëngët, e nxori/e qiti në shteg, i fërkon krahët/ shpatullat/ shpinën/ kurrizin, i dha rrugë/ udhë/ dum*, ose variantet leksikore krijojnë me folje apo me emra të ndryshme, pa lidhje sinonimie, si p.sh., *më luajti/ më iku tepeleku i kokës, vret/*

numëron miza, më hëngri/më plasi shpirtin, i qëroi/ i ndau hesapet, tundi dheun/dynjanë, humbi mendjen/ fillin/ pusullën, i fërkon krahët/ zverkun⁶³.

Përveç varianteve sinonimike idiomatike leksikore, në gjuhën shqipe konstatohen edhe pak variante sinonimike idiomatike gramatikore në trajta apo në rasta të ndryshme, si p.sh., *i vë kapak/ kapakun, një më hu, një më kërcu/ një në hu, një në kërcu*.

Në aspektet plotësisht të kufizuara përfshihen relativizmi, veçimi i gjymtyrëve, ndërtimi me formë pyetëse, ndërtimi me kallëzues dhe numri i përbërësve.

Tiparet e idiomave

-Tiparet më të përgjithshme të idiomave

Si tipare më të përgjithshme të idiomave janë:

Polileksikaliteti

Tipari i parë i nevojshëm i ekzistencës së idiomave është prania e dy ose më shumë fjalëve çfarëdo në përbërje të tyre, si p.sh., *marr vesh, vë re, hedh sytë, ballë për ballë, fut hundët, i ra më qafë, e merr nëpër këmbë, në tym, pas shpine, e piu, e qau, i dhashë një (në kokë) etj.*

Kufizimi leksikor

Te idiomat fjalët e kanë humbur pavarësinë e tyre kuptimore. Po të shkëputen nga togu ose po të vihen në lidhje të tjera, ato kanë kuptim tjetër, si p.sh., fjala *gisht* në “*Ka gisht në vrasjen e deputetit*” (= *ka marrë pjesë në...*), ndërsa në “*Ka një plagë në gisht, fashoi gishtin, i dhemb gishti etj*”. ka kuptimin e një pjese të dorës apo të këmbës. Përgjithësisht fjalët në përbërje të idiomës nuk mund të zëvendësohen nga fjalë të tjera (kuazi-)sinonime, si p.sh., fjala *rrogoz* në *punon nën rrogoz* nuk mund të zëvendësohet me fjalën *qilim* edhe pse janë të afërta kuptimisht.

Figurshmëria

Karakterit i figurshëm i kuptimit të të paktën një fjale përbërëse të idiomës është veçori e përgjithshme e idiomave, si p.sh., *mbylli sytë, s'ta mbush syrin* ku të gjitha fjalët e kanë humbur kuptimin e tyre literal dhe përdoren me kuptim të figurshëm jotransparent apo *jetë qeni, uri ujku* ku *qeni* dhe *ujku* e kanë humbur kuptimin e tyre literal dhe përdoren me kuptim të figurshëm transparent (*qeni=e keqe, ujku=e madhe*).

Kufizimi gramatikor

Për këtë tipar do t'i referohemi vlerësimit të J. Thomait (1981) sipas të cilit “Në njësitë frazeologjike fjalët shpesh janë të ngurosurat në një trajtë të caktuar Për këtë mjafton të vërehet se si duhet të mbetet në një formë të caktuar fjala sy në secilën prej këtyre njësiteve frazeologjike të shqipes: *m'u errën sytë, shkeli syrin, ia bëri me sy, mbylli sytë (vdiq), mbylli një sy, më ra në sy, s'kam sy e faqe, hap sytë, s'ta mbush syrin, mos i jep sy, si e ke syrin, e mori më sysh*”.

Ne nuk mund të ndryshojmë idiomat në të gjitha trajtat e tyre, nuk mund t'i modifikojmë apo të zbatojmë në të gjitha transformimet ashtu siç ndodhe me lidhjet e lira.

⁶³ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

Memorizimi dhe riprodhimi si njësi të gatshme

Në idioma lidhja e fjalëve nuk bëhet aty për aty, në çastin e ligjërimit, por është bërë me kohë, historikisht. Ato memorizohen si një e tërë nga përdoruesit e gjuhës dhe nuk prodhohen nga e para në çastin e ligjërimit, por riprodhohen në ligjërime si njësi të gatshme, të pandara.

Mosprodhueshmëria

Mosprodhueshmëria është rrjedhojë e kufizimit leksikor. Idiomat nuk përbëjnë modele produktive në gjuhë, por kjo nuk pengon ekzistencën e varianteve sinonime idiomatike, si p.sh., *vret/ numëron miza, përvesh/ përvjel mëngët etj.*

Moskompozicionaliteti

Kuptimi i shumicës së idiomave del jo nga shumica e thjeshtë e kuptimeve të fjalëve përbërëse, por nga një shkrirje kuptimore e tyre, nga një lidhje e brendshme e gjymtyrëve ose nga një shndërrim tërësor i figurshëm, që çon në një kuptim të njësuar idiomatik. Kjo duket kryesisht kur një nxënës i huaj nuk mund të interpretojë literalisht një strukturë (idiomatike), edhe pse e njeh kuptimin e zakonshëm të të gjitha fjalëve përbërëse që e përbëjnë, si p.sh., (*punon nën rrogë*).

Kuptimi i “zakonshëm” i kësaj strukture nuk na lejon të konkludojmë se struktura në tërësinë e saj ka kuptimin e një veprimi dredharak. Në këtë rast do të themi se struktura nuk ka kuptim kompozicional, por jokompozicional, gjë që është karakteristikë për shumicën e idiomave të shqipes.

Barasvlershmëria me fjalën

Barasvlershmëria me fjalën është karakteristike për idiomat me kuptim jokompozicional, dmth., është pasojë e tiparit të moskompozicionalitetit të idiomave. Shumica e idiomave të shqipes janë barasvlerës të fjalëve. Kuptimi i idiomave të barasvlershme me fjalën del nga lidhja e brendshme dhe shkrirja kuptimore e gjymtyrëve të tyre ose nga shndërrimi kuptimor i togut në tërësi dhe hyjnë në fjali si njësi të gatshme, sikurse fjalët, si p.sh., idioma *marr vesh te: e marr vesh atë që më thonë, nuk e marr vesh shokun kur flet në gjuhë të huaj, dhe u morëm vesh shumë mirë etj.*

Leksikalizimi

Edhe leksikalizimi është pasojë e moskompozicionalitetit semantik. Nga kjo pikëpamje idiomat me kuptim jokompozicional përbëjnë njësi leksikore. Është interesant fakti që, edhe pse këto idioma përbëhen nga më shumë se një fjalë, ato shpërfaqin në një farë mase shkrirjen e brendshme që e shohim te fjalët e përbëra.

-Tipare të tjera dalluese të idiomave

Si tipare të tjera dalluese të idiomave janë:

Elementet gramatikore arkaike

Një rol të rëndësishëm në ndërtimin e disa idiomave të gjuhës shqipe, dhe, për rrjedhojë, në njohjen e tyre luajnë edhe elementet gramatikore arkaike, si p.sh., *marr më sysh, luajti mendsh (nga mendja, heq qafe) më doli hundësisht, e mori më sysh.* Në këto raste idiomat nuk e kanë të nevojshme respektimin e rregullave gramatikore për të realizuar kuptimin e tyre.

Elemente leksikore dialektore

Në disa idioma të gjuhës shqipe ruhen elemente leksikore dialektore, si p.sh., *“kofini te si kofini pas së vjelash,* të cilat mundësojnë njohjen e tyre.

Elementet leksikore të huaja apo të vjetra

Në disa idioma të gjuhës shqipe ruhen disa elemente leksikore të huaja apo të vjetra që nuk kanë jetë si njësi më vete në sistemin e leksikut të shqipes, por vetëm si gjymtyrë përbërëse të idiomave, si p.sh., *më ra bretku, s'ka duk, i jap dum, bën pallë, doli në selamet, bëri vaki, ia bën hallall etj.*

Mosliteralizimi i strukturës

Disa idioma kanë kuptim literal imagjinar, gjë që ndihmon në njohjen e tyre, si p.sh., *i shkon fjala, m'u bë barku petë, vret rëndë, i bëj ballë, i bëj bisht etj.*

Si konkluzion, si tipare të përgjithshme për idiomat e shqipes mund të njohim polileksikalitetin, kufizim leksikor, figurshmërinë, kufizimin morfo-sintaksor, memorizimin, mosprodhueshmërinë, por edhe moskompozicionalitetin, barasvlershmërinë me fjalën dhe leksikalizimin për shumicën e tyre.

Përkufizimi i idiomave

Tradicionalisht idiomat janë përshkruar si shprehje gjuhësore kuptimi i të cilave është jokompozicional, dmth., kuptim i cili nuk mund të nxirret nga kuptimi i pjesëve përbërëse.

Më poshtë po rendisim disa përkufizime të autorëve dhe të fjalorëve të ndryshëm, të para nga këndvështrime të ndryshme dhe të bëra në kontekste të ndryshme kohore.

1-Kur flet për idiomat, apo njësitë frazeologjike, siç i quan ai, Bally (1909) pohon: “Thuhet që një grup formon një njësi kur fjalët që e përbëjnë humbasin çdo kuptim dhe se vetëm tërësia ka kuptim; përveç kësaj duhet që ky kuptim të jetë i ri dhe të mos jetë thjesht i barasvlershëm me shumën e përbërësve”.

2-Të emërtuara si njësi frazeologjike, sipas J. Thomait (1981), idiomat janë “bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve, që janë formuar historikisht e janë kristalizuar si njësi të pandashme dhe që nga ana e kuptimit kategorial janë të barasvlershme me fjalë të vetme.

3-Si përkufizim të nocionit të idiomës Fraser (1970) propozon se idioma është “një përbërës apo seri përbërësish interpretimi semantik i së cilës nuk është funksioni kompozicional i elementeve (formatives) prej të cilëve ajo përbëhet”.

4- Swinney dhe Cutler (1979) pohojnë se “në formën e saj më të thjeshtë idioma është një seri prej dy ose më shumë fjalësh kuptimi i së cilës nuk rezulton nga kuptimi i fjalëve që e përbëjnë”.

5- “*Oxford Dictionary of English idioms*” (1993) e përkufizon idiomën si “grup fjalësh me kuptim të qëndrueshëm që nuk mund të llogaritet duke mbledhur kuptimet e veçanta të pjesëve përbërëse”

6-“*Longman Dictionary of Contemporary English*” (1995) e përkufizon idiomën si “një grup fjalësh, i cili ka një kuptim të veçantë që është i ndryshëm nga kuptimi i zakonshëm i çdo fjale të veçantë”.

7-“*Oxford Advanced Learner's Dictionary*” (1995) e përkufizon idiomën si “një grup fjalësh kuptimi i të cilës është i ndryshëm nga kuptimi i fjalëve individuale”

8-“*Fjalori i shqipes së sotme*” (2002) e përkufizon idiomën si “shprehje me ndërtim të veçantë, tërësisht a pjesërisht të ngurosur, që përdoret në një gjuhë prej kohësh me kuptim të njësishtëm”.

9-Fjalori i greqishtes “*Fjalori i greqishtes së re standarde*” (1998) e përkufizon idiomën si “shprehje me kuptim ose sintaksë të veçantë që thuhet në një gjuhë”.

10- Riehemann (2001) e përdor termin idiomë për t’iu referuar “një shprehjeje të përbërë nga dy ose më shumë fjalë, ku të paktën një prej tyre nuk ka asnjë nga kuptimet që mund të ketë jashtë kësaj shprehjeje”.

11-Sipas Kunin (1970), “njësia frazeologjike është një kombinim i qëndrueshëm fjalësh me kuptim pjesërisht apo plotësisht të figurshëm.

12-Sipas Loelene and Maureen (2003), “idiomat janë sintagma joliterale interpretimi i figurshëm i të cilave nuk mund të nxirret nga kuptimet literale”.

13-Rowe (2004) pohon se “idioma nuk ka kuptimin që do të shpresonte dikush të kishte literalisht dhe, në shumë raste, nuk mund të përkthehet në gjuhë të tjera”.

14-Sipas Cain & Oakhill and Lemmon, (2005), “idioma është një shprehje e figurshme e cila zakonisht mund të interpretohet literalisht, por e cila merr një kuptim joliteral kur përdoret në një kontekst specifik”

15-Sipas “*Cobuild Dictionary of Idioms*” (1995), “idioma është një grup fjalësh i cili ka kuptim të ndryshëm kur fjalët përdoren së bashku nga kuptimi që do të kishte nëse kuptimi i çdo fjale do të merrej veç e veç. [...] Idiomat janë tipikisht metaforike: në fakt ato janë metafora që janë “ngurosur” apo “fosilizuar”.

16- *Simpson and Mendis (2003)* e përshkruajnë idiomën si “një grup fjalësh që gjenden në një sintagmë pak a shumë të ngurosur kuptimi tërësor i së cilës nuk mund të parashikohet duke analizuar kuptimin e pjesëve përbërëse”.

17-Sipas Fontenelle (1994), “idioma është një njësi shumëfjalëshe e ngurosur kuptimi i së cilës nuk mund të llogaritet nga kuptimet e përbërësve. [...] Në idioma nuk mund të kryhen shumë operacione sintaksore, si p.sh., pasivizimi, pronominalizimi dhe modifikimi”.

18- Moon (1998) shënon se idiomat janë shprehje tipikisht të institucionalizuara, të ngurosur leksiko-gramatikisht dhe jokompozicionale.

Kështu, siç e shohim në tetëmbëdhjetë përkufizimet që arritëm të grumbullojmë mbi idiomat apo njësitë frazeologjike, të gjitha përkufizimet i mëshojnë kuptimit të mbartur të përbërësve apo mosreferencialitetit literal, herë duke e përmendur kuptimin e humbur të gjymtyrëve si kuptim joliteral (përkufizimet 12,13,14), herë duke e nënkuptuar atë. Megjithatë, në të dyja rastet, këto përkufizime na çojnë në kuptimin e mbartur apo në mosreferencialitetin literal të gjymtyrëve, dmth., në idenë se kuptimi i idiomave është i ndryshëm nga shumica e kuptimeve literale të gjymtyrëve që është edhe kushti i nevojshëm për të gjitha frazemat, jo vetëm për idiomat.

Ndërsa për t’i dalluar idiomat si kategori më vete frazeologjike, shumica e autorëve përqendrohen në tri kritere: moskompozicionaliteti semantik, figurshmëria dhe kufizimi gramatikor.

Për mendimin tonë, nga të tria këto kritere, kriteri më pak i përgjithshëm është ai i moskompozicionalitetit, sepse, ashtu siç kemi treguar përgjatë diskutimit tonë mbi idiomat, në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera, ka edhe idioma me kuptim kompozicional.

Kështu, me përjashtim të disa përkufizimeve 1,2,6, shumë përkufizime (4,5,7,12,13,14) e lënë të hapur mundësinë që mbartja e kuptimit të jetë edhe e pjesshme, dmth., jo e të gjitha gjymtyrëve të cilat, për rrjedhojë, mbeten me kuptimin e tyre literal. Madje, mundësia e mbartjes së pjesshme të kuptimit theksohet

shprehimisht në përkufizimin 10 sipas të cilit “të paktën një” prej përbërësve të idiomës “nuk ka asnjë nga kuptimet që mund të ketë jashtë kësaj shprehjeje” si dhe në përkufizimin 11 sipas të cilit ka edhe idioma “me kuptim pjesërisht të figurshëm”.

Si rezultat i mbartjes së pjesshme të kuptimit të disa idiomave, në kuptimin idiomatik kemi kontributin e drejtpërdrejtë të të dy përbërësve: kontributin literal të njëres gjymtyrë dhe kontributin e figurshëm të gjymtyrës tjetër, i cili është transparent, të paktën në analizë, si p.sh. *qeni* = “*i keq*” te idioma *jetë qeni*. Kuptimi i idiomave del kështu i ndryshëm nga shumica e kuptimeve literale të gjymtyrëve, gjë që na ndihmon për të thënë se ka edhe idioma me kompozicionalitet semantik.

Domethënia e këtij trajtimi lidhet me ekzistencën e kompozicionalitetit semantik në disa idioma, i cili është rrjedhojë e shumës së kuptimit literal, por dhe transparent, të një përbërësi dhe të kuptimit të figurshëm, por transparent, të paktën në analizë, të përbërësit tjetër, gjë që nuk cenon përkufizimin e përgjithshëm të idiomave kuptimi i të cilave është i ndryshëm nga shumica e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse.

Në lidhje me idiomat kompozicionale është për t’u shënuar edhe fakti se ato kanë strukturë kolokacionore: fjala me kuptim literal përdoret në mënyrë të lirë dhe shërben si bazë e idiomës, ndërsa fjala me kuptim të figurshëm përdoret në varësi të bazës. Kështu, te idioma *jetë qeni*, *jetë* përbën bazën, ndërsa *qeni* përbën kolokativin e strukturës kolokacionore.

Ndërsa figurshmërinë te idiomat ne e konsiderojmë si kriter të përgjithshëm, edhe pse përmendet vetëm në disa përkufizime (12, 13, 14, 15), sepse ajo ekziston edhe kur vetëm një përbërës është i figurshëm (përkufizimi 11), dhe, për rrjedhojë, nuk mund të bashkekzistojë vetëm me moskompozicionalitetin, por edhe me kompozicionalitetin semantik.

Një kriter tjetër që merret parasysh dhe që përmendet të paktën në disa përkufizime të idiomave (16, 17, 18), por të cilin e konsiderojmë si kriter të përgjithshëm ashtu si kriterin e figurshmërisë, është kufizimi gramatikor. Në përkufizimin 18, Moon e veçon si kriter më vete dhe i mëshon në mënyrë të veçantë.

Në bazë të kriterëve të përzgjedhura prej nesh, do të propozojmë përkufizimin e mëposhtëm për idiomat e gjuhës shqipe si kategori e veçantë frazeologjike: Idioma është lidhje shumëfjalëshe e qëndrueshme me kuptim të figurshëm dhe me kufizim morfo-sintaksor, kuptimi i së cilës nuk është shumë e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse apo frazemë me kuptim të figurshëm dhe me kufizim morfo-sintaksor.

Klasifikime dhe nëngrupime të idiomave

Idiomat mund të klasifikohen sipas shkallës së motivimit të kuptimit, sipas strukturës dhe sipas vlerës leksiko-gramatikore. Klasifikimi më i përhapur i idiomave është ai sipas shkallës së motivimit.

Klasifikimi i idiomave sipas shkallës së motivimit të kuptimit është propozuar fillimisht nga Vinogradov (1947) në lidhje me idiomat e rusishtes. Ai vuri në dukje tre tipa idiomash:

a) Shkrirjet frazeologjike në të cilat përbërësit paraqesin shkallën më të lartë të përzierjes midis tyre. Në to nuk ka asnjë lidhje midis kuptimit të fjalëve individuale dhe kuptimit të gjithë idiomës. p.sh., te idioma *bëj bisht* nuk flasim për asnjë lloj bishti, por se “*dikush i shmanget një detyrimi*”. Kuptimi i përbërësve të kësaj idiome

është përthithur plotësisht nga kuptimi i gjithë idiomës e cila ka kuptim vetëm si një njësi e tërë, ndërsa fjalët përbërëse e kanë humbur kuptimin e tyre.

b) Bashkimet frazeologjike të cilat janë idioma në të cilat vërehet një farë lidhjeje midis kuptimeve të fjalëve individuale dhe kuptimit të gjithë idiomës. P.sh., idioma *i vë kapakun* ka kuptimin “*përfundoj një çështje*”.

c) Kombinimet frazeologjike në të cilat vetëm një përbërës ka kuptim të figurshëm, ndërsa të tjerët kanë kuptim literal. P.sh., në idiomën *dashuri e verbër* që nënkupton “një dashuri absurde”, fjala *e verbër* është fjala me kuptim të figurshëm.

Duke ndjekur shembullin e frazeologjisë ruse, Cowie (1988) sugjeron një dallim midis idiomave të pastra, idiomave të figurshme dhe kolokacioneve të kufizuara të anglishtes. Grupi i parë përfshin kombinime të cilat janë të pamotivueshme apo semantikisht opake, grupi i dytë paraqet një tip pjesërisht të motivuar, kuptimi i të cilave mund të shikohet si zgjerim metaforik i një farë kuptimi fillestar literal, ndërsa në grupin e tretë një përbërës përdoret në kuptimin literal.

Sipas shkallës së motivimit, idiomat e gjuhës shqipe janë kategorizuar nga Jani Thomai (1981, 2006) në njësi frazeologjike të pamotivueshme dhe në njësi frazeologjike të motivueshme.

1. Njësitë frazeologjike të pamotivueshme janë historikisht më të lashta. Karakteristikë themelore e tyre në gjendjen e sotme është pamundësia për t’u zbërthyer kuptimisht, për të nxjerrë kuptimin e së tërës nga gjymtyrët. Kuptimi i njësisve të tilla frazeologjike nuk shpjegohet dot me kuptimin e gjymtyrëve që i përbëjnë, rruga e formimit të këtij kuptimi nuk është e qartë; atë mund ta zbulojnë vetëm gjurmime historike dhe etimologjike. Të tilla janë:

-Njësitë frazeologjike që kanë në përbërjen e tyre një gjymtyrë të pamotivueshmen gjendjen e sotme, dmth., një arkaizëm leksikor: *bëj pallë, i jap dum, vë re etj.*

-Njësi frazeologjike që kanë në përbërjen e tyre një gjymtyrë të krijuar për rimë, si: *me cull e me mull, me laçka e me plaçka, me lecka e me pecka, me tesha e kotesha.....*

-Njësitë frazeologjike që kanë dalë nga një anekdotë, nga një ndodhi, nga një ngjarje historike, si: *avazi i Mukës, iu bë ferra Brahim, flet si e ëma e Zeqos majë thanës, e pagoi sa frëngu pulën, u zunë për mustaqet e Celos etj.*

-Njësitë frazeologjike që nuk kanë togfjalësh të lirë gje gjegjës, si: *i bëj ballë, i bën bisht, iu bë barku petë, m’u bë mendja dhallë, m’u bë zemra mal, ia bleu mendjen, e lëshoi gojën, ia morën mendjen, e mbloodhi mendjen, vret rëndë etj.* Këta togfjalësha kanë vetëm një kuptim të mundshëm, atë frazeologjik, pra, nuk përdoren si togfjalësha të lirë; kështu, *shet mend* folësi i shqipes e përdor vetëm si njësi frazeologjike, pasi si togfjalësh i lirë *shet mend* nuk ka jetë.

Njësitë frazeologjike të pamotivueshme quhen edhe përngjitje frazeologjike ose idioma.

Karakteristikë themelore e këtyre njësisve frazeologjike është pamundësia për t’u zbërthyer kuptimisht, pamundësia për të nxjerrë kuptimin e së tërës nga gjymtyrët.

Ajo nuk është shuma e kuptimit të gjymtyrëve. Kështu njësitë frazeologjike kanë një shkrirje të brendshme të gjymtyrëve. Kjo lidhje e brendshme në gjendjen e sotme të gjuhës (pa hyrë në shqyrtimin historik) nuk duket, pra, njësitë frazeologjike nuk motivohen. Nuk mund të vërtetojmë sot se për ç’arsye dhe në ç’rrugë është arritur

lidhja e fjalëve *bëj* dhe *pallë* për të dhënë kuptimin frazeologjik “*rri rehat, bëj qejf*” etj. Mungesa e motivimit i bën njësitë frazeologjike të këtij grupi të pazbërtheshme në gjymtyrët përbërëse.

Këto njësi frazeologjike përbëjnë shkallën më të lartë të ngurosjes dhe, si rrjedhim, në to elementet kanë humbur pavarësinë (kryesisht kuptimore). Ato kanë humbur kuptimin fillestar, përdoren vetëm në rrafshin e dytë (të figurshëm). Në kuptimin frazeologjik nuk bën pjesë asnjë prej kuptimeve literale të fjalëve përbërëse.

Këto njësi frazeologjike, më shumë se njësitë e tjera frazeologjike, shprehin veçantitë kombëtare të zhvillimit historik të gjuhës, ato nuk përkthehen në gjuhë të tjera fjalë për fjalë, pasi ndërtimi i brendshëm kuptimor është errësuar shumë përgjithësisht janë të ngurosura edhe nga forma.

2. Njësitë frazeologjike të motivueshme në gjuhën shqipe janë më të shumta dhe ndahen në disa grupe, por këtu do të shtjellojmë dy grupe:

Grupin më të pasur e përbëjnë njësitë frazeologjike që kanë dalë nga shndërrimi i figurshëm i togfjalëshit të lirë; në to do të dallohet lidhja ndërmjet kuptimit të njësisë frazeologjike dhe kuptimit të togfjalëshit të lirë prej nga buron ajo. Kemi kështu paralele dy togfjalësha homofonikë, togfjalëshin e lirë dhe atë frazeologjik.

Shkurt, të dy planet kuptimore tek i njëjti togfjalësh (si strukturë, pasi në thelb janë dy togfjalësha) dallohen qartë, por edhe lidhja ndërmjet tyre gjithashtu është e qartë. Ky është dhe motivimi i njësisë frazeologjike: qartësia e marrëdhënieve në mes të kuptimit literal të bashkimit të fjalëve dhe atij të figurshëm, si p.sh., “*Ai nuk lexonte, po kthente fletët e librit pa vëmendje...*” E njëjta lidhje fjalësh bëhet njësi frazeologjike, sapo togu përdoret në planin e dytë, të figurshëm, si p.sh., “*Qe me ne, por e ktheu fletën*” (*tradhtoi*).

Edhe më të motivueshme janë ato njësi frazeologjike që ndërtohen nga një gjymtyrë me kuptim të figurshëm (zakonisht folje) dhe me një gjymtyrë me kuptim literal (zakonisht emër). Në një farë mënyre kuptimi frazeologjik del nga ngjizja e kuptimeve të gjymtyrëve, dmth., kuptimi i figurshëm i foljes+kuptim literal i emrit; kështu, te *bëj durim* folja *bëj* është dobësuar shumë kuptimisht, nuk ka më kuptim leksikor të plotë e të pavarur, bën pak a shumë punën e një foljeje gjysmëndihmëse për të gjithë togun e fjalëve (jo si te *bëj një punë*), kurse emri *durim* ka hyrë me kuptimin literal. Për këtë arsye grupi i njësisë të tilla frazeologjike qëndron shumë afër me togfjalëshat e lirë, është si të thuash, shkalla e kalimit prej këtyre në togfjalësha frazeologjike.

Duke përfunduar me klasifikimin e J. Thomait sipas shkallës së motivimit, duhet theksuar se “kjo ndarje e përgjithshme sipas shkallës së motivimit, në dy grupe, nuk duhet menduar si e prerë, meqenëse ndërmjet grupeve ka raste kalimtare, që janë në zhvillim e sipër ose në kalim nga njëri grup në tjetrin”⁶⁴.

Thomai (1981, 2006) i ka kategorizuar njësitë frazeologjike të gjuhës shqipe edhe sipas vlerës leksiko-gramatikore në bazë të së cilës autori i ndan në pesë grupe kryesore: emëror, mbiemëror, foljor, ndajfoljor dhe pasthirmor.

⁶⁴ Thomai, J. (2006). Leksikologjia e gjuhës shqipe. Botimet Toena, Tiranë.

1. Njësitë frazeologjike emërore kanë kuptimin kategorial të emrit, dmth., kanë vlerë emërore dhe funksionojnë në gjuhë si emra, si p.sh., *ëndrra në diell, qiqra në hell, thelë mbi bisht, të hequrit dorë, mosmarrja parasys*.

Grupi i njësive frazeologjike emërore në gjuhën shqipe nuk është shumë i gjerë dhe nuk shquhet për figurshmëri të lartë ose për ngjyrim emocionues të fortë.

2. Njësitë frazeologjike mbiemërore kanë kuptimin kategorial të mbiemrit, dmth., kanë vlerë mbiemërore dhe funksionojnë në gjuhë si mbiemra, si p.sh., *është i hurit dhe i litarit, është shpirt njeriu, janë mish e thua, daulle e shpuar, si pulë e lagur, me një këmbë në varr, shkel e shko, të ha bukën e të përmbys kupën, i rrahur me vaj e me uthull*.

Njësitë frazeologjike mbiemërore përgjithësisht kanë ngarkesë emocionuese të theksuar, dhe, si njësi që shënojnë cilësi, mund të përdoren bukur për të tipizuar njerëzit sipas vetive të tyre. Ky grup në gjuhën tonë është i pasur.

3. Njësitë frazeologjike foljore kanë kuptimin kategorial të foljes, dmth., kanë vlerë foljore dhe funksionojnë në gjuhë si foljet, si p.sh., *s'e prish gjakun, e sollti në vete, vari buzët, i bëj sytë katër, e ka halë në sy, fut hundët, i doli për hundësh*.

4. Njësitë frazeologjike ndajfoljore kanë kuptimin kategorial të ndajfoljes, dmth. kanë vlerë ndajfoljeje dhe funksionojnë në gjuhë si ndajfoljet, si p.sh., *shkel e shko, aty për aty, si cjapi te kasapi, si sytë e ballit, sa për sy e faqe, me duar boshme gisht në gojë, për mustaqet e Celos, nga të fryjë era, ku ha pula gurë*.

5) Njësitë frazeologjike pasthirmore kanë kuptimin kategorial të pasthirmës, d.mth. kanë vlerë ndajfoljeje dhe funksionojnë në gjuhë si pasthirmat, si p.sh., *s'ke ç'i thua, më plaçin sytë!, punë e madhe!, t'u thaftë gjuha!, zot na ruaj!*

Njësitë frazeologjike të gjuhës shqipe autori i mësipërm (Thomai, 1981, 2006) i klasifikon edhe sipas strukturës:

Në gjuhën shqipe njësitë frazeologjike mund të kenë strukturën e një togfjalëshi ose strukturën e një fjalie.

1. Njësitë frazeologjike me strukturë togfjalëshi, sipas kategorisë leksiko-gramatikore të gjymtyrëve që i përbëjnë, janë llojesh të ndryshme, si p.sh., *me mish e me shpirt, dushk për gogla, kokërr qiqër, me zemër të ngrirë, me mendje të ngritur, për ujë të ftohtë, për faqe të zezë, i bie këmbës, i doli boja, m'u bë zemra mal, e bën qimen tra, s' shkel në dërrasë të kalbur, qesh e ngjesh, fol e qesh, s'ha shqip*,

2. Njësi frazeologjike me strukturë fjalie janë më të rralla në gjuhën tonë. Ato përbëhen zakonisht nga dy gjymtyrë dhe nisin me një fjalë përemërore, shërbyese etj., si p.sh., *me, sa, tek, ku* etj. Megjithatë, ngjashmëria ndërmjet këtyre njësive frazeologjike dhe fjalive nga burojnë në përgjithësi është e jashtme: nga kuptimi dhe funksioni në gjuhë ato mbeten të njëvlershme me fjalën. Ato hyjnë vetë në fjali të tjera si të ishin fjalë, si p.sh., *“ne kemi lindur këtu, ku ha pula gurë”*. *“Vinin tek i shpите era”*.

Klasifikimi dhe nëngrupimet tona të idiomave:

Klasifikimi i idiomave sipas vlerës leksiko-gramatikore

Për sa i përket klasifikimit sipas vlerës leksiko-gramatikore, do të bëjmë tonin klasifikimin e mësipërm të propozuar nga Jani Thomai në:

1. Idiomat emërore të cilat kanë kuptimin kategorial të emrit.

2. Idiomat mbiemërore të cilat kanë kuptimin kategorial të mbiemrit.

3. Idiomat foljore të cilat kanë kuptimin kategorial të foljes.
4. Idiomat ndajfoljore të cilat kanë kuptimin kategorial të ndajfoljes.
5. Idiomat pasthirmore të cilat kanë kuptimin kategorial të pasthirmës.

Klasifikimi strukturor i idiomave

Edhe për sa i përket klasifikimit sipas strukturës, do të bëjmë tonin klasifikimin e mësipërm të propozuar nga Jani Thomai:

1. Idiomat me strukturë togfjalëshi, sipas kategorisë leksiko-gramatikore të gjymtyrëve.

2. Idiomat me strukturë fjalie të cilat përbëhen zakonisht nga dy gjymtyrë dhe nisin me një fjalë përemërore, shërbyese etj., si p.sh., *me, sa, tek, ku* etj.

Në lidhje me strukturën e idiomave, do të dallojmë disa nëngrupime të veçanta strukturore, si p. sh., idiomat me strukturë binare, idiomat me strukturë krahasuese dhe idiomat me strukturë të reduktuar/zgjeruar:

Idiomat me strukturë binare

Nëngrupi i idiomave me strukturë binare lidhet me binomet (e pakthyeshme frazeologjike) që janë sekuenca gjuhësore të përbëra nga dy fjalë të së njëjtës pjesë të ligjëratës që kanë lidhje kuptimi apo që përsëriten, dhe që i përkasin të njëjtës pjesë të ligjëratës, të vendosura përgjithësisht në të njëjtin nivel të hierarkisë sintaksore, të lidhura përgjithësisht me lidhëza bashkërenditëse dhe që zakonisht kanë rend të pakthyeshm⁶⁵, si p.sh., *gjallë a vdekur, larg e larg, fët e fët, degë më degë, gju më gju, flakë për flakë, dhëmbë për dhëmbë, vend a pa vend, shkel e shko, qesh e ngjesh, fol e qesh, qesh e ngjesh, shkel e shko, as mish as peshk, kockë e lëkurë, i hurit dhe i litarit, mish e thua, këmba këmbës, me sot me nesër.*

Ky grup është i pasur me lloje të ndryshme strukturash, prej të cilave dallojmë:

Idioma me vlerë mbiemërore, si p.sh., *fol e qesh, qesh e ngjesh, shkel e shko, as mish as peshk, kockë e lëkurë, i hurit dhe i litarit, mish e thua.*

Idioma me vlerë ndajfoljore, si p.sh., *larg e larg, fët e fët, degë më degë, gju më gju, flakë për flakë, dhëmbë për dhëmbë, vend a pa vend, kodra pas bregut, shkel e shko, qesh e ngjesh, gjallë a vdekur.*

Idioma me vlerë foljore, si p.sh., *merr e jep, të lan e të lyen, vetë shkruan vetë vulos.*

Idiomat me strukturë krahasuese

Një numër i konsiderueshëm idiomash formohen nëpërmjet krahasimit, si p.sh., *(Flet) si miza në qyp (dikush), (E shikon) si dhelpira pulën (dikë a diçka), (E ruaj, e dua) si dritën e syrit (e syve), (Rri) si pulë e lagur, (vajti) si cjapi te kasapi, (ka) sa të hanë qentë, (dridhet) si gjethe plepi, (njihet) si kau balash, e ka si halë në sy "e urren"*

Sintagmat krahasuese ndërtohen me elementet e mëposhtme krahasuese:

1) Me lidhëzën *si*, si p.sh., *si dhelpira pulën, si dritën e syrit, si sëpata pa bisht, si kali në lëmë, si bukë me djathë*⁶⁶.

2) Me lidhëzën *sa*, si p.sh., *sa frëngu pulën, sa hap e mbyll sytë, sa të hanë qentë, sa gishtat e dorës*⁶⁷.

⁶⁵ Për më tepër shih në kreun e binomeve të pakthyeshme.

⁶⁶ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁶⁷ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

3) Në fjalorët shpjegues (FGjSSH, FFSH, FGjSh etj.) dhe në ata dy- e shumëgjuhësh thuajse mungojnë idiomat të ndërtuara me lidhëzën krahasore posi. Shkaku duhet kërkuar, besojmë, jo te mospërdorimi a te mosgjallimi i strukturave frazeologjike me këtë lidhëz, sesa te ligji i ekonomisë në gjuhë. Meqenëse si dhe posi janë sinonime, ato lehtësisht e zëvendësojnë njëra-tjetrën. Në situata ligjërimore të ndryshme hasim ndërtime edhe me si, edhe me posi (e kushtëzuar edhe nga përzgjedhja vetjake e mjeteve shprehëse nga folësit): *si / posi peshku pa ujë, (ra) si / posi vetëtimë në qiell të kaltër etj*⁶⁸.

Në idiomat me strukturë krahasuese, idiomat përfshijnë lidhjen semasiologjike të krahasimit e cila, ndryshe nga metafora, është e dukshme në strukturë. Edhe pse të dyja, krahasimet dhe metaforat, janë forma krahasimi, krahasimet indirekt krahasojnë të dyja idetë duke i lënë të dallueshme pavarësisht nga ngjashmëritë e tyre, ndërsa metaforat krahasojnë dy gjëra drejtpërsëdrejti.

Një nga dukuritë më interesante gjatë shndërrimit të një sintagme të lirë në idiomë është lëvizja semantike te gjymtyra që shërben si krahasim, p.sh., *si peshku pa ujë "pa ndihmë"*. Lëvizja semantike ndodh në sintagmat krahasuese pavarësisht nga numri i gjymtyrëve shënuese që marrin pjesë në to. Këtë gjë na e mundëson teoria e sintagmës që ne kemi përqafuar në fillim të disertacionit. Për rrjedhojë, si te idiomat e tjera që janë formuar nga shndërrimi i figurshëm i strukturave sintagmore gjegjëse, si p.sh., *pas shpine, në tym, e hëngri, e piu, ua mbathi etj.*, ashtu edhe te idiomat e mësipërme me strukturë krahasuese, kemi shkrirje kuptimore të fjalëve përbërëse të edhe të sintagmave krahasuese minimale të formuara nga lidhëza krahasuese si + një fjalë emërtuese, si p.sh., *si rrufeja, si çeliku, si bora, si furrë, si burrat, si i vdekur, si qen*.

Kjo nuk është dukuri vetëm e shqipes. Ne mund të gjejmë njësi të ndërtuara sipas këtij modeli edhe në gjuhë të tjera me shkallë të lartë përpunimi, si në anglishte: *(He fights) like a lion, (to swim) like a dolphin, (to slither) like a snake, (to drink) like a fish, (to eat) like a horse, (to go) like a wind etj.*; në italishte: *(dormire) come on angioletto, (lavorare) come un cane, (morire) come un cane*; në frëngjishte: *(ennuyé) comme la pluie, (lutter) comme un diable, (manger) comme un cochon, (rusé) comme un renard*; në greqishte: *(κόκκινος) σαν αίμα, (κολυμπάει) σαν δελφίνι, (τραγουδώ) σαν αηδώνι, (μαύρος) σαν αράπης etj.*

Ashtu si për idiomat e tjera, kufizimi gramatikor është karakteristik edhe për idiomat me strukturë krahasuese.

Përbërësit e tyre nuk mund të ndryshojnë edhe nëse zëvendësimi nuk bie ndesh me logjikën apo realitetin jashtëgjuhësor, si p.sh., *flet si miza në qyp, e shikon si dhelpra pulën, i shpejtë si rrufeja, i fortë si çeliku, i bardhë si bora, më digjet koka si furrë, e bëri si burrat, fle si i vdekur, vdes si qen, sa për emër, sa për sy e faqe, sa për figurë*.

Edhe modifikimi i sintagmës krahasuese është i ndaluar, si p.sh., **flet si miza në qypin e madh, *i shpejtë si rrufeja e beharit, *sa për shumë figurë*.

As relativizimi i emrit nuk është i mundur, si p.sh., **e shikon si dhelpra pulën që fle, *vdes si qen që s'ka të zot*.

⁶⁸ Memisha, V. (2006). vep. e cit.

Si rezultat i kufizimit të aspekteve të mësipërme gramatikore, edhe idiomat me strukturë krahasuese janë të ngurosura, madje përbëjnë njësi semantike me vlerë fjale, si p.sh., (*do të bëhet si vdekja = patjetër, (vdes) si qen = i braktisur, (punon) si qen = shumë*).

Ndryshe nga idiomat me strukturë krahasuese, gjymtyra pas lidhëzës krahasuese shërben thjesht si pjesë krahasimi për të parën në rastet kur nuk kemi shkrirje kuptimore të sintagmës krahasuese, por kur kemi raste konkrete krahasimi, si p.sh., (*ai është aq i shpejtë sa i vëllai, (ai nuk studion) sa Agroni*, dhe së bashku me lidhëzën krahasuese përbëjnë sintagma krahasuese të lira.

Nga sintagmat krahasuese, do të pranohen si idioma ato që janë më të njohura dhe të konvencionalizuara, si p.sh., *i bardhë si bora*, por jo: **i zi si sterra*, pavarësisht se themi “*sterrë i zi*”; as **si tryelë*, te shembulli nga letërsia artistike “*Mbi të gjitha s’e linte të qetë mendimi se po e ndiqnin, se donin ta kapnin. Ky mendim ia shponte trupë si tryelë*”, e cila mbetet thjesht metaforike dhe e pakonvencionalizuar.

Idiomat me strukturë krahasuese mund të modifikojnë:

Një mbiemër, si p.sh., *kokëfortë si mushkë, i shpejtë si era, i shpejtë si rrufeja, i shpejtë si vetëtima, i fortë si çeliku, i fortë si dem etj.* Që në fjalën e parë shprehim atë që është më e rëndësishme, dmth., mbiemrat, si p.sh., *kokëfortë, i shpejtë*. Krahasimet janë të lehta për t’u gjetur (*si mushkë* dhe *si rrufeja* respektivisht) dhe idiomat për t’u kuptuar (*shumë kokëfortë* dhe *shumë i shpejtë* respektivisht). Sintagmat krahasuese që modifikojnë mbiemrat marrin vlerën e superlativëve.

Një folje, si p.sh., *më digjet koka si furrë, e bëri si burrat, fle si i vdekur, fle si një baldosë, vdes si qen, këmbëngul si mushkë, do të bëhet si vdekja, të rrojë sa bjeshkët! etj.* Që në fjalën e parë shprehim atë që është më e rëndësishme, dmth., foljet, si p.sh., *vdes, këmbëngul*. Krahasimet janë të lehta për t’u gjetur (*si qen* dhe *si mushkë* respektivisht) dhe idiomat për t’u kuptuar (*vdes i braktisur* dhe *këmbëngul shumë* respektivisht). Sintagmat krahasuese që modifikojnë foljet marrin vlerën e sasioreve.

Sipas Mejri (1994), “pjesa e dytë e krahasimit përbën një përsëritje të së parës, por në mënyrë indirekte”

Ka raste kur folja apo mbiemri i modifikuar përbëjnë pjesë të strukturës idiomatike dhe, për rrjedhojë, kemi shkrirje të plotë kuptimore të dy gjymtyrëve- të gjymtyrës krahasuese dhe të gjymtyrës së modifikuar-, për realizimin e një kuptimi frazeologjik, si p.sh., *ha si ari = përfitoj shumë, rrëshqet si ngjalë = dredhon, i vajti bari sa hanxhari = shpenzoi shumë, i ra si plumb ajo fjalë = e goditi shumë*.

Idiomat me strukturë të reduktuar dhe të zgjeruar:

Idiomat me strukturë të reduktuar

Një dukuri tjetër me rëndësi në ndërtimin e idiomave të gjuhës shqipe është edhe cungimi apo reduktimi, kur njëra gjymtyrë nuk shprehet gjuhësisht, si p.sh., *të merr gjak (+në vetull), ia mblodhi këmbët (+në një këpucë), ka mizën (+nën kësulë), ia preu (+mendja), s’ia thotë (+mendja), ua mbathi (këmbëve, s’ia pret (mendja), s’e vlen (barra qiranë)*⁶⁹. Në këtë rast një pjesë e idiomës hiqet dhe pjesa e mbetur, si rezultat i një ngjeshjeje të brendshme semantike, merr mbi vete gjithë peshën kuptimore të idiomës së mëparshme e cila vijon të përdoret në gjuhë dhe me të cilën

⁶⁹ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

hyn në marrëdhënie sinonimike. Ajo bëhet mbartësja e vetme e gjithë përmbajtjes së togut të fjalëve. Kështu që gjymtyrët e tjera nuk janë më të domosdoshme, bien, hiqen, struktura sintagmore cunohet⁷⁰.

Reduktimi është funksional dhe i nevojshëm kur format origjinale janë tepër të gjata.

Shkalla më e lartë e reduktimit është kur mbetet vetëm një folje e paraprirë nga trajta e shkurtër e përemrit vetor, si p.sh., *ua mbathi, e piu, e hodhi etj.*

Pavarësisht nga shkalla e reduktimit, struktura e re përbën sintagmë të mjaftueshme për t'u quajtur idiomë, sepse plotëson kushtin e polileksikalitetit, të figurshmërisë dhe të kufizimit gramatikor.

Idiomat me strukturë të zgjeruar

Jani Thomai (1999) ka vënë në dukje se “njësi frazeologjike sinonimike përbëhen nga zgjerimi i strukturave, si: *u bë tym / u bë tym e flakë / u bë tym e mjegull; ha veten (për diçka) / ha veten me dhëmbë (për diçka);*

Struktura më e gjerë mbart një nga kuptimet e strukturës më të ngushtë (dhe në këtë rast gjymtyra plus ka funksion kufizues), ose shpreh nuanca të veçanta, si intensitet, përsheptim, zgjatje etj. (e në këtë rast gjymtyra plus ka funksion plotësues). Por ka raste që strukturat më të gjera fitojnë një vlerë shtjelluese të semantikës frazeologjike, si tek *e hodhi lumin / e hodhi lumin pa u lagur / e hodhi lumin pa lagur këmbët.*

Klasifikimi i idiomave sipas shkallës së motivimit semantik:

Për sa i përket klasifikimit sipas motivimit semantik, do të propozojmë klasifikimin e mëposhtëm.

Në bazë të mundësisë së motivimit të idiomave në gjendjen e sotme, do t'i ndajmë në dy grupe:

1) **Idioma të pamotivueshme**, si p.sh., *bëj pallë, i jap dum, vë re, me lecka e me pecka, me tesha e kotesha, avazi i Mukës, iu bë ferra Brahim, i bëj ballë, i bën bisht etj.* Idioma të pamotivueshme janë strukturat idiomatike kuptimi i figurshëm i të cilave nuk lidhet me ndonjë kuptim literal të strukturave homoforre. Kuptimi literal nuk ekziston realisht dhe, rrjedhimisht, mungesa e imazhit të skenës literale mund të pengojë përpjekjen për krijimin e imazhit të metaforës konceptore si dhe të kupturit e kuptimit idiomatik.

Thomai propozon katër grupe idiomash (apo njësisish frazeologjike, siç i quan ai) të pamotivueshme në gjuhën shqipe:

-Njësitë frazeologjike që kanë në përbërjen e tyre një gjymtyrë të pamotivueshmen gjendjen e sotme, dmth., një arkaizëm leksikor: *bëj pallë, i jap dum, vë re etj.*

-Njësi frazeologjike që kanë në përbërjen e tyre një gjymtyrë të krijuar për rimë, si: *me cull e me mull, me laçka e me plaçka, me lecka e me pecka, me tesha e kotesha etj.*

-Njësitë frazeologjike që kanë dalë nga një anekdotë, nga një ndodhi, nga një ngjarje historike etj: *avazi i Mukës, iu bë ferra Brahim, flet si e ëma e Zeqos majë thanës, e pagoi sa frëngu pulën, u zunë për mustaqet e Celos etj.*

⁷⁰ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

-Njësitë frazeologjike që nuk kanë togfjalësh të lirë gjegjës: *i bëj ballë, i bën bisht, iu bë barku petë, m'u bë mendja dhallë, m'u bë zemra mal, ia bleu mendjen, e lëshoi gojën, ia morën mendjen, e mblodhi mendjen, vret rëndë*. Këta togfjalësha kanë vetëm një kuptim të mundshëm, atë frazeologjik, pra, nuk përdoren si togfjalësha të lirë; kështu, shet mend folësi i shqipes e përdor vetëm si njësi frazeologjike, pasi si togfjalësh i lirë shet mend nuk ka jetë.

2) **Idioma të motivueshme** të cilat ndahen më tej në:

2a) Idioma të motivueshme me figurshmëri të plotë dhe me kufizim të plotë gramatikor, si p.sh., *i kthej krahët, i fërkoj krahët, s'e mbyll gojën, pas shpine, si sëpata pa bisht etj.*

2b) Idioma të motivueshme me figurshmëri të pjesshme dhe me kufizim të pjesshëm gramatikor, si p.sh., *jetë qeni, sjellje kalamajsh, uri ujku, humbas trenin etj.*

Idiomat e motivueshme janë struktura idiomatike kuptimi i figurshëm i të cilave është i lidhur fort me kuptimin literal të strukturave homoforme.

Idiomat e motivueshme kanë gjegjës literal dhe, për rrjedhojë, imazhi i skenës literale kontribuon në të kuptuarit e kuptimit idiomatik. Të dy planet kuptimore, ai literal dhe ai i figurshëm, si dhe lidhja ndërmjet tyre dallohen qartë. Siç shprehet edhe Thomai (1981), “ky është dhe motivimi i njësisve frazeologjike: qartësia e marrëdhënieve në mes të kuptimit literal të bashkimit të fjalëve dhe atij të figurshëm, si p.sh., “*Ai nuk lexonte, po kthente fletët e librit pa vëmendje...*” E njëjta lidhje fjalësh bëhet njësi frazeologjike, sapo togu përdoret në planin e dytë, të figurshëm, si p.sh., “*Qe me ne, por e ktheu fletën*” (tradhtoi)”.

Nëngrupi i dytë i grupit të dytë të idiomave ndryshon nga idiomat e tjera, sepse në këto idioma vetëm njëra fjalë hyn me kuptim të figurshëm, p.sh., *qeni = “i keq”* të *jetë qeni, trenin = shansin* të *humbas trenin*, i cili është edhe transparent, të paktën në analizë, ndërsa fjala apo fjalët e tjera hyjnë me kuptimin e tyre literal. Për rrjedhojë, këto idioma paraqesin figurshmëri të pjesshme dhe kufizim të pjesshëm gramatikor (vetëm të njëres gjymtyrë), por ajo që është më e rëndësishme është se, për arsye të transparencës së kuptimeve të përbërësve, këto idioma formohen si shumë e kuptimeve të fjalëve përbërëse, pra me kompozicionalitet semantik, dhe nuk përbëjnë njësi të vetme semantike dhe, rrjedhimisht, as njësi të leksikalizuara, por dy apo më shumë njësi leksikore të veçanta.

Formimi i idiomave

Idiomat e gjuhës shqipe janë formuar në rrugë dhe mënyra të ndryshme:

1) Shumica e idiomave janë formuar nga shndërrimi i figurshëm i sintagmave të lira. Këto struktura e kanë nisur jetën e tyre si sintagma të lira dhe kanë përfunduar në sintagma të qëndrueshme, pas përdorimit metaforik. Burger (1973) sqaron se, kur një sintagmë vendoset në një ambient të ri gjuhësor, te i cili zakonisht nuk shfaqet, atëherë sintagma rikuptimësohet. Greciano (1993) shpjegon se idioma pëson një demotivim leksikor për të humbur kuptimin literal para se të rimotivohet duke gjetur një kuptim të figurshëm.

Kështu, një individ i caktuar përdor një strukturë, e cila përgjithësisht përfshin fjalë të jetës së përditshme, në mënyrë të figurshme në një situatë të veçantë. Kjo shprehje metaforike përdoret shpesh me një kuptim të veçantë, pastaj humbet individualitetin e saj dhe komuniteti gjuhësor e depoziton kuptimin metaforik si një

nga kuptimet standarde të shprehjes dhe së fundi pranon përdorimin metaforik në të folurën e tij.

Thomai (1981) thekson shprehimisht: “Një togfjalësh i lirë kalon në njësi frazeologjike duke u përdorur vazhdimisht dhe duke u përsëritur për një kohë të gjatë jo me kuptimin e tij literal (në rrafshin e parë kuptimor), por me kuptim të figurshëm (në rrafshin e dytë kuptimor). Togfjalëshi përdoret për çdo rast të ngjashëm dhe dalëngadalë shpëputet nga kuptimi i parë, literal, kristalizon kuptimin e figurshëm”, si p.sh., *i kthej krahët diku* a)strukturë e lirë me kuptim sipas shumës së kuptimeve literale të përbërësve 2)strukturë frazeologjike me kuptimin “*e braktis dikë*”.

2)Një pjesë e idiomave janë formuar jo nga shndërrimi i figurshëm i sintagmave të lira, por nga struktura me kuptim literal imagjinar, si p.sh., *mbledh mendjen, shes mend, i bëj ballë, i bëj bisht, e lëshoi gojën, i pret gjuha etj.* Ky grup idiomash karakterizohet nga një kuptim literal joreal, imagjinar, i ekzagjeruar dhe madje i pamundur.

Kjo anomali shpjegohet sipas një analize më të thelluar të procesit metaforik. Siç shpjegojnë Fauconnier. & Turner (2002) metafora nuk konsiston thjesht në vendosjen e një korrespondimi me analogji midis një fushe burimore dhe një fushe mbërritëse, ajo nuk është një transferim i thjeshtë i një fushe në një tjetër. Në fakt fushat burim dhe objektiv paraqiten në këtë proces nëpërmjet dy hapësirave mendore hyrjesh të dhënash lidhja e të cilave prodhon, midis gjërave të tjera, një hapësirë të tretë që jo vetëm përbën një bashkim sinkretik nëpërmjet korrespondimit të tipareve të të dy fushave, por që ka gjithashtu karakteristika që nuk i përkasin asnjërës fushë. Kështu, te idioma “*e lëshoi gojën*”, njeriu nuk e lëshon gojën normalisht, por as kur shan.

Në fakt, këtë mungesë lidhjeje dhe këtë absurditet, Smith (1925) i konsideron si faktorë të rëndësishëm për lindjen e shumë idiomave.

3)Disa idioma kanë në përbërjen e tyre një gjymtyrë të krijuar për rimë, si p.sh., *me cull e me mull, me laçka e me plaçka, me lecka e me pecka, me tesha e kotesha etj*⁷¹.

4)Disa idioma janë formuar nga reduktimi i idiomave të tjera, si p.sh. *e piu, ua mbathi etj.*

5)Një numër idiomash mund t’i gjejmë në zgjerimin e idiomave të tjera, si p.sh., *u bë tym / u bë tym e flakë / u bë tym e mjegull; ha veten (për diçka) / ha veten me dhëmbë (për diçka)*⁷².

6)Disa idioma janë formuar me prejardhje nga vetë idiomat, si p.sh., *nga vë në jetë kemi vënia në jetë, nga vë dorë kemi vënia dorë, nga heq dorë kemi heqja dorë etj.*

7)Disa idioma janë formuar me prejardhje nga proverbat, p.sh., nga proverbi *një dru i shtrembër prish gjithë stivën* është formuar idioma *dru i shtrembër*.

8)Disa idioma janë formuar nëpërmjet huazimeve nga gjuhët e tjera, si p.sh., *më bën përshtypje, ka vend, vë pikën mbi i, marr pjesë, hedh hije, thyej akullin etj.* Edhe

⁷¹ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

⁷² Thomai, J. (1999). vep. e cit.

dukuria e huazimit përbën një burim strukturash të reja të figurshme, sepse, edhe pse idiomat konsiderohen si një mënyrë e të menduarit specifike për një gjuhë të dhënë, “shumica e lokucioneve të figurshme udhëtojnë. Ato kapërcejnë kufijtë gjuhësorë me një lehtësi shumë më të madhe se faktet e thjeshta materiale të fjalorit. Frazologjia europiane është e mbushur me kalke të cilat gjenden në krah të krijimeve autoktone”⁷³.

Llojet e idiomave nga pikëpamja e lidhjes së kuptimit idiomatik me kuptimin literal

Lidhja midis përbërësve të idiomave mund të jetë normale apo jonormale. Për rrjedhojë, dallojmë dy lloje idiomash:

Idioma me lidhje normale të përbërësve, të cilat janë ato që si rregull kanë kuptim edhe si kombinime të lira, dmth., dalin me dy plane kuptimore të mundshme, si p.sh., *i kthej krahët diku* a) sintagmë e lirë me kuptim sipas shumës së kuptimeve literale të përbërësve b) strukturë frazeologjike “*e braktis dikë*”

Idioma me lidhjet jonormale të përbërësve, të cilat kanë vetëm një plan kuptimor të mundshëm, atë frazeologjik, si p.sh., *iu bë gjaku ujë, shet mend, i bën bisht, mblidhi mendtë etj.*

Shumica e idiomave me lidhje jonormale të përbërësve normalisht njihen dhe interpretohen si të figurshme, por ekziston mundësia, për ata që duan të luajnë me gjuhën, të krijojnë kontekste në të cilat do të mund t’i përdornin me një kuptim literal për të krijuar një efekt humoristik për arsye të aspekteve eventualisht të papërputhshme që rezultojnë prej tyre.

Prejardhja e idiomave:

Prejardhja vendase e idiomave

Nga prejardhja, pjesa kryesore e idiomave të shqipes është krijim vendas, brenda ligjërimeve popullore. Brenda prejardhjes vendase do të dallojmë dy drejtime kryesore: prejardhjen jashtëgjuhësore dhe prejardhjen gjuhësoret të idiomave.

Prejardhja jashtëgjuhësore e idiomave

Shumica e idiomave të burimit vendas kanë prejardhje jashtëgjuhësore; ato kushtëzohen më shumë nga rrethanat jashtëgjuhësore socio-kulturore sesa nga struktura dhe sistemi i gjuhës.

Duke u mbështetur në aspektin shoqëror-kulturor, mund të dallojmë disa grupe idiomash të shqipes:

1) Grupin kryesor e bëjnë idiomat e krijuara mbi bazën e sendeve e të dukurive të jetës së përditshme dhe që e rrethojnë njeriun. Si gjymtyrë të këtyre idiomave janë fjalë që emërtojnë marrëdhënie farefisnore, pjesë të trupit të njeriut, pjesë të shtëpisë, enë e veshje, vegla pune, bimë e kafshë të njohura, veprime të ndryshme e procese pune etj. Shumë idioma të këtij grupi lidhen me jetën fshatarake e baritore, shprehin këtë mënyrë të jetesës dhe të menduarit dhe në përgjithësi janë të motivueshme me përbërësit e kësaj jete, si p.sh., *kreh bishtin, i vuri ferrën, i rropi lëkurën, iu bë prag, s’ia ha qeni shkopin, ku të shpie mushka, iu bë rrodhe, për dhjamë qeni, stan me lepuj, kërcu mbi samar, gur në opingë, thelë mbi bisht, e hodhi lumin, i ngriti*

⁷³ Tallgren-Tuulio. O.J. (1932): « Locutions figurées calquées et non calquées. Essai de classification pour une série de langues littéraires », *Mémoires de la Société Néo-philologique de Helsinki*, vol. 9

potkonjtë, viç i palëpirë, ashtu i do mushka drutë, qeni qepën të hajë, s'e vlen barra qiranë, i mbylli shtegun, me bisht në shalë etj. Më dukshëm shfaqet natyra popullore e formimit të idiomat që mbështeten në krahasime me sende e dukuri të zakonshme, kryesisht të jetës fshatarake, si p.sh., *u bë derr, u bë pulë, u bë bishë, m'u bë ferrë, u bë petë, u bë gur, u bë grusht, u bë shoshë, u bë lule, u bë nuse, e ka halë në sy, m'u bë zemra mal, m' u bë koka daulle, e bën mizën buall, si sëpata pa bisht, si qeni në vresht, si kau balash, si cjapi te kasapi, si rrodhja pas gunës, si gjilpërat majë më majë, si macja me miun, si qeni me macen, si kali në lëmë, si hu gardhi etj*⁷⁴.

2) Fondi i idiomave me prejardhje jashtëgjuhësore vjen e pasurohet me shprehje që janë formuar në profesione të ndryshme⁷⁵, shumë prej të cilave tashmë janë përgjithësuar, si p.sh., *i hurit dhe i litarit, i kreh bishtin, çan dërrasa, i shkeli gazin, i dha lustër, i nxori rrënjën katrore, e shumëzoi me zero, e vuri në zgjedhë, i zuri rrota bishtin, i vuri fshesën, i shtiu mizat, si kalë pa fre, i nxori bojën, u bë derr, u bë bishë, u bë pulë etj.*

Ka edhe formime librore më të reja: *violina e parë, i jep tonin, me të gjitha velat, i nxjerr rrënjën katrore, e shumëzoi me zero, shkopi i dirigjentit.....*⁷⁶

3) Një grup më të madh përbëjnë idiomat me burim dialektor. Veprimi pasurues i të dy dialekteve mbi gjuhën letrare shqipe ka krijuar gjendjen që frazeologjia të përgjithësohet pa ndonjë pengesë të karakterit tokësor⁷⁷, shumë prej të cilave tashmë janë përgjithësuar, si p.sh., *ia çoi zemrën peshë, ngrehu veshët, si vaji përmbi uthull, kodra pas bregut, ia bëri mendjen dhallë, e vuri në bisht të lahutës etj.*

4) Një grup të veçantë përbëjnë idiomat me prejardhje episodike, nga ndodhi të ndryshme, nga fabulat e nga materialet historike, që kanë dalë si shprehje e moralit të fabulës a të ngjarjes, si p.sh., *për mustaqet e Celos, sa frëngu pulën, e lëshon brezin "jep shkak për grindje", që në kohën e Baba Qemos, avazin e Mukës, si Xhaferri simiten, si breshka te nallbani, i bëhet ferra Brahim, si e ëma e Zeqos majë thanës, i bie legenit, (shkoi) dushk për gogla "shkoi me të hedhur, me hile", të shuan pishën etj*⁷⁸.

5) Shumë idioma janë formuar brenda gjuhës shqipe sipas strukturave të veta ose sipas mënyrës shqiptare së të menduarit⁷⁹ mbi bazën e strukturave me kuptim literal imagjinar, si p.sh., *zë ngoje, shet mend, e mblodhi mendjen i shkon fjala, e lëshoi gojën, m'u bë barku petë, vret rëndë, flakë për flakë, me laçka e me plaçka, të lan e të lyen etj*

Shumica prej këtyre grupeve përbëjnë shtresa të qëndrueshme të prejardhjes së njësive frazeologjike nga burimi vendas, të cilat nuk kanë paralele në gjuhë të tjera dhe shprehin kështu kushtet e veçanta historiko-shoqërore e kulturore të popullit tonë. Por kjo nuk e përjashton mundësinë edhe brenda këtyre shtresave (sidomos në rastin e grupit të parë dhe të dytë) të kemi shkëmbime midis gjuhëve, kryesisht midis gjuhëve ballkanike, si p.sh., *vë dorë*, rum. *A pune mina*, greq. *βάζω χέρι*, serbokrot. *Staviti*

⁷⁴ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁷⁵ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁷⁶ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

⁷⁷ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁷⁸ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁷⁹ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

*ruku; i hurit dhe i litarit, bullg. om kod u vъжел, i hedh hi syve, greq. ρίχνω στάχτη στα μάτια*⁸⁰.

Prejardhja gjuhësore e idiomave

Sipas Thomait, studimi i aspektit shoqëror-kulturor në formimin e frazeologjisë është jashtëgjuhësor në vetvete, porse as kultura materiale, as ajo shpirtërore dhe as historia e fakteve në përgjithësi nuk mund të përjashtojnë kryekëput shqyrtimin gjuhësor. Kështu p.sh., në gjuhën se sotme letrare shqipe përdoret idioma *si kofini pas të vjelash*, të cilën do ta lidhim me vreshtarinë dhe së cilës do t'ia shpjegojmë kuptimin sipas rrethanës që e lindi: *mbaroi vjelja, kofini s'hyn më në punë, pra është gjë e vonuar që s'na duhet më*. Mirëpo ky shqyrtim jashtëgjuhësor na jep vetëm pak përsa i përket truallit të formimit të kësaj idiome, dmth., që ajo është formuar në lidhje me vreshtarinë, pra në troje ku ka vreshta; mund të lidhet edhe me gjithë trojet që kanë të vjela misri dhe që këto të vjela i mbledhin me kosh. Po të hidhemi në shqyrtimin linguistik, do të kapim menjëherë fjalën kofin, që nga pikëpamja e normës së sotme leksikore ka mbetur pak a shumë si një fjalë dialektore. Më tej mund të nxjerrim përfundimin se shprehja *si kofini pas së vjelash* lidhet me trojet gjuhësore të shtrirjesh së fjalës kofin (1981).

Në prejardhjen gjuhësore të idiomave do të dallojmë se:

Disa idioma janë formuar me prejardhje nga vetë idiomat, si p.sh., nga *vë në jetë* kemi *vënia në jetë*, nga *vë dorë* kemi *vënia dorë*, nga *heq dorë* kemi *heqja dorë* etj., midis të cilave dallojmë:

Idiomat emërore që vijnë prej tipit foljor dhe që në vend të foljes si gjymtyrë të parë kanë një emër foljor asnjans ose prapashtesor, si p.sh., *vënia dorë*, *vënie në jetë*, *ngrohja në diell*, *vënia re*, *heqja dorë*. Në vend të emrit foljor prapashtesor del edhe një emër foljor asnjans si *të vënë dorë*, *të dhënë llogari*, *të hequrit dorë* ...⁸¹

Idiomat mbiemërore që vijnë prej tipit foljor dhe që në vend të gjymtyrës foljore kanë një mbiemër prejpjesor, si p.sh., *i rrahur me vaj e me uthull*, *i bërë bishë*, *i bërë derr*, *i qepur me pe të bardhë*. Ekzistojnë edhe kuptimet e kundërta, si p.sh., *mosvënia re*, *mosheqja dorë*, *i pavënë re*, *i pavënë në jetë*...⁸²

Idiomat ndajfoljore ku spikatin ato që e ruajnë të plotë semantikën e togfjalëshit foljor burimor, pa pësuar ndryshime të dukshme kuptimore, si p.sh., *m'u ngrit mendja – me mendje ngritur*, *uli kokën – me kokë ulur*, *na prishi gjakun – me gjak të prishur*, dhe ato me ndryshime të mëvetësishme kumtimi, si p.sh., *mbylli sytë “vdiq” – me sy mbyllur “kuturu”*, *hape gojën “fol” – me gojë hapur “me habi”*⁸³.

Disa idioma janë formuar nga reduktimi i idiomave të tjera, si p.sh., *e piu*, *ua mbathi etj*. Reduktimi i idiomave do të thotë heqja e një përbërësi të idiomës dhe ku, për rrjedhojë, shfaqet një variant i ri i idiomës.

Disa idioma janë formuar me zgjerimi i idiomave të tjera, si p.sh., *u bë tym / u bë tym e flakë / u bë tym e mjegull; ha veten (për diçka) / ha veten me dhëmbë (për diçka)*⁸⁴.

⁸⁰ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁸¹ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁸² Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁸³ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁸⁴ Thomai, J. (1999). vep. e cit.

Disa idioma janë formuar nga proverbat , si p.sh., nga proverbi *një dru i shtrembër prish gjithë stivën* është formuar idiomat *dru i shtrembër*. Edhe formimi i idiomave nga proverbat bëhet me heqjen e një përbërësi të proverbit. Zakonisht pjesa e proverbit që ruhet në idiomat është gjysma e parë.

Loukatos (Λουκάτος, gr.) (1992) e lidh këtë dukuri me dy arsye: a) me njohjen e përgjithshme të proverbit dhe b) me ekonominë e folësit në ligjërim. Kur folësi i drejtohet një bashkëbiseduesi me përvojë dhe njohje të përbashkët të proverbit, të dy pjesët e proverbit janë të njohura te bashkëbiseduesit, atëherë folësi e konsideron të mirëqenë se dëgjuesi mund të plotësojë në mendjen e tij pjesën e papërmendur. Por mund të ndodhë që folësi të mos e njohë ekzistencën e pjesës tjetër, sepse pjesa-idiomë mund të jetë më e përhapur.

Për sa i përket ekonomisë në ligjërim, reduktimi i proverbave bëhet për efikasitetin më të lartë të mundshëm gjatë komunikimit⁸⁵.

Prejardhja e huaj e idiomave

Shqipja ka edhe idiomat të huazuara, por këto nuk zënë vend të rëndësishëm. Një pakicë idiomash të huazuara kanë mbetur krejt të paasimiluara, si rrjedhim edhe të pamotivueshme. Ato kanë hyrë si formula të ngurosurat me karakter ndërkombëtar, kryesisht nga latinishtja e gjuhët neolatine , nuk janë bërë elemente të vërteta të shqipes, përdoren vetëm në stile e fusha të caktuara: *casus belli, honoris causa, modus vivendi, mot a mot, salto mortale...*⁸⁶

Një vend pak më të madh zënë njësitë frazeologjike kalke, dmth., ato që janë përkthyer fjalë për fjalë nga një gjuhë tjetër, si: *më bën përshtypje, hauret e Augjiasit, i hedh hije, ka vend, kullë e fildishtë, marr masa, marr pjesë, troket në derë të hapur, thyej akullin, vë pikën mbi i...*⁸⁷

Në idiomat e huazuara kalke përfshihen:

1) Idiomat nga trashëgimia kulturore e përbashkët europiane, midis të cilave janë ato që janë trashëguar:

a) nga antikiteti greko-latin, si p.sh. *është në qiell të shtatë*.

b) nga letërsia, si p.sh., *lufton me mullinjtë e erës*.

c) nga historia, si p.sh., *veza e Kolombit*.

d) nga gjuhë të ndryshme europiane neolatine, si p.sh., *kullë e fildishtë, vë pikën mbi i, marr pjesë, hedh hije, thyej akullin etj.*

2) Një grup më të vogël përbën frazeologjia me burim nga bota fetare, si p.sh., *vuri kurorë, dha shpirt, shkoi në botën tjetër, ndërroi jetë, bëri kryq etj.* Një pjesë tjetër, pasi ka fituar një kuptim të përgjithësuar (është rikuptimësuar) dhe pasi është zhveshur nga kuptimi fillestar fetar, ka depërtuar në leksikon e gjuhës letrare, si p.sh., *ra në mëkat "bëri faj", i doli shpirti "u lodh shumë", i bie më qafë "e bezdis", i lau duart "s'është më përgjegjës për diçka"*⁸⁸

⁸⁵ Παπαζαχαρίου, Ζ. (1992). vep. e cit.

⁸⁶ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

⁸⁷ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

⁸⁸ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

3) Idiomat nga trashëgimia kulturore e përbashkët ballkanike, si p.sh., *ia preu duart*, *оставямвунжда* (*bullg*), *τον έκοψε τα χέρια* (*gr.*), *a strica treaba cuiva* (*rum.*), *odseci ruke kome*, *pokvariti kome rad* (*sr.-kr.*)⁸⁹.

Kuptohet që ballkanizmat edhe në frazeologji rrjedhin nga një periudhë më e vonët sesa gjasitë që lindin nga bashkësia indoeuropiane. Kjo vërtetohet mënjatë ngaqë këto elemente u mungojnë shumë gjuhëve indoeuropiane jashtë Ballkanit e më anë tjetër ngase disa gjasi ballkanike, për arsye gjeografike dhe marrëdhëniesh, i kanë edhe turqishtja dhe magjarishtja (p.sh., sipas E.Cabejt, kalë jeshil etj.)⁹⁰

4) Idiomat e huazuara nga turqishtja

Përveç shumë fjalëve të shqipes që e kanë prejardhjen nga turqishtja, ka edhe idioma me të njëjtën prejardhje. Dihet se pushtimi turk solli shumë njëllor ndikime në gjuhë të ndryshme të Ballkanit dhe la kështu disa elemente të përbashkëta edhe në frazeologji⁹¹. Sipas Chioti-t (2010) e cila flet për greqishten, mund të themi të njëjtën gjë edhe për shqipen, se “në vija të përgjithshme turqishtja kundrejt ballkanizmave konsiderohet si gjuha që huazoi idioma në gjuhët e tjera ballkanike. Nga shprehjet turke që kanë kaluar në gjuhët ballkanike, disa janë përkthyer plotësisht në gjuhën tjetër, ndërsa disa ruajnë fjalë turke që kanë kaluar si huazime”, si p.sh., *rri sikur i janë mbytur gjemët*.

Por kjo nuk do të thotë se çdo idiomë që përmban fjalë me prejardhje turke duhet të jetë e burimit turk, sepse shumë nga këto fjalë “janë shfrytëzuar si të ishin elemente vetjake për të ndërtuar njësi frazeologjike tipash të ndryshëm”⁹² brendapërbrenda shqipes.

Megjithatë, i takon etimologjisë dhe studimeve krahasuese në fushën e frazeologjisë midis shqipes dhe turqishtes për të ndriçuar më tej këtë çështje.

Përpunimi i idiomave

Ekzistenca e një interpretimi literal dhe e një interpretimi idiomatik të strukturave gjuhësore i ka shqetësuar shumë gjuhëtarët gjenerativistë në vitet '60 të shekullit të kaluar dhe i ka detyruar psikologët të harxhojnë shumë kohë duke u përpjekur të zbulojnë se cili interpretim ndodh i pari në mendjen e dëgjuesit⁹³.

Në vijim të këtij mendimi janë propozuar disa qëndrime:

Qëndrimi i parë lidhet me hipotezën e përpunimit së pari të kuptimit literal (The literal first hypothesis)⁹⁴. Sipas kësaj hipoteze në fillim aktivizohet kuptimi literal i strukturës dhe, pasi mbaron aktivizimi literal, fillon të aktivizohet kuptimi idiomatik. Ky qëndrim parashikon një procedurë trehapëshe. Në fillim dëgjuesi aktivizon kuptimin literal, pastaj e braktis atë, dhe në fund aktivizon kuptimin idiomatik.

Qëndrimi i dytë lidhet me hipotezën e përpunimit të njëkohshëm të idiomave (The simultaneous processing hypothesis)⁹⁵. Sipas kësaj hipoteze të dyja kuptimet

⁸⁹ Thomai, J. & Lloshi, Xh. & Hristovo, R. & Qirjazati, K. & Melonashi, A. (1999). Fjalor frazeologjik ballkanik, Dituria, Tiranë.

⁹⁰ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁹¹ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁹² Thomai, J. (1981). vep. e cit.

⁹³ Howarth, P. (1998). Phraseology and second language proficiency. Applied Linguistics 19(1).

⁹⁴ Bobrow, S. & Bell, S. (1973). On Catching on to Idiomatic Expressions. Memory & Cognition 1.

⁹⁵ Swinney, D. & A. Cutler (1979) The access and processing of idiomatic expressions. Journal of Verbal Learning and Verbal Behaviour 18.

aktivizohen paralelisht. Kështu, kur dëgjuesi ndesh elementin e parë përbërës të idiomës, aktivizimi i të dyja kuptimeve ecën paralelisht. Megjithatë, sipas kësaj teorie, interpretimi i figurshëm shpesh favorizohet.

Në mbështetje të këtij mendimi të fundit ka sjellë prova empirike edhe Gibbs (1986) sipas të cilit interpretimi i figurshëm është dominues, në qoftë se konteksti nuk ndikon fuqishëm mbi dëgjuesin.

Qëndrimi i tretë lidhet me hipotezën e përpunimit të pari të kuptimit të figurshëm (The figurative first hypothesis)⁹⁶. Sipas kësaj hipoteze, në idioma aktivizohet vetëm kuptimi i figurshëm sapo sekuenca nis të dëgjohet. Kjo hipotezë nuk nënkupton se përpunimi literal duhet të ndodhë domosdoshmërisht. Sipas saj, kuptimi literal jo vetëm që nuk ndodh para kuptimit idiomatik, por mund të anashkalohet tërësisht.

Hipoteza me ndikim më të madh ka të ngjarë të jetë hipoteza konfiguracionale (The configuration Hypothesis)⁹⁷ që përbën qëndrimin e katërt i cila sugjeron se idiomat njihen si konfigurime të veçanta fjalësh. Cacciari & Tabossi konkludojnë se struktura idiomatike fillimisht përpunohet literalisht deri sa njihet “çelësi” idiomatik, dmth., konfigurimi i veçantë i fjalëve apo pika ku shfaqet kuptimi i figurshëm e cili lidhet me kuptimin e idiomës. Pas kësaj pike të identifikimit, kuptimi literal ndërpritet dhe idioma nis të përpunohet sipas kuptimit të saj të figurshëm. Për rrjedhojë, pika në të cilën ndeshet “çelësi” idiomatik përcakton se cili lloj kuptimi do të aktivizohet. Nëse “çelësi” nuk ndeshet deri në fund të fjalisë, do të aktivizohen të dyja kuptimet, edhe ai literal edhe ai i figurshëm. Por, nëse “çelësi” ndeshet më parë në fjali, në përfundim të fjalisë do të jetë duke u përpunuar vetëm kuptimi idiomatik.

Nga shumica e qëndrimeve rezulton se strukturat idiomatike përpunohen më shpejt se strukturat korresponduese literale dhe kjo ndodh, sepse strukturat idiomatike përbëjnë njësi të gatshme të memorizuara dhe në shumicën e rasteve paraqiten si njësi jekompozicionale që kërkojnë më pak llogaritje se strukturat korresponduese literale që duhet të ndërtohen nga pjesët e tyre.

Qëndrimi i hipotezës konfiguracionale është superior ndaj hipotezave të tjera të përpunimit të idiomave, sepse merr parasysh zberthyeshmërinë e idiomave dhe aktivizimin e të dyja kuptimeve gjatë përpunimit të idiomave.

Ngjashmëria dhe dallimi i idiomave nga sintagmat e lira:

Tiparet e përbashkëta

Idiomat dhe sintagmat e lira kanë tipare të përbashkëta e tipare dalluese. Tiparet e përbashkëta midis tyre janë:

1) Edhe idiomat janë sintagma, sepse përbëhen nga dy ose më shumë fjalë dhe kanë lidhje gramatikore të njëjta me sintagmat e lira (përcaktuese, objektore, rrethanore etj.).

2) Idiomat lidhen me sintagmat e lira nga prejardhja. Përgjithësisht idiomat e kanë burimin nga sintagmat e lira, dalin nga shndërrimi i figurshëm i tyre. Kjo lidhje është e dukshme edhe në gjendjen e sotme të gjuhës shqipe, si te *hedh baltë* “*e përlyej dikë apo diçka duke folur keq për të*”, *luan derën* “*bën punë të kotë*”, *s’ngre kokë* “*ka*

⁹⁶ Gibbs, R. W. (1980). Spilling the beans on understanding and memory for idioms in conversation. *Memory and Cognition* 8.

⁹⁷ Cacciari, C. & Tabossi, P. 1988. The comprehension of idioms. *Journal of Memory and Language* 2.

rënë shumë e nuk e merr dot më veten”⁹⁸. Idiomat e kanë nisur jetën e tyre si sintagma të lira dhe kanë përfunduar në sintagma të qëndrueshme, pas përdorimit metaforik.

Tiparet dalluese:

Kufizimi leksikor dhe moskompozicionaliteti

Sintagmat e lira ndërtohen sipas ligjeve të përgjithshme të gjuhës: pjesët përbërëse zgjidhen në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra dhe mund të zëvendësohen nga fjalë (kuazi-) sinonime në aksin paradigmatic, ndërsa në aksin sintagmatic fjalët përbërëse të sintagmave të lira lidhen me njëra-tjetrën si shumë e kuptimeve të tyre, ndryshe nga idiomat në të cilat shkelet minimalisht liria e përzgjedhjes së fjalës në aksin paradigmatic, ndërsa në shumicën e rasteve edhe veçoria e kompozicionalitetit semantik në aksin sintagmatic.

Kështu, sipas strukturës së lirë *kodra pas bregut* mund të themi edhe *kodra pas malit*, *kodra pas pyllit*, *kodra pas pllajës etj* ose *mali pas bregut*, *pylli pas bregut*, *lëndina pas bregut etj*. ku secila strukturë mbart kuptim të drejtpërdrejtë si edhe *kodra pas bregut*, ndërsa sipas strukturës idiomatike *kodra pas bregut* “*kot, pa lidhje e pa logjikë*” nuk mund të themi *kodra pas pyllit* ose *lëndina pas bregut* si më sipër te struktura e lirë, sepse asnjëra prej tyre nuk mbart kuptim idiomatik siç mbart *kodra pas bregut*, por janë thjesht struktura të lira.

Forma e preferuar e pranuar

Idiomat kanë një formë të preferuar të pranuar, gjë që nuk ndodh te sintagmat e lira, si p.sh., përbërësi *sytë* te idioma *i bëj sytë katër* është në numrin shumës, trajta e shquar.

Si rregull, së paku një nga gjymtyrët e idiomës mbetet gjithnjë në një trajtë të caktuar ose nuk ka të plotë paradigmen e saj. Në këtë mënyrë, për idiomën nxjerrim një veçori me rëndësi, që e dallon atë nga sintagma e lirë: idioma ka një trajtë të vetme ose një numër të kufizuar trajtash, si p.sh., *marr vesh*, *i bëj sytë katër*, *i ndeu këmbët etj.*, nuk kanë paradigme të plotë, meqenëse nga njëra anë, emri mbetet vetëm në një trajtë, kurse, nga ana tjetër, folja, edhe pse ka disa trajta, nuk ka ndërkaq paradigme të plotë⁹⁹.

Humbja e kuptimit të përbërësve

Gjymtyrët e idiomave (ose të paktën njëra prej tyre) e kanë humbur kuptimin, ndryshe nga fjalët e sintagmave të lira, të cilat e ruajnë këtë e me të njëjtin kuptim mund të hyjnë edhe në lidhje të tjera fjalësh; p.sh., te idioma *i bie më qafë (dikujt)*, fjalët *bie* dhe *qafë* nuk e ruajnë kuptimin e tyre të pavarur, e kanë humbur kuptimin literal dhe të dyja së bashku japin kuptimin tërësor, idiomatik. Në çdo lidhje tjetër fjalët *bie* dhe *qafë* nuk i kanë më këto kuptime (*i bie derës*, *i bie me grusht*, *qafa e çizmes*, *qafa e malit etj*). Prandaj në shumicën e idiomave kuptimi tërësor nuk është shumë e thjeshtë e kuptimeve të fjalëve përbërëse, por del nga lidhja e shkrirja e brendshme e gjymtyrëve ose shndërrimi i figurshëm që është kryer historikisht. Ndryshe nga këto, në togfjalëshin e lirë fjalët ruajnë pavarësinë kuptimore. Kuptimi tërësor është shumë e kuptimeve të fjalëve përbërëse. Kështu kuptimi tërësor i

⁹⁸ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

⁹⁹ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

togfjalëshit të lirë *shoh mirë* është i barabartë me kuptimin e foljes *shoh* + kuptimin e ndajfoljes *mirë*. Nga ana tjetër, fjalët *shoh* e *mirë* ruajnë po ato kuptime edhe kur shkëputen nga ky togfjalësh, edhe kur janë gjymtyrë të togfjalëshave të tjerë të lirë (*shoh keq, shoh larg, shoh një njeri, prit të shoh pak..., dëgjoj mirë, flet mirë, punon mirë, më vjen mirë...*).

Mosndryshimi i numrit të fjalëve

Idiomat janë të qëndrueshme nga pjesët përbërëse. Është më pak e pranueshme të heqim pjesë të cilat normalisht janë të pranishme në sekuencat e ngurosura sesa të shtojmë pjesë të tjera. Pakësimi i përbërësve e prish idiomën, ndërsa shtimi i përbërësve ose nuk pranohet ose, kur pranohet, nuk është pjesë e njësisë kështu te shembulli **ashtu i do mushka* në vend të *ashtu i do mushka drutë* ngurosja idiomatike është prishur.

Mosndryshimi i rendit të fjalëve

Rendi i gjymtyrëve është pothuaj i pandryshueshëm. Prishja e rendit fillestar zakonisht e prish fare idiomën. Kështu në idiomat *kodra pas bregut, me krahë hapur, marr vesh, si sytë e ballit...* gjymtyrët nuk mund të ndërrojnë vendet (**breg pas kodrash, *me hapur krahë, *vesh marr, *si të ballit sytë*)¹⁰⁰.

Njësi të gatshme të gjuhës

Idiomat nuk krijohen në çastin e ligjërimit, por hyjnë në ligjërim si njësi të gatshme, të formuara që më parë, ndryshe nga sintagmat e lira që ndërtohen në çastin e ligjërimit. Sintagmat e lira ndërtohen në çastin e të folurit nga bashkimi i lirë i fjalëve në fjali.

Vlerë fjale

Shumica e idiomave shënojnë një koncept të vetëm dhe hyjnë në fjali si një fjalë e vetme dhe kryejnë funksionin e një gjymtyrë të vetme të fjalisë (kryefjalë kallëzues, rrethanor etj.), ndryshe nga sintagmat e lira të cilat zbërthehen në gjymtyrët e tyre, me të cilat mund të lidhen fjalë të tjera.

Mosprodhueshmëria

Idiomat nuk përbëjnë modele produktive, prandaj nuk krijohet mundësia që sipas ndërtimit të një idiome të formohet një varg idiomash të tjera. Kështu, sipas *kodra pas bregut* (emër i pashquar shumë në rasën emërore +p parafjalë + emër i shquar njëjës në rasën rrjedhore) nuk formohen idioma të tjera, kurse sintagma të lira me këtë ndërtim mund të formohen shumë (*yje pas reve, fshatra pas malit, lumenj pas pyllit, shtëpi pas rrugës...*)¹⁰¹.

Mospërkthimi fjalë për fjalë

Idiomat nuk mund të përkthehen fjalë për fjalë nga një gjuhë në një tjetër siç ndodh zakonisht me sintagmat e lira.

Mosmodifikimi i gjymtyrëve

Në shumë raste idiomat nuk mund të modifikohen as pjesërisht as si një e tërë, si p.sh., *flet kodra pas bregut* ndryshe nga sintagma e lirë *kodra pas bregut* e cila mund të modifikohet në mënyra të ndryshme, si p.sh., *kodra e parë pas bregut, kodra pas bregut të thepisur*

¹⁰⁰ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

¹⁰¹ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

Mungesa e transformimeve sintaksore

Idiomat përgjithësisht nuk u nënshtrohen transformimeve sintaksore si: pasivizimit, relativizimit, veçimit etj., ndryshe nga sintagmat e lira të cilat u nënshtrohen të gjitha këtyre transformimeve sintaksore.

Memorizimi dhe riprodhimi si njësi të gatshme në ligjërim

Idiomat përbëjnë njësi të gatshme të gjuhës dhe si të tilla janë të memorizuara në leksikon mendor të folësve të gjuhës. Forma e tyre përcaktohet nga përdorimi, ndryshe nga sintagmat e lira përbërja e të cilave përcaktohet nga kuptimi i përbërësve dhe të cilat, për rrjedhojë, nuk janë të memorizuara, por ndërtohen në ligjërim.

Ngajshmëria dhe dallimi i idiomave nga fjalët

Tipare të përbashkëta

Idiomat dhe fjalët kanë tipare të përbashkëta e tipare dalluese. Tiparet e përbashkëta janë:

Përbërja

Idiomat, ashtu si dhe fjalët e prejardhura, por edhe disa fjalë të përbëra, si p.sh., *syshkruar* etj., përbëhen nga të paktën dy pjesë, idiomat nga fjalë, ndërsa fjalët nga morfema, të cilat (fjalët idiomatike dhe afikset) nuk janë të pavarura dhe nuk mund të përdoren më vete me kuptimin me të cilin përdoren brenda strukturës.

Njësi kuptimore

Ashtu si dhe fjalët, shumica e idiomave përbëjnë njësi kuptimore, si p.sh., struktura *kokë e madhe* ka një kuptim tërësor, kuptimin e një fjale të vetme “*njeri i shquar, i zoti dhe i zgjuar*” ashtu si njësitë e ndryshme njëfjalëshe.

Vlera dhe funksioni

Ashtu si dhe fjalët, shumica e idiomave shënojnë një koncept të vetëm, hyjnë në fjali si një fjalë e vetme dhe kryejnë funksionin e një gjymtyre të vetme të fjalisë (kryefjalë kallëzues, rrethanor etj.), ndryshe nga sintagmat e lira të cilat zërthehen në gjymtyrët e tyre, me të cilat mund të lidhen fjalë të tjera.

Tipare dalluese

Po sjellim disa nga dallimet kryesore ndërmjet njësisë frazeologjike dhe fjalës

1) Idiomat formohen prej dy ose më shumë fjalësh të plota që janë njësi të pavarura në përbërjen e leksikut të gjuhës sonë dhe që përgjithësisht i gjejnë rregullisht të përdorura edhe veçan, edhe në lidhje të tjera fjalësh, por me kuptim tjetër, si p.sh., pjesët e idiomës *mori erë “u zbulua” (marr një libër/një laps nga tavolina, një thikë/një lugë nga sirtari etj; fryn erë, dëgjoj erën, era rrëzoi pemët, etj.)*. Por jo të gjitha fjalët e gjuhës formohen prej dy ose më shumë morfemash.. Disa fjalë, ndryshe nga idiomat, formohen vetëm nga një pjesë morfematike, vetëm nga rrënja, si p.sh., *punë, lum, djathë etj.*, ndryshe nga idiomat që përbëhen nga më shumë se një fjalë.

2) Fjala është njësi e vetme e pandashme me formësim gramatikor tërësor. Formësimi gramatikor tërësor i saj shpërfaqet me treguesit gramatikorë (me mbaresat), që zënë vend në fund; fjala vjen, foljet e emrat *di, kap, kohë, krah, lexoj, lidh, lis, udhë* kanë forma ndryshimi me tregues gramatikorë, që i marrin në fund, si njësi e vetme (*lidh-im/-ni/-a/-e/-i/-ur..... lis-i/-a/-ave/-ash...*). Te idiomat secila gjymtyrë ka pavarësi morfologjike, treguesit gramatikorë nuk i merr struktura

frazeologjike në tërësi, po mund t'i marrë çdo gjymtyrë veç e veç¹⁰² dhe kryesisht folja, si p.sh.:

m'u bë gjaku ujë

iu bë gjaku ujë

na u bë gjaku ujë

u ishte bërë gjaku ujë

3) Fjalët kanë një theks kryesor, kurse idiomat kanë aq theksa sa edhe fjalë shënuese; mund të krahasojmë fjalët *gur, sonte, zemërgur* me idiomat *e bëj zemrën gur, pemë pa kokrra, stan me lepuj...*¹⁰³

4) Karakteristikë e përgjithshme e idiomave është njëkuptimësia (monosemantizmi), ndryshe nga fjalët, shumica e të cilave ka më shumë se një kuptim. Por ka edhe idioma që, sikurse fjalët, mund të marrin shumë kuptime ose krijojnë homonimi, sinonimi e antonimi me njësi të tjera frazeologjike: *bëj fjalë 1. "flas mbi një çështje" 2. "grindem me dikë"; marr vesh 1. "dëgjoj", 2. "kuptoj", 3. "bindem"*¹⁰⁴

5) Idioma mund të japë një nuancë kuptimore më të hollë në krahasim me fjalën sinonime, mund të shënojë një shkallë më të lartë të cilësisë ose të intensitetit të veprimit. Të marrim dy shembuj: *"Ai, që e dinte se po e ndiqnin këmba-këmbës, ua mbathi dhe në pyll e mbajti frymën", "Udhëtoi vetëm gjithë ditën dhe kur dielli u fsheh prapa malit, u ndal në një fshat të vogël"* Te këta dy shembuj mund të krahasojmë idiomën *e mbajti frymën* me foljen *u ndal*. Këto njësi janë sinonime, sepse në përgjithësi shënojnë të njëjtin veprim, por, po t'i shohim më imtësisht, idioma ka diçka të veçantë: ajo përdoret kur është fjala për dikë që ndalet në një vend, pasi ka vrapuar me një frymë e shumë shpejt, pa qëndruar asgjekund, nga frika, se dikush e ndjek nga pas¹⁰⁵.

6) Në shumë raste idiomat kanë ngjyrim emocionues, shprehin edhe qëndrimin e folësit për atë që përmendet, kurse fjalët sinonime mund të jenë asnjënjë; mund të krahasojmë shembujt *"Lamja ashtu e ka, fut hundët kudo, po në vend të ndreqë, prish", -Këtu duhet ndërhyrë o Selim, se s'na lejohet të bëjmë sehir kur shkelet ligji"*. Në rastin e parë idioma *fut hundët* ka edhe ngjyrim keqësues e përbuzës, në krahasim me foljen *ndërhyj* të shembulli i dytë. Në këto kontekste këto njësi nuk mund ta zëvendësojnë njëra-tjetrën¹⁰⁶.

Përdorimi i idiomave

Idiomat përbëjnë vlera të mëdha në përmbajtje e në ngjyrimin emocionues, prandaj ato "shfaqen edhe në ligjërimin bisedor, në të folurit e përditshëm, edhe në raste kur nuk ka ndonjë synim artistik. Por ato përdoren më dendur në letërsinë artistike, në shkrime publicistike, veçanërisht në publicistikën letrare, në shkrime satirike, në fejtone etj. Vështirë të gjesh një vepër letrare në prozë pa një pasuri, sado të vogël, të frazeologjisë. Në duart e shkrimtarëve, të përkthyesve, të publicistëve, të mësuesve e të shkollarëve, të veprimtarëve shoqërorë e të kujtdo tjetër gjenden mjete

¹⁰² Thomai, J. (2006). vep. e cit.

¹⁰³ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

¹⁰⁴ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

¹⁰⁵ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

¹⁰⁶ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

të fuqishme për ta bërë ligjërimin sa më të kuptueshëm, më emocionues e më ndikues”¹⁰⁷.

Por jo të gjitha idiomat janë të përshtatshme për të gjitha stilet dhe regjistrat e gjuhës. Shumica e idiomave janë përdoren në mënyrë të kufizuar në një stil apo regjistër të caktuar.

1) Shumica e idiomave përdoren në ligjërimin e folur popullor si dhe në të folurën e personazheve të ndryshëm të veprave letrare. Ky ligjërim është i pasur me idioma të tipave të ndryshëm. Idiomat që përdoren në këtë ligjërim konsiderohen joformale dhe pasqyrojnë një marrëdhënie të afërt midis bashkëfolësve si dhe sugjerojnë një qëndrim të çlirët, si p.sh., *(e kapi) me presh në dorë, i vë fre gojës, e bëri për pesë para, si sëpata pa bisht, si qeni në vresht, si kau balash, s'ia var trastën, bluan hollë, çan dërrasa, hap hendek “krijon dallime me dikë”, i jap ujë “e kalit”, i shkel gazin, i vë fre....; e hëngra, e qau etj.*

2) Disa idioma përdoren kryesisht në ligjërimin e shkruar libror. Idiomat që përdoren në këtë ligjërim konsiderohen formale dhe kanë tendencë të pasqyrojnë një marrëdhënie të distancuar midis bashkëfolësve si dhe të sugjerojnë një ton serioz të bisedës, si p.sh., *violina e parë, i jep tonin, me të gjitha velat, i nxjerr rrënjën katrore, e shumëzoi me zero, shkopi i dirigjentit, kullë e fildishtë, vë pikën mbi i, marr pjesë, hedh hije, thyej akullin etj.* Në këtë ligjërim përdoren edhe disa formula të ngurosurave me karakter ndërkombëtar, si p.sh., *casus belli, honoris causa, modus vivendi, mot a mot, salto mortale.*

3) Ka edhe idioma që përdoren në të gjitha regjistrat dhe stilet e gjuhës. Ato konsiderohen stilistikisht neutrale (sidomos ato që mbushin zbrazëtitë e gjuhës), sepse përdoren në të gjitha regjistrat dhe stilet e gjuhës, si p.sh., *ngul këmbë, heq dorë, bëj shaka etj.*

Me rëndësi është që përgjithësimi i idiomave në mbarë gjuhën bëhet pa kufizime dialektore, krahinore a truallsore; p.sh., te shprehja *si kofini pas të vjelash* ruhet një fjalë dialektore (*kofin*), që s'mund të zëvendësohet me fjalën e përgjithshme *kosh-i*, por kjo nuk e pengon idiomën të shtrihet në përdorim të përgjithshëm e të bëhet pronë e gjuhës standarde. Këtë mund ta themi edhe për shprehjet *e bën tërkuzë, i ha kurrizi, kodra pas bregut, me kuç e me maç, s'ia var torbën*. Gjuha standarde i merr e i përvetëson këto shprehje pavarësisht nga ç' dialekt ose e folme vijnë¹⁰⁸.

Çngurosjja e idiomave dhe loja e fjalëve me idiomat

Një nga përdorimet stilistikore të idiomave është edhe loja e fjalëve të cilën e arrijmë nëpërmjet çngurosjes së idiomave dhe të cilën mund ta quajmë edhe lojën e çngurosjes së idiomave. Kjo është veçori e idiomave të cilat mund të kenë njëkohësisht edhe një kuptim si kombinime të lira fjalësh.

Loja e fjalëve me idioma mund të jetë e paqëllimshme ose e qëllimshme.

Kur loja e fjalëve është e paqëllimshme, ajo shkaktohet nga mosnjohja e kuptimit idiomatik të strukturës nga përdoruesi, por nga njohja e saj nga dëgjuesi. Fëmijët e vegjël përbëjnë shembuj shkëlqyer të një keqkuptimi të tillë, sepse bagazhi i

¹⁰⁷ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

¹⁰⁸ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

tyre mendor nuk është i mjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, ata nuk arrijnë të dallojnë kuptimin e figurshëm të idiomave. Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë dështimin e fëmijëve për të njohur dhe për të parë përtej kuptimit literal të sekuencës së fjalëve, sepse nuk i kanë këto idioma në fjalorin e tyre mendor.

Shembulli I

-(Një shoqe i thotë nënës së fëmijës:) *Po je sëmure, mos rri, por bjeri pas.*

-(Fëmija që e dëgjon reagon:) *Mami, po s'i bie dot ti vetë pas, lemë mua t'i bie (kurrizit tënd).*

Shembulli II

-(Një komshije, Teuta, i përgjigjet nënës së Vjolës:) *Vajza ime fle me pulat.*

-(Vjola që e dëgjon reagon:) *I thua j teta Teutës të mos e lërë Edlirën (vajzën e Teutës) të flejë me pulat, sepse do të zërë morra.*

Këta dy shembuj na tregojnë se me ndihmën e rrethanave të përshtatshme devijimet e mësipërme të idiomave shkaktojnë humor.

Kur loja e fjalëve është e qëllimshme, ajo shkaktohet nga njohja e kuptimit idiomatik të strukturës si nga përdoruesi ashtu edhe nga dëgjuesi. Në këtë rast folësi e ndryshon qëllimisht kuptimin idiomatik në kuptim literal. Arsyet e lojës së qëllimshme të fjalëve janë ose humorit ose thjesht tërheqja e vëmendjes pa synim humoristik.

Shembull i lojës së qëllimshme të fjalëve për humor:

-*T'i them këto që të mbash sytë hapur.*

-*Unë hapur i mbaj deri sa shtrihem për gjumë.*

Në këtë rast konstatojmë përpjekjen e shfrytëzimit të natyrës së dyfishtë të idiomës “*mbaj sytë hapur*”: nga njëra anë kuptimi literal i sekuencës së fjalëve dhe nga ana tjetër kuptimi idiomatik. Efekti humoristik përftohet në sajë të pajtimit të dyja kuptimeve të ndryshme brenda të njëjtit kontekst.

Shembull i lojës së qëllimshme të fjalëve për tërheqje vëmendjeje:

Paztox i ri tani edhe më rezultativ, për të mos u lodhur duke vrrarë miza (për reklamën e një insekticidi mizash).

Edhe në këtë rast konstatojmë përpjekjen e shfrytëzimit të natyrës së dyfishtë të idiomës “*vret miza*”: nga njëra anë kuptimi literal i sekuencës së fjalëve dhe nga ana tjetër kuptimi idiomatik.

Kushti i parë për krijimin e lojës së fjalëve është ekzistenca e idiomave, sepse “çdo çngurosje presupozon një ngurosje të mëparshme të cilën e devijon apo e rimotivon”¹⁰⁹. Çngurosja përbën modelin mbi të cilin krijohet çngurosja. Në qoftë se nuk do të kishte ndonjë shprehje për të modifikuar, nuk do të mund të ndërtohej aludimi.

Kushti i dytë për krijimin dhe për të kuptuarit e lojës së fjalëve është njohja e idiomave, sepse përndryshe sequenca e fjalëve nuk do të perceptohej si e devijuar dhe do të humbiste të gjithë efektin stilistikor.

¹⁰⁹ Fiala P. & Habert B. (1989). La langue de bois en éclat : les défigements dans les titres de presse quotidienne, in *Mots*, 21, Paris : Presses de la Fondation Nationale des sciences politiques.

Kushti i tretë për krijimin e lojës së fjalëve është moscënimi i integritetit (leksikor) të strukturës, sepse atëherë do të prishej kuptimi idiomatik dhe, për rrjedhojë, çngurosja nuk do të funksiononte¹¹⁰.

Lojërat e fjalëve (me idioma) mund t'i përkufizojmë si rikthim i paqëllimshëm apo i qëllimshëm i kuptimit idiomatik të një strukture në kuptimin e saj literal, të cilët, që të dy, realizohen njëkohësisht brenda të njëjtit kontekst, ose shkurt, mund t'i quajmë devijim të idiomave.

Nga pikëpamja gjuhësore, lojërat e fjalëve përbëjnë njëkohësisht testin dhe provën e ngurosjes, por na ndihmojnë gjithashtu të kuptojmë dikotominë midis gjuhës dhe ligjërimit, të propozuar nga Ferdinand de Saussure, sepse, ndërsa idiomat futen në ligjërimit si njësi të gatshme, të njëjtat struktura gjuhësore, duke funksionuar si lojëra fjalësh mbi bazën e idiomave, krijohen në ligjërimit.

Vlera dhe roli i idiomave

Në lidhje me vlerën e idiomave në gjuhë do t'u referohemi vlerësimeve të Jani Thomait. Kështu, gjithë funksionet e njësive frazeologjike mund t'i bashkojmë në dy grupe: funksione që lidhen me aftësitë shënuese dhe ato që lidhen me aftësitë vlerësuese.

Në grupin e parë hyjnë aftësitë që kanë njësitë frazeologjike për të shënuar sende, dukuri, cilësi a veprime njëllor si fjalët, qoftë krahas këtyre, qoftë edhe më vete, e në këtë mënyrë ato mbushin zbrazëtite e sistemit leksikor. Aftësi shënuese kanë gjithë njësitë frazeologjike, krahas me shënuesit e tjerë njëfjalësh, porse tek ato kjo bie në sy më shumë kur për sendin, dukurinë, cilësinë a veprimin e dhënë nuk ka shënues njëfjalësh: *si çjapi te kasapi, nga sytë këmbët, shtyn urët, iu tha dora, për ujë të ftohtë, s'e vë ujët në zjarr, më zuri gjuha lesh, i zuri rrota bishtin, ngul këmbë, heq dorë*. Kjo duket, ndonëse në një shkallë më të ulët, edhe tek ato njësi frazeologjike, që, kundrejt fjalëve sinonime me to, sjellin nuanca të tjera kuptimore e plotësojnë kështu zbrazëtite e sistemit semantik, kur shënojnë një shkallë më të lartë të intensitetit të veprimit a të cilësisë: *u bë derr "u mërzi shumë", daulle e shpuar "llafazan i madh", m'u dogj zemra "u përmallova shumë", i hurit e i litarit "kriminel", kockë e lëkurë "shumë i dobët", pikë loti "shumë i kulluar"*. Me këto funksione lidhet edhe mundësia që jep frazeologjia për të zëvendësuar huazimet leksikore: *ngul këmbë për insistoj, mësallë me dy faqe për hipokrit, hë për hë për aktualisht*.

Në grupin e dytë hyjnë aftësitë që kanë idiomat për të vlerësuar sendet, dukuritë, cilësitë a veprimet nga ana emocionale e stilistikore ose nga shprehësia, gjë që arrihet nga tema semantike, nga figura gjuhësore që ndërtohet, nga konteksti historik e shoqëror i krijimit e i përdorimit, sidomos nga ngjyrimi emocional i veçantë. Një tregues i dukshëm i idiomave është ndjeshmëria më e vogël kundrejt normës së përgjithshme gjuhësore dhe ndjeshmëria më e madhe kundrejt normës stilistike. Kjo shpjegohet me shkallën më të lartë të funksioneve vlerësuese të njësive frazeologjike (2006).

¹¹⁰ Mejri, S. (1998). «Structuration sémantique et variation des sequences figées». In S. Mejri, A. Clas, G. Gross & T. Bacchouche (éds), *Le figement lexical, Préactes des premières Rencontres Linguistiques Méditerranéennes* (Tunis, 17-19 Septembre 1998), Tunis: Université de Tunis I/CERES.

Idiomat shpesh përdoren për të vënë në dukje qëllimin e folësit apo të shkrimtarit dhe ta bëjnë tekstin më shprehës. Ato shërbejnë për të vlerësuar ngjarje dhe njerëz, për të tërhequr vëmendjen, për të ilustruar fakte dhe për të organizuar tekste. Përdoren gjithashtu për të treguar zemërim, për të fyer dikë, për t'iu referuar diçkaje të pakëndshme apo për të zbavitur dëgjuesin dhe për të qetësuar njerëzit. Në sajë të figurshmërisë së tyre, idiomat rrisin ekspresivitetin e tekstit.

Vlera e idiomave lidhet edhe me rolin e tyre në gjuhë. Idiomat janë të rëndësishme, sepse përdoren shumë shpesh. Është e pamundur të flasësh, të lexosh apo të dëgjosh shqip pa ndeshur në gjuhën idiomatike.

Një arsye tjetër e rolit të rëndësishëm të idiomave në gjuhë është se shpesh ato përdoren në leximin e tyre idiomatik më shumë se në leximin e tyre literal, si p.sh., shprehja literale *i ngul thikën pas shpine* në leximin literal është e rrallë, sepse përbën një rast kriminal shumë të rrallë në atë pozicion, sesa leximi idiomatik “*është i pabesë*”, shprehja literale *nuk hap rrugë* në leximin literal është e rrallë, sepse lidhet me një profesion të veçantë, atë të inxhinierit të ndërtimit, sesa leximi idiomatik “*toleroj*”, apo fjala dialektore *kofin* në kuptimin literal është shumë më e rrallë se përdorimi idiomatik në idiomën *si kofini pas së vjelash*.

Një arsye tjetër e rolit të idiomave në gjuhë është se e bëjnë përdoruesin e tyre të jetë sa më i natyrshëm në përdorimin e gjuhës.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se idiomat:

Përbëjnë pasurim dhe zgjerim të mjeteve të shprehjes në gjuhë.

Mbushin zbrazëtitë e leksikut kur mungojnë njësi njëfjalëshe për të shprehur disa nocione.

Sjellin nuanca të holla kuptimesh.

Shërbejnë për të zëvendësuar fjalët e huaja në gjuhë.

Sjellin ngjyrimë emocionuese dhe ekspresivitet në ligjërim.

Mbartin vlera stilistikore, si p.sh., në diferencimin e regjistrave, në krijimin e lojrave të fjalëve etj.

Përbëjnë një mënyrë ekonomike për krijimin e njërive të reja gjuhësore.

Përkthimi i idiomave

Përkthimi duhet të kuptohet si një proces kompleks i transferimit të një teksti nga gjuha burimore në një tekst komunikativisht adekuat dhe të barasvlershëm në gjuhën mbërritëse.

Shpesh dëgjohet pikëpamja se idiomat janë të papërkthyeshme dhe se pamundësia e përkthimit përbën veçorinë e tyre kryesore. Por kjo pamundësi e supozuar e përkthimit të idiomave nuk e ka detyruar asnjë përkthyes të dorëzohet. Çdo idiomë mund të përballohet me mundësitë e gjuhës në të cilën përkthehet.

Procesi i përkthimit të idiomave përfshin hapat e mëposhtëm:

1) Identifikimin e idiomave në gjuhën burimore, p.sh., *m'u pre gjaku*

2) Analizën e kuptimit idiomatik në gjuhën burimore, p.sh., *m'u pre gjaku = u tremba*

3) Përkthimin e kuptimit idiomatik në gjuhën mbërritëse, p.sh., *u tremba = φοβήθηκα (gr.), I was afraid (angl.), j'ai eu peur (fr.)*.

4) Zëvendësimi i idiomave në gjuhën mbërritëse me një formë adekuate e cila mund të jetë e tipave të mëposhtme:

-me idioma që përmbajnë përbërës identikë (kuptimisht dhe leksikalisht), p.sh., *m'u pre gjaku = ου κόπηκε το αίμα (gr.); apo jetë qeni = vie de chien (fr.), dog's life (angl.)*

-me idioma që përmbajnë përbërës leksikorë të ndryshëm, por me imazh të përafërt, p.sh., *10 me yll = 10 με τόνο (gr.)*

-me idioma me imazh të ndryshëm nga gjuha burimore, p.sh., *s'dua t'ia di = δεν μου καίγεται καρφί.*

-me fjalë (meqë përgjithësisht idiomat kanë fjalë si barasvlerës gjegjës), p.sh., *jetë qeni = σκυλίσια ζωή (gr.)*

-me perifrazime.

-me paraqitje të idiomave në formën origjinale dhe me shënim në fund.

-me heqje ose mosparaqitje të idiomave në gjuhën mbërritëse, sepse, ose nuk mund të përkthehet në mënyrë të kënaqshme, ose nuk konsiderohet e rëndësishme për situatën e komunikimit.

6. 2. Perifrazat me folje të desemantizuar

Historiku i perifrazave me folje të desemantizuar

Perifrazat me folje të desemantizuar janë struktura që përbëhen nga një folje pak a shumë e desemantizuar dhe zakonisht nga një emër në një nga kuptimet e tij literale. Folja është pothuajse e zhveshur nga kuptimi leksikor, ndërsa përmbajtjen semantike strukturës ia jep emri. Si shembuj mund të sjellim: *bëj debat, bëj dëm, bëj durim, bëj keq, bëj kompromis, bëj kontroll, bëj krushqi, bëj luftë, bëj një përkulje, bëj një telefonatë, bëj padi, bëj pushim, bëj përpjekje, bëj përshtypje, bëj premtime, bëj presion, bëj pushime, bëj stërvitje, bëj vërejtje, bëj vizitë, bëhem afër, bëhem vonë, bëhet ditë/natë, bën ftohtë/ngrohtë/vapë, e bëj pirg diçka, kam cipë, kam dhimbje, kam dijeni, kam etje, kam faj, kam frikë, kam ftohtë, kam gjumë, kam kontakte me, kam krushqi me, kam kujdes, kam mall për, kam miqësi me, kam mosmarrëveshje me, kam nevojë për, kam përgjegjësi, kam sedër, kam shpresë, kam të drejtë, kam turp, kam uri, kam vapë, marr hak, marr leje, marr masa, marr me qira, marr mundimin të..., marr në kontroll, marr në ngarkim, marr në provim, marr në punë, marr në pyetje, marr në telefon, marr pëlqimin e dikujt, marr pushime, marr një vendim, marr guximin të, marr hua diçka, jap shpresë, jap urdhër, jap të drejtë, jap një këshillë, jap një vendim, jap përgjigje, jap shpjegime, jap me qira, jap hua diçka, bie me barrë, bie në dashuri me, bie në koma, hedh fajin dikujt, hedh fallin, mbaj përgjegjësi, mbaj një fjalim, mbaj zi, mbaj nën kontroll, jam në hall, jam me barrë, jam në lëvizje, jam në rrezik, vë bast, vë kufi në, vë lidhje me, vë në dukje, lë nam, lë një amanet, lë një porosi, dal në pension, del nga kujtesa, del nga përdorimi, del përfundimi, nxjerr mësim, nxjerr një përfundim, zë fill, zë shoqëri me, më zë inati, kaloj klasën, kaloj në sulm, kaloj provimin, ngre kurth, ngre padi kundër dikujt, hedh fajin dikujt, hedh fallin, hedh në gjyq, hyn në lidhje me, tërheq vëmendjen, tregoj kujdes, vjen në ndihmë, më vjen turp, më vjen ndot/të pështirë, më vjen habi/çudi, mbetem me barrë etj.*

Këtë dukuri gjuhësore e ka vënë re edhe Bally kur trajtonte lokucionet frazeologjike të gjuhës frënge. Bally (1909) shkruante se “Mund të citojmë gjithashtu edhe një tip tjetër lokucioni që përbën kalimin midis serisë dhe njësisë absolute: bëhet

fjalë për lokucione që perifrazojnë foljet. Ky rast është jashtëzakonisht i shpeshtë dhe do të ishte e vështirë të gjeje një folje të zakonshme që të mos kishte në krah të saj një lokucion të përbërë të barasvlershëm; meqë shpesh ky lokucion përfshin një emër të së njëjtës familje me foljen, kjo mënyrë formimi është dhe më tipikja?”. Të gjithë e dimë se në vend të “*duroj*”, mund të themi gjithashtu “*bëj durim*”, në vend të “*përpiqem*” mund të themi “*bëj përpjekje*” etj.

Në vitet 1910, për këtë strukturë Poutsma (1926) ka shkruar se “Ekziston gjithashtu një tendencë e theksuar në anglishten moderne që shpreh një ide foljore nëpërmjet një kombinimi që përbëhet nga një folje me kuptim të zbehur dhe nga një emër veprimi. Për rrjedhojë, përbërësi i fundit përbën pjesën e vërtetë domethënëse të kallëzuesit, ndërsa përbërësi i parë i shërben kryesisht qëllimit të një lidhësi”.

Jespersen (1909) është i pari që përdori një emërtim të veçantë për këto folje. Ai i quajti folje të lehta (light verbs, angl.) dhe i aplikoi në struktura folje + emër të gjuhës angleze, si p.sh., në:

have a drink = pi një pije (kam një pije, lit.)

give a sigh = lëshoj një psherëtimë (jap një psherëtimë, lit.)

take a walk = bëj një shëtitje (marr një shëtitje, lit.)

make a bow = bëj një përkulje

Për këto struktura Jespersen shkruan se “Janë në përputhje me tendencën e përgjithshme [të anglishtes moderne] që vendos një folje pa kuptim, e cila mbart treguesit e vetës dhe të kohës, para idesë me të vërtetë të rëndësishme”.

Ndërsa M. Gross (1981) këto folje i ka quajtur folje mbështetëse (verbes supports, fr.).

Qëndrueshmërinë e këtyre strukturave me vlerë foljore e kanë vënë re dhe e kanë studiuar edhe studiuesit shqiptarë, por secili sipas interesave të fushës së vet të studimit. Kështu, A. Xhuvani (1921) i ka parë në fushën e leksikut ashtu siç ka parë edhe grupin e lokucioneve, i ka quajtur “frazë” dhe i ka përkufizuar si “mënyrë të folurit që e kanë marrë kuptimin jo prej përdorimit, por prej fjalëve veçan; p.sh., *me i dalun zot, me qenë i zoti i vetit* etj.

K. Cipo (1949) i ka quajtur “lokucione pavetore” dhe në to ka përfshirë shprehje si bëka ftohtë, po bën vapë, u bë ditë, ka erë etj.

M. Domi (1985) i ka quajtur “shprehje” të formuara nga një folje e një emër, të shoqëruar ose jo me parafjalë. Në këto raste ky grup fjalësh ka një kuptim të vetëm, ka vlerën e një foljeje dhe mund të marrë edhe kundrinë të drejtë a të zhdrejtë, si p.sh., *kam frikë, i zë besë, i bëj ballë*. Këtë grup strukturash ai e ka zgjeruar edhe me ato që ai i quan “shprehje pavetore” siç janë rastet e ndërtimeve të formuara prej foljes jam e një emri, mbiemri a ndajfoljeje, si p.sh., *ish e pamundur, është marrëzi, është mirë, ti cilat i quan apo rastet si më vjen keq, ra shi* etj.

S. Prifti (1962) i quan “shprehje ndajfoljore” dhe i trajton në kapitullin për kallëzuesin (foljor). Ato përbëhen “nga një folje dhe një ndajfolje, në të cilat kuptimin kryesor e mban ndajfolja dhe jo folja, sepse në ndajfoljen përmbledhet rezultati i foljes. Për këtë shkak tërë fraza mund të kthehet në një folje të formuar nga ndajfolja, si p.sh., *u bënë afër, u bënë larg, u bëra vonë, bëhuni bashkë*. Në kuadrin e kallëzuesit foljor që ai studion, autori dallon edhe një grup tjetër kallëzuesish foljorë siç janë rastet *marr vesh, e morri sysh, e merr me mend, jap ndihmë, bëri luftë, kam*

shpresë, kam ndihmë, s'ka të mbaruar, mori dënimin, merr të nxehtë, thith lagështirë, ku kemi strukturën folje + emër dhe të cilat ai i quan “perifraza”.

Këto struktura të qëndrueshme M. Celiku (1962) i quan “togfjalështa të qëndrueshëm me tendencë leksikalizimi ose të leksikalizuem plotësisht me drejtim leksikor” apo “togfjalështa të qëndrueshëm foljorë që nuk janë leksikalizue ende plotësisht. Me leksikalizimin e tyre pasurohen tashma mjetet nominative të gjuhës: nga dy ose ma shumë komponentë (fjalë kuptimplote) që janë lidhun bashkë me një mënyrë të pandashme formohen disa njisi të reja leksikore, që pasurojnë fjalorin e këtyre të folmeve e që janë ekuivalente kuptimisht me një fjalë të vetme; ma drejtë: sinonime të fjalëve ekzistuese. Disa shembuj: *baj luft, çoj haber, ...*”.

Frazeologu J. Thomai (1981) i quan “njësi frazeologjike” struktura si *bëj pushim “pushoj”; bëj durim “duroj”; bëri ndërhyrje “ndërhyri”; i erdhi ngordhja “ngordhi”; s'i dhanë dot vendim “s'vendosën dot”; bënte përpjekje “përpiquej”; ka lidhje “lidhet”; s'kish dyshim “s'dyshohet”; bënte përçapje “përçapej”; kanë besim “besojnë” etj.* Ai thekson se “Në gjuhën shqipe të shkruar e të folur është i pasur grupi i togfjalëshave frazeologjike që ndërtohen nga një folje me kuptim të përgjithshëm dhe një emër foljor i prejardhur nga një folje tjetër”. Sipas autorit “në përbërjen e këtyre njësive frazeologjike hyjnë folje të përdorimit të shpeshtë, sidomos folja bëj, e cila, pasi shkuptimësohet (desemantizohet) në një farë shkalle, luan rolin e një foljeje gjysmëndihmëse. Themi se togfjalëshi në këtë rast rrjedh nga “zbërthimi” i një foljeje, sepse gjymtyra e dytë e togfjalëshit (emri foljor), siç dihet, formohet nga tema e asaj foljeje”.

Ndërsa te “*Leksikologjia e gjuhës shqipe*” (2006) i njëjti autor (J. Thomai) thekson se “Në një farë mënyre kuptimi frazeologjik del nga ngjizja e kuptimeve të gjymtyrëve, dmth., kuptimi i figurshëm i foljes + kuptimi literal i emrit; kështu, te *bëj durim* [*“bëj durim e s'duroj dot”*] folja bëj është e dobësuar shumë kuptimisht, nuk ka më kuptim leksikor të plotë e të pavarur, bën pak a shumë punën e një foljeje gjysmëndihmëse për gjithë togun e fjalëve (jo si te bëj një punë), kurse emri durim ka hyrë me kuptimin literal.” “Formohen më shpesh me foljet e përdorimit të dendur si bëj, kam, marr, shoh ... dhe janë gjedhe popullore, por vitet e fundit janë bërë karakteristike edhe për gjuhën e shkruar, veçanërisht për letërsinë politiko-shoqërore (*bëj kujdes, kam dyshim, e kam në vëmendje, marr masa, marr vendim.....*) gjymtyrët ruajnë deri diku pavarësinë, mund të ndahen e të ndërrojnë vend dhe jashtë togfjalëshit mund të përdoren me ato kuptime”. Sipas autorit të mësipërm “Gjymtyra që ka kuptim të figurshëm është më e qëndrueshme, ajo përbën vatrën gramatikore e organizuese të këtyre njësive frazeologjike dhe i jep karakter frazeologjik togfjalëshit. Gjymtyra me kuptim literal është vatra kuptimore e njësive frazeologjike, përmban kuptimin themelor dallues, sepse merret vesh që *bëj durim* e *bëj qejf* dallohen kuptimisht nga gjymtyrët e tyre të dyta”.

Edhe në “*Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*” (1999) në grupin e strukturave frazeologjike, J. Thomai përfshin vetëm ato “të tipit *bëj durim “duroj”*, të cilat, veç lidhjeve fjalëformuese me foljet sinonimike (*duroj - durim*) dhe njësive kuptimore, kanë edhe gjymtyrë me kuptim abstrakt, me figurshmëri më të lartë, madje edhe me idiomatikë, që shprehet nëpërmjet shuarjes ose errësimit të raporteve të brendshme sintaksore (kundrinore) ndërmjet gjymtyrëve”.

Këto struktura ne do t'i quajmë perifriza me folje të desemantizuara ose shkurt perifriza. Por para se të kalojmë në arsyet e emërimit të këtyre strukturave si perifriza së pari do të shohim dallimin e mundshëm që ekziston midis termave perifrazë dhe parafrazë dhe së dyti terminologjinë e përdorur në gjuhësinë botërore dhe shqiptare deri tani për të gjithë strukturën si dhe për foljen dhe rolin e foljes më vete.

Dallimi midis termave parafrazë dhe perifrazë

Në "*Fjalori i shqipes së sotme*" (2002), termi parafrazë përkufizohet si "Fjali që jep në mënyrë të zbërthyer kuptimin e një fjale a të një shprehjeje, parafrazim (p.sh., "*ajo që e ka lindur e që e ka rritur*" në vend të "*e ëma*"), ndërsa termi perifrazë si "Grup fjalësh ose fjali që zbërthen kuptimin e një fjale". Në vija të trasha të dy termat përkufizohen si mënyrë e të folurit me më shumë se një fjalë në vend të një fjale të vetme dhe janë shumë afër njëri-tjetrit kuptimisht. Dallimin më të qartë midis këtyre dy termave e gjejmë në versionin elektronik të fjalorit Larousse¹¹¹ të cilin theksohet se "Perifriza nuk bën gjë tjetër veçse mban vendin e një fjale ose të një shprehjeje; në thelb ajo nuk thotë më shumë se aq, ndërkohë që parafriza shton mendime të tjera, ajo shpjegon dhe zhvillon". Edhe strukturat me folje të desemantizuar që ne studiojmë nuk bëjnë gjë tjetër veçse, siç thotë Bally, "perifrazojnë foljet" dhe nuk shtojnë mendime apo shpjegime të tjera, prandaj ne i quajmë ato perifriza dhe jo parafriza.

Terminologjia për strukturën dhe foljen dhe roli i foljes

Në literaturën gjuhësore përdoren shumë terma për emërtimin e këtyre strukturave. Më të zakonshëm janë ata që përmbajnë edhe përbërësin foljor në emërtim¹¹²: në gjermanishte, ato quhen Funktionsverbgefüge (ndërtime me folje funksionale), në anglishte, përdoret "*light verb constructions*" (ndërtime me folje të lehta) apo support verb constructions (ndërtime me folje mbështetëse) apo, periphrases (perifriza), ndërsa costruzioni a verbo supporto (ndërtime me foje mbështetëse) në italisht, construções com verbo suporte (ndërtime me folje mbështetëse) apo construções com verbo leve (ndërtime me folje të lehta) në portugalisht. Nga ana tjetër, mund të gjejmë terma si opitel'nye vyrazeniya (shprehje përshkruese) në rusisht, që nuk përmbajnë përbërësin foljor. Këto ndërtime kanë disa emërtime edhe në shqipe, si p.sh., fraza nga A. Xhuvani, perifriza nga S. Prifti, njësi frazeologjike nga J. Thomai, togfjalësha të qëndrueshëm me tendencë leksikalizimi ose të leksikalizuem plotësisht nga M. Celiku.

Për emërtimin e foljes janë përdorur termat light verbs (folje të lehta) nga Jespersen, verbes supports (folje mbështetëse) nga Gross dhe folje të shkuptimësuar apo të desemantizuara nga Thomai.

Për emërtimin e veçorive të foljeve janë përdorur cilësime si folje funksionale (M. Gross, 1981; J. Grimshaw & A. Mester, 1988), apo ndihmëse (P.E. Hook, 1974; A. Abeillé et al., 1998), ose gjysmëndihmëse (J. Thomai, 1981, 2006). Në fakt ato nuk janë as funksionale, as ndihmëse, as gjysmëndihmëse, sepse ndryshe prej tyre, janë të zhveshura nga kuptimi, por ngjajnë apo afrohen me to nga roli mbështetës që u

¹¹¹ <http://www.larousse.com/en/dictionnaires/francais/>

¹¹² Dobos, Csilla. 1991. Leíró kifejezések az orosz jogi szaknyelvből [Descriptive expressions in the Russian legal language]. Ph.D. thesis, University of Debrecen, Debrecen, Hungary.

ofrojnë emrave prejfoljorë që të zhvillojnë argumentet e tyre. Në raste të caktuara mund të afrohen më shumë me foljet gjysmëndihmëse për arsye të vlerës aspektore që mund të marrin kundrejt foljeve të thjeshta sinonime.

Arsyet e përzgjedhjes së emërimit perifrazë me folje të desemantizuar

Strukturat që studiojmë do t'i quajmë perifraza me folje të desemantizura ku do të ruhet përbërësi foljor dhe të cilit do t'i shtohet cilësimi "i desemantizuar" që shënon natyrën e foljes, cilësim i cili ka dhe njëfarë tradite në shqipe (shih Thomai, 2006). Gjatë studimit ne do të operojmë me të tre termat – folje të lehta, folje mbështetëse dhe folje të desemantizuara – sipas përdorimit nga autorët të cilëve u referohemi, ndërsa një dallim midis foljeve të desemantizuara dhe foljeve të lehta nga njëra anë dhe foljeve mbështetëse nga ana tjetër do ta gjejmë në kapitullin "Dallimi midis perifravezave dhe lidhjeve të lira". Emërtimi bazë i strukturës do të jetë perifrazë që do të përdoret edhe si emërtim i shkurtuar dhe më praktik i gjithë strukturës. E zgjedhim këtë emërtim, sepse në shumë raste ai perifrazon foljet e thjeshta të përdorimit të zakonshëm. Bally që i pari që i dalloi si "... një tip tjetër lokucioni që përbën kalimin midis serisë dhe njësisë absolute: bëhet fjalë për lokucione që perifratojnë foljet" dhe, pavarësisht se nuk gjeti një emër për to, ishte shumë afër emërimit të tyre si perifraza nëpërmjet përkufizimit që u bëri si perifrazim të foljeve. Emërtimin si perifraza e gjejmë në disa autorë si te Prifti (1962), Bardosi (1999), ose te Fidler (2007) dhe Leroi (2004) që përdorin variantin apo sinonimin parafrazë.

Veçoritë e përbërësve të perifrazës

Veçori të foljes:

Duke e emërtuar strukturën në fjalë si perifrazë me folje të desemantizuar, gjëja e parë që bie në sy është rëndësia që merr folja në këtë strukturë. Kjo na shtyn që së pari të trajtojmë dukurinë "folje e desemantizuar". Cilat janë veçoritë e saj? Nga burojnë këto folje? etj. Këtu është vendi për të theksuar se kur flasim për veçori të elementeve përbërëse të strukturës apo për veçori të të gjithë strukturës, duhet të kemi parasysh se këto veçori mbulojnë tërësisht rastin tipik të perifravezave dhe pjesërisht rastet kufi.

Veçoritë kryesore të foljes së desemantizuar janë:

Desemantizimi i foljes

Në lidhje me desemantizimin e foljes në perifraza ka dy qëndrime:

Sipas një qëndrimi, foljet në perifraza nuk mund të kontribuojnë semantikisht në përmbajtjen e strukturës, por vetëm mund të kenë disa role funksionale, si p.sh., të kthejnë emrin në shprehje foljore (Han, 1988; Grimshaw and Mester, 1988; Park, 1992).

Sipas një qëndrimi tjetër, këto folje kanë një farë përmbajtje semantike e cila ndikon në shënimin e aspektit (Jackendoff, 1990; Butt, 1995, Thomai, 1981) apo të rasës (*bëj durim* (kall.) *bëhet natë* (em.) apo në parafralimizimin e emrit (*kam kontakte me vs bie në kontakt me*).

Edhe pse është e vërtetë se në kuadrin e kolokacionit domethënia leksikore e foljes nuk bën gjë tjetër veçse përsërit një pjesë të kuptimit të emrit me të cilin

kombinohet ¹¹³, nuk mund të thuhet se janë të zhveshura nga kuptimi, sepse përzgjedhja e foljeve të desemantizuara jep një kuptim lehtësisht të ndryshëm strukturës, si p.sh., *jam me barrë vs bie me barrë*, apo *kam kontakte me vs bie në kontakt me*, ku rastet *bie me barrë* dhe *bie në kontakt me* tregojnë fillimin e veprimeve.

Mosparashikueshmëria e përzgjedhjes së foljes

Folja në perifrază nuk zgjidhet nga folësi mbi një bazë semantike, por në bazë të përdorimit. Ajo është në funksion të emrit dhe funksioni i saj është të shprehë mënyrën, kohën, vetën etj. Kështu, në shembullin *Partitë politike debatuan për presidentin ri*, është folja që përcakton shpërndarjen e argumenteve emërore, ndërsa po të shohim shembullin *partitë politike bënë debat për presidentin e ri*, është e dukshme lidhja midis foljes debatuan dhe grupit folje-emër (bënë debat): e njëjta lidhje sintaksore, i njëjti kuptim, e njëjta përzgjedhje e argumenteve emërore. Në këtë rast është emri *debat* që vendos për përzgjedhjen dhe jo folja *bënë*, e cila nuk shërben veçse si mbështetëse për emrin predikativ. Për të përdorur *bëj debat* folësi i gjuhës duhet në fillim të njohë njësinë leksikore *debat* dhe vetëm kur të dojë të përdorë këtë emër në një kontekst sintagmatik, ai do të ketë nevojë për një folje të veçantë e cila do t'i lejojë të shprehë argumentet e emrit *debat* pa shtuar ndonjë shënjes të ri leksikor.

Mosparashikueshmëria duket edhe në përzgjedhjet e ndryshme që bëjnë emrat sinonime. Kështu, në shqipe thuhet *e ftuara na bëri / la përshtypje shumë të mira*, por *e ftuara na la mbresa shumë të mira*, ku dallojmë se emri *përshtypje* mund të përzgjedhë foljen *bëj* ose *lë*, ndërsa emri semantikisht i afërt me të *mbresa* nuk mund të zgjedhë veçse foljen *lë* për të njëjtin funksion. Të njëjtin argumentim mund të japim edhe për *mbaj një fjalim vs bëj një leksion*.

Mosparashikueshmëria duket edhe gjatë përkthimit kur kalojmë në një gjuhë tjetër¹¹⁴. Kështu, në shqipe themi *bëj një shëtitje*, ndërsa në anglishte *take a walk (marr një shëtitje, lit.)*, ku të njëjtat fjalë korresponduese në gjuhë të ndryshme (*shëtitje* dhe *walk*) përzgjedhin folje të ndryshme për të njëjtin funksion.

Në të gjitha rastet e mësipërme emri përzgjedh foljen për të formuar një tërësi semantike dhe kjo përzgjedhje është e kufizuar, sepse nuk mund të përzgjedhim një folje të dhënë me çfarëdo emri.

Heqja e foljes së desemantizuar

Në perifraza folja mund të hiqet dhe informacioni kuptimor nuk humbet¹¹⁵. Kjo do të thotë se emri predikativ është sinonim me të gjithë strukturën që përfshin foljen e desemantizuar. Kjo veçori mund të kontrollohet duke zëvendësuar një fjali me sintagmën emërore:

Agroni ishte i kënaqur që i vëllai morri një vendim të drejtë.

Agroni ishte i kënaqur për vendimin e drejtë të vëllait.

¹¹³ Alonso Ramos, M. (1998). Etude sémantico-syntaxique des constructions à verbe support. Ph.D. thesis, Université de Montréal, Montreal, Canada.

¹¹⁴ Danlos, L. 1992. Support Verb Constructions: Linguistic Properties, Representation, Translation.

¹¹⁵ Langer, S (2004). A Formal Specification of Support Verb Constructions. in SemantikimLexikon. Langer, S. and Schnorbusch, D. [Eds.]. Tübingen.

Ngjashmëria formale me foljen kryesore

Një veçori kryesore e foljes në perifraza është se ajo ka gjithnjë të njëjtat forma me foljen kryesore¹¹⁶, por ajo është e dobësuar semantikisht dhe, për rrjedhojë, përcjell një kuptim jotransparent në strukturën ku bën pjesë. Kështu, në shembullin *jap këshilla* ku folja *jap* është e përdorur si folje e desemantizuar mund të përdoret në të njëjtat mënyra, kohë, numra, veta etj., si në shembullin *jap një mollë* ku folja *jap* është e përdorur si folje në kuptimin e saj kryesor.

Informacioni gramatikor i foljes

Elementi foljor në perifrazë mund të zgjedhohet dhe të na japë informacion mbi kohën, mënyrën, vetën, numrin etj.,¹¹⁷ si dhe për ndonjë nuancë aspektore apo dhe lloje të tjera informacioni semantik¹¹⁸. P.sh., përdorimi i *jap një përgjigje* kundrejt foljes së thjeshtë *përgjigjem* tregon se veprimi bëhet qëllimisht.

Mospredikativiteti i foljes

Për sa i përket natyrës semantike të foljeve të desemantizuara kemi theksuar se ato janë pak a shumë të desemantizuara, dmth., se nuk i shtojnë kuptim emrit me të cilin kombinohen dhe se nuk zgjidhen për kuptimin, por në funksion të emrit i cili i përzgjedh. Për rrjedhojë, këto folje nuk kryejnë funksionin e kallëzuesit të fjalisë por shërbejnë si mbështetje për një emër predikativ që e luan këtë rol (Gross, 1975; 1981; 1998). Në këtë optikë, kuptojmë se përmbajtja e kallëzuesit mbartet pothuajse plotësisht nga emri, ndërkohë që folje është një mbështetës sintaksor. Siç thekson edhe G. Gross (2005), “foljet nuk kanë funksion predikativ, nuk janë ato që përzgjedhin argumentet në fjali. Funksioni i tyre është të aktualizojnë kallëzuesit emërorë. Ato luajnë të njëjtin rol si dhe mbaresat e kallëzuesve foljorë” (krhs. Bally, 1909).

Dallimi i foljes së desemantizuar nga folja e thjeshtë sinonime

Perifrazat hyjnë në marrëdhënie sinonimie me foljet e thjeshta, por mund të ndryshojnë prej tyre në lidhje me vlerën e tyre aspektore si të shkurtra, durative etj. P.sh., *Drita i dha një të fshirë dhomës dhe u largua për në punë*, tregon një veprim më të shkurtër dhe më të shpejtë se *Drita fshiu dhomën dhe u largua për në punë*.

Zëvendësimi i foljes së desemantizuar

Në shumë raste është e mundur që një folje e desemantizuar të zëvendësohet nga një folje tjetër e desemantizuar dhe kryesisht nga “*bëj*”. Perifraza e re e krijuar është jogramatikore nuk përdoret në gjuhë, por mund të kuptohet¹¹⁹. Kjo duket në shembujt e mëposhtëm:

Vajza bëri një psherëtimë për vajza lëshoi një psherëtimë.

Uji nuk ka bërë valë akoma për uji nuk ka marrë valë akoma.

Drejtori bëri një fjalim për drejtori mbajti një fjalim.

Kjo është e mundur kur folja është plotësisht e desemantizuar dhe nuk mbart informacion aspektor.

¹¹⁶ Butt, M. (2003). The Light Verb Jungle. Harvard Working Papers in Linguistics 9.

¹¹⁷ Vincke, V & Csirik, J. (2010). Hungarian corpus of light verb constructions. In Proceedings of the 23rd International Conference on Computational Linguistics. Beijing, China.

¹¹⁸ Butt, M. (2003). vep. e cit.

¹¹⁹ Langer, S (2004). vep. e cit.

Nominalizmi i foljeve të desemantizuara

Me nominalizim të foljeve të desemantizuara do të kuptojmë krijimin e emrave prejfoljorë mbi bazën e këtyre foljeve dhe, për rrjedhojë, siç shkruan Thomai (2006), realizimin edhe të njësisive me vlerë emërore në gjuhë, si p.sh., nga *marr një vendim* përftohet *marrja e një vendimi*. Ky lloj nominalizmi nuk është i mundshëm në të gjitha gjuhët, si p.sh., në frëngjishte, por është gjithnjë i mundshëm në anglishte nëpërmjet formës me –ing.

Natyra e foljeve të desemantizuara: të shpeshta

Gjatë studimit të foljeve të desemantizuara duhet të njohim edhe natyrën e tyre. Foljet e desemantizuara janë folje të përdorimit të zakonshëm dhe me kuptim të përgjithshëm¹²⁰ të cilat, “kur kombinohen me disa plotësa, humbasin një pjesë të kuptimit të tyre normal dhe quhen të varfëruara semantikisht”¹²¹.

Numri i foljeve të desemantizuara: të pakta

Duket se ka një grup qendror foljesh të desemantizuara që ekziston në gjuhë të ndryshme dhe që lidhen me rastin tipik të perifrazave. Midis foljeve të desemantizuara, më të zakonshme në anglishte janë *take “marr”, give “jap”, make “bëj”, have “kam”, do “bëj” dhe brengen “sjell”, doen “bëj”, gaan “shkoj”, geven “jap”, hebben “kam”, komen “vij”, krijgen “marr”, maken “bëj”, nemen “marr” dhe stellen “shpall”* në gjermanishte¹²².

Për shqipen do të dallonin katër folje kryesore, si p.sh., *bëj, kam, marr, jap*. Pothuajse të njëjtat folje të përdorimit të zakonshëm njeherë edhe M.Celiku (1962) kur shkruan se “...te togfjalëshat e qëndrueshëm me tendencë leksikalizimi ose të leksikalizuem plotësisht numri i foljeve, që lozin rolin e komponentit të parë gjithashtu është i kufizuem; përmendim ndër të tjera: *baj, kam, marr, vej, mbaj* etj. Pra, përse u përket komponentëve të para kemi një kufizim të theksuem në numrin e verbave”, apo J.Thomai (2006) kur shkruan se ato “... formohen më shpesh me foljet e përdorimit të dendur si *bëj, kam, marr, shoh...*”.

Sipas Butt (1995) numri i foljeve të desemantizuara nëpër gjuhë të ndryshme lëviz nga 5 në 20. Disa nga foljet që sipas tij i gjejmë në gjuhë të ndryshme janë *come “vij”, go “shkoj”, take “marr”, give “jap”, hit “godas”, throw “hedh”, give “jap”, rise “ngrihem”, fall “bie” dhe do/make “bëj”*. Shqipja është shumë e pasur me folje apo me struktura të tilla¹²³ dhe për të do të dallonim mbi 20 folje të tilla, si p.sh., *bëj, kam, marr, jap, bie, hedh, mbaj, jam, vë, lë, dal, nxjerr, zë, kaloj, ngre, heq, hyj, tërheq, tregoj, vjen, mbetem* etj., të renditura kryesisht sipas shkallës së desemantizimit dhe rasteve të përdorimit.

Në mënyrë të përmbledhur mund të kujtojmë tiparet e përgjithshme të foljeve të desemantizuara:

-Së pari, foljet e desemantizuara janë të zhveshura nga kuptimi dhe nuk kanë si rol veçse të aktualizojë emrin predikativ që i ndjek. Foljet e humbasin vlerën e tyre

¹²⁰ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

¹²¹ M. Butt and W. Geuder. (2001). On the (semi)lexical status of light verbs. In Norbert Corver and Henk van Riemsdijk, editors, *Semi-lexical Categories*, volume 59 of *Studies in Generative Grammar*. Mouton de Gruyter.

¹²² Stevenson, S., Fazly, A., and North, R. (2004). Statistical measures of the semi-productivity of light verb constructions. In *Proceedings of the ACL 2004 Workshop on Multiword Expressions: Integrating Processing*, pages 1–8, Barcelona, Spain.

¹²³ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

predikative në favor të emrit, duke qenë se nuk mund të kemi dy kallëzues të njëpasnjëshëm brenda një fjalie të thjeshtë.

-Për më tepër, foljet e desemantizuara mund të hiqen nga formimi i grupit emëror që përmban kallëzuesin emëror dhe argumentet e tij. Mirëpo ky reduktim nuk mund të ndodhë veçse pas një transformimi me relativizim mbi sekuencën në fjalë, nga ku duket dhe lidhja midis disa kallëzuesve emërorë dhe disa foljeve të thjeshta.

Veçori të emrit:

Veçoritë kryesore të emrit janë:

Mosdesemantizimi i emrit ose përdorimi i emrit në kuptim literal

Në qoftë se folja është pak a shumë e desemantizuar brenda perifrazës, emri nuk është i desemantizuar. Ai përdoret në një nga kuptimet e tij literale dhe është mbartës i vërtetë i gjithë strukturës shumëfjalëshe¹²⁴. Ai plotëson dhe saktëson foljen semantikisht. Për rrjedhojë mund të themi se përmbajtja e strukturës mbartet vetëm nga emri i cili luan rolin e kallëzuesit semantik në perifrazë, ndërsa folja është një mbështetës i thjeshtë sintaksor. Kështu, në shembujt *Agroni ka kontakte me të gjithë shokët e shkollës* dhe *qeveria bën fushatë kundër pirjes së duhanit*, përmbajtja e kallëzuesve transmetohet vetëm nga emrat *kontakte* dhe *fushatë*, ndërsa foljet nuk shërbejnë veçse për të “zgjedhuar” këta emra.

Natyra abstrakte e emrit

Një nga veçoritë dalluese të emrave që hyjnë në përbërje të perifrazave është natyra e tyre abstrakte dhe foljet mund të konsiderohen si folje mbështetëse që funksionojnë pranë një kategorie të caktuar emrash abstraktë¹²⁵. Emrat duhet të jenë emra abstraktë të prejardhur nga foljet apo mbiemrat, por kurrë nuk mund të jenë emra konkretë¹²⁶. Në këtë pikë ka një marrëveshje pothuajse unanime: vetëm emrat abstraktë mund të kenë argumente.

Një problem që ekziston me emrat abstraktë është se kuptimi i këtyre emrave mund të bëhet konkret me kalimin e kohës, me anë të asociacionit metonimik. Le të krahasojmë përdorimet e emrit propozim në dy shembuj të ndryshëm:

Agroni i bëri një propozim komisionit.

Agroni e vendosi propozimin mbi tavolinë.

Përdorimi konkret i emrit abstrakt nuk përfshihet në ndërtimin me folje të desemantizuar, sepse e ka humbur kuptimin e veprimit dhe, për rrjedhojë, edhe rolet semantike.

Natyra prejfoljore e emrave

Në shumicën e rasteve emri lidhet morfologjikisht me një folje nga e cila edhe rrjedh. Kjo është arsyeja që shumë emra përbërës të perifrazave janë prejfoljorë dhe shprehin veprime apo gjendje ashtu si edhe folja, si p.sh., *bëj debat* = *debattoj*, *bëj durim* = *duroj*, *bëj kontroll* = *kontrolloj*, *bëj luftë* = *luftoj*, *bëj një telefonatë* = *telefonoj*, *kam shpresë* = *shpresoj*, *marr në punë* = *punësoj*, *marr një vendim* =

¹²⁴ Bardosi, V. (1999). vep. e cit.

¹²⁵ Lapore, E., Ranchhod E. & Yannacopoulou A. (2008). Syntactic variation of support verb constructions. *Linguisticae Investigationes*, 31(2).

¹²⁶ Cinková, S. & Kolářová, V. (2005). Nouns as Components of Support Verb Constructions in the Prague Dependency Treebank. In Šimková, Mária (ed.), *Insight into Slovak and Czech Corpus Linguistics*, pp. 113–139. Veda Bratislava, Slovakia.

vendos, jam në rrezik = rrezikohem, më zë inati = inatosem, tregoj kujdes = kujdesem, vjen në ndihmë = ndihmoj, më vjen turp = turpërohem etj. Por kemi edhe raste kur është folja ajo që rrjedh nga një emër, si p.sh., *surprizoj* që vjen nga *surprizë*.

Paralelisht me shembujt e mësipërm, ka edhe shumë emra që nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga folja. P.sh, nuk ka asnjë folje “*dushohem, banjosem, krushqohem, vapoSEM etj.*” edhe pse *dush, banjë, krushqi, uri, vapë, vëmendjen* tregojnë veprime dhe gjendje në *bëj dush, bëj banjë, bëj krushqi, kam uri, kam vapë, tërheq vëmendjen*.

Predikativiteti i emrit

Në punimet mbi perifrazat me folje të desemantizuara, pohohet se emri që hyn në përbërje të perifrazave ka natyrë predikative¹²⁷. Natyra predikative e emrit është pasojë e natyrës prejfoljore të tij.

Shumë folje për një emër

Ka emra që hyjnë në përbërjen e shumë perifrazave, por shprehin informacion të ndryshëm aspektor etj. Përveç këtyre dallimeve, këto perifraza janë sinonime¹²⁸. Kështu, në grupin sinonimik *jam me barrë, bie me barrë, mbetem me barrë* apo në grupin sinonimik *kam inat, mbaj inat kundër dikujt, ia nxjerr inatin dikujt, më zë inati, ha inat me dikë*, kemi emrat *barrë* dhe *inat* që përdoren me folje të ndryshme të desemantizuara në shumë perifraza sinonime, por, përveç dallimeve nuancore, dalin edhe në trajta dhe në funksione të ndryshme.

Kufizime morfo-sintaksore të emrit

Në lidhje me ngurosjen e strukturës në studim Celiku (1962) thekson: “Për sa u përket komponentëve të dyta vihet re një kufizim i formave gramatikore.. ... te togfjalëshat e leksikalizuem komponentet e dyta dalin zakonisht në trajtë të pashquar, në rasën kallëzore, në numrin njëjës kur ato janë emra”, si p.sh., *bëj dëm, bëj durim, bëj presion, kam dijeni, kam etje, kam frikë, kam ftohtë, kam gjumë, kam uri, kam vapë* etj. Siç duket nga shembujt e mësipërm, prania e një emri në rasën kallëzore, njëjës, të pashquar, por pa nyje, është shenjë e një shkalle kohezioni sintaksor më të ngushtë midis përbërësve të perifrazës, por kjo nuk do të thotë se emrat e perifrazave nuk përdoren edhe në trajta të tjera, me apo pa nyje, apo se disa emra nuk dalin vetëm në forma të tjera, siç do ta shohim më poshtë.

Për rrjedhojë, ajo që i karakterizon më shumë emrat përbërës të perifrazave është tendenca për të pasur një karakter të ngurosur (pavarësisht se në cilën formë ka tendencë të ndodhë ngurosja) dhe në më pak raste një ngurosje të mirëfilltë. Rastin e ngurosjes së mirëfilltë e gjejmë në disa emra që përdoren vetëm në trajtën e shquar, si p.sh., *tërheq vëmendjen, të theksin, marr mundimin të...*, apo vetëm në trajtë të pashquar, si p.sh., *vë në dukje, vë në lëvizje, vjen në ndihmë, marr në kontroll, marr në ngarkim, marr në punë, marr në pyetje, marr në telefon, jam me barrë, ia kam borxh, ia kam hua, ia lë amanet diçka dikujt, ia lë barrë diçka dikujt*, apo vetëm në rasën emërore, si p.sh., *del përfundimi, del vendimi, më merr malli, më vjen inat* etj.

Një nga rastet e emrave që në përbërje të perifrazave kanë tendencë të kenë një karakter të ngurosur është rasti i emrave që zakonisht dalin në trajtë të pashquar, në

¹²⁷ Alonso Ramos, M. (1998). vep. e cit.

¹²⁸ Langer, S (2004). vep. e cit.

rasën kallëzore, në numrin njëjës, por ato mund të përdoren edhe me nyje, në të shquarën, në emërore, në shumës, si p.sh. *bëj presion*, por edhe *bëj një presion të madh*, *kam etje*, por edhe *kam shumë etje* apo *nuk kam etjen e djeshme* *jap urdhër*, por edhe *jap një urdhër*, *jap urdhra*, *iu dha urdhri të... etj.*

Raste të tjera të emrave që në përbërje të perifrastave kanë tendencë të kenë një karakter të ngurosuar janë rastet e emrave që zakonisht dalin:

-me nyje (të pashquar), si p.sh., *bëj një telefonatë*, *jap një këshillë*, *jap një vendim*, *lë një amanet*, *lë një porosi*, *marr një vendim*, *mbaj një fjalim*

-në të shquar, si p.sh., *jap bekimin*, *ia nxjerr inatin dikujt*, *ia hedh fajin dikujt*, *mbaj premtimin*, *etj.*

-në shumës, si p.sh., *bëj përpjekje*, *bëj vërejtje*, *bëj premtime*, *bëj pushime*, *bëj shpjegime*, *jap shpjegime*, *nxjerr mësim*, *marr masa* etj, por në të gjitha këto nënraste mund të dalin edhe në forma të tjera, si p.sh., *bëri vetëm dy telefonata*, *i dha këshillën më të mirë*, *do të të jap një bekim*, *nuk dha asnjë shpjegim* etj.

Kufizimi i emrave në trajtën e pashquar pa nyje sjell edhe kufizimin e disa operacioneve sintaksore karakteristike për emrat.

Mospronominalizimi

Ndonjëherë emri i pashquar pa nyje nuk mund të rimerret me trajtë të shkurtër (të pronominalizohet), p.sh.:

Ke uri? –Po, kam dhe jo, po, e kam.

Por, kur ka përcaktime të mëtejshme në fjali, në shumicën e rasteve emri mund të rimerret me trajtë të shkurtër, si p.sh.:

Ke dhimbje? –Po, kam dhe jo po, e kam, por mund të themi: *po, tani e kam në pjesën e sipërme të dorës.*

Mosrelativizimi

Në rastin e emrave të pashquar pa nyje, do të ishte e pamundur të relativizohet emrin (ta rimerrim me një përemër lidhor), si p.sh., *kam vapë që më shqetëson shumë*, por mund të thuhet: *kam një vapë që më shqetëson shumë*, sepse edhe emrat që zakonisht shfaqen pa nyje në perifrasta, e lejojnë ndërtimin e një fjalie lidhore kur shoqërohen me nyje.

Edhe pse mund të gjejmë edhe raste të kundërta, si p.sh., *kam mbështetje të cilën e gjej në rrethin e ngushtë familjar*; *kam etje e cila më vjen nga ëmbëlsira që kam ngrënë*, ato mbeten, gjithsesi, ndërtime jo të zhdërvjellëta

Ajo që duam të theksojmë është se kur ekziston mundësia e përdorimit të njëjës së pashquar, emri sillet si një sintagmë emërore e rregullt. Mirëpo, një emër pa nyjë i jep një shkallë më të lartë kohezioni perifrastës, në mënyrë të tillë që lidhja midis foljes dhe emrit ka tendencë të perceptohet si më e ngushtë.

Por, me gjithë rëndësinë që ka mungesa e nyjës, ajo “nuk përbën veçse një anekdotë”, siç shkruan Giry-Schneider (1991), apo, siç vlerëson Romero-Méndez (2007), “Nuk është aspak çudi që një ndërtim me folje të lehtë me emër që tregon një veprim të mund të alternohet midis një interpretimi akumulativ me një emër në shumës dhe një interpretimi sasior. Për më tepër, emrat që tregojnë veprim mund t’u referohen gjithashtu ngjarjeve të veçanta dhe në këtë mënyrë mund të pranojnë gjithashtu njëjën e shquar”.

Nëna i dha një të puthur fëmijës

Nëna i dha disa të puthura fëmijës

*Nëna i dha tri të puthura fëmijës
Nëna i dha fëmijës të puthurën e lamtumirës*

Forma pyetëse

Një kriter tjetër vlerësimi të mungesës së autonomisë së emrit në perifriza është forma pyetëse e cila, po të bëhej mbi foljen, do të prodhonte një thënie pyetje-përgjigje që do të pranohej me vështirësi.

-Doktori nuk i dha shpresa të sëmurit.

*-*Çfarë nuk i dha? do të ishte më pak e pranueshme nga Çfarë bëri?*

Kjo ndihet më shumë me emrat me parafjalë.

**Me se ra? –Me barrë. Do të ishte më e pranueshme të pyesnim me Çfarë bëri?*

**Ku ra? –Në kurth. Do të ishte më e pranueshme të pyesnim me Çfarë pësoi ?*

Vërejtje:

Pyetje të tilla mund të bëhen me foljen kam dhe sidomos me foljen jam, të cilat janë edhe folje të përdorimit më të përgjithshëm.

-Agroni nuk ka asnjë shpresë të fitojë. -Çfarë nuk ka Agroni?

-Agroni bën shumë hile. -Çfarë bën Agroni?

Pranueshmëria e dobët e këtyre thënieve është lehtësisht e shpjgueshme. Meqë folja është e desemantizuar, nuk është e mundur që pyetja të bëhet mbi predikatin sintaksor. Folja e desemantizuar ushqehet semantikisht nga emri dhe nuk mund të shfaqet me përemra pyetës.

Mungesa e autonomisë së emrit në perifriza duket edhe në rastin e plotësive të emrave predikativë. Ata vazhdojnë të varen sintaktikisht nga emri predikativ dhe bëhen plotës të gjithë kallëzuesit të përbërë. Kjo çon në mundësinë e veçimit të tyre nga emri predikativ dhe nga i gjithë kallëzuesi i përbërë, por në pamundësinë e veçimit të emrit predikativ nga folja. E kundërta ndodh me lidhjet e lira ku është e pamundur shpërbërja e sintagmës emërore (emri plotës nga drejtuesi i tij), por është i mundur veçimi i gjithë sintagmës emërore nga folja, si p.sh.:

Nuk mbaj përgjegjësi për situatën.

Vetëm për situatën që nuk mbaj përgjegjësi, por:

Mbaj këpucë me taka.

Vetëm me taka mbaj këpucë, por duhet thënë: Vetëm këpucë me taka mbaj.

Veçori të strukturës:

Veçoritë kryesore të gjithë strukturës me folje të desemantizuar janë:

Kompozicionaliteti i pjesëshëm semantik i strukturës

Kuptimi i perifravezave nuk është tërësisht kompozicional, dmth ai nuk del si shumë e kuptimeve të pjesëve të tyre përbërëse. Emri merret në një nga kuptimet e tij literale, ndërsa folja zakonisht e humbet në një farë mase kuptimin e saj origjinal. Kështu, te *bëj stërvitje* folja *bëj* është e dobësuar shumë kuptimisht, nuk ka më kuptim leksikor të plotë e të pavarur, si te *bëj bukë/këpucë/tjegulla/raki etj.* që ka domethënie të plotë dhe të pavarur “prodhoj, përgatis”, kurse emri *stërvitje* ka hyrë me kuptimin literal. Edhe te *jap një këshillë* folja *jap* është e dobësuar shumë kuptimisht, nuk ka më kuptim leksikor të plotë e të pavarur, si te *jap një libër/mollë etj.*, që ka domethënie të plotë dhe të pavarur dorëzohj, kurse emri *këshillë* ka hyrë me kuptimin literal.

Kjo duket edhe në përkthimin e tyre në gjuhë të tjera (pavarësisht se shumica përputhen). Gjatë kalimit në gjuhë të tjera përkthimi i pjesëve të perifravezës nuk ka

domethënie, si p.sh., *bëj një shëtitje*, por *take a walk në anglishte (marr një shëtitje, lit.)*, *bëj luftë*, por *δίω μια μάχη në greqishte (jap një luftë/betejë, lit.)*. Siç theksojnë edhe Samardžić & Merlo, “Kuptimi i tyre është pjesërisht jokompozicional, i formuar në mënyrë konvencionale, gjë që do të thotë se nuk mund të analizohen si ndërtime të rregullta dhe se nuk mund të përkthehen në gjuhë të tjera në mënyrë të drejtpërdrejtë fjalë për fjalë”.

Gjysmë-prodhueshmëria e perifrashave

Čermák (1974) vëren një shkallë të lartë prodhueshmërie të perifrashave në pothuajse të gjitha gjuhët europiane, ndërsa sipas Stevenson, S., Fazly, A. & North, R. (2004) vërejnë se “Ndërtimet me folje të lehta janë shumë produktive në disa gjuhë, si p.sh., në persishte, në urdu dhe në japonishte. Në gjuhë të tjera, si p.sh., në frëngjishte, në italishte, në spanjishte dhe në anglishte, këto ndërtime janë gjysmë-produktive”. Në këto të fundit përfshihet edhe shqipja. Kjo do të thotë se foljet e desemantizuara të shqipes kanë tendencë të përdoren me shumë emra që i takojnë një klase të caktuar semantike (por jo me të gjitha), si p.sh., bëj presion/shantazh, bie në ujdi/kompromis me dikë, kam sedër/cipë/turp, bën ftohtë/ngrohtë/nxehtë/vapë etj.

Sinonimia e perifrashave

Në shumë raste ekziston një folje e thjeshtë sinonime e cila mund të zëvendësojë të gjithë perifrashën. Shpesh kjo folje lidhet morfologjikisht me emrin predikativ¹²⁹, si p.sh., *marr një vendim = vendos, kam shpresë = shpresoj, bëj stërvitje = stërvitem etj.*

Por ka raste kur perifrasha është sinonime me një njësi tjetër leksikore, si p.sh., *bëj qejf = kënaqem, bëj përshtypje = impresionoj, bëj gjumë = fle, bën keq = dëmton, kam cipë = turpërohem etj.*

Në shumë raste perifrashave nuk u korrespondon një folje e thjeshtë sinonime në gjuhë, si p.sh., kam uri, kam etje, kam të drejtë, mbaj zi etj.

Bërthama sintaksore dhe bërthama semantike e strukturës

Në përbërjen e strukturës dallojmë dy bërthama: një bërthamë sintaksore dhe një bërthamë semantike që nuk janë të njëjta – bërthama sintaksore përbëhet nga folja dhe shpreh kohën, vetën, mënyrën dhe numrin e strukturës, ndërsa bërthama semantike përbëhet nga emri i cili përfshin rolet semantike të argumenteve dhe të cilat u jepen argumenteve nga folja dhe emri (kallëzuesi i përbërë). Kështu, në shembullin *Punëdhënësi u bëri premtim për rritje rroge punëtorëve*, mënyrën, numrin, vetën dhe kohën e bërjes së premtimit e shpreh folja *bëj*, ndërsa rolet semantike i takojnë emrit *premtim* (agjenti, qëllimi, përfituesi janë punëdhënësi, për rritje rroge dhe punëtorëve respektivisht) dhe i jepen çdo argumenti nga kallëzuesi i përbërë.

Përmbajtja kuptimore e strukturës

“Veçoria semantike karakteristike e perifrashave është se kuptimi i tyre përbëhet kryesisht nga kuptimi i emrit predikativ”¹³⁰. Siç do të ilustrimet edhe nga shembujt e mëposhtëm, pjesa më e madhe e kuptimit dallues të perifrashave vjen nga plotësi i foljes së desemantizuar dhe jo nga folja. Kështu, te *bëj stërvitje* folja *bëj* është e dobësuar shumë kuptimisht, nuk ka më kuptim leksikor të plotë e të pavarur, si te *bëj bukë/këpucë/tjegulla/raki etj.*, ku ka domethënie të plotë dhe të pavarur “*prodhoj*,

¹²⁹ Langer, S (2004). vep. e cit.

¹³⁰ Krenn, B. & G. Erbach (1994). Idioms and support verb constructions. In Nerbonne, J., K. Netter & C. Pollard (eds.) German in Head Driven Phrase Structure Grammar, 297–340. Stanford, CA: CSLI Publications.

përgatis”, kurse emri *stërvitje* ka hyrë me kuptimin literal. Edhe te *jap një këshillë* folja *jap* është e dobësuar shumë kuptimisht, nuk ka më kuptim leksikor të plotë e të pavarur, si te *jap një libër/mollë etj.* ku ka domethënie të plotë dhe të pavarur “*dorëzoh*”, kurse emri *këshillë* ka hyrë me kuptimin literal.

Struktura e perifrazës: kallëzues i përbërë

Përderisa në përbërjen e strukturës dallojmë dy bërthama: një bërthamë sintaksore dhe një bërthamë semantike që nuk janë të njëjta – bërthama sintaksore përbëhet nga folja, ndërsa bërthama semantike përbëhet nga emri, kjo strukturë kërkon një trajtim të veçantë¹³¹. Struktura e perifrazës mund të funksionojë si një kallëzues i vetëm¹³² ashtu si çdo folje tjetër e thjeshtë dhe nuk ka asnjë dallim midis një perifraxe dhe foljes së thjeshtë në lidhje me predikativitetin apo me strukturën argumentale. Kështu në shembullin me perifraxë *kandidati për deputet u bëri premtime për një të ardhme më të mirë simpatizantëve të tij* dhe, në shembullin me kallëzuesin leksikor gjegjës (njëfjalësh), *kandidati për deputet u premtoi për një të ardhme më të mirë simpatizantëve të tij* kanë të njëjtin numër dhe tipa argumentesh (kandidati për deputet, për një të ardhme më të mirë dhe simpatizantëve të tij respektivisht). Në vend të një foljeje të vetme, në perifraxë kemi një strukturë komplekse e cila lidhet si një e tërë me kryefjalën me ndërmjetësinë e *bëj*. Sintaktikisht, struktura duket e plotë: mund të përfshijë kryefjalën dhe plotësit e strukturës folje + emër¹³³. Për analizën sintaksore funksioni i kundrinorit të drejtë është një lidhje shumë e ngushtë midis foljes dhe një përbërësi emëror që e plotëson dhe që e saktëson semantikisht. Mund të themi se folja + emër formojnë së bashku një kallëzues sintaksor të vetëm¹³⁴. Kjo ide e barazimit të perifrazës me një folje të thjeshtë ka një traditë: P.sh., Leclère (1971) tregon se disa emra si *constatation* (fr.) (=konstatim) apo *impression* (fr.) (=përshtypje) në kombinim me disa folje si *faire* (fr.) (=bëj) apo *avoir* (fr.) (=kam) respektivisht kanë një sjellje sintaksore të barasvlershme me atë të një foljeje. Akoma më tutje në kohë, Bally trajton prapashtesat mbaresore të perifraxave si infikse: kështu, sipas analizës së tij, në *il prenait peur* (ai merrte frikë, lit.) mbaresa –ait e pret më dysh rrënjën “*prendre peur*” (marr frikë, lit.).

Këtë lloj kallëzuesi do ta quajmë kallëzues të përbërë (shih Celiku, 1962; Butt, 1995 etj.). Për këtë Ramos(2001) thotë se “karakterit “i ngjitur” i ndërtimeve me folje mbështetëse, kryesisht ato ku emri shfaqet pa nyjë, ka bërë që disa gramaticienë t’i trajtojnë këto ndërtime si një lloj foljeje të përbërë, që funksionon sintaktikisht si një fjalë e vetme”

Perifraxa me folje të desemantizuar: njësi leksikore

Për të verifikuar nëse perifraxat përbëjnë njësi leksikore, duhet të shikojmë nëse ato janë të paanalizueshme semantikisht, dmth., nëse është e pamundur t’ia atribuojmë një pjesë të kuptimit tërësor secilit element përbërës dhe, pra, nëse shprehja ka kuptim vetëm en bloc¹³⁵. Nga shqyrtimi i bërë rezulton se perifraxat hyjnë në ligjërim si njësi

¹³¹ Vincze, V & Csirik, J. (2010). vep. e cit.

¹³² Celiku, M. (1962). vep. e cit.

¹³³ Gross, M. (1981). vep. e cit.

¹³⁴ Giry-Schneider, Jacqueline. 1987. Les prédicats nominaux en français. Les phrases simples à verbe support, Genève: Droz.

¹³⁵ Alonso Ramos, M. (1998). vep. e cit.

të vetme me vlerën e një foljeje dhe, për rrjedhojë, janë kombinime të leksikalizuara të një foljeje të desemantuzar dhe të një emri. Ato sillen si folje të thjeshta leksikore (dmth, njëfjalëshe) në lidhje me predikativitetin dhe strukturën argumentale¹³⁶, si p.sh., *Agroni bëri përpjekje për notë të mirë = Agroni u përpoq për notë të mirë* ku folja “*u përpoq*” është dyvalente ashtu si dhe perifraza “*bëri përpjekje*”.

Edhe po t’u referohemi qëndrimeve tradicionale sipas të cilave janë kryesisht njësitë e leksikalizuara që kanë tendencë të shfaqin sjellje të veçantë sintaksore, rezulton se perifrazat duhet të konsiderohen si struktura pak a shumë të leksikalizuara¹³⁷ dhe se duhet të depozitohen në leksikon mendor si zëra të ndarë me çdo folje dhe emër të specifikuar plotësisht.

Meqë perifrazat njihen si njësi leksikore, do të mund të jepnim disa mendime të përgjithshme mbi paraqitjen e tyre në fjalorë. Në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe perifrazat janë përmendur në kuptimet e ndryshme të emrit si shembuj apo si raste përdorimi të emrit me një folje të desemantuzuar, me apo pa shpjegime apo përkufizime, si p.sh., *s’vihet inat me dikë a me diçka: nuk mund të hahesh me dikë a me diçka; bënë kontroll: kontrolluan; bëj durim: duroj; e mori në telefon; bëri një vërejtje; e zuri inati; e mori në pyetje; e ka dhënë me qira,*¹³⁸ etj.

Mendojmë se për foljet e desemantuzuar do të mund të përpilonim zëra leksikografikë të cilat do të vendoseshin ose pas kuptimeve të emrit ose në vijim të kuptimeve të foljeve të desemantuzuar, ose në të dyja variantet, të shoqëruara me përkufizimet përkatëse. Të tre variantet së bashku ose qoftë edhe dy variantet e fundit do t’i mundësonte më mirë një fjalor elektronik. Një mënyrë e tillë paraqitjeje do të mundësonte edhe rikonceptimin e fjalorëve dygjuhësh ku duhet të zë më shumë vend paraqitja e perifravezave që përbën një vështirësi reale në mësimin apo në përkthimin e gjuhëve të huaja.

Perifraza me folje të desemantuzuar: njësi sintaksore

Për të justifikuar ekzistencën e strukturës sintaksore brenda perifrazës, do t’u referohemi vlerësimeve të Ramos dhe të Lazard.

Sipas Ramos-it (2001) “Frazologjizimi nuk na pengon të trajtojmë kolokacionet si sintagma, dmth., sekuenca folje dhe plotës” “Edhe në qoftë se ndërtimet me folje mbështetëse përbëjnë një tërësi semantike, ato janë sintagma në nivel sintaksor, dmth., sekuenca të formuara nga një folje dhe një emër të lidhura sintaktikisht”. “Bëhet fjalë për dy bashkësi: bashkësia e fjalëformave që shfaqen në frazë dhe bashkësia e të gjitha lidhjeve sintaksore të përcaktuara mbi bashkësinë e parë.

Edhe Lazard (1982) insiston në faktin se një dukuri e vetme mund të trajtohet si një njësi nga pikëpamja semantike apo leksikore, por si një sintagmë nga pikëpamja sintaksore. Sipas tij “Të analizosh një lokucion si një folje të shoqëruar me një plotës nuk përjashton aspak që në një optikë tjetër, në një studim leksikor për shembull, të trajtohet si një njësi”

Ne bashkohemi me mendimin e Lazard-it. Fakti që një sekuencë mund të jetë tërësisht e idiomatizuar nuk na pengon t’i gjejmë një strukturë sintaksore.

¹³⁶ Karimi-Doostan G. 1997. *Light Verb Constructions in Persian. PhD thesis, University of Essex.*

¹³⁷ Cinková, S. & Kolářová, V. (2005). vep. e cit.

¹³⁸ Fjalori i shqipes së sotme. (1984). Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë.

Krijimi i foljeve prejëmërore

Ka raste kur foljet e thjeshta sinonime të perifrazave formohen mbi bazën e emrit, si p.sh., nga perifraza *bëj surprizë* rrjedh folja *surprizoj* e cila është duke u përdorur gjithnjë e më shumë dhe është drejt rrugës së institucionalizimit në gjuhën shqipe.

Natyra frazeologjike e perifrazave

Jo të gjithë autorët që janë marrë me trajtimin e foljeve të desemantizuara (light verbs, angl. apo verbes supports, fr.) e kanë theksuar apo pranuar përkatësinë frazeologjike të këtyre strukturave. Një nga autorët që nuk e kanë pranuar përkatësinë frazeologjike të këtyre strukturave është Celiku (1962) i cili këto struktura i quan “togfjalësha të qëndrueshëm me tendencë leksikalizimi ose të leksikalizuem plotësisht” dhe i veçon nga “togfjalëshat foljorë të leksikalizuem të tipit frazeologjik” që ai i quan frazeologjike.

Disa autorë e kanë pranuar natyrën frazeologjike të perifrazave në mënyrë të tërthortë, jo duke i emërtuar ato si frazeologjike, por duke i emërtuar me emërtime tipike të njësive të qëndrueshme të gjuhës ose duke i vënë përkrah njësive të tjera të gjuhës të njohura si frazeologjike, pra duke pranuar qëndrueshmërinë e tyre. Kështu, struktura të ngjashme Cipo (1949) i ka quajtur “lokusione pavetore”, Prifti (1962) i ka quajtur “shprehje ndajfoljore” ato që përbëhen “nga një folje dhe një ndajfolje dhe “perifraza” ato me strukturën folje + emër.

Ndërsa autorë të tjerë e kanë pranuar shprehimisht natyrën frazeologjike të këtyre strukturave. Kështu Bally i ka quajtur një tip tjetër lokucionesh (frazeologjike) kur shkruante se “Mund të citojmë gjithashtu edhe një tip tjetër lokucioni që përbën kalimin midis serisë dhe njësisë absolute: bëhet fjalë për lokucione që perifrazojnë foljet. Ky rast është jashtëzakonisht i shpeshtë dhe do të ishte e vështirë të gjeje një folje të zakonshme që të mos kishte në krah të saj një lokucion të përbërë të barasvlerëshëm”. Thomai (1999) i quan “njësi frazeologjike” dhe i përfshin në nëngrupin e dytë të njësive frazeologjike, por vetëm ato “të tipit *bëj durim* “=*duroj*”, të cilat, veç lidhjeve fjalëformuese me foljet sinonimike (*duroj - durim*) dhe njësisë kuptimore, kanë edhe gjymtyrë me kuptim abstrakt, me figurshmëri më të lartë, madje edhe me idiomatikë, që shprehet nëpërmjet shuarjes ose errësimit të raporteve të brendshme sintaksore (kundrinore) ndërmjet gjymtyrëve”.

Për të justifikuar natyrën frazeologjike të perifrazave do të mbështetemi në veçoritë kryesore të perifrazave, të përmendura më sipër:

Perifrazat kanë natyrë frazeologjike, sepse plotësojnë kushtin e nevojshëm të frazemave që është mbartja e kuptimit ose mosreferencialiteti literal i cili shfaqet në njërin gjymtyrë të tyre, në atë foljore, e cila shprehet me folje të desemantizuar, dmth, me kuptim të mbartur të ndryshëm nga kuptimi literal i këtyre foljeve të cilat nuk arrijnë të rikuptimësohen por mbeten pak a shumë të desemantizuara.

Si kushte të tjera të mjaftueshme për të justifikuar natyrën frazeologjike të frazemave mund të përmendim:

Kompozicionalitetin e pjesëshëm semantik të strukturës. Kuptimi i perifrazave nuk del mbi bazën e kuptimeve të pjesëve të tyre përbërëse. Emri merret në një nga kuptimet e tij literale, ndërsa folja zakonisht e humbet në një farë mase kuptimin e saj original.

Mosparashikueshmërinë e përzgjedhjes së foljes. Folja në perifrazë nuk zgjidhet nga folësi mbi një bazë semantike, por është emri ai që e përzgjedh foljen e cila do t'i shërbejë si mbështetës për të ndërtuar fjali. Pra, në këtë rast frazeologjizimi i perifrazës qëndron në mënyrën e veçantë të përzgjedhjes së kolokativit.

Kufizimin gramatikor të emrit. Për sa u përket emrave si përbërës të perifrazave, ata kanë tendencë të kenë një karakter të ngurosur i cili përgjithësisht shfaqet në trajtën e pashquar, në rasën kallëzore dhe në numrin njëjës.

Këto kushte janë të mjaftueshme për t'i emërtuar këto struktura frazema ose struktura frazeologjike.

Tiparet frazeologjike të perifrazave

Tiparet frazeologjike të perifrazave në mënyrë të përmbledhur janë:

Polileksikaliteti

Kufizimi leksikor

Desemantizimi i foljes

Kompozicionaliteti i pjesshëm semantik i strukturës.

Kufizimi morfo-sintaksor i emrit.

Leksikalizimi i strukturës.

Memorizimi i strukturës dhe riprodhimi si njësi e gatshme.

Gjysmëprodhueshmëria e strukturës.

Mosparashikueshmëria e përzgjedhjes së foljes dhe natyra kolokacionore lidhjes së përbërësve.

Përkufizimi i perifrazave

Në bazë të veçorive dhe të tipareve të mësipërme të perifrazave, po japim një përkufizim që në thelb përbën përmbledhje të veçorive dhe tipareve kryesore.

Perifraza është lidhje shumëfjalëshe e qëndrueshme e përbërë nga një folje e desemantizuar dhe përgjithësisht nga një emër abstrakt me kuptim literal, kuptimi i së cilës nuk është shumë e kuptimeve literale të përbërësve apo frazemë e përbërë nga një folje e desemantizuar dhe përgjithësisht nga një emër abstrakt me kuptim literal.

Rasti tipik dhe rastet kufi të perifrazave:

Rasti tipik i perifrazave

Rasti tipik i perifrazave është ai me emër të pashquar pa nyje në rolin e kundrinorit të drejtë¹³⁹, si p.sh., *bëj debat, bëj dëm, bëj durim, bëj keq, bëj përpyekje, bëj përshtypje, bëj pushime, bëj stërvitje, kam dhimbje, kam dijeni, kam etje, kam faj, kam frikë, kam ftohtë, kam gjumë, kam kontakte me, marr hak, marr leje, marr masa, jap shpresë, jap urdhër, jap të drejtë etj.* Rasti tipik lidhet me foljet kryesore të desemantizuara të shqipes *bëj, kam, marr* dhe *jap*, të cilat korrespondojnë edhe me foljet e lehta të veçuara nga Jespersen për anglishten (have, give, take, do/make).

Këtë rast tipik e lënë të nënkuptohet edhe gjuhëtarët shqiptarë kur theksojnë se foljet kryesore që hyjnë në përbërjen e këtyre strukturave janë *bëj, kam, marr, vë, mbaj etj.*¹⁴⁰ apo *bëj, kam, marr, shoh...*¹⁴¹ ose kur theksojnë se "... komponentet e dyta

¹³⁹ Langer, S (2004). vep. e cit.

¹⁴⁰ Çeliku, M. (1962). vep. e cit.

¹⁴¹ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

dalin zakonisht në trajtë të pashquar, në rasën kallëzore, në numrin njëjës kur ato janë emra”¹⁴².

Raste kufi të perifrazave

Në kategorinë e perifrazave duhet të përfshihen edhe rastet kufi dhe më pak qendrore. Përndryshe do të studiohej dhe do të mbulohej vetëm një pjesë e vogël e dukurisë. Në këtë paragraf do të diskutojmë rastet kufi të mëposhtme:

1) Përveç rastit tipik të perifrazave, dmth., folje + emër të pashquar pa nyje, vihen re edhe raste të tjera ku emri mund të shoqërohet me nyje apo del më shpesh me nyje, si p.sh., *bëj një përkulje, bëj një telefonatë, jap një këshillë, jap një leksion, jap një vendim, lë një porosi, marr një vendim, nxjerr një konkluzion, bëj një pushim, jap një këshillë etj.*

2) Një rast tjetër kufi përbëhet nga perifraza me një emër me parafjalë në rolin e rrethanorit. Ndryshimi midis këtyre strukturave dhe strukturave tipike me folje të desemantizuar qëndron në faktin se te këto struktura kemi tri elemente përbërëse - parafjalën, emrin dhe foljen e desemantizuar, si p.sh., *marr në ngarkim, marr në punë, marr në pyetje, marr në telefon, jam në hall, bie në kurth etj.*

3) Një rast tjetër kufi përbëhet nga perifraza që ndërtohen me emra që përdoren vetëm në trajtë të shquar, si p.sh., *marr pëlqimin e dikujt, tërheq vëmendjen, vë theksin, marr mundimin të...*, apo me emra që përgjithësisht dalin në trajtë të shquar, si p.sh., *ia nxjerr inatin dikujt, ia hedh fajin dikujt, mbaj premtimin etj.*

4) Përveç kombinimit tipik folje + emër, perifrazat në shqipe paraqesin edhe struktura të ndryshme sintaksore, si p.sh., folje + ndajfolje apo emër të ndajfoljësuar në rolin e rrethanorit, si p.sh., *e marr seriozisht, bëhem vonë, bëhen afër, bëj tutje, marr majtas/djathtas, bëj majtas/djathtas, bie rehat etj.*

5) Një rast të mëtejshëm kufi përbëjnë strukturat me folje të desemantizuar të cilat janë sekuenca të qëndrueshme jo me kundrinor, rrethanor apo me kallëzuesor, dmth jo me kallëzues të përbërë, por me kryefjalë, dmth., folje + emër-kryefjalë, si p.sh., *del përfundimi, del vendimi, më merr malli, më vjen inat, më zë inati, më zë halli etj.*

Këto struktura kanë ngjashmëri me perifrazat tipike në disa drejtime – kuptimi i foljes është i dobët/i reduktuar dhe emrat mbartin kuptimin kryesor predikativ, por shkelet varësia e argumenteve emërorë nga folja¹⁴³, dmth., nuk kemi kallëzues të përbërë.

6) Një rast tjetër kufi është edhe zgjerimi i gamës së perifrazave me folje të tjera përveç listës minimale jesperseniane, që për shqipen përfshin foljet *bie, hedh, mbaj, jam, vë, lë, dal, nxjerr, zë, ngre, heq, hyj, tërheq, tregoj, vjen, mbetem etj.*, si p.sh., *bie me barrë, bie në dashuri me, bie në koma, hedh fajin dikujt, hedh fallin, mbaj përgjegjësi, mbaj një fjalim, mbaj zi, mbaj nën kontroll, jam në hall, jam me barrë, jam në lëvizje, jam në rrezik, vë bast, vë kufi në ..., vë lidhje me, vë në dukje, lë nam, lë një amanet, lë një porosi, dal në pension, del nga kujtesa, del nga përdorimi, del përfundimi, nxjerr mësim, nxjerr një përfundim, zë be, zë fill, zë shoqëri me, më zë*

¹⁴² Çeliku, M. (1962). vep. e cit.

¹⁴³ Langer, S (2004). vep. e cit.

inati, kaloj në sulm, ngre kurth, ngre padi kundër dikujt, hedh fajin dikujt, hedh fallin, hedh në gjyq, hyn në lidhje me, tërheq vëmendjen, tregoj kujdes, vjen në ndihmë etj.

Dallimi midis perifrazave dhe idiomave me vlerë foljore

Perifrazat kanë natyrë frazeologjike dhe përbëjnë një kategori të veçantë frazemash, dmth., një kategori frazeologjike të dallueshme nga kategoritë e tjera dhe kryesisht nga idiomat.

Identifikimi i perifrazave nuk është gjithmonë i qartë dhe i sigurt. Dallimet midis perifrazave dhe njësive frazeologjike janë si më poshtë:

1) Idiomat karakterizohen nga kuptimi i mbartur i figurshëm ndryshe nga perifrazat të cilat karakterizohen nga kuptimi i mbartur i njërit element përbërës (foljes) i cili nuk ka arritur të rikuptimësohet, por ka mbetur pak a shumë i desemantizuar, si dhe nga përdorimi me një kuptim literal i elementit tjetër përbërës (emrit apo ndajfoljes). Veçoria semantike që karakterizon perifrazat është se kuptimi i tyre është kryesisht kuptimi i emrit predikativ, plus informacionin semantik që vjen nga folja mbështetëse për sa i përket kohës dhe aspektit.

2) Natyra dhe shkalla e figurshmërisë në idioma është e ndryshme nga perifrazat: në perifraza folja ka njëfarë kuptimi metaforik, dhe, për rrjedhojë, mund të formojë perifraza të reja, ndërsa idiomat konsiderohen si metafora të fosilizuara apo të vdekura dhe, për rrjedhojë, nuk mund të formohen të tjera.

3) Në krah të përkufizimit të termit perifrazë që jep “*Fjalori i termave gjuhësorë*”¹⁴⁴ gjejmë edhe një dallim midis perifrazës dhe njësisë frazeologjike “Marrëdhëniet që zhvillojnë fjalët përbërëse të perifrazës janë më të lirshme nga ato që zhvillohen në një njësi frazeologjike. Kjo do të thotë se elementet e perifrazës mund të zëvendësohen me sinonime, ndërsa kjo gjë nuk ndodh me elementet e njësisë frazeologjike”. Kështu, mund të themi *bëj një xhiro, bëj një shëtitje, bëj një udhëtim*, apo *take a walk (=bëj një shëtitje), take a stroll (=bëj një xhiro), take a run (=bëj një udhëtim)* në anglishte, por mund të themi vetëm *mori opingat* për kuptimin idiomatik “*nuk mori asgjë*” dhe jo *mori këpucët*, apo *mori sandalet*, apo *mori shapkat*; apo vetëm à cheval (në kalë, lit.) për kuptimin idiomatik “midis, ndërmjet” dhe jo à jument (në pelë, lit.), à poulain (në mëz, lit.), à âne (në gomar, lit.), à moule (në mushkë, lit.), në frëngjishte.

4) Perifrazat dallohen nga njësitë frazeologjike edhe për sa i përket fleksibilitetit morfo-sintaksor. Kështu, foljet në perifraza transformohen edhe në diatezën pësore, ndërsa emrat mund të marrin nyje, mund të përdoren në shumës, mund të modifikohen me epitete dhe mund të pronominalizohen, mund të relativizohen.

5) Njësitë frazeologjike nuk kanë sinonime folje të thjeshta me të cilat lidhen morfologjikisht, ndryshe nga perifrazat që në shumë raste janë sinonime me një folje të thjeshtë e cila lidhet morfologjikisht me emrin predikativ. Kështu, te perifraza *bëj durim* = foljen e thjeshtë *duroj*, konstatojmë se *durim* dhe *duroj* lidhen morfologjikisht midis tyre, ndërsa te njësia frazeologjike *i kthej krahët dikujt* = foljen

¹⁴⁴ Λεξικό γλωσσολογικών όρων: http://www.greek-language.gr/greekLang/modern_greek/tools/lexica/glossology/show.html?id=261

e thjeshtë e *braktis dikë* konstatojmë se folja e thjeshtë *braktis* nuk lidhet morfologjikisht me emrin *krahët* të njësisë frazeologjike.

Dallimi midis perifrazave dhe lidhjeve të lira

Një çështje tjetër e rëndësishme është edhe dallimi midis perifrazave dhe lidhjeve të lira. Por si mund të vihet kufiri midis tyre? A mund të shërbejë çdo emër abstrakt + folje mbështetëse për të formuar perifraza? Jo. Sa më larg foljes së desemantizuar dhe sa më larg emrit abstrakt, aq më shumë u afrohem lidhjeve të lira. Ramos (1998) shkruan se “në qoftë se një folje mbështetëse do të seleksionohet sipas përkufizimit të saj karakteristik dhe në qoftë se bashkëndodhja e saj do të pasqyrohet mirë në zërin e saj leksikografik, atëherë ajo do të kombinohet lirisht me çdo emër klasa semantike e të cilit mbulohet nga përkufizimi”. Kështu, *bëmë plane për shpëtimin e të plagosurve* përbën perifrazë, por *miratuam planin për ndihmë apo commit a crime (= kryej një krim)* nuk përbën perifrazë, sepse foljet përdoren në kuptimin e tyre të plotë, dmth., kuptimi i tyre nuk është i reduktuar semantikisht¹⁴⁵, pavarësisht se shërben si folje mbështetëse. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për rastet: *i bëri një propozim drejtorit* vs *i parashtrroi një propozim drejtorit*. Pra, në të dyja rastet kemi folje mbështetëse, por, në fakt, vetëm në rastin e parë kemi folje të desemantizuar, ndërsa në rastin e dytë kemi sintagmë të lirë. Këtu qëndron edhe dallimi midis foljeve të desemantizuara dhe foljeve mbështetëse dhe afria midis foljeve të desemantizuara dhe foljeve të lehta. Në këtë kuadër foljet e desemantizuara apo foljet e lehta janë folje mbështetëse, por jo të gjitha foljet mbështetëse janë folje të desemantizuara. Termi folje mbështetëse është hiperonim i foljeve të desemantizuara apo foljeve të lehta¹⁴⁶.

Një rast tjetër dallimi lidhet me emrat prejfoljorë kuptimi i të cilëve mund të bëhet konkret me kalimin e kohës, me anë të asociacionit metonimik¹⁴⁷. Le të krahasojmë përdorimet e emrit propozim në dy shembuj të ndryshëm:

Agroni i bëri një propozim komisionit.

Agroni e vendosi propozimin mbi tavolinë.

Përdorimi konkret i emrit prejfoljor nuk përfshihet në ndërtimin me folje të desemantizuar, sepse e ka humbur kuptimin e veprimit dhe, për rrjedhojë, edhe rolet semantike.

Ndërsa në rastet mori patentën/ diplomën/ rrogën; vë në gropë; mbyll me kllapë; marr në shtëpi; dal në fotografi, jo vetëm që kemi emra konkretë, por edhe foljet përdoren në kuptimin e tyre të plotë, jo të desemantizuar.

6. 3. Frazetermat

Përkufizimi i frazetermave

Me termin frazeoterm kuptojmë ato njësi shumëfjalëshe të qëndrueshme nominale me funksion emërtues dhe me kufizim sintaksor, kuptimi i të cilave nuk

¹⁴⁵ Langer, S (2004). vep. e cit.

¹⁴⁶ Vincze, V. (2011). Semi-Compositional Noun + Verb Constructions: Theoretical Questions and Computational Linguistic Analyses. PhD thesis. University of Szeged.

¹⁴⁷ Oyharçabal, B. (2006). “Basque light verb constructions”, in J. I. Hualde and J. Lakarra (eds.) A Festschrift for Larry Trask, University of the Basque Country, Bilbao.

është shumë e kuptimeve literale të përbërësve dhe të cilat shërbejnë vetëm për të emërtuar objekte dhe dukuri të reja të realitetit ose për të riemërtuar ato ekzistuese.

Në frazeoterma përfshihen njësi shumëfjalëshe kryesisht terminologjike, të cilat, përveç kriterit të kufizimit sintaksor, plotësojnë edhe atë të vlerës ekskluzivisht denotative, si p.sh., *sy magjik, çelës anglez, tru i vogël etj.* Nga shembujt e mësipërm vërejmë se jo të gjithë tipat janë të figurshëm (*tru i vogël*, p.sh.).

Natyra frazeologjike e frazeotermave

Për sa i përket natyrës frazeologjike apo jo të frazeotermave, në shqipe mbizotëron mendimi se ato nuk janë frazeologjike. Kështu, J. Thomai (1981) përjashton nga frazeologjia togfjalëshat jo të figurshëm dhe vëren: “Togjet këpucë me qafa, bombë dore, bibliotekë kombëtare etj., që përmenden aty-këtu, si dihet, janë togje të qëndrueshme, por jo të tipit frazeologjik”.

Ne bashkohemi me mendimin më të hershëm të J. Stefit (1970) i cili flet për: “Shprehje frazeologjike emërore që janë emërtime objektsh: Fakulteti i Filologjisë, tensioni ndërkombëtar, luftë e ftohtë, gjendje e nderë, Ushtria e Kuqe, këpucë me qafa etj.”, mendim të cilin e ruajmë për objektin tonë të frazeotermave, të përcaktuar në bazë të kriterëve tona dhe i cili nuk mbështetet domosdoshmërisht në kriterin e figurshmërisë.

Hausmann (2006) i quan frazeotermat një nga kategoritë e frazeologjisë: “Frazeologjia (njësia: frazema) përbëhet nga frazeotermat (arret cardiaque, equipement portuaire, feu rouge), nga kolokacione (administrer une gifle, un celibataire endurci, grievement blesse) dhe nga lokucione (casser les pieds a qqn, prendre la mouche, un cordon bleu)”, dmth njeh natyrën frazeologjike të lidhjeve të qëndrueshme nominale.

Edhe Granger & Paquot (2008) e njohin natyrën frazeologjike të lidhjeve të qëndrueshme nominale, si p.sh., *black hole (=vrinë e zezë)*, por i quan fjalë të përbëra (compounds, angl.)

Frazeotermat kanë natyrë frazeologjike, sepse plotësojnë kushtin e nevojshëm të frazemave që është mbartja e kuptimit apo mosreferencialiteti literal i cili shfaqet në gjymtyrët ose në strukturën e frazeotermave.

Si kushte të tjera të mjaftueshme për të justifikuar natyrën frazeologjike të frazemave mund të përmendim:

Kompleksitetin sintaksor (të shprehur në shkallën e ngurosjës sintaksore) si dhe kompleksitetin semantik (të shprehur në opacitetin semantik), që përbëjnë dy prej kriterëve kryesorë të frazemave.

Natyra e përbërësve të frazeotermave

Përbërësit që hyjnë në përbërjen e frazeotermave në shqipe mund të jenë me kuptim literal ose me kuptim të figurshëm. Dallojmë tri raste:

-kur të dy përbërësit e një grupi frazeotermash përdoren në kuptimin e tyre literal, si p.sh., *dritë e kuqe, tru i vogël, zorrë e trashë, zorrë e hollë, pushim i gjatë, pushim i shkurtër, dërrasë e zezë, chaise longue (fr.), black belt (angl.), μαύρη ζώνη (gr.)*.

-kur të dy përbërësit e një grupi tjetër frazeotermash shënojnë sende dhe dukuri në mënyrë të figurshme si p.sh., *nuse e lalës, kali i qyqes, sy magjik, Udha e Qumështit, Arusha e Madhe*.

-kur vetëm një nga përbërësit e një grupi tjetër frazeotermash shënon sende dhe dukuri në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa tjetri përdoret me kuptim literal, si p.sh., *natë e bardhë, luftë e ftohtë, lakuriq i natës, fruta deti, pomme de terre (fr.), French window (angl.), λευκή απεργία (gr.)*.

Tipat e frazeotermave nga pikëpamja e natyrës së përbërësve

Mbi bazën e figurshmërisë apo jo të përbërësve dallojmë tre tipa frazeotermash:

1) Frazeotermat me figurshmëri të plotë dhe me moskompozicionalitet, si p.sh., *sy magjik, gjuhë lope, kashta e kumtrit*. Karakteristikë e këtij tipi është humbja e kuptimeve literale të përbërësve dhe përdorimi i tyre në frazeoterma me kuptime të figurshme. Kështu kuptimi i frazeotermi *sy magjik* nuk përfshin as kuptimin e fjalës *sy*, as kuptimin e fjalës *magjik*, por zhvillon një kuptim të ri që nuk lidhet me kuptimet literale të përbërësve, por që lidhet me shumën e kuptimeve jotransparente që zhvillojnë të dyja fjalët, dmth realizohet me moskompozicionalitet semantik.

2) Frazeotermat me figurshmëri të zbehur dhe me kompozicionalitet, si p.sh., *natë e bardhë, luftë e ftohtë, çelës anglez, porta hungareze, lule blete, lule dimri, gjel deti, fruta deti, French window (angl.), λευκή απεργία (gr.), Shtëpi e Bardhë, White House (angl.), Kryqi i thyer etj.* Vetëm një fjalë hyn në përbërjen e frazeotermi me kuptim joliteral i cili zhvillohet vetëm në lidhje me fjalën tjetër që përdoret me kuptim literal. Kështu fjala *e bardhë* te frazeotermi *natë e bardhë* kuptimin e saj joliteral, tërësisht transparent, “*gjatë së cilës nuk flemë por rrimë zgjuar*”, e zhvillon vetëm në lidhje me fjalën *natë*, dmth realizohet me kompozicionalitet semantik.

3) Frazeotermat pa figurshmëri, por me moskompozicionalitet, si p.sh., *zorrë e hollë, tru i vogël, chaise longue (fr.), flamur i bardhë, dërrasë e zezë, λευκή σημαία (gr.), Kryqi i Kuq, Red Cross (angl.), black belt (angl.)*. E veçanta e këtyre frazeotermave është sepse përbërësit përdoren në kuptimet e tyre literale, por edhe sepse zhvillojnë një kuptim të shtuar, për rrjedhojë, këto frazeoterma kanë një kuptim cilësisht të ri. Kështu kuptimi i frazeotermi *zorrë e hollë* përfshin edhe kuptimin e fjalës *zorrë* edhe kuptimin e fjalës *e hollë* por zhvillon edhe një kuptim të ri që është “*organ i qenieve të gjalla me një funksion të caktuar*”, dmth realizohet me moskompozicionalitet semantik.

Llojet e frazeotermave

Në përbërjen e frazeotermave bëjnë pjesë tri lloje sintagmash të qëndrueshme:

1) Sintagmat e qëndrueshme terminologjike apo të gjuhëve të specializuara, si p.sh., *zorra e hollë, çelës anglez, cle anglaise (fr.) etj.*

2) Sintagmat e qëndrueshme të nomenklaturës, si p.sh., *fruta deti, Shtëpi e Bardhë, White House (angl.), Mali i Zi, Deti i Zi, Black Sea (angl.), La Mer Noire (fr.) etj.*

3) Sintagmat e qëndrueshme të gjuhës së përgjithshme, si p.sh., *sy magjik, natë e bardhë, chaise longue (fr.) disc jockey (angl.) etj.*

Ndërtimi i frazeotermave

Nga ana e strukturës leksikore frazeotermat formojnë vetëm modele të kufizuara me bazë emërore. Modelet kryesore janë:

1. Emër+emër: *gur mulliri, gur kufiri, shkop gome, lule deleje, lule dielli.*
2. Emër+mbiemër: *pikë e vdekur, zorrë e hollë, tru i vogël.*
3. Emër+parafjalë+emër: *tel me gjemba.*

Dallimet midis frazeotermave dhe sintagmave të lira nominale

1) Në sintagmat e lira nominale realizohen aftësitë kombinuere të pakufizuara¹⁴⁸ të elementëve përbërës të tyre, ndërsa te të paktën një përbërës i frazeotermave këto aftësi janë të kufizuara, dmth., të paktën një përbërës i frazeotermave realizon kuptimin e vet të mbartur vetëm brenda një ose pak frazeotermave dhe nuk mund të përdoret me këtë kuptim në lidhje me fjalë të tjera jashtë këtij frazeotermi, si p.sh., *çelës anglez*, apo e gjithë struktura ka kuptim të mbartur, si p.sh., *tru i vogël*.

2) Në sintagmat e lira nominale kuptimi është kompozicional si shumë e thjeshtë aritmetike e kuptimeve literale të përbërësve, ndërsa kuptimi i frazeotermave mund të jetë jokompozicional ose kompozicional, por jo si shumë e kuptimeve literale të përbërësve, dmth., frazeotermat kanë një farë opaciteti semantik.

3) Në sintagmat e lira nominale lidhjet ndërmjet objekteve të realitetit objektiv ose objekteve dhe vetive të tyre janë të lira, ato krijohen në çastin e ligjërimit, por në frazeoterma këto lidhje janë të ngulitura e të përhershme¹⁴⁹. Frazeotermat janë njësi të memorizuara dhe hyjnë në ligjërim si njësi të gatshme.

4) Ndryshe nga sintagmat e lira nominale, frazeotermat janë njësi të mëvetësishme leksiko-sintaksore¹⁵⁰, duhet të zënë vend në fjalor dhe mundësisht si zë më vete. Frazeotermat, duke qenë funksionalisht barasvlerës të fjalës, shërbejnë për të shënuar, si edhe fjala, një objekt ose një dukuri të vetme.

Zbulimi i statusit të një sintagme nëse ajo është e lirë apo e qëndrueshme bëhet nëpërmjet testimit të ngurosjes leksiko-semantike të strukturës. Në rastin e frazeotermave me ngurosje leksiko-semantike do të kuptojmë faktin që të paktën një përbërës i frazeotermat zhvillon një kuptim joliteral brenda frazeotermat dhe me të cilin nuk mund përdoret me fjalë të tjera jashtë këtij frazeotermi.

Kështu, përbërësi *e flohtë* në sintagmën *luftë e flohtë* nuk realizon një nga kuptimet e tij literalë (të fjalorit), por zhvillon një kuptim të ri, joliteral. Meqë, përbërësi *e flohtë* në kuptimin e ri, joliteral por transparent “*shantazhues*”, të zhvilluar brenda sintagmës *luftë e flohtë*, nuk mund të lidhet me fjalë tjetër jashtë kësaj sintagme, sintagma *luftë e flohtë* është e ngurosur dhe e fushës nominale, dmth, frazeoterm, dhe nënkupton “*një luftë pa armë, me shantazhe dhe bllokada*”. Në vijim të këtij argumentimi theksojmë se nuk mund të themi ~~*veprim, masa të flohta, por veprim, masa shantazhuese.*~~

Vështirësia më e madhe është të zbulojmë ngurosjen e frazeotermave të tipit të tretë përbërësit e të cilave ruajnë kuptimet e tyre literale në përbërje të frazeotermat, por që, përveç tyre, zhvillojnë edhe një kuptim të ri, joliteral të shprehur me shtimin e

¹⁴⁸ Duro, A. (2001). Terminologjia si sistem. Panteon, Tiranë

¹⁴⁹ Duro, A. (2001). vep. e cit.

¹⁵⁰ Duro, A. (2001). vep. e cit.

një seme të veçantë në totalin e semave të të dy përbërësve, pra struktura si një e tërë ka një element semantik ekstra, i cili i shtohet shumës së kuptimeve të përbërësve. Edhe pse i njohim kuptimet literale të secilit përbërës veç e veç, mund të mos e kuptojmë apo të dyshojmë për atë kuptim tërësor të veçantë që sintagma transmeton. Përveç shumës së kuptimeve të të dy përbërësve, frazeotermat e tipit të tretë simbolizojnë apo përfaqësojnë diçka, apo tregojnë një funksion të veçantë, si p.sh:

Kryqi i Kuq është *kryq*, është edhe *i kuq*, por edhe përfaqëson diçka: *një shoqatë humanitare*.

Fletët e verdha janë *fletë*, janë edhe *të verdha*, por përfaqësojnë diçka: *pjesë të një libri telefonik*.

Flamuri i bardhë është *flamur*, është edhe *i bardhë*, por edhe simbolizon diçka: *dorëzimin*.

Kutia e zezë është *kuti*, është edhe *e zezë*, por edhe tregon një funksion të veçantë: *regjistrimin e bisedave të pilotit*

Drita e kuqe është *dritë*, është edhe *e kuqe*, por edhe tregon një funksion të veçantë: *ndalimin e qarkullimit*.

Kështu, përbërësi *e kuqe* në sintagmën *dritë e kuqe* nuk realizon vetëm një nga kuptimet e tij literale (të fjalorit), por zhvillon edhe një kuptim të ri, të shtuar. Meqë, përbërësi *e kuqe* në kuptimin e ri, të shtuar “*ndalues*”, të zhvilluar brenda sintagmës *dritë e kuqe*, nuk mund të lidhet me fjalë tjetër jashtë kësaj sintagme, sintagma *dritë e kuqe* është e ngurosur dhe e fushës nominale, dmth frazeoterm, dhe nënkupton “*një dritë të kuqe në rrugë që sinjalizon ndalimin e detyruar të qarkullimit të automjeteve*”. Në vijim të këtij argumentimi theksojmë se nuk mund të themi *kanal, gardh—i kuq*, por *kanal, gardh ndalues*.

Ndërsa sintagmat e mëposhtme:

-kënd i ngushtë, kënd i gjerë (shih Duro, 2001)

-bibliotekë kombëtare, Fakulteti i Filologjisë (shih Stefi, 1970)

-ve pate, bukë gruri (shih Cipo, 1949)

janë sintagma të lira (grupi i parë i u përket gjuhëve të specializuara, dmth, terminologjike, grupi i dytë i përket gjuhës së nomenklaturës, grupi i tretë i përket gjuhës së përgjithshme, dhe të gjitha së bashku janë të fushës nominale), sepse nuk kanë mosreferencialiteti literal apo mbartje të kuptimit dhe, për rrjedhojë, nuk kanë as opacitet semantik.

Kufiri midis frazeotermave dhe sintagmave të lira nominale nuk është as i prerë as i lehtë për t’u vendosur. Kjo varet nga shkalla e njohjes të gjuhës.

Dallimet midis frazeotermave dhe idiomave

Dallimet midis frazeotermave dhe idiomave lidhen me strukturën, me ngurosjen, me vlerën leksiko-gramatikore etj.

Struktura

Frazeotermat përbëhen nga dy fjalë shënuese, si p.sh., *gur mulliri, pikë e vdekur etj.*, ndërsa idiomat nga një, nga dy ose më shumë se dy fjalë shënuese, si p.sh., (*gënjeshërë me xhufkë, i hedh baltë (dikujt), më bëhet zemra mal, ia merr macja bukën nga dora (dikujt)*).

Ngurosja

Frazeotermat nuk paraqesin kufizim apo ngurosje të kategorive morfologjike, por vetëm ngurosjeje sintaksore, ndërsa idiomat, përveç ngurosjes sintaksore, kanë në një farë mase edhe ngurosje morfologjike. Shih më poshtë për sa i përket krahasimit midis frazeotermave dhe idiomave nominale.

Nominaliteti

Frazeotermat kanë vetëm vlerë emërore, ndërsa idiomat mund të jenë me vlerë emërore, mbiemërore, foljore, ndajfoljore apo pasthirrmore.

Korrespondimi sinonimik

Përgjithësisht idiomat bashkëjetojnë me fjalët sinonime ndërsa frazeotermat përgjithësisht nuk kanë njësi njëfjalëshe sinonime korresponduese.

Figurshmëria

Vetëm një pjesë e frazeotermave kanë prejardhje të figurshme, si p.sh., *sy magjik*, *nuse e lalës*, *Udha e Qumështit* etj., ndërkohë që idiomat janë të gjitha të figurshme. Kjo bën që figurshmëria të jetë tipar i përgjithshëm i idiomave dhe tipar i veçantë për një pjesë së frazeotermave, por jo kriter dallues për to.

Gjedhe formimi

Disa frazeoterma përbëjnë edhe gjedhe frazemoformuese. Të tilla janë frazeotermat *lule dele*, *lule shpate*, *lule shqiponje*, *lule sapuni*, *rrënjë katrore*, *rrënjë kubike*, *rrënjë algjebrike* etj. me përbërës fjalët *lule*, *rrënjë* etj.

Dallimet midis frazeotermave dhe idiomave me vlerë emërore

Shumica e dallimeve midis frazeotermave dhe idiomave janë të vlefshme dhe shërbejnë edhe si dallime midis frazeotermave dhe idiomave nominale. Themi shumica, sepse struktura dhe nominaliteti që përbëjnë dallime midis frazeotermave dhe idiomave në përgjithësi, përbëjnë ngjashmëri midis frazeotermave dhe idiomave nominale: edhe frazeotermat edhe idiomat nominale kanë strukturë me dy fjalë shënuese dhe janë të fushës nominale.

Një ndërlitim të dukshëm përbëjnë frazeotermat e tipit *sy magjik* ku të dy përbërësit karakterizohen nga kuptimi i figurshëm dhe kufizimi sintaksor, gjë që i afron me idiomat. Por ajo që i dallon nga idiomat është mungesa e njërit prej kritereve të rëndësishëm siç është kufizimi morfologjik. Meqë karakterizohen edhe nga një tipar tjetër siç është funksioni emërtues i cili karakterizon edhe grupe të tjera frazemash që ne i kemi quajtur frazeoterma, mund t'i përfshijmë në kategorinë e këtyre të fundit.

Për sa u përket dallimeve, më kryesoret janë dy: njëri lidhet me emërtimin dhe tjetri me ngurosjen.

1) Në nivel funksional, frazeotermat janë njësi ekskluzivisht emërtuese, ndërsa idiomat me vlerë emërore janë njësi kryesisht ekspresive, me vlerë stilistikore dhe emocionale.

Frazeotermat shërbejnë për të emërtuar sende dhe dukuri të reja ose për të riemërtuar disa ekzistuese, pasqyrojnë lidhjet ndërmjet objekteve të realitetit objektiv,

ose të objekteve dhe vetive të tyre¹⁵¹, ndërsa idiomat nominale shërbejnë kryesisht për të vlerësuar, dikë apo diçka, dmth, shënojnë cilësi të qenieve a të sendeve¹⁵².

2) Në nivel formal, idiomat me vlerë emërore nuk kanë paradigmë të plotë, ndërsa përbërësit e frazeotermave nuk paraqesin kufizim morfologjik. Kështu, frazeotermi *sy magjik* mund të përdoret në të dy numrat, trajtat dhe në të gjitha rasat:

→ *Administratori porositi tre sy magjikë për dyert e pallatit të ri.*

→ *Syri magjik që i propozoi shitësi ishte i një cilësie shumë të mirë.*

→ *Nesër do të vijë ustai për instalimin e syrit magjik.*

Ajo çka është e ngurosur në një shkallë të konsiderueshme të frazeotermat është lidhja midis përcaktuesit dhe bazës (të përcaktuarit), gjë që e bën njësinë të përdoret si një e tërë dhe e pandarë. P.sh., nuk duhet thënë: *Kryeqytetasit festuan natën më të bardhë dhe më të bukur të dhjetëvjeçarit*, por: *Kryeqytetasit festuan natën e bardhë më të bukur të dhjetëvjeçarit.*

Ndërsa frazeotermat paraqesin vetëm kufizim sintaksor, idiomat nominale, përveç kufizimit sintaksor, paraqesin në një farë mase edhe kufizim morfologjik i cili duket në përdorimin e kufizuar morfologjik të idiomave nominale të mëposhtme:

Daulle e shpuar dhe jo *një daulle e shpuar, dy daulle të shpuara etj.*

Ëndrra në diell dhe jo *ëndërr në diell, një ëndërr në diell, ea ëndrra në diell, dy ëndrra në diell, etj.*

Shesh me lule dhe jo *një shesh me lule, sheshe me lule, disa sheshe me lule etj.*

Pasqyrimi i frazeotermave në fjalorë dhe përkufizimi i tyre

Frazeotermat jokompozicionalë karakterizohen nga kuptimi i veçantë tërësor: tërësia nënkupton diçka të ndryshme nga shumta e kuptimeve të përbërësve, dmth, frazeotermat mbeten pak a shumë opakë edhe nëse i njohim kuptimet e përbërësve të tyre, prandaj del nevoja e përkufizimit të frazeotermave gjë e cila zbulon kuptimin e tyre. Vetëm nëpërmjet përkufizimit kemi akses të plotë të domethënias e tyre.

Duke shprehur një kuptim tërësor të veçantë jokompozicional, frazeotermat jokompozicionalë përbëjnë edhe njësi leksikore të mëvetësuar siç janë fjalët.

Për arsye të nevojës së përkufizimit dhe të faktit që përbëjnë njësi leksikore, frazeotermat duhet të pasqyrohen në fjalorë jo thjesht si mjet ilustrues në shërbim të fjalës dhe të varen prej saj, por si zë leksikografik më vete edhe në fjalorët e përgjithshëm në varësi të vëllimit dhe të synimeve të fjalorit. E nevojshme është që të paraqiten në fjalorë dhe të përkufizohen edhe frazeotermat kompozicionalë.

Tiparet e frazeotermave

Tiparet frazeologjike të frazeotermave në mënyrë të përmbledhur janë:

Polileksikaliteti (strukturë me dy fjalë shënuese)

Kufizimi leksikor

Kufizimi sintaksor dhe mungesa e kufizimit morfologjik

Funksioni emërtues

Nominaliteti (sintagmë nominale)

Memorizimi dhe riprodhimi si njësi e gatshme

¹⁵¹ Duro, A. (2001). vep. e cit.

¹⁵² Thomai, J. (1981). vep. e cit.

Gjedhe frazemoformuese për disa prej të tyre
Mungesa e sinonimisë me njësi njëfjalëshe për shumicën prej tyre
Figurshmëria për një pjesë të tyre
Moskompozicionaliteti semantik për shumicën prej tyre
Njësi leksikore për frazeotermat jokompozicionalë.

6. 4. Binomet e pakthyeshme frazeologjike

Përkufizimi dhe historiku i binomeve të pakthyeshme frazeologjike

Binomet e pakthyeshme frazeologjike, shkurt binomet frazeologjike apo binomet, janë frazema të përbëra nga dy fjalë që janë të afërta semantikisht dhe që përgjithësisht i përkasin të njëjtës pjesë të ligjëratës, janë të vendosura në të njëjtin nivel të hierarkisë sintaksore, lidhen me lidhëza bashkërenditëse dhe kanë rend të pakthyeshmë, si p.sh., *urtë e butë, shëndoshë e mirë, rreth e rrotull, copë e thërrime, çikë e thërrime, copë e çikë, natë e ditë, ditë e natë, fund e krye, anë e kënd, fund e majë, kryq e tërthor, mbarë e prapë, lart e poshtë, poshtë e lart, brenda e jashtë, jashtë e brenda, herët ose vonë, pak a shumë, nga koka te këmbët, bardhë e zi, me sot e me nesër, me sot me nesër, hollë e gjatë, gjallë a vdekur, rrallë e tek, orë e pa kohë, rrallë e për mall, kokë e këmbë, poshtë e përjetë, këmbë e duar, kockë e lëkurë, sot a nesër, mirë a keq, krah për krah, dorë për dorë, sot për sot, tani për tani, një për një, fjalë për fjalë, fije për fije, nga çasti në çast, ditë për ditë, vit për vit, kokë për kokë, gjysh pas gjyshi, brez pas brezi, dita ditës, dita ditën, viti vitit, viti vitin, këmba këmbës, kot më kot etj.*

Termi “binome të pakthyeshme” (irreversible binomials, angl.) u krijua nga Yakov Malkiel më 1959. Në punimin e tij “Studies in irreversible binomials”, Malkiel përshkruan veçanërisht lidhjet semantike midis dy përbërësve të binomeve, por edhe lidhjet semantike midis përbërësve të binomeve dhe kuptimit të së tërës. Ai thekson se binomet shpesh kanë veçori sintaksore dhe semantike të paparashikuara mbi bazën e formës së tyre.

Në literaturën shqiptare binomet i gjejmë të përfshira në njësitë frazeologjike të gjuhës shqipe (shih Thomai, 1981) ku rolin kryesor e luajnë binomet e figurshme.

Numri i përbërësve dhe mjete lidhës

Termi *binom* është term i matematikës (ku i referohet një shprehjeje të përbërë prej dy elementesh të lidhura me shenjën plus ose minus) i cili përdoret gjithnjë edhe më shumë edhe në gjuhësi. Për rrjedhojë, në binomet gjuhësore kemi dy fjalë të lidhura midis tyre me mjete lidhëse. Mjeti kryesor lidhës janë lidhëzat bashkërenditëse, si p.sh., “e”, “a” etj.

Natyra e fjalëve përbërëse

Modeli i parë i binomeve në gjuhën shqipe është kombinimi i fjalëve (kuazi-) sinonime, si p.sh., *shëndoshë e mirë, urtë e butë, rreth e rrotull, copë e çikë etj.*

Një model tjetër binomesh përfshin kombinimin e fjalëve (kuazi-) antonime, si p.sh., *lart e poshtë, mbarë e prapë, rrallë e tek, pak a shumë etj.*

Modelin tjetër e përbën kombinimi i fjalëve që plotësohen reciprokisht, si p.sh., *këmbë e duar, kockë e lëkurë, fund e krye, ditë e natë etj.*

Një model të shpeshtë binomesh e përbën struktura me përsëritjen e së njëjtës fjalë, si p.sh., *krah për krah, dorë për dorë, sot për sot, tani për tani, një për një, nga çasti në çast, ditë për ditë, vit për vit, fjalë për fjalë, kokë për kokë, gjysh pas gjyshi, brez pas brezi, dita ditës, dita ditën, viti vitit, viti vitin, këmba këmbës, kot më kot etj.*

Arsyet e rendit të pakthyesëm të binomeve

Preferenca për një rend të caktuar, dmth., se cila gjymtyrë vjen e para dhe cila e dyta, pretendohet se përcaktohet nga faktorë të ndryshëm. Gjuhëtarë të ndryshëm që janë marrë me studimin e binomeve propozojnë kritere të ndryshme. Kështu, Malkiel (1959) propozon faktorët semantikë, Cooper & Ross (1975) bashkëveprimin e faktorëve fonologjikë dhe semantikë, Gill (1988) faktorët prozodikë, Sa'ied (1979), Gorgis (1999) dhe Bakir (1999) propozojnë si faktorë shtesë faktorët pragmatikë, ndërsa Fenk-Oczlon (1989) argumenton se rregulli më i suksesshëm për parashikimin e rendit të fjalëve në binome është “fjala më e shpeshtë para fjalës më pak të shpeshtë”, dmth., se fjala e parë në një binom ka të ngjarë të jetë me shpeshtësi më të lartë përdorimi në gjuhë sesa fjala e dytë.

Edhe ne mendojmë se rregulli më i përgjithshëm për parashikimin e rendit të fjalëve në binome është fjala më e shpeshtë para fjalës më pak të shpeshtë. Megjithatë, brenda këtij rregulli të përgjithshëm, në raste të caktuara mbizotërojnë faktorët e tjerë të përmendur më lart. Për rrjedhojë, rendi i fjalëve në binomet e pakthyeshme frazeologjike përcaktohet nga ndërveprimi i shumë faktorëve: semantiko-pragmatikë, fonologjikë, kulturorë dhe të shpeshtësisë së përdorimit të fjalëve.

Faktorët semantiko-pragmatikë lidhen me prirjen e njeriut drejt pozitives, sasisë, rëndësisë etj. Faktorët semantiko-pragmatikë kryesorë që ndikojnë në pakthyeshmërinë e binomeve janë:

-Rrjedha logjike e ngjarjeve dhe veprimeve, si p.sh., *sot a nesër, herët ose vonë etj.*

-Pozitivja në jetë e cila vjen para negatives, si p.sh., *mirë a keq, gjallë a vdekur, mbarë e prapë etj.*

Një arsye tjetër për rendin e caktuar të fjalëve në binome është se fjalët përdoren sipas gjatësisë së tyre, dmth., sipas numrit të rrokjeve dhe numrit të bashkëtingëlloreve në rrokje duke ndjekur parimin e peshës më të madhe në fund të strukturës. Për rrjedhojë, në shumë binome rendi është fjalë e shkurtër plus fjalë e gjatë, si p.sh., *çikë e thërrime, rreth e rrotull, poshtë e përprjetë, lart e poshtë etj.*, por nuk ndodh gjithnjë kështu. Në shumë raste ndodh e kundërta, si p.sh., *bardhë e zi, shëndoshë e mirë.*

Kur krijimi i binomeve nuk mund të shpjegohet as me faktorin e shpeshtësisë së përdorimit të fjalëve, as me faktorët semantiko-pragmatikë as me ato fonologjikë, mund të flasim gjithashtu për ndikimin e faktorëve kulturorë. Në një gjuhë mund të vihet re një rend i ndryshëm nga një gjuhë tjetër për shkak të dominimit të kulturave të ndryshme, si p.sh. *bardhë e zi* në shqipe vs *black and white* në anglishte.

Binomi korrespondues i një gjuhe mund të ketë rend të kthyesëm në një gjuhë tjetër, si p.sh., *lart e poshtë* dhe *poshtë e lart* në shqipe, por vetëm *up and down* në anglishte.

Me gjithë rregullat e mësipërme, ka raste që u shpëtojnë të gjitha rregullave të propozuara dhe përbëjnë përjashtime, si p.sh., *shëndoshë e mirë*, ku fjala e parë *shëndoshë* nuk është më e shpeshtë se *mirë*, nuk është më e shkurtër se *mirë* dhe as mendohet se ka arsye e veçantë kulturore apo semantiko-pragmatike për paravendosjen e saj.

Llojet e binomeve frazeologjike në bazë të kuptimit

Mbi bazën e kuptimit literal apo të figurshëm që binomet mund të kenë, do të dallojmë dy lloje binomesh: binomet literale, si p.sh., *shëndoshë e mirë*, *bardhë e zi*, *mirë e bukur*, *lart e poshtë*, *mbarë e prapë*, *rreth e rrotull*, *poshtë e përjetë*, *urtë e butë*, *rrallë e tek*, *pak a shumë*, *rrallë e për mall etj.*, dhe binomet e figurshme, si p.sh., *flakë më flakë*, *mish e thua*, *me kuç e me maç*, *hiq e mos këput*, *kodra pas bregut etj.*

Binomet e figurshme janë binome për strukturën e veçantë binare, por idioma për kuptimin e figurshëm që kanë. Binomet e figurshme do të mund t'i përfshinim në kategorinë frazeologjike të idiomave, për arsye se ato i karakterizon figurshmëria e cila është më e rëndësishme se struktura dhe e cila përbën një nga kriteret bazë të kategorisë së idiomave. Në kategorinë e mirëfilltë frazeologjike të binomeve të pakthyeshme frazeologjike do të propozonim të përfshiheshin vetëm binomet literale të cilat dallohen vetëm për strukturën e tyre të veçantë binare, ndërsa binomet e figurshme do t'i quanim **idioma me strukturë binare**.

Kategoria e binomeve literale është relativisht e ngushtë dhe nga struktura është më e thjeshtë se kategoritë e tjera. Tipar i përgjithshëm i kësaj kategorie është struktura me përsëritje të një fjale ose me bashkëlidhje të dy fjalëve semantikisht korelative (sinonime, antonime, etj. Ato përbëjnë nga ana strukturore grupin më të thjeshtë të frazeologjisë ndajfoljore, madje shkallën e parë në fushën e frazeologjisë gjuhësore.

Është me rëndësi të vihet re këtu se gjymtyrët që bashkërendohen midis tyre kanë një lidhje të caktuar kuptimore, përgjithësisht sinonime a antonime, por që në mjedisin fjalësor përkatës kanë edhe vlerë të mëvetësishme.

Ngurosjat e binomeve frazeologjike (literale)

Jo vetëm binomet e figurshme (apo idiomat me strukturë binare), por edhe binomet literale janë frazeologjike. Në dallim nga binomet literale, binomet e figurshme janë frazeologjike edhe për figurshmërinë e tyre ashtu si idiomat.

Në vijim të studimit tonë do të përqendrohemi në argumentimin e natyrës frazeologjike të binomeve literale, sepse këto paraqesin disa pika shumë interesante në lidhje me ngurosjen e tyre frazeologjike:

Mbartja kuptimore

Nga pikëpamja kuptimore binomet (literale) kanë një domethënie më të gjerë se atë që nënkuptojnë pjesët e tyre përbërëse. Kështu, kuptimi i binomit *bardhë e zi* (si p.sh., *Film i xhiruar bardhë e zi*.) është më shumë se shuma e kuptimeve të fjalëve përbërëse *bardhë + zi*, i cili është “*që nuk ka asnjë ngjyrë me përjashtim të së bardhës dhe të zezës*”. Kuptimet bazë të këtyre elementeve leksikore kanë një rol në kuptim, por formojnë vetëm një pjesë të këtij kuptimi. Shprehja ka edhe tiparin kuptimor të

mungesës së ngjyrave, i cili nuk mund të nxirret prej kuptimeve të fjalëve përbërëse. Si rrjedhojë e këtij kuptimi të shtuar, binomet rezultojnë me kuptim jokompozicional.

E njëjta gjë mund të thuhet për binomin *ditë për ditë = vazhdimisht*, i cili fiton idenë e shtuar të vazhdimësisë, ose binomi *këmbë e duar = kudo, në të gjithë trupin*, i cili fiton idenë e gjithështrirjes dhe kështu strukturat e mësipërme fitojnë një kuptim të shtuar si *vazhdimisht, kurdo, kudo, shumë* etj., gjë që e bën kuptimin e tyre jokompozicional.

Për sa u përket binomeve literale shtojmë se lidhja frazeologjike është në përgjithësi e dobët, sepse, përveç mbartjes së kuptimit që shprehet me kuptimin e shtuar, përbërësit ruajnë edhe kuptimin e tyre literal.

Kufizimi sintaksor

Shumica e binomeve përbëjnë shprehje dygjymtyrëshe me lidhje të forta sintaksore¹⁵³, gjë e cila i paraqitet me rend të pakthyesëm, si p.sh., *bardhë e zi, shëndoshë e mirë* etj. Edhe ato binome që nuk janë të pakthyeshme, shfaqin një tendencë të qartë për një renditje të preferuar, si p.sh., *gjerë e gjatë vs gjatë e gjerë*.

Kufizimi sintaksor shprehet edhe me moslejimin e modifikimit të gjymtyrëve të binomeve. Për rrjedhojë, nuk mund të themi **shëndoshë e shumë mirë, *mirë e shumë bukur, *shumë mirë e bukur, *mirë e më bukur* etj.

Kufizimi morfologjik.

Kufizimi morfologjik lidhet me binomet në përbërje të cilëve kemi pjesë të ndryshueshme të ligjëratës. Kështu, p.sh., përbërësit emra të binomeve kanë tendencë të përdoren në një formë të ngurosor (pavarësisht se në cilën formë ka tendencë të ndodhë ngurosja), si p.sh., *vit për vit, fund e krye, anë e kënd, copë e thërrime*.

Kufizimi leksikor.

Kufizimi leksikor shprehet me tendencën e përbërësve të binomeve për t'u përdorur vetëm në shoqërinë e njëri-tjetrit, si p.sh., *shëndoshë e mirë* dhe jo **shëndoshë e shkëlqyer; mirë e bukur* dhe jo **përkryer e bukur; mirë e bukur* dhe jo **mirë e këndshëm; vit pas viti* dhe jo **vit pas moti; gjallë a vdekur* dhe jo **gjallë a vvarë, plagosur* etj.

Struktura e binomeve frazeologjike (literale)

Shumica e binomeve janë struktura të ndërtuara me dy fjalë të së njëjtës pjesë të ligjëratës. Por cilat janë pjesët e ligjëratës që hyjnë në formimin e binomeve dhe cilat pjesë të ligjëratës kontribuojnë më shumë në ndërtimin e tyre? Klasat leksikore që hyjnë në ndërtimin e binomeve janë:

Shumica e elementeve përbërës të binomeve janë emra, si p.sh., *brez pas brezi, natë e ditë, fund e krye, nga koka te këmbët, krah për krah* etj.

Një shumicë elementesh përbërëse të binomeve janë edhe ndajfolje, si p.sh., *shëndoshë e mirë, bardhë e zi, mirë e bukur, mbarë e prapë, rreth e rrotull, poshtë e përppjetë* etj.

Së fundi, kemi një grup binomesh me strukturë tjetër ku gjymtyra e dytë nuk është e barasvlershme me gjymtyrën e parë, si p.sh., *orë e pa kohë, rrallë e për mall*.

¹⁵³ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

Tipat e binomeve frazeologjike sipas strukturës

Kategorizimi më i vështirë i binomeve është ai mbi bazën e strukturës ku përfshihen shumë elemente, si p.sh., numri i pjesëve përbërëse, rendi i tyre, natyra e tyre leksiko-gramatikore, marrëdhëniet e tyre sintaksore dhe mjeti lidhës. Në vijim të studimit tonë do të abstragojmë nga figurshmëria e binomeve, dmth., nga dallimi midis binomeve të figurshme dhe binomeve literale, dhe do të përqendrohemi te struktura në përgjithësi.

Do të dallojmë dy raste binomesh: rastin tipik dhe rastet kufi.

Rasti tipik i binomeve

Me rastin tipik të binomeve do të kuptojmë binomet që lidhen me lidhëze bashkërenditëse dhe që kanë rend të pakthyesëm.

Në rastin tipik të binomeve të gjuhës shqipe gjejmë binome me përbërës fjalë sinonime apo antonime, si p.sh., *shëndoshë e mirë, bardhë e zi, mirë e bukur, mbarë e prapë, çikë e thërrime etj.*, me përbërës fjalë që përsëriten, si p.sh., *krah për krah, ditë për ditë, vit për vit etj.*, apo me përbërës fjalë që plotësohen reciprokisht, si p.sh., *kokë e këmbë, kockë e lëkurë etj.*

Raste kufi të binomeve

Rasti kufi me parafjalë.

Rasti i parë dhe më i rëndësishëm kufi për gjuhën shqipe është ai ku fjalët përbërëse lidhen me parafjalë, si p.sh., *krah për krah, dorë për dorë, sot për sot*, nga koka te këmbët, brez pas brezi etj. Parafjalët më të rëndësishme janë për, pas.

Rasti kufi me lidhje asidentike

Një rast tjetër kufi janë binomet me lidhje asidentike, si p.sh., *me sot me nesër, dita ditës, dita ditës etj*

Rasti kufi me anomali sintaksore

Një rast tjetër kufi janë binomet me anomali sintaksore, si p.sh., *dita ditës, dita ditën etj.* në të cilët janë thyer rregullat e lidhjes sintaksore. Bëhet fjalë për “togfjalëshat me nënrenditje pa ndonjë parafjalë po me një emër në rasën emërore dhe një në dhanore-rrjedhore të shquar, ose si formë më e vjetër, në rasën kallëzore të shquar, si: *dita ditës/ dita ditën, viti vitit/ viti vitin, këmba këmbës etj*”¹⁵⁴.

Rasti kufi i binomeve me rend jo të pakthyesëm

Një rast tjetër kufi janë binomet që nuk kanë rend të pakthyesëm, si p.sh., *lart e poshtë dhe poshtë e lart, gjerë e gjatë dhe gjatë e gjerë.*

Rasti kufi i binomeve me përbërës me strukturë sintagme

Rasti me përbërës me strukturë sintagme përbëjnë një tjetër rast kufi të binomeve, si p.sh., *me sot e me nesër.*

Rasti kufi i binomeve me gjymtyrë jo të barasvlershme

Së fundi, kemi një grup binomesh me strukturë tjetër ku gjymtyra e dytë nuk është e barasvlershme me gjymtyrën e parë, si p.sh., *orë e pa kohë, rrallë e për mall.*

Tiparet frazeologjike të binomeve të pakthyeshme frazeologjike

Kur flasim për tipare të binomeve, do të nënkuptojmë vetëm binomet literale, sepse binomet e figurshme kanë tiparet e përgjithshme të idiomave, përveç strukturës dypjesëshe që i bashkon me binomet. Por, tiparet e mëposhtme do të karakterizojnë

¹⁵⁴ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

edhe binomet e figurshme, përveç figurshmërisë që karakterizon vetëm këto të fundit. Tiparet kryesore të binomeve (literale) në mënyrë të përmbledhur janë:

Polileksikaliteti. Këtu është për t'u theksuar se flitet për strukturë sintagmore dhe jo togfjalëshore, sepse togfjalëshi nuk shpreh lidhje bashkërenditëse¹⁵⁵.

Kufizimi leksikor

Moskompozicionaliteti semantik

Leksikalizimi

Memorizimi.

Struktura dypjesëshe. Me strukturë dypjesëshe do të kuptojmë dy fjalë apo dy grupe fjalësh që lidhen midis tyre nga një mjet lidhës që mund të jetë një lidhëze apo një parafjalë

Afërsia semantike e përbërësve.

Hierarkia e përgjithshme sintaksore e përbërësve.

Lidhja e përgjithshme me lidhëza apo parafjalë.

Pakthyeshmëria e përgjithshme e gjymtyrëve.

Funksioni i binomeve frazeologjike

Nga ana funksionale binomet e pakthyeshme frazeologjike janë frazema ndajfoljore që shënojnë mënyrë, kohë ose vend.

Shumica e binomeve të pakthyeshme frazeologjike shënojnë mënyrë me kuptim intensifikues si ndajfoljet *shumë, tepër, fare, krejt etj.*, si p.sh., Pas ndërhyrjes fëmija është **shëndoshë e mirë** – “*shumë mirë*”; E tregoi historinë **fjalë për fjalë** - “*tepër hollësisht*”, ose pa ndonjë nuancim tjetër, si p.sh., Film i xhiruar **bardhë e zi** – “*pa ngjyra*”

Një pjesë tjetër e tyre shënojnë kohë me kuptimin e shpeshtësisë apo të vazhdimësisë si ndajfoljet *shpesh, dendur, ngaherë, vazhdimisht etj.* Kështu, ditë për ditë merr kuptimin *shpesh, dendur, ngaherë, vazhdimisht etj.* dhe jo *çdo ditë*, si p.sh., **Ditë për ditë** po kjo punë është me ty – “*ngaherë, vazhdimisht*”.

Pak binome të pakthyeshme frazeologjike shënojnë vend me kuptimin e gjithështrirjes si ndajfolja *kudo*, si p.sh., Uji i ftohtë e drodhi **fund e krye** dhe e pruri në vete – “*kudo*”.

Kufiri dhe identifikimi i binomeve frazeologjike

Për të përcaktuar kufirin e binomeve të pakthyeshme frazeologjike, do të nisemi nga arsyeja që çon në krijimin e tyre, e cila është kohezioni semantik apo lidhja opake midis kuptimit të fjalëve të veçanta dhe kuptimit të gjithë strukturës¹⁵⁶.

Roli i kohezionit semantik duket në rastin e binomeve të pakthyeshme jofrazeologjike të cilat, edhe pse përbëhen nga fjalë që janë të afërta semantikisht dhe që përdoren shpesh pranë njëra-tjetrës, nuk kanë natyrë frazeologjike, sepse shpeshtësia e përdorimit të tyre nuk ka çuar në mbartje kuptimore të strukturës apo në kohezion semantik, gjë për të cilën interesohet frazeologjia, si p.sh., *lerë e rritur, kokë*

¹⁵⁵ Memushi, R. (2004). vep. e cit.

¹⁵⁶ Libben G. (1998). Semantic transparency in the processing of compounds: consequences for representation, processing and impairment. *Brain Lang.*

a pilë, sot e tutje, tani e tutje, kohë më kohë, kohë pas kohe, herë pas here, rrugë më rrugë, shteg më shteg, fshat më fshat, shtëpi më shtëpi, derë më derë, javë për javë, muaj për muaj, babë e bir, nënë e bijë, zonja e zotërinj, bukë me djathë etj.

Roli i kohezionit semantik duket më mirë në rastin e binomeve me fjalë sinonime. Binomet me fjalë sinonime, edhe pse mund të shprehin intensitet, edhe pse mund të jenë të shpeshta, nuk mund të jenë frazeologjike, në qoftë se elementet përbërëse nuk kanë kohezion semantik dhe në qoftë se nuk janë të memorizuara si sekuenca të gjuhës. P.sh., te shprehja “*bora dhe e ftohta*”, edhe pse e shpeshtë, nuk ka asgjë të pandryshueshme. Folësit janë të lirë të përmbysin renditjen e përbërësve (*e ftohta dhe bora*) dhe të zëvendësojnë fjalët *borë* apo *e ftohta* me fjalë të afërta semantikisht, si p.sh., *bora dhe dimri, bora dhe acari, shiu dhe e ftohta etj.*, gjë që nuk mund të ndodhë në binomet frazeologjike, si p.sh., **shëndoshë e shkëlqyer* në vend të *shëndoshë e mirë*, **përkryer e bukur* në vend të *mirë e bukur*, **vit pas moti* në vend të *vit pas viti*, **gjallë a vrarë* në vend të *gjallë a vdekur etj.* Pra, fjalët *borë* dhe *e ftohtë*, edhe pse janë sinonime kontekstuale, edhe pse kanë funksion intensifikues, nuk janë binome frazeologjike. Shpeshtësia e tyre nuk ka çuar në kohezion semantik dhe, për rrjedhojë, as në memorizimin e tyre si sekuenca të shkëputura të gjuhës.

Për togjet *sot e tutje, tani e tutje etj.*, Thomai (1981) thekson se “kanë përgjithësisht përmbajtje njëplanëshe, pa idiomaticitet dhe pa ndonjë zhvillim të dukshëm kuptimor, prandaj mendojmë se duhet të merren jo si njësi frazeologjike”, por si lidhje të lira binare.

“Disa prej tyre formojnë vargje relativisht të hapura, brenda një fushe leksikore”¹⁵⁷. Në këtë rast bëhet fjalë për binomet me fjalë që përsëriten, si p.sh., *rrugë më rrugë, shteg më shteg, fshat më fshat, shtëpi më shtëpi, derë më derë, ditë për ditë, javë për javë, muaj për muaj, vit për vit etj.* Edhe në këto binome nuk kemi zhvillim kuptimor dhe togfjalëshi mbetet një strukturë me përsëritje të thjeshtë, si p.sh., “çdo ditë”, “çdo vit”, në shembujt: Tërë këtë javë, ditë për ditë kishte vajtur te nëna. Vit për vit këtë tokë e kemi mbjellë me grurë. “Nga ana strukturore këtu kemi, si të thuash, “tip formimi”, gjë që s’është karakteristike për frazeologjinë gjuhësore në përgjithësi”¹⁵⁸. Pra, binomet frazeologjike duhet të jenë struktura me lidhje asociative midis elementeve, me kohezion semantik dhe me rend përgjithësisht të pakthyesëm. Këto janë rastet për të cilat interesohet frazeologjia.

Një rol të veçantë për rastin e binomeve me fjalë sinonime në gjuhën shqipe luan edhe lidhëza e përdorur. “Për sa i përket lidhëzës bashkërenditëse shtuese, ajo është lidhëza *e*. Kjo nuk mund të zëvendësohet me asnjë lidhëze tjetër bashkërenditëse shtuese (“dhe” apo “edhe”), gjë që tregon se sa thellë ka shkuar ngurosja formale e këtyre njësive frazeologjike”¹⁵⁹.

Në qoftë se kohezioni te binomet është shumë i fortë, atëherë prej tyre mund të lindin fjalë të përbëra, si p.sh., *tutje-tëhu, vajtje-ardhje, aty-këtu, ecejak etj.*¹⁶⁰.

¹⁵⁷ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

¹⁵⁸ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

¹⁵⁹ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

¹⁶⁰ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

Dallimi midis binomeve frazeologjike dhe lidhjeve të lira binare

Duhet thënë se lidhjet e binomeve frazeologjike të këtij lloji me sintagmat e lira burimore janë ende të gjalla, për arsye se këto të fundit jetojnë dhe përdoren gjerësisht. Tek ato, më shumë se në tipat e tjerë, në zbulimin e vlerës semantike luan rol konteksti, më ngushtë folja të cilën plotësojnë. Kështu konteksti do të na shkoqitë nëse kemi një binom frazeologjik apo një lidhje të lirë binare, si p.sh., te fjalia *Mësuesi e ndau fjalinë fjalë për fjalë*, struktura binare “*fjalë për fjalë*” përdoret si lidhje e lirë binare vetëm në kuptimin e saj literal, ndërsa te fjalia *Nxënësi e tha mësimin fjalë për fjalë*, struktura binare “*fjalë për fjalë*” përdoret si binom frazeologjik me kuptimin e shtuar “*plotësisht, tërësisht*”. Po kështu, te fjalia *Të dyja kukullat janë të qepura krah për krah*, struktura binare “*krah për krah*” përdoret si lidhje e lirë binare vetëm në kuptimin e saj literal, ndërsa te fjalia *Të dy shokët ecnin krah për krah*, struktura binare “*krah për krah*” përdoret si binom frazeologjik me kuptimin e shtuar “*shumë afër*”.

Kuptimi frazeologjik i binomeve të mësipërme nuk del nga shuma e kuptimeve të fjalëve përbërëse të sintagmës, por është ngritur mbi këtë kuptim të cilit i është shtuar edhe një kuptim suplementar, edhe pse vlera e drejtpërdrejtë kuptimore e gjymtyrëve është ende shumë e qartë. Nga ky ballafaqim shohim shkëputjen e binomeve frazeologjike prej burimit, zhvillimin e tyre kuptimor frazeologjik, por edhe ruajtjen e përbërësve kuptimorë fillestarë.

Dallimi dhe ngjashmëria midis binomeve frazeologjike literale dhe binomeve frazeologjike të figurshme

Afritë dhe dallimet midis binomeve literale dhe binomeve të figurshme bëhen më të kapshme në rastin e përdorimit në kontekst të strukturave binare që mund të kenë dy lexime, një literal dhe një të figurshëm, si p.sh., *uji i ftohtë e drodhi fund e krye dhe e pruri në vete vs gjithë kultura duhet të përshkohet fund e krye nga ideologjia jonë marksiste-leniniste; mua do më pëlqente t’ia shkulja mustaqet fije për fije nga inati vs kaçaku e pyeti fije për fije për punët e pazarit*. Shembujt e mësipërm ilustrues janë marrë nga letërsia artistike siç figurojnë në veprën “*Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*” (1981) të Jani Thomait. Vetëm konteksti na ndihmon të kuptojmë nëse kemi një binom literal apo një binom të figurshëm. Në fjalitë *uji i ftohtë e drodhi fund e krye dhe e pruri në vete* dhe *mua do më pëlqente t’ia shkulja mustaqet fije për fije nga inati*, binomet janë përdorur në kuptimin e tyre literal. Fjalët janë përdorur në kuptimin literal dhe në mjedisin fjalësor përkatës kanë edhe vlerë të mëvetësishme mund të përdoren jashtë lidhjes binare me kuptimin e përdorur brenda kësaj lidhjeje, por struktura shumëfjalëshe përshkohet edhe nga një kuptim i shtuar “*kudo nëpër trup*”, gjë që e bën kuptimin e strukturës jokompozicional, ndërsa vetë strukturën njësi leksikore. Në fjalitë *gjithë kultura duhet të përshkohet fund e krye nga ideologjia jonë marksiste-leniniste dhe kaçaku e pyeti fije për fije për punët e pazarit*, binomet janë përdorur në kuptimin e figurshëm. Fjalët nuk janë përdorur në kuptimet e tyre literale, por e gjithë struktura ka fituar një kuptim të ri të figurshëm: *fund e krye = krejtësisht; fije për fije = hollësisht*, dhe, për rrjedhojë, këto struktura shumëfjalëshe përbëjnë njësi të vetme leksikore.

Për sa i përket ngjashmërisë midis binomeve literale dhe atyre të figurshme, ato kanë të njëjtën strukturë dypjesëshe, si p.sh., binomet literale *shëndoshë e mirë, rreth*

e rrotull kundrejt binomeve të figurshme *flakë për flakë, dhëmb për dhëmb, me kuç e me maç etj.*, ku vihet re e njëjta strukturë dypjesëshe përbërësit e të cilave lidhen me lidhëze apo me parafjalë.

Paraqitja e binomeve frazeologjike literale në fjalorë

Shumë binome (literale) janë pasqyruar edhe në fjalorët shpjegues të shqipes. Ato nuk janë pasqyruar si kategori më vete ashtu si idiomat, por janë përfshirë në shembujt e dhënë për kuptimet e fjalëve përbërëse të tyre. Disa prej tyre janë shoqëruar edhe me shpjegime. Por le t'i shohim këto të dhëna më konkretisht:

Shumica e binomeve të pasqyruar në fjalorët e shqipes që konsultuam (1984; 2002) janë shoqëruar edhe me shpjegime, si p.sh., *rrallë e për mall = shumë rrallë; rreth e rrotull = nga të gjitha anët.*

Disa binome janë pasqyruar të pashoqëruara me shpjegime, si p.sh., *është shëndoshë e mirë, mirë e bukur etj.*

Shumica e binomeve të pasqyruara në fjalorë janë dhënë në të dy zërat leksikografikë, si p.sh., *rreth e rrotull, pak a shumë, bardhë e zi, gjallë a vdekur, mirë e bukur etj.*

Shumë binome mund të kenë edhe kuptim literal edhe kuptim të figurshëm, dmth., mund të përdoren si binome literale apo si idioma, si p.sh., *bardhë e zi*, por ky fakt nuk është pasqyruar mjaftueshëm nëpër fjalorët shpjegues të shqipes, dmth., veç e veç dhe me sqarimet përkatëse, me përjashtim të disa rasteve, si p.sh., *bardhë e zi = në të bardhë e në të zezë; jo me ngjyra* (për filmat etj.) si binom literal dhe *i sheh (gjërat) bardhë e zi = i sheh gjërat në mënyrë të thjeshtuar*, si idiomë në zërin leksikografik *bardhë*, por edhe në zërin leksikografik *zi* me referim për sqarime të zëri leksikografik *bardhë*.

Disa binome literale janë pasqyruar edhe si idioma (binom i figurshëm) ndërkohë që mund të mos jenë të tilla, sepse nuk kanë figurshmëri dhe përkufizimet e tyre janë të njëjta në të dy rastet, si p.sh., *rrallë e për mall = shumë rrallë*, si idiomë të zëri leksikografik *mall*, dhe *rrallë e për mall = shumë rrallë*, si binom literal të zëri leksikografik *rrallë*¹⁶¹.

6. 5. Lokucionet gramatikore

Historiku i lokucioneve

Në gjuhë të ndryshme të botës ku përdoret fjala lokucion, kuptimet e saj lëvizin nga kuptimi i përgjithshëm si "*mënyrë e të shprehurit, stil*"¹⁶² të ai terminologjik gjuhësor, fillimisht i gjerë si "*grup fjalësh i ngulitur nga tradita, kuptimi i të cilit shpesh është metaforik, i figurshëm*"¹⁶³, për të mbërritur tek ai special gjuhësor si grup i ngulosur fjalësh *me karakter jo të figurshëm*¹⁶⁴ dhe *me vlerë gramatikore*¹⁶⁵, si

¹⁶¹ Fjalori i shqipes së sotme. (2002). Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë.

¹⁶² Nouveau Petit Robert (2001). Dictionnaires Le Robert, Paris.

¹⁶³ Nouveau Petit Robert (2001). vep. e cit.

¹⁶⁴ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

¹⁶⁵ Thomai, J. (2006). vep. e cit.

p.sh., duke qenë se, për arsye se, në qoftë se, sa do që, në vend që, në lidhje me, në drejtim (të...), me anën (e...) etj.

Në kuptimin e tij të gjerë gjuhësor, të përdorur që më 1680¹⁶⁶, termi lokucion u rimor nga Bally (1909) dhe u përdor si “lokucion frazeologjik”. Lokucionet frazeologjike baliiane, përveç shprehjeve të ngurosura të figurshme, përfshinin edhe shprehje të ngurosura jo të figurshme, si p.sh., *en dépit de (pavarësisht nga), nulle part (asgjëkund)* etj.

Me kalimin e kohës, pati një rendje të madhe vetëm pas shprehjeve të ngurosura të figurshme. Kjo praktikë pune nisi në vitet 30’ dhe mbizotëroi deri në vitet 70’. Nismëtar ishte gjuhëtari rus Vinogradov (1947) i cili, për këto shprehje të ngurosura të figurshme, propozoi termin “njësi frazeologjike”. Kjo bëri që të lihen jashtë kategorisë së njësisve frazeologjike vinogradoviane shprehjet e ngurosura jo të figurshme të cilat filluan të përvijohen si një kategori frazeologjike më vete. Karakteristikë e përmbajtjes së tyre kuptimore është dobësimi¹⁶⁷, por jo humbja e kuptimit të përbërësve. Për to u ruajt emërtimi “lokucione” në një përdorim gjuhësor “special”¹⁶⁸, ndërsa lokucioni si emërtim gjuhësor në kuptimin e gjerë balian filloi të zëvendësohet në shumë gjuhë me termin shprehje të ngurosura, frazemë etj.

Për të dyja kuptimet gjuhësore të termit “lokucion” është folur edhe në gjuhësinë shqipe. Për kuptimin e gjerë gjuhësor në shqipe është folur që në fillim të shekullit të XX. Kështu, A. Xhuvani i ka studiuar lokucionet që më 1921. Ai ka quajtur ato “një mënyrë të folurit, domethanëja e të cilave ka rrjedhë jo nga fjalët qi i formojnë lokucionet, por nga përdorimi i ktyne fjalëve, një përdorim si me thanë i breshnuem qi u ka dhanë ktyneve, të marrun si një grumbulli, një kuptim mbë vehte. Lokucione p.sh. janë në shqipet kto: me kallzuem diçka për fije e për pe, me i ardhun ndokujt tjegulla për qark etj.”, dmth ka përfshirë në to vetëm njësitë shumëfjalëshe të qëndrueshme me moskompozicionalitet, por i ka kufizuar vetëm te ato me figurshmëri.

I. D. Sheperi (1927), duke quajtur lokucione “dy (ose dhe tri) fjalë, të cilat ndonse të ndara, përbëjnë të dyja një kuptim të veçantë, ose një formë të fjalës (të së dytës), ose një pjesë tjetër të ligjëratës si p.sh., *marr vesh (=kuptoj), kam shkruar (=shkrova), në vend (të..., parafjalë)*” etj, i ka parë në mënyrë shumë të gjerë. Autori përfshin në lokucione jo vetëm njësi shumëfjalëshe të figurshme, por edhe jo të figurshme, si dhe kohët e përbëra të foljeve.

N. Bulka (1958) i ka quajtur lokucionet “shprehje metaforike që po t’i përkthesh fjalë për fjalë në gjuhë tjetër, e humbasin kuptimin e tyre”, dmth i ka parë ato në mënyrë të njëanshme duke theksuar më shumë vlerën letraro-artistike të tyre dhe përfshin në to jo vetëm njësi shumëfjalëshe të figurshme si p.sh., “i vrit të trasha”, “u dha datën”, por edhe njësi njëfjalëshe të figurshme, si p.sh. “u doq ng’ajo q’e gjeti”, “u dha mbi ta” si dhe disa kompozita të figurshme si p.sh. “dorë-thatë”, “gjëmë-madhi”, etj.

Termi lokucion është përdorur në kuptimin **special** gjuhësor vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të XX për ato shprehje të ngurosura, **jo të figurshme** që shërbejnë

¹⁶⁶ Nouveau Petit Robert (2001). vep. e cit.

¹⁶⁷ Domi, M. (1985). vep. e cit.

¹⁶⁸ Nouveau Petit Robert (2001). vep. e cit.

për “**organizimin sintaksor të fjalisë**”¹⁶⁹, dhe të cilat u quajtën “**lokucione gramatikore**” nga J. Thomai (2006), term të cilin do ta ruajmë në vijim të punimit tonë për ato shprehje të ngurosura, jo të figurshme që shërbejnë për organizimin sintaksor të fjalisë, si p.sh., *me anën (e ...), me përjashtim (të...), në sajë (të...), në bazë (të...), në vend (të...), në përputhje me, në pajtim me, lidhur me, në lidhje me, në bazë (p.sh., fshati), me gjithë (p.sh., përpjekjet), në qoftë se, po qe se, sa do që, duke qenë se, në mënyrë që, me qëllim që, për shkak se, në vend që, nga frika se, me kusht që, në rast se etj.*

Në kuptimin special gjuhësor, lokucionet gramatikore i kanë studiuar edhe gjuhëtarë të tjerë, por pa përmendur tiparin e tyre gramatikor.

Kështu, M. Çeliku (1975) studion lokucionet parafjalore “që formohen nga bashkimi i një ose dy parafjalëve me një emër që në rastin konkret nuk funksionon më si emër”, si p.sh., *në mes, në drejtim, në adresë, në vend, në kurriz, në favor, për arsye, për shkak etj.*

Sh. Demiraj (1970) studion lokucionet ndajfoljore dhe thekson se: “Për lokucione ndajfoljore të formuara nga togje të lira të tipit parafjalë + emër mund të bëhet fjalë vetëm atëherë kur pjesët përbërëse të tyre si kuptimisht edhe gramatikisht janë shndërruar, si të thuash, në një njësi të pandashme me vlerë dhe tipare ndajfoljore”, midis të cilave ai dallon lokucionet ndajfoljore “që nuk kanë kuptim të figurshëm”, si p.sh., *me natë, me radhë, me nxit etj.*, por edhe “lokucione ndajfoljore me kuptim të figurshëm”, si p.sh., *në tym, nën dorë etj.* Autori dallon edhe lokucione të tjera ndajfoljore jo me kuptim të figurshëm, si p.sh., *nga herë, nga mot, me të keq, me të mirë etj.*

Edhe E. Hysa (1970) studion lokucionet ndajfoljore dhe konstaton “një radhë lokucioneve ndajfoljore të formuara kryesisht nga emra me rrugë të ndryshme” si p.sh., nga lidhja e dy emrave me kuptim pak a shumë të afërt nëpërmjet lidhëzës këpujore *e: ... copë e çikë, rreth e rrotull etj.*, nga përdorimi i një emri me parafjalë të ndryshme: *... me egërsi, me gëzim, me kohë, me natë etj.* dhe kryesisht nga përsëritja e të njëjtit emër: *... njolla-njolla, fije-fije, litar-litar etj.*

Lokucionet kanë gjetur vend edhe në veprën “*Gramatika e gjuhës shqipe I*” (2002). Ato nuk janë bërë objekt i një vështrimit të përgjithshëm si kategori e njësi e caktuar gramatikore, por bëhet fjalë për lokucione përkatëse kur trajtohen disa pjesë të caktuara të ligjëratës, konkretisht për lokucione ndajfoljore, si p.sh., *... rreth e rreth, orë e çast, ... copa-copa, vende-vende, ... dita-ditës, ... ditë për ditë, drekë për drekë, ...një nga një, dy nga dy, ... drejt për drejt, sot për sot, ...me të qeshur, me të shpejtë, ... me kohë, me natë, me hir, me pahir, etj.*; për lokucione parafjalore, si p.sh. *me anë, me anën, në bazë, në vend etj.*; për lokucione lidhëzore, si p.sh., *në është se, në qoftë se, duke qenë se etj.* dhe për lokucione pjesëzore, si p.sh., *as që, ja që, jo që jo etj.*

M. Domi (1985) quan lokucion “përgjithësisht një njësi gjuhësore të përbërë prej dy a më shumë fjalësh që formojnë një tërësi të vetme për nga kuptimi, me vlerën e një pjese të caktuar të ligjëratës”. Autori pranon qenien jo vetëm të lokucioneve ndajfoljore, parafjalore, lidhëzore, por edhe të lokucioneve foljore, si p.sh., *bëj ballë, ngre krye*, të lokucioneve emërore, si p.sh., *të bërit ballë, të ngriturit krye, lule blete, lule dimri, gjel deti*, të lokucioneve mbiemërore, si p.sh., *i dalë menç*, të lokucioneve

¹⁶⁹ Grand Larousse de la langues française. (1971). Paris.

numërore, si p.sh., *tridhjetë e një* dhe të lokucioneve përemërore, si p.sh., *gjithë sa (qenë aty u çuditën)*.

Lokucionet janë pasqyruar edhe në fjalorët shpjegues të shqipes. Te “*Fjalori i gjuhës shqipe*” (1954), me lokucion kuptohet një “mënyrë të foluri, shprehje, grup prej dy ose më shumë fjalësh, që shprehin një kuptim të vetëm”, ndërsa te “*Fjalori i shqipes së sotme*” (1984), me lokucion kuptohet një “grup fjalësh që nga ana gramatikore e leksikore është i barasvlershëm me një fjalë të vetme dhe që ka në përbërjen e tij të paktën një fjalë emërtuese; shprehje gjuhësore” dhe përmenden rastet “lokucion ndajfoljor, parafjalor”. Në rastin e parë termi përdoret në kuptimin e gjerë gjuhësor, ndërsa në rastin e dytë në kuptimin special gjuhësor.

Natyra frazeologjike e lokucioneve gramatikore

Deri tani, në gjuhësinë shqiptare lokucionet gramatikore kurrë nuk janë trajtuar si objekt i disiplinës së frazeologjisë. Edhe pse shumë nga përkufizimet e mësipërme të autorëve shqiptarë i mëshojnë si tërësisë kuptimore dhe kufizimin leksikor, të cilat përbëjnë tipare të natyrës frazeologjike, asnjë prej tyre nuk ka pranuar natyrën frazeologjike të lokucioneve gramatikore. Kështu, Thomai (2006) thekson se “nuk do të trajtohen si njësi frazeologjike edhe lokucionet gramatikore (me vlerë lidhëze, parafjale etj), si: *me anën (e ...), për arsye se, ashtu si, po qe se, duke qenë se, lidhur me, në mënyrë që, me qëllim që*”. Siç e përmendëm edhe më lart, disiplina gjuhësore që është marrë më shumë me trajtimin e tyre është morfologjia. Ndryshe nga specialistët e morfologjisë që i shikojnë lokucionet si mënyrë formimi shprehjesh gjuhësore me kuptim unitar, frazeologjia i shikon si shprehje të qëndrueshme me kuptim të mbartur të përbërësve.

Gjëja e parë që do të provojmë në punimin tonë është se lokucionet gramatikore në kuptimin special gjuhësor janë frazeologjike. Për këtë do t'i drejtohem për ndihmë, së pari, kriterit të sintagmës (shih Agani:1975, Dhima:2007) të cilin ne pranojmë dhe që është më përfshirës se ai i togfjalëshit i cili i përjashton lokucionet gramatikore nga kategoritë frazeologjike për shkak të strukturës së tyre jotogfjalëshore, ndërkohë që sintagma i hap rrugën përfshirjes së tyre në frazeologjinë e gjuhës, dhe së dyti, kriterëve të kufizimit leksikor dhe të moskompozionalitetit semantik i cili rrjedh nga kuptimi i zbehur i përbërësve. Të dyja këto kritere të nevojshme janë të mjaftueshme që struktura sintagmore e lokucioneve gramatikore të konsiderohet frazeologjike.

Kështu, fjala *drejtim* në “*në drejtim (të...)*” nuk ka kuptimin e zhvendosjes së lëvizjes dhe takimit të dy pikave të nisjes dhe të mbarimit të lëvizjes, por vetëm të lidhjes apo referimit të një çështjeje të caktuar dhe nuk mund të zëvendësohet me një fjalë të përafërt me të. P.sh, themi *në drejtim (të çështjes, problemit)* por jo ~~*në kah*~~ (*të çështjes, problemit*). As parafjala *në* nuk mund të zëvendësohet me një fjalë të përafërt me të. P.sh, themi *në drejtim (të çështjes, problemit)* por jo ~~*te drejtimi*~~ (*i çështjes, problemit*). As mund të përdoret jashtë kësaj strukture me këtë kuptim të zbehur. Mund të themi: *drejtori tha fjalë të mira në drejtim të punës së nxënësve (= për, referuar...)*, por jo: ~~*drejtimi i drejtorit në punën e nxënësve*~~, por: *referimi i drejtorit në punën e nxënësve*.

As fjala *natë* në *me natë* nuk ka kuptimin e periudhës kohore që nga përfundimi deri në lindjen e diellit, por vetëm periudhën para lindjes së diellit dhe nuk mund të

zëvendësohet me një fjalë të përafërt me të dhe as mund të përkthehen fjalë për fjalë në gjuhë të ndryshme. P.sh, themi *me natë*, por jo ~~*me mbasdite, me mesditë*~~ dhe nuk mund të përkthejmë *me natë* në frëngjisht me ~~*avec nuit*~~ ose në anglisht me ~~*with night*~~. As parafjala *me* nuk mund të zëvendësohet me një fjalë të përafërt me të. P.sh, themi *me natë* por jo ~~*gjatë natës*~~, sepse i ndryshon kuptimi.

Fjalët që hyjnë në përbërjen e lokucioneve gramatikore e kanë të zbehur, apo të dobësuar kuptimin dhe e kanë humbur plotësisht mëvetësinë morfo-sintaksore si fjalë të veçanta. Për rrjedhojë, ato “përdoren në një formë të ngurosur dhe, në përgjithësi, edhe në një kuptim pak a shumë të ndryshuar”¹⁷⁰. Te shembujt në drejtim (të ...), *me natë etj.*, emrat kanë humbur kategoritë morfologjike dhe aftësitë e lidhjeve të tyre sintaksore, pasi nuk ka mundësi të marrin, para ose prapa, përcaktorë me apo pa përshtatje. Në këto raste edhe parafjalët e humbasin aftësinë e tyre kombinuere, nuk shprehin lidhjen sintaksore të emrave pas tyre, duke qenë se përdoren vetëm para një emri në formë të ngurosur. Kjo gjë nuk ndodh me sintagmat e lira homonimike, si p.sh., *Për të shpëtuar nga qentë, fëmijët vrapuan në drejtim të shtëpisë/ ë drejtime të ndryshme/në çdo drejtim të mundshëm. Netët e dimrit nuk duhen krahasuar me netët e verës/ me natën e mëparshme/ me këto netët e fundit.*

Si konkluzion mund të themi se sintagmat e mësipërme janë të ngurosur për shkak të kufizimit leksikor dhe të moskompozicionalitetit semantik i cili rrjedh nga kuptimi i zbehur i përbërësve.

Burger (1998) i përfshin lokucionet gramatikore në një kategori më vete frazeologjike dhe i quan “njësi frazeologjike strukturore që krijojnë lidhje gramatikore”.

Edhe Granger & Paquot (2008) i përfshijnë lokucionet gramatikore në një kategori më vete frazeologjike që përdoren për “strukturimin dhe organizimin e përmbajtjes së një teksti” dhe i quajnë “frazema tekstuale.”

Llojet e lokucioneve gramatikore në shqipe

Në bazë të kriterëve që ne kemi parashtruar, në bazë të fushës në të cilën operojmë e cila lidhet me lokucionet në kuptimin special gjuhësor si grup fjalësh i ngurosur, jo i figurshëm dhe me vlerë gramatikore dhe në bazë të vëllimit të lokucioneve të konstatuara, rezulton që lokucionet gramatikore në gjuhën shqipe mund t’i ndajmë dhe t’i klasifikojmë në tri lloje:

Lokucione parafjalore, si p.sh., *me anën (e ...), me përjashtim (të...), në sajë (të...), në bazë (të...), në vend (të...), në përputhje me, në pajtim me, lidhur me, në lidhje me, në bazë (p.sh., fshati), me gjithë (p.sh., përpjekjet) etj.*

Lokucione lidhëzore, si p.sh., *në qoftë se, po qe se, sa do që, duke qenë se, në mënyrë që, me qëllim që, për shkak se, në vend që, nga frika se, me kusht që, në rast se etj.*

Lokucione ndajfoljore, si p.sh., *me kohë, me natë, prej kohe, prej kohësh, më këmbë etj.*

Për sa i përket tiparit “gramatikor” me të cilin cilësohen lokucionet nga Thomai (2006), ai përputhet me cilësimin e bërë nga “Grand Larousse de la langues française” (1971), si njësi që shërbejnë për “organizimin sintaksor të fjalisë”, por ai mbetet tipar

¹⁷⁰ Gramatika e gjuhës shqipe 1 (2002). vep. e cit

i pjeshëm, sepse është i vlefshëm vetëm për lokucionet parafjalore, lidhëzore dhe pjesëzore, dhe jo për lokucionet ndajfoljore të cilat, ashtu si dhe ndajfoljet, përbëjnë gjymtyrë fjalie. Lokucionet parafjalore, lidhëzore dhe pjesëzore janë njësi shumëfjalëshe shërbyese, dmth me vlerë gramatikore, ndërsa lokucionet ndajfoljore janë njësi shumëfjalëshe emërtuese, dmth., me funksion gramatikor.

Tiparet frazeologjike të lokucioneve gramatikore

Tiparet frazeologjike të lokucioneve gramatikore në mënyrë të përmbledhur janë:

- Polileksikaliteti
- Kufizimi leksikor
- Mungesa e figurshmërisë dhe zbehja e kuptimit të përbërësve
- Moskompozicionaliteti semantik.
- Ngurosja e plotë gramatikore.
- Struktura sintagmore me një fjalë emërtuese.
- Leksikalizimi dhe përdorimi si njësi leksikore
- Barasvlershmëria me fjalën
- Memorizimi dhe riprodhimi si njësi të gatshme

Përkufizimi i lokucioneve gramatikore

Në bazë të kriterëve dhe të tipareve të përcaktuara më sipër, lokucionet gramatikore në shqipe janë lidhje shumëfjalëshe të qëndrueshme me kufizim të plotë morfo-sintaksor, me kuptim të zbehur, dhe me vlerë përgjithësisht gramatikore, kuptimi i të cilave nuk është shumë e thjeshtë e kuptimeve literale të përbërësve.

Delimitimi i lokucioneve gramatikore

Për të përcaktuar kufijtë e lokucioneve gramatikore në shqipe kanë rëndësi jo vetëm kriteret dhe tiparet e tyre dalluese, por edhe krahasimi i tyre me kategoritë e tjera frazeologjike më të afërta.

Autorë të ndryshëm nisen nga kriteret e ndryshme në përcaktimin e kufijve të lokucioneve gramatikore, gjë që e bën vëllimin lokucionor të njërit autor të jetë pjesërisht i ndryshëm nga ai i të tjerëve.

Kështu, Thomai (1981) niset nga kriteri i strukturës togfjalëshore dhe i mosfigurshmërisë, por përfshin në lokucionet gramatikore edhe njësi shumëfjalëshe me figurshmëri e cila nuk përbën kriter dhe tipar të lokucioneve gramatikore, si p.sh., *nën dorë, nën hundë, nën rrogos, në tym, pas shpine etj.*, por të idiomave.

“Gramatika e gjuhës shqipe I” (2002) i mëshon kriterit të barasvlershmërisë me fjalët, në bazë të të cilit në kategorinë e lokucioneve gramatikore përfshihen njësi shumëfjalëshe me një, por edhe me më shumë se një fjalë emërtuese, pa figurshmëri, por edhe me figurshmëri, si p.sh., *me natë, më këmbë*, por edhe *në tym, tym e flakë, javë për javë, ditë për ditë etj.*, të cilat jo të gjitha janë lokucione gramatikore.

Edhe Hysa (1970) i mëshon kriterit barasvlershmërisë me fjalët, prandaj, në lokucionet ndajfoljore për të cilat ai flet, përfshin edhe shumë lidhje të lira fjalësh, si p.sh., *me egërsi, me nxitim*; fjalë të përbëra, si p.sh., *njolla-njolla, togje-togje, shkallë-shkallë*; si dhe shumë binome (frazeologjike ose jofrazeologjike), si p.sh., *rreth e qark, mëngjez e mbrëmje, ditë e javë etj.* Përdorimi i fjalëve emërtuese në një formë të

ngurosur te lokucionet gramatikore nuk duhet ngatërruar me përdorimin e dy fjalëve, të afërta kuptimisht apo të njëjta, në një trajtë dhe renditje të caktuar, kur ky përdorim nuk çon në zbehje të kuptimit të fjalëve, si p.sh., *me natë vs drekë e darkë, herët ose vonë, natë për natë, shtëpi më shtëpi*. Këto të fundit janë binome, sepse struktura e njësisë shumëfjalëshe *natë për natë, javë për javë, kokërr më kokërr, fshat më fshat*, nuk paraqet zbehje të kuptimit dhe, për rrjedhojë, nuk përbën kriter të formimit të lokucioneve gramatikore.

Demiraj (1970) i mëshon idesë së humbjes së mëvetësisë gramatikore dhe kuptimore, por përfshin në lokucionet gramatikore edhe njësi shumëfjalëshe me figurshmëri (idioma), si p.sh., *në tym, nën dorë*.

Domi (1985) i mëshon idesë së dobësisë së kuptimit të përbërësve të lokucionit dhe qëndrueshmërisë së strukturës, por në praktikë, në lokucionet gramatikore përfshin edhe lidhje të lira, si p.sh., *njëzet e tre, dy mijë*; kolokacione frazeologjike, si p.sh., *borë e bardhë, dyllë i verdhë, korb i zi*; idioma, si p.sh., *bëj ballë, të bërët ballë, ngre krye, të ngriturit krye etj.*

Në bazë të kriterëve të propozuara dhe tipareve dalluese të lokucioneve gramatikore, duhet të përjashtojmë nga vëllimi lokucionor i autorëve shqiptarë shumë të ashtuquajtura lokucione gramatikore dhe, në varësi të lidhjes së qëndrueshme apo të lirë që paraqesin, do t'i përfshijmë në kategoritë e tjera frazeologjike apo do t'i përjashtojmë edhe nga frazeologjia.

Kështu, shumë të ashtuquajtura lokucione gramatikore nuk janë të tilla, por janë idioma, si p.sh., *në tym, në tym e flakë, bëj ballë, të bërët ballë, ngre krye, të ngriturit krye, punë e madhe, më qafsh etj.*

Shumë të tjera janë binome (frazeologjike ose jofrazeologjike), si p.sh., *rreth e rrotull, pak a shumë, javë për javë, shtëpi më shtëpi, jo që jo, po se po etj.*

Disa të tjera janë kolokacione frazeologjike, si p.sh., *borë e bardhë, dyllë i verdhë, korb i zi etj.*

Disa të tjera janë frazeoterma, si p.sh., *lule blete, lule dimri, gjel deti etj.*

Shumë të ashtuquajtura lokucione gramatikore nuk janë frazeologjike, por lidhje të lira, si p.sh., *në pazar, në borët, me egërsi, me nxitim, më të djathtë, më së fundi, nga lart etj.*

Disa të tjera janë shprehje të përbëra gramatikore, si p.sh., *para se, tridhjetë e tre, sado që, para se, sapo që, si ...ashtu edhe, jo vetëm që ...por edhe etj.*

Shumë të tjera janë fjalë të përbëra, si p.sh., *njolla-njolla, togje-togje, shkallë-shkallë.*

Dallimet midis lokucioneve ndajfoljore dhe idiomave me vlerë ndajfoljore

Lokucionet ndajfoljore dallohen nga idiomat me vlerë ndajfoljore në disa drejtime:

Kuptimi i përbërësve me vlerë emërtuese të lokucioneve ndajfoljore është i zbehur, ndërsa në idiomat me vlerë ndajfoljore përbërësit i humbasin krejtësisht kuptimet e tyre literale dhe zhvillojnë kuptime joliterale. Kështu, *në tym* e ka humbur mëvetësinë kuptimore dhe gramatikore. Kuptimi i tij idiomatik është “*kot*” (shih Demiraj:1970; Gramatika e gjuhës shqipe 1:2002).

Lokucionet ndajfoljore nuk janë të figurshme, ndërsa idiomat me vlerë ndajfoljore kanë edhe figurshmëri edhe ekspresivitet. Kështu, idioma *në tym* nuk ka

asnjë lidhje kuptimore me tymin, por përdoret për të shënuar një gjendje tjetër, atë të kotësisë apo të mungesës së rëndësisë, dhe, për rrjedhojë, fiton figurshmëri dhe ekspresivitet në sajë të imazhit konceptor referues.

Ndryshe nga lokucionet ndajfoljore që kanë vetëm një fjalë emërtuese në përbërjen e tyre, idiomat me vlerë ndajfoljore mund të kenë në përbërjen e tyre edhe më shumë se një fjalë emërtuese, si p.sh., “*me natë*” vs “*në tym*”, “*me krahe hapur*”, “*sa të hanë qentë*” etj.

6. 6. Proverbat

Domethënia letrare e proverbave

Proverbat kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e letrarëve dhe veçanërisht të folkloristëve shqiptarë (për më shumë, shih “*Fjalë të urta të popullit shqiptar*”, (1983) të cilët janë përqendruar në përshkrimin semantik dhe etnologjik të tyre, duke nënvizuar aspektin e tyre didaktik. Në thelb, proverbat janë gjykime e vlerësime të mirëfillta situatash e shfaqjesh nga më të ndryshmet të jetës materiale e shpirtërore. Për këtë arsye ato në tërësinë e tyre përbëjnë një enciklopedi më vete të urtësisë e të filozofisë së popullit, të mendimit e të psikologjisë së tij, të ndërgjegjes së tij artistike e estetike. Me anën e tyre populli bën përgjithësime të përvojës së vet, nxjerr përfundime e shpreh mendime për aspekte, çështje e probleme, që i kanë dalë atij gjatë punës, luftës dhe jetës së vet nëpër shekuj¹⁷¹, si p.sh., *Peshku në det, tigani në zjarr. Uji lan gjithçka, veç faqen e zezë jo. Mulliri bluan me aq ujë sa ka. Kali i huaj të lëshon në ujë. Uji që nuk ecën, s’piket. Ujë fle, hasmi s’fle. Ujku mjegull do. Delen që ndahet nga tufa e ha ujku. Ujku qimen ndërron, por zakonin s’e harron. S’bëhet vreshti me urata, por me shata e me lopata. I ngopuri s’e kujton të uriturin. Uthulla e fortë prish enën e vet. Ç’ka zemra, e tregon fytyra. Larg sysh, larg zemrës. Unë them “ja ujku!”, ti kërkon gjurmët. Besë e shqiptarit – si purtekë arit. I mërguari - i dënuari. I ikuri dhe i vdekuri s’kanë hatër. Shoku shokun ta ndihmojmë, në rrezik e në nevojë. Gabimet që harrohen, përsëriten. Punën e sotme mos e lër për nesër. Çdo pësim bëhet mësim. Ku hyn dielli, nuk hyn mjeku. -Polli kau?-Polli. -Ku vete Paskali? -Ku ta shpjerë kali. Ha bukën? Mos e përmbys kupën.*

Proverbat janë studiuar nga pikëpamja funksionale dhe janë konsideruar si “një vepër e përkryer letrare e cila sjell tri funksione bazë: perceptimin, estetikën dhe edukimin”¹⁷² dhe e cila, për arsye të anonimatit, bën që proverbat të konsiderohen si pjesë e folklorit. Proverbi është përshkruar si “një fjali e shkurtër e folklorit, përgjithësisht e njohur, e cila përmban mençuri, një të vërtetë, një moral dhe pikëpamje tradicionale në formë metaforike, të qëndrueshme dhe të memorizuara dhe e cila transmetohet nga brezi në brez”¹⁷³.

¹⁷¹ A.Sh.Sh. (1983). vep. e cit.

¹⁷² Phuc, D. H. (2010, May). A study on metaphor and simile in English idioms and Vietnamese equivalents. <http://www.scribd.com/doc/32025804/A-STUDY-ON-METAPHOR-AND-SIMILE-IN-ENGLISH-IDIOMS-AND-VIETNAMESE-EQUIVALENTS-%C3%90-ng-H-ng-PhucQH1-E>.

¹⁷³ Mieder, W. (2007). Proverbs as cultural units or items of folklore. In Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) *Phraseology. An International Handbook of Contemporary Research*, Vol. 1. Berlin: de Gruyter.

Duke u krahasuar me gjinitë e tjera folklorike si me përrallat, me legjendat, me anekdotat, me gjëzat etj., proverbat “kanë formën më koncize, por jo domosdoshmërisht më të thjeshtën”¹⁷⁴. Proverbat përmbushin nevojën njerëzore për të përmbledhur përvojën dhe vëzhgimet në xhevahire të urtësisë popullore të cilat ofrojnë komente të gatshme mbi marrëdhëniet personale dhe çështjet shoqërore të cilat janë nga më të ndryshmet, madje edhe të kundërta, si p.sh., *Dielli duket që në mëngjes vs Dardha e ka bishtin prapa*.

Duke cituar një proverb, në vend që thjesht të flasim për veten tonë, ne i referohemi mençurisë së komunitetit dhe i drejtohem për ndihmë autoritetit të traditës¹⁷⁵. Proverbat llogariten si “akte të ligjëratës së zhdrejtë”¹⁷⁶. P.sh., duke përdorur proverbin *Punën e sotme mos e lër për nesër*, mund të nënkuptojmë atë që themi për punën dhe periudhën kohore, por ne përcjellim gjithashtu edhe një paralajmërim të përgjithshëm të dëgjuesi. Proverbat e figurshëm na lejojnë të jemi dyfish jo të drejtpërdrejtë, sepse kërkojnë që dëgjuesi të zbatojë skenarin proverbial në kontekstin e pranishëm si dhe të nxjerrë konkluzione të përshtatshme¹⁷⁷. Kërkimet mbi proverbat kanë treguar se ato mund të funksionojnë për të evituar angazhimin personal dhe të drejtpërdrejtë (Taylor, 1962; Arewa and Dundes, 1964; Barley, 1972).

Për rrjedhojë, proverbat mund të shprehin një këshillë, një paralajmërim apo një urdher. Pavarësisht nga forma me të cilën paraqitet, çdo proverb e ka gjithnjë synimin moral. Ata përdoren me shkathtësi e me ëndje nga populli për të shprehur ide e dëshira të ndryshme. Kur përdoren me vend, kryejnë me shkathtësi rolin e argumentit, të parabolës, të pohimit apo të mohimit tepër shprehës, duke i dhënë gjallëri, forcë, mençuri e kolorit bisedës apo ligjëritimit¹⁷⁸.

Origjina e proverbave dhe fillimet e studimit të tyre

Origjina e proverbave shkon deri në periudhat e para të njerëzimit, por njohja e tyre si shprehje gjuhësore që pasqyrojnë një ideologji të përbashkët vjen më vonë¹⁷⁹. Për sa i përket origjinës së studimit të proverbave, studimi i tyre për herë të parë i atribuohet Aristotelit (1991) në shekullin IV para Krishtit. Në gjuhën e tij (greke) proverbat u quajtën “*paroimia*” dhe u përkufizuan në kuadrin e *gnome*-ve si “thënie të sanksionuara nga përdorimi dhe me zbatim të përgjithshëm”.

Për sa u përket burimeve të prejardhjes së proverbave, ato janë të larmishme. Në fillim do të dallojmë burimet që janë të përgjithshme për të gjitha gjuhët europiane në fondin e të cilave bën pjesë edhe shqipja. Këto burime janë katër:

Burimi i parë i proverbave për të gjithë kontinentin evropian dhe përtej tij është antikiteti greko-romak mençuria proverbiale e të cilit gjeti një përhapje të gjerë gjeografike kryesisht nëpërmjet gjuhës latine dhe konkretisht nëpërmjet përkthimit të

¹⁷⁴ Mieder, W. (2007). vep. e cit.

¹⁷⁵ Norrick, N.R (2007). Proverbs as set phrases. In Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) *Phraseology. An International Handbook of Contemporary Research*, Vol. 1. Berlin: de Gruyter.

¹⁷⁶ Searle, J.R. (1975): Indirect speech acts. In: Cole, P./Morgan, J.L. (eds.), 59–82.

¹⁷⁷ Norrick, N.R (2007). vep. e cit.

¹⁷⁸ A.Sh.Sh. (1983). vep. e cit.

¹⁷⁹ Lacavalla, C. (2007). *Lexique-grammaire des proverbes en Quand/Quando*. Thèse, Università degli studi di Bari.

teksteve latine në gjuhët europiane, si p.sh., *Nuk ka tym pa zjarr* (= *Where there is smoke, there is fire* (angl.). *Il n'y a pas de fumée sans feu* (fr.). *Δεν υπάρχει καπνός χωρίς φωτιά* (gr.). *Qeni që leh nuk të ha* (= *Barking dogs do not bite* (angl.)), *Chien qui aboie ne mord pas* (fr.). *Σκύλος που γαβγίζει δεν δαγκώνει* (gr.). *Me një dallëndyshe s'vjen behari* (= *One swallow does not make a summer* (angl.)). *Une hirondelle ne fait pas le printemps* (fr.).

Burimi i dytë është Bibla nga e cila kemi shembuj të spikatur si: *Ç'ke mbjellur, do të korrësh* (= *As you sow, so you reap* (angl.)). *Ό,τι σπείρεις θα θερίσεις* (gr.). *Kush i bën gropën shokut, bie vetë brenda* (= *He who digs a pit for others, falls in himself* (angl.)). *Celui qui creuse une fosse y tombera* (fr.). *Όποιος σκάβει τον λάκκο τ' αλλουνού, πέφτει ο ίδιος μέσα* (gr.).

Burimi i tretë i proverbave të përbashkëta europiane është latinishtja mesjetare. Latinishtja mesjetare kishte statusin e lingua franca dhe, si e tillë, prodhoi proverba të reja, si p.sh., *Hekuri rrihet sa është i nxehtë* (= *Strike while the iron is hot* (angl.)). *Il faut battre le fer quand il est chaud* (fr.). *Στη βράση κολλάει το σίδερο* (gr.). *Gjithçka që shkëlqen nuk është ar.* (= *All that glitters is not gold* (angl.)). *Tout ce qui brille n'est pas or* (fr.). *Ό,τι λάμπει δεν είναι χρυσός* (gr.). *Një pikurë vlen sa një mijë fjalë* (= *picture is worth a thousand words* (angl.)). *Μια εικόνα αξίζει όσο χίλιες λέξεις* (gr.).

Burimi i katërt e përmbys lëvizjen historike të proverbave nga Europa në Shtetet e Bashkuara. Këta proverba janë përhapur që nga mesi i shekullit XX në Europë nëpërmjet medias, si p.sh., *Kur ikën macja, lozin minjtë* (= *When the cat is away, the mice will play* (angl.)). *Quand le chat n'est pas là, les souris dansent* (fr.). *Όταν λείπει η γάτα, χορεύουν τα Ποντίκια* (gr.).

Burim tjetër i rëndësishëm për proverbat e shqipës janë fabulat, anekdotat, përrallat, dhe këngët e popullit shqiptar. Kështu, proverbi *ndaç lyp, ndaç lep, pa punue kush s'të jep* lidhet me fabulën për sorrën që kërkonte të ndante me hutin gjahun e zënë prej këtij të fundit, proverbi *ha kondosh e pi kondosh* lidhet me një anekdotë për Nastradinin, anekdotë në të cilën vihet në lojë të çmuarit e njeriut nga veshja, proverbi *oxhaku le të jetë i shtrembër, por tymi të shkojë drejt*, lidhet me përrallën vajza fínokë, kurse *bir Selman i nënës ç'të të qaj më parë* është gati ai varg që pjesërisht lot rolin e refrenit në këngën “Ne plep’ i Bilishtit dy martina ranë”¹⁸⁰.

Në rastet e tjera (dhe këto përbëjnë shumicën dërrmuese) përgjithësimi i proverbave arrihet mbi bazën e analizës dhe krahasimit paraprak të shumë fakteve, mbi bazën e një përvoje të gjatë jetësore¹⁸¹, si p.sh., *Ujë fle, hasmi s'fle. I zoti e di ku i pikon çatia. Luga e madhe të shqyen gojën. Delen që ndahet nga tufa e ha ujku. Uji lan gjithçka, veç faqen e zezë jo. Frika e ruan vreshtin. I zoti e di ku i pikon çatia. Në krah të ujkut han edhe skilja.*

Siç e pamë, proverbat që zbukurojnë ligjërimin tonë kanë origjinin nga më të ndryshmet. Ashtu si tërësia e fjalorit, fondi proverbial i një gjuhe është në lëvizje të përhershme: citate apo aforizma që dikur ishin të ngulitura në vepra letrare të njohura, në një moment të caktuar të historisë së gjuhës, i janë nënshtuar procesit të proverbializimit, si p.sh., *Të jesh, apo të mos jesh*. Nga ana tjetër, proverba që dikur ishin të shpesh të harrohen dhe humbasin në të njëjtën kohë, ndoshta, me realitetin që

¹⁸⁰ A.Sh.Sh. (1983). vep. e cit.

¹⁸¹ A.Sh.Sh. (1983). vep. e cit.

i ka krijuar, si p.sh., *nuk bëhet kofini pas të vjelit*, që lidhet me aktivitetin bujqësor apo *gusht e gunë*, që lidhet me aspektin meteorologjik.

Interesimi gjuhësor për proverbat

Si në literaturën e huaj ashtu edhe në literaturën shqipe proverbat janë trajtuar deri vonë kryesisht si objekt i shkencës së paremiologjisë, për përmbajtjen e tyre të veçantë semantike, etnologjike dhe stilistike, duke lënë mënjanë ndërtimin e tyre leksikor dhe sintaksor.

Ndryshe nga ky qëndrim në thelb semantik, etnologjik dhe stilistik, Alain Rey na jep një përshkrim më të gjerë dhe më të larmishëm të botës proverbiale në hyrjen e "*Falorit të proverbave dhe të diktoneve*" (Dictionnaire de proverbes et dictons, 1989). Ai komenton aspektet e ndryshme të proverbit, jo vetëm përmbajtjen, por edhe anën formale, kur thotë se "Duke gjykuar për përmbajtjen e proverbave siç gjykohet për një mendim filozofik apo një maksimë moraliste, humbasim nga sytë natyrën e tij. Duke gjykuar mbi formën e tij, përkundrazi, zbulojmë fuqinë e tij". Për sa i përket përshkrimit formal, ai pohon se proverbi është fjali e plotë, si p.sh., *Le miel n'est pas fait pour les ânes (mjalti nuk është bërë për gomarët, lit.)*, ose eliptike, si p.sh., *À bon cheval, bon gué (kali i mirë për ujë të thellë, lit.)*, ndryshe nga lokucioni që mund të futet në përbërjen e fjalisë.

Mirella Connena (1988) na shpjegon se përse tradicionalisht studimet paremiologjike nuk janë përqendruar në aspektin sintaksor dhe leksikor të proverbave, por vetëm në aspektin semantik, etnologjik dhe stilistikor. Kjo ka ndodhur ndoshta ngaqë proverbi nuk është një objekt plotësisht dhe vetëm gjuhësor, por një objekt kulturor që pëson kufizime të shumta. Interesimi i gramatikës për normën e gjuhës dhe "të folurën e bukur" e ka bërë dukurinë proverbiale një kategori të neglizhuar dhe të marxhinalizuar me pretekstin se proverbat nuk i përkasin skemave që konsiderohen si "normale"¹⁸². Problemi është të zbulojmë nëse proverbat përbëjnë një dukuri gjuhësore dhe, për rrjedhojë, të trajtueshme nga ana sintaksore dhe leksikore, apo nëse bëhet fjalë vetëm për një mbidukuri të asimilueshme me shfaqjet folklorike të pranishme në të gjitha kulturat¹⁸³. Duheshin pritur zhvillimet e reja frazeologjike që do t'i jepnin hov edhe studimit gjuhësor të proverbit i cili gëzon shumicën e tipareve karakteristike të frazemave, si p.sh., mbartjen e kuptimit, pandryshueshmërinë strukturore, kufizimin leksikor, njësi të gatshme të memorizuara etj. Gjuhëtarët kanë mendime të kundërta nëse proverbat duhet të studiohen si kategori e frazemave apo nëse duhet të përjashtohen nga sistemi i gjuhës meqë janë njësi të pavarura të ligjërit. Megjithatë, shumica e studiuesve bien dakord se proverbat duhet të studiohen në kraht të shprehjeve të tjera frazeologjike. Për më tepër, fakti që proverbi mund të integrohet në një mënyrë apo një tjetër në një ligjëratë normale na bën të besojmë se kjo strukturë e urtësisë popullore mund të përbëjë objektin e një studimi gjuhësor frazeologjik. Studimet e fundit përqendrohen gjithnjë e më shumë te karakteristikat sintaksore dhe leksikore të proverbit. Proverbi përbën para së gjithash një fjali autonome. "Gjinia proverbiale është popullore, e lidhur me traditën, por kohët e fundit përbën gjithashtu edhe objektin e studimeve semantike,

¹⁸² Anscombe, J.C. (2006). "Les proverbes : un figement du deuxième type?". *Linx* 53.

¹⁸³ Anscombe, J.C. (2006). vep. e cit.

semiotike, stilistike dhe pragmatike”¹⁸⁴. “Proverbat sillen si shenja për sjelljen njerëzore dhe kontekstet sociale dhe si të tilla duhet të studiohen edhe nga pikëpamja strukturore edhe nga pikëpamja semiotike”¹⁸⁵. “Proverbi është fakt gjuhësor”, thekson Conenna (2002). Rritja e interesit teorik e bën të nevojshëm studimin e këtij tipi fjalësh jo si thënie të përfshira në tekste apo në kontekste, por si fjali autonome të përfshira në një kontinuum me kategoritë e tjera frazeologjike. Për rrjedhojë, “numërimi dhe përshkrimi i veçorive leksikore dhe sintaksore janë thelbësore për studimin e tyre”¹⁸⁶.

Në studimet e fillimit të shekullit XX gramaticieni Jespersen (1924) dallonte *formatat nga shprehjet e lira*. “Formula mund të jetë një fjali e plotë apo një grup fjalësh, ose mund të jetë një fjalë, ose mund të jetë vetëm një pjesë e fjalës, - kjo nuk është e rëndësishme, por duhet të jetë gjithmonë diçka e cila për instinktin e ligjërimit ekzistues është një njësi e cila nuk mund të analizohet apo të shpërbëhet më tej sipas mënyrës që mund ta bëjë lidhja e lirë”. Studimi i Jespersenit mbi sintaksën e ngurosur shtrihet gjithashtu edhe te proverbat që ai i konsideron si formula të të njëjtit nivel me shprehjet e tjera të ngurosura. Proverbi *Handsome is that handsome does* (karakterit dhe pamja janë më të rëndësishme se pamja, perifrazimi ynë), pavarësisht nga fakti se çfarëdo që ishte në kohën e krijimit të fjalisë për herë të parë, tani, praktikisht nuk është veçse një formulë siç tregohet edhe nga përdorimi i saj pa asnjë paraprijës ashtu si dhe nga rendi i fjalëve”.

Siç theksojnë edhe Burger et al. (2007) “Ndërsa në vitet ’70 diskutimi nëse duhet të propagandojmë një konceptin “të ngushtë” (me orientim strikt formal strukturalist) apo një konceptim “të gjerë” (duke përfshirë perspektivën pragmatike, sociolinguistike dhe psikolinguistike) të frazeologjisë ishte akoma i zjarrtë, sot ka një konsensus të përgjithshëm se frazeologjia përfshin një paletë shumë të gjerë dukurish dhe çështjesh gjuhësore. Po kështu, nuk mund të mohohet më se proverbat zotërojnë tipare të rëndësishme frazeologjike”.

Qëllimi i këtij studimi është t’i japim proverbit një status që i njeh veçori gjuhësore specifike: krijohet në gjuhë dhe hyn në ligjërim si njësi e gatshme frazeologjike, por kjo veçori gjuhësore është specifike, sepse proverbat gëzojnë autonomi gramatikore.

Në vijim do të paraqesim atë që kemi zbuluar në lidhje me proverbat përmes një studimi leksiko-sintaksor.

Veçori përcaktuese dhe dalluese të proverbave

Në kapitullin e mëparshëm arsyetuar se përse proverbi përbën fakt gjuhësor dhe konkluduar kështu, sepse proverbi krijohet në gjuhë dhe futet në ligjërim si njësi e gatshme.

Ajo që na intereson në këtë kapitull janë veçoritë gjuhësore të proverbave. Për këtë arsye do të paraqesim tiparet e proverbave të cilat do t’i ndajmë në dy grupe: në veçori përcaktuese dhe në veçori dalluese:

¹⁸⁴ Lacavalla, C. (2007). vep. e cit.

¹⁸⁵ Mieder, W. (2007). vep. e cit.

¹⁸⁶ Lacavalla, C. (2007). vep. e cit.

Veçoritë përcaktuese

Veçoritë përcaktuese të proverbave do t'i gjejmë në përmbajtjen dhe në strukturën e proverbsit.

Veçoria e parë përcaktuese lidhet me përmbajtjen e proverbsit dhe është autonomia semantike, apo siç e quan Schapira (1999) "autonomia referenciale", sepse çdo njësi që krijohet në gjuhë krijohet për kuptimin e saj. Proverbi është një thënie semantikisht autonome. Sipas Kleiber (2005) "Proverbat përbëjnë kategori semantike, ose, e thënë ndryshe, ata kanë një kuptim të cilin mund ta përkufizojmë".

Veçoria e dytë përcaktuese lidhet me strukturën e proverbsit, të cilën Schapira (1999) e ka quajtur "autonomi gramatikore". Bëhet fjalë për struktura frazale mbartëse të një mesazhi të përfunduar dhe të plotë, madje edhe në rastet kur forma e tyre është eliptike. Sipas Connena (2000) proverbat përbëjnë "fjali të plotë, pa pozicione të lira, ku variacionet e mundshme, statistikisht të rralla, janë shumë të kufizuara".

Këto dy veçori i përmend edhe Thomai (1999) sipas të cilit "Proverba quhen thënie të organizuara strukturalisht si fjali dhe me pohim tashmë të mbyllur, të vërtetë.....".

Veçoria e tretë përcaktuese është përgjithësimi apo karakteri i përgjithësuar i proverbsit. Proverbat përbëjnë fjali të përgjithësuar. Ata nuk janë fjali episodike, por i referohen, siç thotë Kuroda (1973) "një dukurie të përgjithshme apo të zakonshme të gjërave". Fusha e tyre nuk është ajo e dukurive specifike të individëve apo të ngjarjeve, ose ata nuk shprehin pohime mbi fakte të veçanta, por shprehin konkluzione mbi situatat e veçanta që hasen¹⁸⁷. Veçoria e përgjithësimit është shumë i rëndësishme sidomos për proverbat literalë në lidhje me justifikimin e natyrës frazeologjike të tyre, sepse konkluzioni i shprehur nga karakteri i përgjithësuar është njëfarë kuptimi i shtuar i cili i jep natyrë jokompozicionale kuptimit të proverbave literale, si p.sh., te proverbi literal *Ku hyn dielli, s'hyn mjeku*, ku kemi konkluzionin (kuptimin e shtuar) "njeriu nuk sëmuret apo nuk sëmuresh", por edhe kuptimit të proverbave të figurshëm, si p.sh., *Ujku qimen e ndërron, por zakonin s'e harron*, ku konkluzioni (kuptimi i shtuar) është "njeriu nuk ndryshon".

Duke iu referuar Schapira-s (2000), mund të konkludojmë se "Thënia e aftë për të fituar statusin përmik duhet të jetë detyrimisht fjali e përgjithësuar e cila, mbart një mesazh të mbaruar, autonom nga pikëpamja referenciale dhe gramatikore, gjë që, sigurisht, ka pasoja gjuhësore suplementare: fjalia duhet të paraqitet si një thënie anaforike e mbyllur, pa lidhje deiktike me folësin ose situatën e ligjëritimit". Kjo shpjegon se përse shprehje të përdorimit të përgjithshëm, si p.sh., *vret miza, ndaj shapin nga sheqeri etj.*, nuk janë bërë proverba: ose, sepse nuk janë të ndërtuara në mënyrë frazale dhe, për rrjedhojë nuk transmetojnë një mesazh të plotë, ose, sepse aludojnë për situata që i referohen një konteksti konkret, kështu që në të dyja rastet humbasin karakterin autonom të nevojshëm për formimin e proverbsit.

Sipas këndvështrimit dhe terminologjisë së tij, Kleiber (2000) i përmbledh tiparet përcaktuese të proverbsit në trekëndëshin sendërtim – fjali – përgjithësim, të cilat shprehin edhe konceptin tonë për proverbsin.

¹⁸⁷ Kleiber, G. (2000). Sur le sens des proverbes, Langages, 139, Larousse.

Veçori dalluese të proverbave

Për sa i përket strukturës së përgjithshme të proverbave, ata përbëhen nga të paktën dy fjalë dhe paraqiten në formën e fjalisë, ndërsa veçoritë jo përcaktuese, por dalluese që i karakterizojnë janë të shumta. Midis tyre mund të përmendim koncizitetin, anonimatit, moralizimin, autoritetin, ritmin, binaritetin, figurshmërinë, prozodinë, eliptizmin etj., shumica e të cilave janë të natyrës sintakso-stilistikore, ndryshe nga veçoritë përcaktuese të cilat janë me natyrë semantiko-gramatikore. Nga të dy llojet e veçorive ato që janë më të rëndësishme janë tiparet e natyrës semantiko-gramatikore dhe kjo është e vetëkuptueshme, sepse njësitë të gjuhës krijohen së pari për kuptimin e tyre.

Le t'i shikojmë këto tipare një nga një:

Konciziteti

Veçoria e parë dalluese, por jo përcaktuese, e proverbave është konciziteti i cili jo vetëm që shërben për t'i nxjerrë në pah proverbat, por është gjithashtu mjete i parë dhe më i rëndësishëm mnemonik që i karakterizon¹⁸⁸. Proverbat janë përgjithësisht të shkurtra dhe lakonike. Kjo ka bërë që në mjaft raste i gjithë proverbi të ndërtohet si fjali eliptike me vetëm dy fjalë, si p.sh., *Punove, fitove*, si fjali e thjeshtë, si p.sh., *Bashkimi bën fuqinë*, apo si fjali e përbërë me dy pjesë por shumë e shkurtër, si p.sh., *Kush kërkon, gjen*. Zakonisht evitohen fjalët e shprehjet lidhëse, të ndërmjetme e sqaruese të cilat jo vetëm rritin shkallën e koncizitetit, por e shprehin mendimin në mënyrë më të gjallë, më tërheqëse dhe më emocionante, më dinamike, më me kolorit, si p.sh., *I dënuari - i fituari*¹⁸⁹. Në shumë studime, konciziteti përmendet si një tipar i shpeshtë, por jo i nevojshëm. "Proverbi është përgjithësisht i shkurtër, por jo domosdoshmërisht" shkruan Whiting (1932). Mund të konkludojmë se edhe proverbat që "nuk janë shumë të shkurtër", janë të shkurtër.

Anonimati

Për sa i përket autorësisë së proverbave, proverbat paraqiten si pjesë e një thesari këshillash empirike të akumuluar në rrjedhën e kohës nga urtësia popullore. Por shpesh harrojmë se "çdo proverb, si sekuencë e ngurosur, përbën, në origjinë, një thënie të lirë, të thënë nga një folës i caktuar"¹⁹⁰. Fakti që humbasim gjurmët e origjinës nuk do të thotë se nuk ka zë origjinal. Ajo që ka ndodhur është kalimi nga një univers individual në një univers të përbashkët. Kështu, nëse unë pohoj se *Kush punon, fiton*, kjo do të thotë se e ka thënë dikush tjetër para meje dhe se është bashkësia gjuhësore që e ka konvencionalizuar përmbajtjen e thënies.

Moralizimi

Ajo që e përcakton proverbin, është funksioni i tij i jashtëm i cili, përgjithësisht, është moral dhe didaktik. Njerëzit i përdorin proverbat për t'u thënë të tjerëve se çfarë duhet të bëjnë në një situatë të dhënë ose se çfarë qëndrimi duhet të mbajnë kundrejt saj. Nëpërmjet përdorimit të proverbave folësi mban edhe qëndrim, jep edhe mësim.

¹⁸⁸ Schapira, C. (1999). Les stéréotypes en français. Proverbes et autres formules. Paris : Ophrys.

¹⁸⁹ A.Sh.Sh. (1983). vep. e cit.

¹⁹⁰ Mejri, S. (2001a). « La structuration sémantique des énoncés proverbiaux », *L'information grammaticale*, N°88, Paris.

Autoriteti

Proverbi përcjell edhe një efekt autoritativ, një “mbizë” pas të cilit folësi fshihet¹⁹¹. Mesazhi proverbial vishet me një autoritet imponues dhe, për rrjedhojë, nuk lejon kundërshtime. Në fakt proverbi përbën objektin e një konsensusi, prandaj fiton aprovimin e menjëhershëm dhe të pakushtëzuar të bashkëbiseduesit i cili, po të ishte në të njëjtën situatë ligjërimore, do të kishte përdorur të njëjtin mekanizëm¹⁹². Kështu, në lidhje me një fëmijë që ka të njëjtat të meta si i ati, thuhet *Si i ati dhe i biri*, sepse vihet re se, në përgjithësi, fëmijët bëhen gjithmonë të njëjtë me prindërit. Kur dikush ia vë dukje këto të meta, është e mundshme që fëmija bashkëbisedues të protestojë dhe të pretendojë të kundërtën. Por mjafton që në një situatë të tillë t’i thuhet fëmijës proverbi *Si i ati dhe i biri*” që pohimi të mos shkaktojë asnjë kundërshtim nga ana e fëmijës. Ky dallim reagimi përballë formulës së sanksionuar rrjedh nga fakti unanimisht i pranuar se, si frazemë, proverbi ka domethënie globale dhe nuk kërkon të riinterpretohet në secilën ngjarje të veçantë të ligjërimin. Në raste të tilla proverbat janë strategji për situatën, janë strategji me autoritet, sepse shprehin arsyetimin e shoqërisë, vlerat e saj dhe mënyrën e të bërit të gjërave¹⁹³. Autoriteti i proverbave është i tillë që nuk vihet në diskutim¹⁹⁴.

Polifonia

Proverbat janë fjali të thëna nga një folës i cili huazon një zë tjetër “për të shprehur një sekuencë ligjërimore e cila nuk i përket”¹⁹⁵. Kjo polifoni përfshin zërin e përdoruesit të proverbit i cili i mbivendoset zërit tjetër të origjinës, i njohur si anonim, dhe të cilit proverbi i detyron ekzistencën e tij. Këtë fakt e provon edhe përdorimi i treguesve mbështetës “siç thotë edhe proverbi” etj.

Ritmi

Një tipar tjetër i proverbave është prania e padiskutueshme e strukturave melodike, dmth., e ritmit i cili shërben për të shprehur një kadencë karakteristike edhe në thëniet e zhveshura nga rima, si p.sh., *Iku macja, lozin minjtë. Nga ferrë e vogël, del lepur i madh. Po s’qau fëmija, s’i jep nëna lë pijë*.

Ritmi shprehet në strukturën metrike të proverbit e cila është simetrike. Simetria nuk matet gjithmonë vetëm me numrin e njëjtë të rrokjeve, por edhe me gjatësinë e tingujve që e sjell strukturën binare në një simetri të caktuar, si p.sh., *Hëngre drekë, gatuaj darkë. Larg sysh, larg zemrës. Qeni që leh, nuk të ha. Delen që ndahet nga tufa e ha ujku. Ç’ka zemra, e tregon fytyra. Peshku në det, tigani në zjarr. Me një lule s’vjen behari*.

Ritmi lidhet edhe me natyrën vjershëruese të proverbit. Shumica e proverbave kanë pamjen e krijimeve poetike. Mund të themi se organizimi i veçantë, poetik i gjuhës është prirje e përgjithshme, parapëlqehet nga proverbat tanë. Ata kanë masë, ritëm, rimë, kadencë poetike, inversion etj. Kjo prirje lidhet me dëshirën për të rritur forcën shprehëse të proverbit, por edhe me arsye mnemonetike. Në mjaft raste nuk kemi organizim të veçantë të tij dhe proverbi del me formën e krijimeve në prozë. Në

¹⁹¹ Mejri, S. (2001a). vep. e cit.

¹⁹² Schapira, Ch. (2000). Proverbe, proverbialisation et déproverbialisation, Langages, no 139.

¹⁹³ Obelkevich, J. (1987), "Proverbs in social history", in P. Burke and R. Porter (eds.), The Social History of Language, Cambridge: Cambridge University Press.

¹⁹⁴ Schapira, Ch. (2000). vep. e cit.

¹⁹⁵ Greimas, A.J. (1960). Idiotismes, proverbes, dictons, Cahiers de lexicologie, no 2.

këto raste gjuha e proverbave është shumë e afërt me gjuhën e folur, por, sigurisht, jo identike, se, në fund të fundit, ajo disi organizohet artistikisht¹⁹⁶.

Binariteti

Proverbat karakterizohen edhe nga binariteti strukturor. Richards (2005) përmend dy lloje binariteti: binaritetin ritmik i cili stimulon memorizimin dhe binaritetin informues dhe semantik (temë+remë). Tipat kryesore të strukturës binare janë si më poshtë:

-pranëvënia e dy fjalive kryesore të përfunduara (të bashkërenditura apo asidentike), si p.sh., *Pyet shtatë a tetë dhe bëj si di vetë. Mos shpejto gjuhën, po shpejto punën. Ujku qimen ndërron, por zakonin s'e harron. Ujë të fle, hasmi s'fle.*

-pranëvënia e dy fjalive kryesore eliptike, si p.sh., *Peshku në det, tigani në zjarr. Kusia mbi prush, thëllëza në fushë. I duruari, i fituari etj.*

-pranëvënia e dy fjalive fjali të pavarura, si p.sh., *Bane kishën? Thyej edhe meshën. Ha bukën? Mos e përmbys kupën.*

-fjali e përbërë ku fjalja e varur është fjali lidhore pa ose me paraprijës në rolin e kryefjalës, si p.sh., *Kush fut duart në mjalhtë, në mos hëngërt, do lëpijë. Kush kërkon, gjen. Kush merr mendjen e botës, i sjell dëm kokës. Qesh më mirë kush qesh i fundit. Kush qe i zoti, bloi. Kush s'ka kokë, ka këmbë. Kush e nis vallen, di ta dredhë vetë.*

-fjali e përbërë ku fjalja e varur është fjali rrethore, si p.sh., *Kur të vinë mendtë, s'ti hanë as qentë. Kur ikën macja, lozin minjtë. Kur digjesh nga qulli, i fryn edhe kosit. Ku hyn dielli, nuk hyn mjeku.*

-fjali e thjeshtë, si p.sh., *Bashkimi bën fuqinë. Nuk mbahen dy kunguj nën një sjetull. Paraja çan detin. I zoti e nxjerr gomarin nga balta. Derri do plumb. Frika e ruan vreshtin etj.*

Por, duhet theksuar se shprehja sintaksore nuk është e njëjtë për të gjitha proverbat dhe se nuk do të ishte e mundur që të përfshinim të gjithë proverbat në skemat binare të mësipërme.

Struktura binare është struktura më e përgjithshme. Përveç saj, vihet re, shumë rrallë, edhe prania e strukturës katrinare (katërpjesëshe), si p.sh.:

-*Ku qe? -Asgjëkundi. -Ç'bëre? -Asgjëkafshë.*

-*Ku qe? -Në Domën. -Ç'ka prune? -Kromen.*

Ndaç lyp, ndaç lep, pa punue kush s'të jep.

Figurshmëria

Proverbat kanë dy plane të përmbajtjes: një plan të figurshëm, që i takon së tërës dhe nuk i përgjigjet kuptimit të fjalëve të veçanta dhe një plan të drejtpërdrejtë që del nga kuptimi literal i fjalëve. Për rrjedhojë, dallojmë dy lloje proverbash: proverbat e figurshme, si p.sh., *Delen që ndahet nga tufa e ha ujku. Qeni që s'di të lehë, ta sjell ujkun në vathë. Çakalli bëri kërdinë, ujkut i doli nami. Ujku qimen ndërron, por zakonin s'e harron. S'bëhet vreshti me urata, por me shata e me lopata. Uthulla e fortë prish enën e vet. Kali i huaj të lëshon në ujë. Luga e madhe të shqyen gojën dhe proverbat literale, si p.sh., *Larg syve, larg zemrës. Si i ati dhe i biri. Bashkimi bën fuqinë. Shoku shokun ta ndihmojmë, në rrezik e në nevojë. Gabimet që harrohen,**

¹⁹⁶ A.Sh.Sh. (1983). vep. e cit.

përsëriten. Punën e sotme mos e lër për nesër. Çdo pësim bëhet mësim. Ku hyn dielli, nuk hyn mjeku. Besë e shqiptarit – si purtekë arit.

Shumica e proverbave janë të figurshme dhe në shumicën e herëve nënkuptojnë një metaforë. Proverbat literale janë më të pakta. Kuptimi i tyre nxirret nga kuptimet denotative të përbërësve të tyre, por arrijnë të njihen si të tilla nga shkalla e lartë e së vërtetës së përgjithshme që shprehin. Si konkluzion mund të themi se figurshmëria paraqitet si një çështje e përdorimit të proverbit sesa si një veçori e brendshme semantike e vetë proverbave.

Rima

Një tipar tjetër dallues, por jo përcaktues i proverbave është edhe rima që karakterizon shumicën e proverbave, si p.sh., *S'pyet ariu nga miu. I përtuari – i mjeruari. Me një gur, s'bëhet mur. Puno sot, të shlodhesh mot. S'bëhet vreshti me urata, por me shata e lopata. Duaj atdhenë si shqiponja folenë. Ma mirë bari e në shtëpi, se vali në Rumeli. Liria fitohet e nuk dhurohet. Ujku qimen e ndërron, por zakonin s'e harron. Prit omar të mbijë bar, dhe e cila ndihmon në memorizimin e proverbave.*

Pakohësia (atemporalite, fr.)

Një tipar themelor i proverbave është karakteri i përgjithshëm, atemporal. Sintaktikisht shprehet me karakteristikat e mëposhtme: ose me mungesën e foljes në fjali, si p.sh., *I duruari, i fituari. Ma mirë bari e në shtëpi, se vali në Rumeli. Peshku në det, tigani në zjarr*, ose me praninë dominuese të së tashmes së dëftores, si p.sh., *S'pyet ariu nga miu. Me një gur, s'bëhet mur. S'bëhet vreshti me urata, por me shata e lopata. Ujku qimen e ndërron, por zakonin s'e harron*, ose me praninë e urdhërores apo të së ardhmes së dëftores me vlerë atemporale, si p.sh., *Punën e sotme mos e lër për nesër. Pyet shtatë a tetë dhe bëj si di vetë. Mos shpejto gjuhën, po shpejto punën., Do të qeshë më mirë ai që do të qeshë i fundit.* Kjo mungesë e veçanësisë në kohët foljore lidhet me kuptimin e përgjithshëm të proverbave.

Koha e tashme nxjerr në pah vlerën historike të së vërtetës së përhershme, ndërsa përdorimi i urdhërores dhe i së ardhmes justifikohet me shprehjen e këshillave dhe të rregullave të sjelljes.

Koha e foljes te proverbat nuk mund të ndryshojë pa sjellë ndryshime në natyrën e proverbit. Kështu në proverbin *Kur ikën macja, lozin minjtë*, mund të ndryshojmë kohën e tashme në kohë të shkuar, si p.sh., *Kur iku/kishte ikur macja, luajtën minjtë apo në kohë të ardhme, si p.sh., Kur do të ikë/ të ketë ikur macja, do të lozin minjtë*, por proverbi shpërbëhet. Thënia merr vlerën e lidhjes së lirë dhe nuk është më proverb. Ndërsa në rastin e proverbave me lidhje asidentike, nuk mund ta ndryshojmë kohën pa ndryshuar edhe strukturën e cila është model formal më karakteristik për proverbat sesa për lidhjet e lira. Kështu, proverbi *Ikën macja, lozin minjtë* përbën strukturë asidentike aq të ngurosuar saqë nuk mund t'i ndryshohet koha. Pra nuk do të mund të thoshim **Do të ikë macja, do të lozin minjtë* apo **Iku/kishte ikur macja lozën minjtë*.

Papërcaktimi vetor

Papërcaktimi vetor është një tipar tjetër i proverbave. Ajo nënkupton mosreferimin ndaj një kryefjale konkrete dhe shprehet sintaktikisht me vetën e përcaktuar nga kryefjala e shprehur (veta e tretë), apo në vetën e dytë të urdhërores, por edhe në vetën e dytë njëjës si vetë e përgjithësimi, si p.sh., *Po s'mbolle, s'korr.*

Hëngre drekë, gatuaj darkë, Kur digjesh nga qulli, i fryn edhe kosit. S'ke qe dhe kërkon parmendë, ku kryefjala e nënkuptuar është “njeriu”, apo në vetën e parë shumës si vetë e përgjithësimit, si p.sh., *Rrimë e nge s'kemi*, ku kryefjala e nënkuptuar është “njeriu”.

Në proverba nuk mund të flitet as për ndryshim të vetës, sepse ndryshimi i vetës së proverbit do të sillte ndryshimin e natyrës së proverbit, do ta shpërbente atë.

Kështu, s'mund të jetë proverb struktura *Si pati kokën, i vunë qylafin*, e gjendur në “*Fjalë të urta të popullit shqiptar*”, por e prejardhur nga proverb *Sipas kokës dhe qylafi/festja*, sepse:

-përbën rast konkret, dmth nuk ka përgjithësim, gjë që e përforcon edhe përdorimi në një kohë konkrete, e shkuara.

-nuk futet në ligjërim me vlerë fjalie, por me vlerë gjymtyre të fjalisë, sepse, që të realizohet fjalia, kërkohen edhe gjymtyrë të tjera midis të cilave rolin kryesor e luan kryefjala e cila mund të jetë e vetave të ndryshme.

-nuk ka moralizim, këshillë.

-për rrjedhje, është idiomë.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për strukturën *Mos i qit/bëj bisht punës*, e gjendur në “*Fjalë të urta të popullit shqiptar*”.

Struktura eliptike

Një tipar tjetër i shpeshtë i proverbave është edhe struktura eliptike kryesisht pa folje, si p.sh., *Pushka plot – llafi top. Një prashitje – sa dy vaditje. Më i rëndë bishti se sqepari. Martesa e nxituar – pendimi i gjatë*.

Përveç foljes, në proverba mund të mungojë edhe emri, si p.sh., *Më mirë vonë se kurrë. I mërguari - i verbuari. I përtuari – i mjeruari*.

Mungesa e foljeve apo e emrave shoqërohet edhe me mungesën e fjalëve lidhëse.

Nëpërmjet strukturës eliptike mendimi shprehet në mënyrë më të gjallë, më tërheqëse dhe emocionante, më dinamike, më me kolorit¹⁹⁷, ndërkohë që dëgjuesi duhet të mobilizojë parimet retorike për të nxjerrë konkluzione¹⁹⁸.

Në rastin kur struktura eliptike e proverbit reduktohet në dy fjalë, si p.sh., *I mërguari - i verbuari*, proverb i ka natyrë binare.

Struktura asidentike

Përveç strukturës eliptike (e cila shoqërohet edhe me mungesën e fjalëve lidhëse), ka proverba që përbëjnë vetëm struktura asidentike e cila përbën model formal më karakteristik për proverbat sesa për lidhjet e lira, si p.sh., *Ikën macja luajnë minjtë. Zure në gojë qenin, bëj gati shkopin. Zure bollën, shtypi kokën. Hëngre drekë, gatuaj darkë*. Kështu, proverb *Ikën macja, lozin minjtë* përbën një strukturë asidentike aq të ngurosuar saqë nuk mund t'i ndryshohet koha që të mund të shprehë qoftë edhe lidhje të lirë. Pra nuk do të mund të thoshnim **Do të ikë macja, do të lozin minjtë apo *Iku macja lozën minjtë*. Që të ndryshojmë kohën, do të duhet të ndryshojmë edhe strukturën, nga asidentike në strukturë me lidhëse.

¹⁹⁷ A.Sh.Sh. (1983). vep. e cit.

¹⁹⁸ Nordahl, H. (1999): Proverbes sans verbe: Petite étude syntaxico-rhétorique sur les proverbes à ellipse verbale. In: Boysen, G./Moestrup, J. (eds.): Études de linguistique et de littérature dédiées à Morten Nøjgaard. Odense.

Përsëritja

Një tjetër tipar i proverbave është edhe përsëritja e së njëjtës fjalë brenda disa proverbave, si p.sh., *Uji fle, hasmi s'fle. Qesh më mirë kush qesh i fundit. Larg sysh, larg zemrës. Ku hyn dielli, nuk hyn mjeku. Kovaçi masha bën e masha s'ka. Dyzet stane, dyzet hane. Mos shpejto gjuhën, po shpejto punën.* Përsëritja ndihmon në përqendrimin e vëmendjes në fjalë kyç dhe në theksimin e kontrastit midis pjesëve me fjalë të përsëritur. Përsëritja nxjerr më mirë në pah edhe ndërtimin binar të proverbit.

Krahasimi

Disa proverba ndërtohen mbi bazën e një krahasimi, si p.sh., *Besë e shqiptarit – si purtekë arit. Armiku në shtëpi – si gjarpri në gji etj.*

Krahasimi shtrihet kryesisht në një pjesë (pjesa e dytë), por ndodh që krahasimi të shtrihet në të dyja pjesët, si p.sh., *Si i ati dhe i biri.*

Krahasimi në proverba shpesh është pjesë e strukturës eliptike të proverbit.

Dialogu

Mjaft proverba të shqipes ndërtohen në formë dialogu, si p.sh.:

-*Palokë, të fali pasha! -Prej shokësh mos u ndasha!*

-Pse je i leckosët? -Se shërbenj të huajtë.

-Mori Mari, a të pëlqen Vata? -Si të gjykojë gjykata.

-Polli kau? -Polli.

-Mirëmëngjes! -Ziej fasule.

-Ku vete Paskali? -Ku ta shpjerë kali.

Këtë strukturë të veçantë për shprehjet e ngurosura të gjuhës e gjejmë edhe në gjuhë të tjera, si p.sh., në greqishte:

-*Τι κάνουν τα παιδιά σου κόρακα; - Όσο πάνε και μαυρίζουν. (-Ç'bëjnë fëmijët sorrë? -Nxihen gjithnjë e më shumë, lit.)*

-*Τι κάνει η μάνα του Αντώνη; -Ξηλώνει και μπαλώνει. (-Ç'bën e ëma e Andonit? -Shqep e arnon, lit.)*

Tipa fjalish

Siç kemi parë në vijim të punimit tonë, fjalia proverbiale paraqitet me një larmi të madhe strukturash gramatikore dhe konkretisht:

Si fjali e thjeshtë, si p.sh., *Bashkimi bën fuqinë. Nuk mbahen dy kunguj nën një sqetull. Paraja çan detin. I zoti e nxjerr gomarin nga balta. Derri do plumb. Frika e ruan vreshtin etj.*

Si fjali e përbërë, si p.sh., *Ujët fle, hasmi s'fle. Kur digjesh nga qulli, i fryn edhe kosit. Qesh më mirë kush qesh i fundit.*

Si dy fjali të pavarura, si p.sh., *Bane kishën? Thyej edhe meshën. Ha bukën? Mos e përmbys kupën.*

Si fjali pohore, si p.sh., *Ujët fle, hasmi s'fle. Kur digjesh nga qulli, i fryn edhe kosit. Qesh më mirë kush qesh i fundit. Peshku në det, tigani në zjarr. Frika e ruan vreshtin*

Si fjali mohore, si p.sh., *Me një lule s'vjen behari. Gjënë e keqe s'e gjen gjë. Me një gur, s'bëhet mur. Po s'qau fëmija, s'i jep nëna lë pijë. S'ka qeder shqiponja nga mushkonja. S'gjuhet me zagat lidhur. Nuk mbahen dy kunguj nën një sqetull.*

Si fjali pyetëse të cilën e gjejmë:

Në pyetje retorike, si p.sh.,

A mund t'i biesh malit me kokë?

*Ka kope pa çoban?
Është Papa katolik?
Ti usta, unë usta, po kotheret kush i ha?
Ti zot, unë zot, po gomarë kush e kullot?
Ti bos, unë bos, po lopën kush do ta kullos?
Në dialogë, si p.sh.,
-Ku vete Paskali? –Ku ta shpjerë kali.
Në dy fjali të pavarura, si p.sh.,
Bane kishën? Thyej edhe meshën.
Ha bukën? Mos e përmbys kupën.*

Fjalë dialektore

Në proverbat e shqipes vihet re edhe një shmangie nga gjuha standarde në lidhje me përbërjen e tyre leksikore, si p.sh., *Nuk bëhet kofini pas të vjelit. Fshati që duket, s’do kallauz*, të cilat janë proverba të gjuhës letrare, por në të cilat ka fjalë dialektore (*kofini dhe kallauz*). Proverbat përmbajnë fjalë dialektore për arsye të prejardhjes së tyre nga dialekte të ndryshme.

Ka gjithashtu raste ku vetë proverbi është dialektor, si p.sh., *Tregoi kufirin të të dijë timinë (Lukovë). Kurbet – ukubet (Korçë), në të cilat ka edhe fjalë dialektore (timinë dhe ukubet)*. (Shembujt janë marrë nga “Fjalë të urta të popullit shqiptar”, 1983).

Ka shumë raste ku ekzistojnë variante dialektore morfologjike të proverbove të gjuhës standarde, si p.sh., *Qan puna për të zonë (Jug). Di duar për një kokë (Kurvelesh). Ik me kamët tuaja, mos ik me kamët e huaja (Elbasan). Bane kishën? Thyej edhe meshën (Shkodër). Kush lëfton, fiton (Jug)* (Shembujt janë marrë nga “Fjalë të urta të popullit shqiptar”, 1983).

Sintaksë e çrregullt (dhe dialektore)

Në disa raste, në proverbat e shqipes vihet re edhe një shmangie kundrejt sintaksës së gjuhës, si p.sh., *Besë e shqiptarit – si purtekë arit*. S’kalohet me lepurin në barkut, të cilat në fakt përbëjnë variante dialektore të proverbove gjegjëse në gjuhën standarde. (Shembujt janë marrë nga “Fjalë të urta të popullit shqiptar”, 1983).

Natyrë frazeologjike e proverbove

Para se të flasim për natyrën frazeologjike të proverbove, do të vëmë në dukje se proverbat ndahen në dy lloje: në proverba të figurshëm kuptimi i të cilëve nuk i përgjigjet kuptimit të fjalëve të veçanta dhe në proverba literalë kuptimi i të cilëve i përgjigjet fjalëve të veçanta. Kjo ndarje paraprake do të na nevojitet gjatë sqarimit të kriterëve të ngurosjës të cilat nuk janë plotësisht të njëjtë për të dyja llojet e proverbove dhe kryesisht për proverbat literalë të cilët nuk kanë moskompozicionalitet semantik të drejtpërdrejtë.

Në lidhje me natyrën frazeologjike ose jo të proverbove, Thomai (2006) thekson se “Nuk hyjnë në frazeologjinë gjuhësore edhe proverbat ..., meqenëse këto kanë vlerë fjalie, kurse njësitë frazeologjike gjuhësore kanë vlerë fjale”, ndërsa te “*Fjalori frazeologjik frazeologjik i gjuhës shqipe*” (1999) pohon se “Përfundimisht, proverbat e disa fjalë të urta i afron me frazeologjinë gjuhësore figurshmëria dhe qëndrueshmëria e strukturës, por dallohen qartë prej saj, se kanë strukturë fjalie dhe shprehin gjykim, pra kanë edhe kuptim e funksion fjalie”. Pas këtyre qëndrimeve mund të lexojmë se, indirekt, J.Thomai e pranon natyrën frazeologjike të proverbove,

por kriteri i barasvlershmërisë me fjalën që dominonte në periudhën e studimit të frazeologjisë prej tij, e ka penguar ta përqafojë natyrën frazeologjike të proverbave.

Ne e pranojmë natyrën frazeologjike të proverbave, të cilën e shohim në disa nivele dhe për të cilën do t'u referohemi edhe kërkimeve të bëra nga autorë të ndryshëm si Conenna (1998), Kleiber (2000) etj.

Niveli i parë lidhet me kufizimin leksikor. Proverbat nuk pranojnë zëvendësimin e përbërësve të tyre me fjalë të tjera (kuazi-)sinonime:

Delen që ndahet nga tufa e ha ujku.

**Dashin që ndahet nga tufa e ha ujku.*

**Delen që ndahet nga tufa e ha çakalli.* Në këto raste proverbi shpërbëhet, sepse nuk transmetohet asnjë kuptim proverbial. Kjo është arsyeja që proverbi konsiderohet i ngurosur leksikalisht.

Ky kodifikim proverbial mund të afrohet me ngurosjen formale të fjalëve të përgjithshme të cilat, nëse modifikohen formalisht, nuk i referohen të njëjtit entitet jashtëgjuhësor¹⁹⁹. Kështu, shenja [frut], nëse transformohet në [fruth], nuk i referohet të njëjtit referent.

Niveli i dytë dhe kryesor lidhet me mbartjen e kuptimit apo me mosreferencialitetin literal i cili shfaqet me moskompozicionalitetin semantik për proverbat e figurshëm dhe me moskompozicionalitetin në nivel pragmatik për proverbat literalë. Përcaktimi i proverbave nga veçoria e përgjithësimin bën që proverbat literalë, edhe pse “semantikisht dhe sintaktikisht janë 100% kompozionale”, “të jenë jokompozionale nga pikëpamja e funksionit pragmatik”²⁰⁰, sepse, si rezultat i përgjithësimin proverbial, fitohet një kuptim i shtuar i cili është konkluzioni i shprehur nga përgjithësimi proverbial. Në këtë rast kuptimi vendoset në një nivel më të lartë se ai i shumës së domethënies të fjalëve të veçanta. Secili prej këtyre proverbave, marrë në tërësinë e tij, në fund të fundit, paraqitet si figurë më vete, p.sh., si një tablo a kuadër në llojin e vet, i jetës, së një farë skice sintetike artistike etj. Sidoqoftë, në këtë rast tërë arti i proverbit qëndron te vërtetësia dhe te drejtësia e mendimit të tij, te mprehtësia dhe saktësia e këtij mendimi. P.sh., *Shtëpia e shqiptarit – e mikut dhe e shtegtarit*, pasqyron thelbin e një ane të tërë të rëndësishme të jetës morale të popullit, mikpritjen e tij aq karakteristike tradicionale²⁰¹. Literaliteti është i dukshëm. Flitet për shtëpi shqiptare, për miq dhe për shtegtarë, por edhe për një kuptim të shtuar, atë të mikpritjes karakteristike të shqiptarit, që vjen si rezultat i përgjithësimin. Edhe në shembullin *Ku hyn dielli, s'hyn mjeku*, literaliteti është i dukshëm. Flitet për diellin që hyn dhe për mjekun që s'hyn, por edhe për një kuptim të shtuar “nuk sëmuresh”, që është rezultat i përgjithësimin. I shprehur në formë formule, kuptimi i këtij proverbi do të paraqitej kështu: prania e diellit + mosnevoja e mjekut + nuk sëmuresh(kuptim i shtuar) = shtëpia me diell të bën mirë për shëndetin. Nuk flitet për një situatë konkrete, por për një dukuri të përgjithshme. Në qoftë se strukturën *Ku hyn dielli, s'hyn mjeku* do ta përdornim për të shprehur pohime mbi fakte të veçanta, si p.sh., *Të sëmuretë mendorë bëhen shumë agresivë nën efektin e rrezeve të diellit, prandaj në të gjitha pavijonet ku hyn dielli,*

¹⁹⁹ Michaux, C. « Le proverbe : nom ou phrase? », Actes du 11 Congreso Internacional de Paremiologia (Gordoue, mai 1998), Paremia, n° 8.

²⁰⁰ Mel'čuk, I. (1998). vep. e cit.

²⁰¹ A.Sh.Sh. (1983). vep. e cit.

nuk hyn mjeku i paspecializuar (në përqsje fizike), atëherë proverbi do të shpërbëhej, sepse flitet për një situatë konkrete (*hyn dielli dhe nuk hyn mjeku*) pa kuptimin e shtuar “*nuk sëmuresh*” të proverbit. Ngurosja pragmatike përbën kushtin përcaktues për përfshirjen e këtyre strukturave të qëndrueshme shumëfjalëshe në frazeologji, sepse lidhet me kriterin e mbartjes së kuptimit për të cilin këto struktura bëhen objekt studimi të frazeologjisë.

Për rrjedhojë, në të dyja rastet proverbat nënkuptojnë më shumë nga sa thonë literalisht. Karakteri frazeologjik i proverbave literalë, qëndron te qëndrueshmëria leksiko-gramatikore dhe te përgjithësimi që bëhet burim i kuptimit të shtuar.

Niveli i tretë lidhet me ngurosjen morfologjike të elementeve të proverbave. Proverbat nuk pranojnë përdorimin e përbërësve të tyre në të gjitha trajtat e paradigmës formale:

Peshku në det, tigani në zjarr.

**Peshqit në det, tigani në zjarr.*

**Peshku në det, tiganët në zjarr.*

Niveli i katërt lidhet me ngurosjen sintaksore të strukturës së proverbave, e cila karakterizohet nga (kuazi-)pamundësia e kryerjes së transformimeve sintaksore, si p.sh: modifikimi i përbërësve, pasivizimi dhe pronominalizimi.

Ujku qimen ndërron, por zakonin s’e harron.

**Ujku i pyllit qimen ndërron, por zakonin s’e harron.*

**Ujku i rrezikshëm qimen ndërron, por zakonin s’e harron.*

Luga e madhe të shqyen gojën.

**Goja të shqyhet nga luga e madhe.*

I zoti e ngreh gomarin nga balta.

**I zoti e ngreh gomarin nga balta, por i zoti është i sëmure.* (Proverbi është shpërbërë).

Niveli i pestë, i cili është tipik për proverbin, lidhet me kohën dhe vetën e caktuar në të cilat përdoren proverbi, ndryshimi i të cilave do ta shpërbente proverbin, siç shpjeguar edhe më sipër. Kjo, plus kushteve të tjera të ngurosjes, e bën ngurosjen e proverbave të jetë “shkallë e fundit e ngurosjes”²⁰², por kjo nuk e përjashton idenë se ka shkallë të ndryshme të ngurosjes brenda proverbave. Është vënë në dukje (shih G. Gross, 1996) se ekziston një seri e tërë shkallësh ngurosjeje: ose në lidhje me kuptimin (disa proverba janë më transparente se të tjerat; kemi madje edhe proverba literale), ose në lidhje me sintaksën, sepse janë të mundshme disa operacione transformacionore.

Sipas të dhënave që disponojmë interesimi për proverbat si njësi të ngurosura (dhe si objekt i frazeologjisë) ka nisur me Jespersen (1924), dhe është rimarrë më gjerësisht nga Makkai (1972) dhe Alexander (1984) të cilët ofrojnë një ndarje të njërive shumëfjalëshe frazeologjike në dy grupe: shprehje me vlerë fjale dhe shprehje me vlerë fjalie. Proverbat bëjnë pjesë në grupin e dytë, të cilët Makkai i quan *idioma sememike (sememic idioms)*. Proverbat janë quajtur *fjali tërësisht të ngurosura (phrases entierement figees)* (M. Gross 1982), *tipa të veçanta fjalish të ngurosura (types particuliers de phrase figee)* (Conenna 1998), *formalisht dhe semantkisht të*

²⁰² Conenna, M. (2000). “Structure syntaxique des proverbes français et italiens”, en Langages, 139.

ngurosura (formellement et semantiquement figes) (Schapira 1999), *nënklasa të shprehjeve të ngurosura (sous-classes des expressions figees)* (Anscombe 2003).

Kleiber (2000) i përkufizon proverbat si “një shprehje idiomatike apo të ngurosur, dmth., si njësi shumëfjalëshe të koduar që paraqet njëkohësisht një farë ngurosje të formës dhe një farë “ngurosje” referenciale apo stabilitet semantik, e cila paraqitet me kuptim të parafabrikuar, dmth., të ngulitur me konvencion për çdo folës”.

Si kategori të veçantë frazeologjike i konsideron proverbat edhe Moon (1998) e cila i përfshin nën termin e saj ombrellë “*Shprehje të ngurosura*”, ndërsa Glaser (1998) dhe Fiedler (2007) në termin e tyre ombrellë “*Njësi frazeologjike*”, ndërsa Burger (1998) i përfshin në grupin e “*Njësi frazale*” (*propositional units*), Melcuk (1998) në grupin e *pragmatemave*, Howarth (1998b) në grupin e *shprehjeve funksionale (functional expressions)*, ndërsa Granger dhe Paquot (2008) i përfshijnë në grupin e *frazemave komunikative (communicative phrasemes)*.

Duke ndjekur këta autorë dhe në kuadrin e konceptit të gjerë për frazeologjinë, proverbat do t’i përfshijmë në sferën e frazeologjisë.

Tiparet frazeologjike të proverbave Polileksikaliteti

Proverbat ashtu si dhe shprehjet e tjera frazeologjike kanë strukturë shumëfjalëshe, por proverbat janë një prej kategorive frazeologjike struktura shumëfjalëshe e së cilave është strukturë fjalie.

Kufizimi leksikor

Proverbat karakterizohen nga kufizimi leksikor i përbërësve. Ndryshe nga lidhjet e lira në të cilat fjalët përbërëse mund të ndryshojnë sipas nevojave të bisedës, përbërësit leksikorë të proverbat paraqiten të pazëvendësueshme me fjalë të tjera (kuazi-)sinonime.

Figurshmëria

Shumica e proverbave janë të figurshme dhe në shumicën e herëve nënkuptojnë një metaforë. Proverbat literale janë më të pakta dhe kuptimi i tyre nxirret nga kuptimet denotative të përbërësve të tyre, por arrijnë të njihen si të tilla nga shkalla e lartë e së vërtetës së përgjithshme që shprehin.

Moskompozicionaliteti

Proverbat e figurshëm karakterizohen nga moskompozicionaliteti semantik, ndërsa proverbat literale nga moskompozicionaliteti nga pikëpamja e funksionit pragmatik. Përcaktimi i proverbave nga veçoria e përgjithësimi bën që proverbat literale, edhe pse “semantikisht dhe sintaktikisht janë 100% kompozicionalë”, “të jenë jokompozicionalë nga pikëpamja e funksionit pragmatik”²⁰³. Në këtë rast kuptimi vendoset në një nivel më të lartë se ai i shumës së domethënies të fjalëve të veçanta.

Kufizimi gramatikor

Proverbat karakterizohen nga kufizimi gramatikor, sepse nuk pranojnë përdorimin e përbërësve të tyre në të gjitha trajtat e paradigmës formale dhe sepse nuk

²⁰³ Mel’čuk, I. (1998). vep. e cit.

lejojnë modifikimin e përbërësve si dhe kryerjen e të gjitha transformimeve sintaksore, si p.sh., pasivizimi, pronominalizimi etj.

Vlera e fjalisë

Proverbat, përveç se kanë strukturë fjalie, kanë edhe vlerë fjalie. Ato përdoren në ligjërim me vlerë fjalie duke ruajtur autonominë frazale.

Memorizimi dhe riprodhimi si njësi e gatshme

Ashtu siç kemi theksuar edhe më lart, proverbat krijohen në gjuhë, dhe përdoren në ligjërim si njësi të gatshme të memorizuara. Memorizimi i tyre lehtësohet, në sajë të tipareve dalluese që ata kanë. Schapira (1999) thekson se tipari i konçizitetit është mjeti i parë dhe më i rëndësishëm mnemonik që karakterizon proverbat, dhe kur proverbat përmbajnë më shumë se një fjali, janë mjetet fonostilistike, si p.sh., ritmi dhe rima, dhe mjetet sintaksore, si p.sh., përsëritja, që e lehtësojmë memorizimin.

Mosprodhueshmëria

Ashtu si dhe idiomat, proverbat nuk janë produktive. Fjalët që hyjnë në përbërjen e tyre (si ato jotransparente në proverbat e figurshëm, ashtu edhe ato transparente në proverbat literalë) nuk shtrihen në krijimin e proverbave të tjera.

Përgjithësimi

Proverbat përbëjnë fjali të përgjithësuar. Ata nuk janë fjali episodike, por i referohen një dukurie të përgjithshme apo të zakonshme të gjërave. Fusha e tyre nuk është ajo e dukurive specifike të individëve apo të ngjarjeve, ose ata nuk shprehin pohime mbi fakte të veçanta, por shprehin konkluzione mbi situatat e veçanta që hasen.

Përkufizimi i proverbave

Deri para 40 vjetësh, proverbi përbente objekt të studimeve kulturore, etnologjike apo folklorike sesa të studimeve gjuhësore. Përkufizimi i proverbit u ka shkaktuar shumë kokëçarje studiuesve. Kjo ka çuar në krijimin e dy rrymave të kundërta në lidhje me përkufizimin e tij: rryma pesimiste në të cilën bëjnë pjesë Taylor (1962) et Whiting (1932). Sipas Taylor-it “Përkufizimi i proverbit është tepër i vështirë për të shlyer sipërmarrjen”, dhe rryma optimiste ithtarët e së cilës mendojnë se përkufizimi i proverbit është i mundshëm, madje i nevojshëm.

Me gjithë paralajmërimet e Taylor-it mbi pamundësinë e përkufizimit të proverbit, paremiologjistët kanë propozuar lloje të ndryshme përkufizimesh përgjatë viteve. Sipas optimistëve, ne e kemi kompetencën e proverbit. Mund të themi se “paremiografi e di intuitivisht se çfarë është proverbi”²⁰⁴.

Mieder e përshkruan proverbin si më poshtë: “Proverbi është një fjali e shkurtër e folklorit, përgjithësisht e njohur, e cila përmban urtësi, të vërtetë, një moral dhe pikëpamje tradicionale në një formë metaforike, të ngurosur dhe të memorizuar, dhe e cila transmetohet brez pas brezi”²⁰⁵

Për Fiedler (2007) “Proverbi është një fjali koncize, shumë e njohur, e cila shpreh një të vërtetë të përgjithshme, një përvojë të përbashkët, një këshillë apo një

²⁰⁴ Milner, G. M. (1969). "Quadripartite structures", *Proverbium*, 14.

²⁰⁵ Mieder, W. (1985b): Popular views of the proverb. In: *Proverbium* 2

parim moral në një formë të lehtë për t'u mbajtur mend dhe transmetohet brez pas brezi”.

Por përkufizimet e tyre janë bërë mbi bazën e tiparit letrar, dmth., të formulave të ngjeshura të urtësisë popullore si njësi të folklorit.

Proverbin si njësi të folklorit e kanë parë dhe e shohin akoma edhe sot shumë fjalorë të përgjithshëm, midis të cilëve do të veçonim:

OALD (2000) e përkufizon proverbin si “sintagmë apo fjali shumë e njohur e cila jep këshilla ose thotë diçka që është përgjithësisht e vërtetë”.

LDOCE (2003) e përkufizon proverbin si “formulë e shkurtër shumë e njohur e cila jep këshilla ose thotë diçka që është përgjithësisht e vërtetë”.

“*Fjalori i greqishtes së re standarde*” (1998) e përkufizon proverbin si “fjali popullore e cila shpreh në mënyrë lakonike një të vërtetë për jetën, një mendim që buron nga përvoja e gjatë dhe e përbashkët, zakonisht në mënyrë alegorike”.

“*Fjalori i gjuhës së re greke*” (2002) e përkufizon proverbin si “sentencë të shkurtër popullore (metrike apo në prozë) që shpreh në mënyrë alegorike apo në mënyrë tallëse një të vërtetë, që përbën produkt të një përvoje të gjatë jetësore dhe që përdoret për të dhënë një mësim apo për të komentuar një situatë”.

Larousse (1971) e përkufizon proverbin si “thënie e shkurtër që shpreh një këshillë popullore, një të vërtetë logjike ose një konstatim empirik dhe që është bërë e përdorimit të përgjithshëm”.

Nouveau Petit Robert (2000) e përkufizon proverbin si “formulë që ka tipare formale të qëndrueshme, shpesh metaforike ose të figurshme dhe që shpreh një të vërtetë nga përvoja ose një këshillë të urtësisë praktike dhe popullore, të përbashkët për çdo grup shoqëror”.

“*Fjalori i shqipes së sotme*” (1984) e përkufizon proverbin si “Fjali e shkurtër që shpreh një mendim të plotë e të figurshëm, i cili përgjithëson përvojën e shumë brezave e përmban një mësim të urtësisë popullore”.

Vetëm dyzetvjeçarin e fundit proverbat kanë gjetur vend në fushën e gjuhësisë në përgjithësi, dhe të frazeologjisë në veçanti. Në përkufizimet e tyre, studiues të ndryshëm kanë theksuar tipare të ndryshme gjuhësore të proverbave.

Kleiber (2000) i përkufizon proverbat si “një shprehje idiomatike apo të ngurosur, dmth., si njësi shumëfjalëshe të koduar që paraqet njëkohësisht një farë ngurosje të formës dhe një farë “ngurosje” referenciale apo stabilitet semantik, e cila paraqitet me kuptim të parafabrikuar, dmth., të ngulitur me konvencion për çdo folës”.

Në kuadrin e shprehjeve të ngurosura, proverbat janë emërtuar si “fjali tërësisht të ngurosura” nga M. Gross (1982), si “tipa të veçanta fjalish të ngurosura” nga Connena (1998), si “formalisht dhe semantikisht të ngurosura, binare dhe metaforike” nga Schapira (1999), si “nënklasa të shprehjeve të ngurosura” nga Anscombres (2003).

Përkufizimi që ne propozojmë për proverbin është: Lidhje shumëfjalëshe e qëndrueshme me vlerë fjalie, përgjithësisht metaforike, që shpreh një të vërtetë të përgjithshme dhe që përmban një këshillë apo mësim të urtësisë popullore në formën e një morali, kuptimi i së cilës nuk është shumë e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse apo frazemë me vlerë fjalie, përgjithësisht metaforike, që shpreh një të

vërtetë të përgjithshme dhe që përmban një këshillë apo mësim të urtësisë popullore në formën e një morali.

Statusi i dyfishtë i proverbave

Përgjatë punimit tonë treguam se para se proverbi të jetë njësi e folklorit, është njësi gjuhësore. Ai ngjizet në gjuhë, dhe, prej këtej, përdoret në ligjërim si krijim letrar. Për rrjedhojë, proverbi ka një status të dyfishtë të veçantë si fakt kulturor dhe si fakt gjuhësor. Proverbat “janë përgjithësim i njohjes dhe i shprehjes gjuhësore”²⁰⁶. Në studimin tonë ne u përqendruam në analizën gjuhësore të dukurisë proverb, por si lidhet proverbi me folklorin? Pse duhet të përbëjë edhe gjini folklorike?

Proverbat përbejnë njësi minimale të ligjërit, mendim të cilin e thekson edhe Zuluaga (1980) sipas së cilës “njësitë që ne i quajmë thënie frazeologjike funksionojnë si sekuenca autonome të ligjërit, shprehja e tyre korrespondon me njësitë e ndryshme intonative; me fjalë të tjera, ato përbëjnë njësi minimale të komunikimit”, por edhe Thomai (1999) sipas të cilit “Proverba quhen thënie të organizuara strukturalisht si fjali dhe me pohim tashmë të mbyllur, të vërtetë ku ngjan me strukturën minimale të çdo krijimi (të ligjërit)”. Duke përbërë njësi të ligjërit proverbat ngjajnë me çdo krijimtari tjetër ligjërimor, duke qenë se kanë funksion perceptues dhe edukues ato ngjajnë me çdo krijimtari tjetër letrar dhe duke qenë se karakterizohen nga anonimat i ato përfshihen në krijimtarinë folklorike.

Për arsye të statusit të dyfishtë proverbat mund dhe duhet të studiohen nga dy disiplina të veçanta: 1) nga frazeologjia për natyrën e tyre gjuhësore dhe 2) nga paremiologjia si degë e folklorit që studion proverbat për natyrën e tyre letrare.

Kundërproverbi

Kundërproverbi lidhet me devijimin proverbial i cili është përkufizuar nga Schapira (2000) si “devijim që konsiston në manipulimin e një shprehjeje të perceptuar si e ngurosur, nëpërmjet një përpunimi leksikor, semantik ose stilistikor që krijon një kuptim ligjërimor duke u nisur nga kuptimi në gjuhë të shprehjes origjinale”.

Në sajë të devijimit proverbial krijohen kundërproverbat të cilat nuk i përkasin fondit të proverbave.

Devijimi proverbial konsiston:

-në imitim të proverbave ekzistuese, dmth., në një krijim origjinal duke u nisur nga një kallëp proverbial i aftë për t’u identifikuar menjëherë si i tillë, si p.sh., *Dija vjen duke lexuar sipas oreksi vjen duke ngrënë. E ftohta do të ftohtë sipas Plumbi do plumb.*

-në deformimin, në një farë mase, të një proverbi të pranuar, si p.sh., *Të gjitha rrugët të çojnë në TEG sipas Të gjitha rrugët të çojnë në Romë. Secili për vete, mësuesi për të gjithë sipas Secili për vete Zoti për të gjithë.*

-në shtimin e elementeve të huaja fjalisë proverbiale, si p.sh., *Qeni që leh nuk të ha, por jo kur është i zgjidhur sipas Qeni që leh nuk të ha. Peshku i madh e ha të voglin, por ky këtu është shumë i shkathët dhe nuk e kap dot sipas Peshku i madh e ha të voglin.*

²⁰⁶ Vivanco, V.(2008). On the Distinction between Proverbs and Idioms. Retrieved December, 4, 2008 from http://www.Linua-jip.De/pdf/Linguaa-JIP-Research.distinction_between_proverbs_idioms.pdf.

-në përdorimin e një proverbi të figurshëm në një situatë literale e cila i shërben si mbështetje, si p.sh., duke ndier erën dhe duke parën tymin e diçkaje që digjet, mund të themi se *Nuk ka tym pa zjarr*.

Duke e sulmuar proverbin në atë që ai ka më të çmuar- autoritetin që i jep fama e së vërtetës e rikonfirmuar vazhdimisht nga përdorimi- folësi e kthen fjalinë proverbiale në ligjërim të lirë. Por këto devijime proverbiale mund të kuptohen dhe të shijohen vetëm nëse folësi dhe bashkëbiseduesi janë të familjarizuar me përmbajtjen e shprehjes origjinale.

Me përdorimin e kundërproverbave, synohet të shfrytëzohet prestigji proverbial për qëllime politike, publicitare, apo thjesht autoritative, por në përdorimin e kundërproverbave ndihet edhe dëshira për të luajtur apo për të bërë humor me shprehjen e ngurosur.

Përkthimi i proverbave

Proverbat ashtu si frazemat në përgjithësi janë tipike për gjuhë të caktuara dhe janë mbartës dhe pasqyruer të një kulture të caktuar. Për rrjedhojë, përkthimi i tyre në gjuhë të tjera është i vështirë. Kështu ndodh edhe me proverbat e shqipes, të cilët janë të vështirë për t'u përkthyer në gjuhë të tjera dhe anasjelltas. Do të dallonim tri mënyra përkthimi të proverbave:

1) Mënyra e parë e përkthimit të proverbave do të ishte me një proverb të njëjtë kuptimisht dhe leksikalisht të gjuhës tjetër, si p.sh., *Të gjitha rrugët të çojnë në Romë* = *All roads lead to Rome (angl.)* = *Tous les chemins mènent à Rome (fr.)* = *Όλοι οι δρόμοι οδηγούν στη Ρώμη (gr.)*. *Edhe muret kanë veshë* = *Walls have ears (angl.)* = *Les murs ont des oreilles (fr.)* = *Και οι τοίχοι έχουν αυτιά (gr.)*.

2) Mënyra e dytë do të ishte me një proverb me figurë të ndryshme, por me kuptim të njëjtë, si p.sh., *Gur gur bëhet mur* = *Φασούλι το φασούλι γεμίζει το σακούλι (gr.)*. *Zure në gojë qenin, bëj gati shkopin* = *Speak of the devil and he will appear (angl.)*.

3) Mënyra e tretë do të ishte me perifraksim të proverbit në rast se nuk ekziston një proverb gjegjës leksikalisht ose me figurë të ndryshme.

Dallimi midis proverbave dhe idiomave

Pas epokës vinogradoviane, shumë studiues janë të mendimit se proverbat dhe idiomat duhet të studiohen krahas krahas, sepse proverbat kanë shumë anë të përbashkëta me idiomat. Prandaj, para se të japim dallimet midis proverbave dhe idiomave së pari do të vëmë në dukje ngjashmëritë midis proverbave dhe idiomave:

1) Proverbat dhe idiomat kanë që të dy autonomi referenciale apo semantike. Ata kanë një kuptim të parafabrikuar, të ndryshëm nga shuma e kuptimeve literale të pjesëve përbërëse. Kjo do të thotë se kuptimi i tyre mund të jetë i paqartë edhe për folësit e lindur të gjuhës.

2) Proverbat dhe idiomat karakterizohen nga kufizimi leksikor i përbërësve. Ndryshe nga lidhjet e lira në të cilat fjalët përbërëse mund të ndryshojnë sipas nevojave të bisedës, përbërësit leksikorë të proverbave dhe të idiomat paraqiten të pazëvendësueshme me fjalë të tjera (kuazi-)sinonime.

3) Proverbat dhe idiomat janë që të dy shprehje të ngurosurave gjuhësore. Ata krijohen në gjuhë dhe futen në ligjërim si njësi të gatshme.

- 4) Proverbat dhe idiomat janë që të dy të ngurosur morfo-sintaktikisht.
- 5) Idiomat dhe shumica e proverbave janë të figurshme.
- 6) Proverbat lidhen me idiomat, sepse ka raste ku idiomat dalin nga proverbat, si p.sh., idioma *dru i shtrembër* ka dalë nga proverbi *një dru e shtrembër prish gjithë stivën*.

Midis proverbave dhe idiomave ka edhe shumë dallime të cilat i bëjnë këto dy kategori frazeologjike të dallueshme midis tyre:

1) Dallimi i parë lidhet me gramatikën dhe konkretisht me faktin se proverbi ka vlerë fjalië, dhe përbën thënie të pavarur, ndërsa idioma ka vlerë fjale dhe funksionon si pjesë e fjalisë.

2) Proverbat kanë një shkallë përgjithësimi shumë më të rëndësishme, ndërsa idiomat u referohen situatave të veçanta.

3) Nga pikëpamja funksionale, proverbi mund të konsiderohet si një vepër e përkryer letrare e cila sjell tri funksione bazë: perceptimin, estetikën dhe edukimin²⁰⁷. Kështu, po të shohim proverbin *Ujku qimen ndërton, por zakonin s'e harron* i cili mund të interpretohet si “*Sado që të përpiqet të ndryshojë pamjen e jashtme një njeri me vese, ai nuk i ndryshon dot veset (p.sh., të vjedhjes, të agresivitetit)*”. Kjo do të thotë se veset e njeriut nuk ndryshojnë lehtë dhe se ne nuk duhet të mashtrohemi nga ndryshimi i pamjes së jashtme të dikujt me vese.

Funksioni perceptues përcjell përvojën e jetës dhe të punës së njeriut dhe në rastin e proverbit tonë është që të ndihmojë njerëzit të njohin vështirësinë apo pamundësinë e korrigjimit të veseve.

Funksioni edukues përcjell një mësim dhe në rastin e proverbit tonë është që të këshillojë njerëzit se nuk duhet të mashtrohen nga ndryshimi i pamjes së jashtme të dikujt me vese.

Funksioni estetik lidhet me përdorimin e fjalëve egzagjeruese dhe piktoreske të cilat mund ta bindin lehtë dhe në mënyrë të këndshme lexuesin.

Ndërsa idiomat nuk bëjnë ndonjë koment, ndonjë kritikë apo të japin ndonjë mësim. Idiomat shpesh kryejnë një funksion estetik, por jo funksionin e perceptimit apo të edukimit. Meqë u mungojnë këto dy funksione i perceptimit dhe i edukimit, idiomat nuk mund të bëhen vepër letrare.

4) Mosndryshimi i kohës dhe i vetës është një tipar që i dallon proverbat nga idiomat të cilat përgjithësisht ndryshojnë në kohë dhe kryesisht në vetë.

5) Mosndryshimi i kryefjalës te proverbat. Kur folëm për mosndryshimin e vetës së foljes te proverbat, përmendëm se proverbat përdoren në një vetë të përcaktuar, sepse kryefjala e tyre është e përcaktuar (e shprehur apo e nënkuptuar) dhe nuk mund të ndryshojë, si p.sh., *Uji që nuk ecën, s'pihet. Ujë të fle, hasmi s'fle. Ujku mjegull do. S'ha ujku mish me porosi, ku kryefjalët janë të shprehura, apo, si p.sh., Ruaj dhinë, t'i pish qumështin. Po s'mbolle, s'korr*, ku kryefjala e nënkuptuar është “*njeriu*”. Kjo ndodh sepse kryefjala është pjesë përbërëse e strukturës proverbiale dhe ndryshimi i saj është si të ndryshosh një fjalë çfarëdo që kontribuon në funksionin e ri semantik të strukturës së ngurosur. Raste të tilla të pamundësisë së ndryshimit të kryefjalës gjejmë

²⁰⁷ Phuc, D. H. (2010, May). vep. e cit.

edhe te idiomat kur shprehen me njësi shumëfjalëshe me strukturë fjalie, si p.sh., *Agronit nuk ia ha qeni shkopin*.

6) Eliptizmi, dmth., mungesa e foljes apo e emrit e shoqëruar me mungesën e lidhëzës është karakteristikë e shpeshtë e proverbave, por jo e idiomave.

7) Ka edhe proverba literale, por jo idioma literale.

8) Ndryshe nga idiomat që shprehin koncepte, proverbat shprehin gjykim²⁰⁸.

Dallimi midis proverbave dhe fjalive të tjera të përgjithësuara

Proverbat bëjnë pjesë në fjalitë e përgjithësuara dhe më saktësisht në grupin e fjalive tipizuese, dmth., të atyre që paraqesin një veçori si tipike të një klase, si p.sh., *Macet janë gjitarë. Shimpazetë janë majmunë. Bora është e bardhë*.

Fjalitë e përgjithësuara të mësipërme janë fjali analitike që shprehin një të vërtetë enciklopedike që del nga njohja jonë e botës, dmth., të bazuar në funksionin e parë të gjuhës që është funksioni referencial. Për rrjedhojë, kuptimi i tyre nxirret nga shumica e përbërësve imediatë.

Ndërsa “e vërteta e proverbit është një e vërtetë gjuhësore e bazuar jo vetëm në njohjen tonë të botës, por gjithashtu dhe sidomos në ngulitjen në gjuhë të një sendërtimi që lë të nënkuptohet një kontratë semiotike konstante midis shënjesit frazal dhe përmbajtjes semantike që ai mbart”²⁰⁹. Për rrjedhojë, “interpretimi standard i një proverbi nuk jepet kurrë me kuptimin e tij kompozicional, sepse proverbi nga pikëpamja e përkufizimit është sendërtim”²¹⁰.

Edhe pse të përgjithësuara, fjalitë tipizuese nuk janë krijime gjuhësore, por fjali analitike, lidhje të lira.

Përdorimi i proverbave

Proverbat përdoren si në gjuhën e folur ashtu edhe në gjuhën e shkruar, sepse, ata vijnë në mendjen e folësit pothuajse automatikisht si njësi të parafabrikuara. Proverbat kanë një forcë retorike të rëndësishme dhe për këtë arsye përdoren në shumë lloje komunikimi, duke filluar nga ai i bisedës miqësore, i fjalimeve të fuqishme politike apo i betimeve fetare, deri te poezia lirike dhe shtypi i shkruar dhe ai elektronik. Në fakt proverbat gjenden kudo, dhe “është kudogjendja e tyre që i ka bërë studiuesit e shumë disiplinave t’i studiojnë ato që nga kohët klasike deri në epokën moderne”²¹¹.

Duke e lidhur një situatë të veçantë me një proverb, çështja e veçantë përgjithësohet brenda dukurisë së përgjithshme të jetës. Kështu, në vend që të qortonim drejtpërsëdrejti dike, sepse ka lënë në mes një aktivitet apo një punë të nisur me dëshirën e tij, do t’i bënim vërejtje në mënyrë të tërthortë duke përdorur proverbin *Po hyre në valle, do ta hedhësh deri në fund*.

²⁰⁸ Thomai, J. (1999). vep. e cit.

²⁰⁹ Mejri, S. (2001a). vep. e cit.

²¹⁰ Kleiber, G. (1989). Sur la définition du proverbe. In Gertrud Gréciano (ed.), *Europhras* 88. Strasbourg: Université des Sciences Humaines.

²¹¹ Mieder, W. (2007). vep. e cit.

6. 7. Formulatat frazeologjike të bashkëbisedimit

Përkufizimi dhe përmbajtja e formulave frazeologjike të bashkëbisedimit

Formulat frazeologjike të bashkëbisedimit, shkurt formulatat frazeologjike apo formulatat, janë frazema apo lidhje shumëfjalëshe të qëndrueshme frazeologjike që përdoren rregullisht dhe njësoj në një situatë të veçantë të komunikimit, si në përshëndetje, në përgëzime, në ftesa etj., si p.sh., *Mirë se erdhe*, një formë përshëndetjeje kur njerëzit takohen, apo *Ditën e mirë*, formë përshëndetjeje kur njerëzit ndahen, *U bëfsh njëqind vjeç. (Të rrosh) edhe njëqind (vjet)*, që thuhet në ditëlindjen e dikujt, apo *Zot i madh* si pasthirrmë që shpreh habi etj.

Ato janë quajtur me emra të ndryshëm si *shprehje të lidhura* (Fonagy, 1982 – “*enonces lies*”), *formula të situatës* (Yorio, 1980 – “*situation formulas*”), *shprehje të ligjërimin* (Alexander, 1984 – “*discoursal expressions*”), *idioma pragmatike* (Roos, 2001 – “*pragmatic idioms*”), *idioma funksionale* (Cowie et al, 1983 – “*functional idioms*”), *formula të rutinës* (Gläser, 1986a, Fiedler, 2007 – “*routine formulae*”), *idioma të aktit të ligjërimin* (Sadock 1972, Burger 1973 etj. – “*speech act idioms*”), *formula të ligjërimin* (Granger & Paquot, 2008 – “*speech act formulae*”) apo *rutina të bashkëbisedimit* (Coulmas, 1981a – “*conversational routines*”).

Frazeologjia tradicionale u ka kushtuar vëmendje të veçantë formulave frazeologjike të bashkëbisedimit të cilat përbëjnë një grup më vete, sepse e pasqyrojnë ligjërimin si ndërveprim²¹². Sipas Cowie (1988) formulatat frazeologjike të bashkëbisedimit “përbëjnë një pasqyrim të gjerë të mënyrës se si funksionojnë në ligjërim (si përshëndetje, pyetje, ftesa etj)”. Ato janë formulatat më të ngurosura të ligjërimin²¹³, janë karakteristike për ligjërimin e folur²¹⁴ dhe përdoren në lloje të ndryshme të takimeve shoqërore²¹⁵. Përveç kësaj, mund të shihen si një shprehje e komunikimit fatik²¹⁶.

Ngurosja e formulave frazeologjike të bashkëbisedimit

Para se të flasim për ngurosjen e formulave frazeologjike të bashkëbisedimit, duhet të theksojmë se, në bazë të kuptimit të figurshëm apo jo të fjalëve përbërëse, mund t’i ndajmë në formula frazeologjike literale dhe në formula frazeologjike të figurshme. Vetëm pak formula frazeologjike të bashkëbisedimit janë metaforike, si p.sh., *Punë e madhe. Më shtrifsh. Në djall (kjo punë). Si ia çon? Me fund. Të lumtë goja. Ju lumshin këmbët. Tundu vendit! Me shëndet! Më qafsh! How do you do? (angl.) Ti ëyive? (gr.)*. Shumica e formulave frazeologjike të bashkëbisedimit janë me kuptim literal dhe është pikërisht për këto të fundit që do të përpiqemi të argumentojmë se kanë natyrë frazeologjike, sepse te formulatat frazeologjike të figurshme mbartja e kuptimit është më e dukshme.

Formulat frazeologjike literale karakterizohen nga tipare frazeologjike si p.sh., kuptimi i shtuar, kufizimi leksikor, trajtat e ngurosura gramatikore dhe ngurosja prozodike.

²¹² Granger, S. & Paquot, M. (2008). vep. e cit.

²¹³ Granger, S. & Paquot, M. (2008). vep. e cit.

²¹⁴ Aijmer, K. (1996). vep. e cit.

²¹⁵ Cowie, A.P. (2001): *Speech formulae in English: problems of analysis and dictionary treatment*. In: Van der Meer, G./Ter Meulen, A. (eds.): *Making Sense: from Lexeme to Discourse*. Groningen.

²¹⁶ Fiedler, S. (2007). vep. e cit.

Kuptimi i shtuar

Formulat frazeologjike literale, ashtu si dhe formulat e tjera, janë të lidhura me një situatë të caktuar përdorimi dhe, kur “kjo situatë përsëritet, edhe sjellja gjuhësore që ka funksionuar në të shkuarën përsëritet dhe bëhet modeli i sanksionuar për pjesëtarët e komunitetit ligjërimor. Në këtë mënyrë forma gjuhësore lidhet në mënyrë asociative me një përshëndetje, falënderim apo të falur dhe përdoret automatikisht kur ndodh një lloj i caktuar situatë”²¹⁷. P.sh., një shprehje përshëndetjeje do të përzgjidhet mbi bazën e periudhës së ditës, nëse është mëngjes, drekë apo darkë.

Kuptimi referencial literal nuk zhduket, por ai shoqërohet edhe me një kuptim të shtuar i cili mund të jetë pak a shumë mbizotërues. Asociimi i formulave frazeologjike literale me një situatë të caktuar përdorimi bën që formulat, edhe pse “semantikisht dhe sintaktikisht janë 100% kompozicionale”, “ato janë jekompozicionale nga pikëpamja e funksionit pragmatik”²¹⁸.

Kështu struktura *Edhe njëqind!* e përdorur në një vizitë në shtëpinë e një miku që ka ditëlindjen lidhet në mënyrë asociative me modelin e sanksionuar të urimit dhe merr kuptimin e shtuar të urimit.

Por e njëjta strukturë mund të gjendet edhe në dialogun e mëposhtëm midis dy arkitektëve:

-*Sa vjet mendoni të rezistojë akoma kjo urë?*

-*Edhe njëqind.*

Në këtë rast struktura *edhe njëqind* nuk lidhet në mënyrë asociative me modelin e sanksionuar të urimit, nuk është më urim. Kjo shoqërohet edhe me ndryshimin e vlerës së strukturës nga vlerë fjalie që ka formula në vlerë gjymtyre që ka lidhja e lirë.

Kufizimi leksikor

Përveç mbartjes së kuptimit, ajo që i bën këto shprehje të quhen frazeologjike është kufizimi leksikor dhe kufizimi gramatikor.

Për të justifikuar kufizimin leksikor të formulave frazeologjike literale, do të analizojmë formulën e mirënjohur të përshëndetjes *Natën e mirë*.

Kështu, themi: *natën e mirë*, por jo **natën e mbarë* apo **natën e shkëlqyer* si formula sinonime, apo **natën e keqe* si formulë antonime. Po kështu edhe për *rrugë të mbarë*, nuk mund të themi **rrugë të mirë* apo **rrugë të shkëlqyer* si formula sinonime, apo **rrugë të keqe* si formulë antonime. Po kështu, themi: *me fund!* por jo të kundërtën **pa fund*, sepse nuk ekziston asnjë kuptim i kundërt me vlerë formule, as **me fillim*, sepse përsëri nuk ekziston asnjë kuptim të kundërt me vlerë formule.

Kufizimi morfo-sintaksor

Edhe për të justifikuar kufizimin sintaksor të formulave frazeologjike literale, do të analizojmë formula të mirënjohura si *Natën e mirë! Mirë se erdhe!*

Po të tentonim t'i modifikonim këto formula, kuptimi i formulës do të prishej dhe do të kalonim në lidhje të lira. Kështu, në qoftë se modifikojmë formulën *Natën e mirë!* në **Natën shumë të mirë!*, formulën *Mirë se erdhe!* në **Shumë mirë se erdhe!*, kuptimi i formulës prishet. Ndërsa po të zëvendësojmë lidhëzën *se* me sinonimin e saj që përfitojmë një kuptim krejtësisht të ndryshëm: *mirë që erdhe* (p.sh., *sepse fëmijën*

²¹⁷ Aijmer, K. (1996). vep. e cit.

²¹⁸ Mel'čuk, I. (1998). vep. e cit.

nuk e zinte gjumi pa ty). Kuptimi i formulës *edhe njëqind (vjet)* kur bëhet përbërës i një ndërtimi më të gjerë, si p.sh., *edhe njëqind (vjet)* të tjera mund të jetojmë me këto të mira që kemi sot. Kjo shoqërohet edhe me ndryshimin e vlerës së strukturës nga vlerë fjalie që ka formula në vlerë gjymtyre që ka lidhja e lirë.

Në lidhje me kufizimin morfologjik mund të themi se, për formulën *Natën e mirë!* nuk mund të ndryshojmë trajtat dhe të themi **Nata e mirë!* Kufizimi morfologjik është karakteristikë e veçantë për shqipen si gjuhë flektive, formë e cila na largon menjëherë nga formula dhe na çon te kuptimi referencial literal i lidhjes së lirë.

Kufizimi prozodik i formulave frazeologjike kundrejt lidhjeve të lira korresponduese

Jespersen²¹⁹ ka tërhequr vëmendjen edhe mbi ngurosjen prozodike të formulave. Duke folur për formulën e anglishtes “*How do you do?*” (*Si je?*) ai thotë se në të “...çdo gjë është e ngurosur: ne nuk mund të ndryshojmë as theksin ose të bëjmë ndonjë pauzë midis së tërës ...”. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për formulat e shqipes. Prozodi e ngurosur do të thotë se theksi nuk mund të zhvendoset nga pozicioni i tij normal në ndonjë element tjetër të formulës dhe se nuk mund të bëhet pauzë midis elementeve të formulës, përndryshe do të kishim kuptimin e thjeshtë referencial të lidhjes së lirë, si p.sh., në: “*Ne do të presim edhe njëqind vjet po të jetë nevoja për të gjetur një prijës si ai*” ku theksohet lidhëza “*edhe*”. Edhe intonacioni është gjithnjë i fiksuar, përgjithësisht ngritës. Ndryshimi i një strukture nga formulë në lidhje të lirë shoqërohet edhe me ndryshimin e intonacionit, si p.sh., *Si në shtëpinë tënde!* vs *Asgjëkund nuk mund të ndihesh rehat si në shtëpinë tënde*, apo *Në dasmë!* vs *Kishte ardhur në dasmë i paftuar*. Kjo shoqërohet edhe me ndryshimin e vlerës së strukturës nga vlerë fjalie që ka formula në vlerë gjymtyre që ka lidhja e lirë.

Llojet e formulave frazeologjike të bashkëbisedimit

Gjuhëtarë të ndryshëm përfshijnë grupe apo lloje të ndryshme formulash në formulat e tyre frazeologjike.

Kështu, sipas Aijmer²²⁰, “Rutinat e bashkëbisedimit apo shprehjet e ligjërimit përfshijnë një larmi sintagmash të cilat janë të shpeshta në gjuhën e folur, si p.sh., sharje (*bloody hell*), pasthirrma (*oh dear*), përshëndetje (*good morning*), përgjigje të sjellshme (*thank you, I am sorry*), formula të organizimit të ligjërimit të llojeve të ndryshme (*frankly speaking, to be brief*) dhe “biseda të vogla” (*what a nice day*)”.

“Idiomat pragmatike” të Roos²²¹ mund të ndahen në:

1) Formula shoqërore, dmth., shprehje që kryejnë funksione fatike në komunikim (e.g. *How are you? You are welcome*)

2) “Gambit” (vërejtje hyrëse), dmth., shprehje që përdoren për të strukturuar ligjërimitin (e.g. *It was nice talking to you. Believe it or not*)

3) Formula ekspresive (e.g. *Dear me. What the hell*).

“Formulat e rutinës” të Glasser²²² midis të tjerave përfshijnë formula përshëndetjeje dhe ndarjeje (e.g. *How do you do? Take care*), formula përgëzimi dhe

²¹⁹ Jespersen, O. (1968 [1924]). *The philosophy of grammar*. London : George Allen & Unwin.

²²⁰ Aijmer, K. (1996). vep. e cit.

²²¹ Roos, E. (2001). *Idiom und Idiomatik: Ein sprachliches Phänomen im Lichte der kognitiven Linguistik und Gestalttheorie*. Aachen.

ngushëllimi (e.g. *Merry Christmas. May I express my sympathy*), formula pyetjeje (e.g. *May I ask who is callin?/ Who come?*), formula të të falurit (e.g. *Excuse me. No hard feelings*), formula inkurajimi (e.g. *Never mind. Keep smiling*), formula përgjigjeje (e.g. *You're welcome. Touch wood*), formula paralajmërimi (e.g. *Wet paint. Beware of dog!*), dhe formula retorike (e.g. *so to speak, to the best of my knowledge*).

Në klasifikimin tonë do të kufizohemi në formulat frazeologjike që e kanë më të theksuar ndërveprimin dhe do të dallojmë si lloje kryesore:

Formulat frazeologjike të përhëndetjes: takim-ndarje, si p.sh., *Si ia çon? Mbrëmja e mirë! Mirë se erdhe! Mirë se vjen! Mirë se rri! Mirë se të gjeta! Mirë ardhsh! Mirë mbetsh! Mbetsh me shëndet! Qofsh mirë! Natën e mirë! Ditën e mirë! Të lumshin këmbët! A je burrë! Drekën e mirë! Mirë të gjetsha!*

Formulat frazeologjike të përgëzimit dhe ngushëllimit, si p.sh., *Të lumshin duart! Për hajër! Për të mira! Me shëndet (xhaketën, pantallonat etj)! Në kokën tuaj! U bëfsh njëqind vjeç! Edhe njëqind (vjet)! Të lumtë goja! Edhe në kokën tënde (edhe në kryet tënd)! Edhe në dasmën tënde! Në gëzime! I mbajtsh me shëndet! (Ju ardhshim) për të mirë.*

Formulat frazeologjike të falënderimit, si p.sh., *T'u bëftë dita një mijë! Ta paça borxh! Ta paça hua! Qofsh me ymër. Qofsh me jetë. T'u bëftë dita një mijë!*

Formulat frazeologjike të ftesës, si p.sh., *Mirë se erdhe! Si në shtëpinë tënde!*

Formulat frazeologjike të lejes, si p.sh., *Me leje? Më falni?*

-formulat frazeologjike të lutjes, si p.sh., *Më shtrifsh! Më qafsh! Zoti na ruajtë! Mos e dhëntë Zoti!*

Formulat frazeologjike të sharjes, si p.sh., *Vafsh në djall! Në djall (kjo punë)! Ta marrë dreqi!*

Formulat frazeologjike të qortimit, si p.sh., *Mirë të të bëhet! Vrafsh veten!*

Formulat frazeologjike të betimit, si p.sh., *Për kokën e! Qafsha nënën (babanë)! Më plaçin sytë! Për shpirt të nënës! Për këtë zjarr! Më vraftë buka! Për atë zot!*

Formulat frazeologjike të dollisë, si p.sh., *Me fund! Të paça! Të kam gjetur me dolli! Të kam gjetur me dy dolli!*

Formulat frazeologjike të përgjigjes, si p.sh., *S'ka përse! S'ka gjë! Punë e madhe! S'prish punë! Tundu vendit! Më vjen keq (=jo)!*

Formulat frazeologjike pashtrimore, si p.sh., *O Zot! O Perëndi! Zot i madh! O burra! Mon Dieu! (fr.) My Good! (angl.) Χριστέ μου! (gr.)*

Formulat frazeologjike pjesëzore, si p.sh., si udhëron.

Ka dhe shumë **urime dhe mallkime** për situata më të veçanta, si p.sh., *Në kokën tuaj! U bëfsh njëqind vjeç! Edhe njëqind (vjet)! Edhe në kokën tënde (edhe në kryet tënd)! Edhe në dasmën tënde! Në gëzime! Ju bëftë mirë! T'u bëftë gjak e dhjamë! Punë të mbarë! Me krahë të lehta! Fat të mbarë! Gjumë të ëmbël! Rrugë të mbarë! Të vafte mbarë! Qofsh me jetë! Me jetë të gjatë! Pastë këmbën e mbarë! Mos ia pafsha bojën! Me zemër të bardhë! Me faqe të bardhë! Me këmbë të lehta! Ju lumshin*

²²² Gläser, R. (1986a). *Phraseologie der englische Sprache*. Tübingen : Max Niemeyer.

këmbët! Të lumshin krahët! Iu thafshin krahët! Punë e mbarë! Myshk e sheqer! I rëntë flama! Mos ia pafsha bojën! I rëntë pika (një pikë)!

Delimitimi i formulave frazeologjike të bashkëbisedimit dhe veçimi i tyre si grup më vete

Jo të gjitha llojet e formulave janë frazeologjike. Të tilla janë formulat e mbishkrimeve, si p.sh., *Rrezik zjarri! Ndalohet kalimi! Ndalohet duhani! Defense de fumer (fr.) No smoking (angl.) etj.*, formulat e përdorura në rite të ndryshme (si p.sh., fetare) apo në dokumente të ndryshme (p.sh., juridike), etj. Këto formula karakterizohen kryesisht nga përmbajtja e tyre informuese, ndryshe nga formulat frazeologjike të bashkëbisedimit të cilat përdoren në takimet shoqërore dhe karakterizohen kryesisht nga funksioni i tyre fatik.

Formulat e mbishkrimeve, të riteve të ndryshme etj. nuk kanë natyrë frazeologjike, sepse nuk paraqesin mbartje kuptimore, por përdoren në kuptimet e tyre literale, ndryshe nga formulat frazeologjike të bashkëbisedimit që kanë kuptim të mbartur të lidhjeve të lira homonimike, si p.sh., *Edhe njëqind vjet! vs Na duhen edhe njëqind vjet të tjera për të pyllëzuar këto male.*

As formulat e bashkëbisedimit nuk janë të gjitha me natyrë frazeologjike, si p.sh., *Të lutem! Të faleminderit! Qofsh i mbarë. Qofsh me shokë. Mos mbetsh i vetëm. Të rroni vetë! Të pastë lënë bekimin! etj.*, sepse nuk paraqesin mbartje kuptimore, por përdoren në kuptimet e tyre literale.

Formulat frazeologjike të bashkëbisedimit kanë gjithashtu edhe shkallën më të lartë të ngulosjes leksiko-gramatikore, dmth., përmbajnë tipare të mjaftueshme frazeologjike për t'i përfshirë në frazeologji si kategori më vete.

Meqë bashkëbisedimi është dukuri e përditshme e ligjëritimit, formulat frazeologjike të bashkëbisedimit janë edhe më të shpeshta dhe, duke u përdorur shumë shpesh, ato hasen më shpesh si formula sesa si lidhje të lira.

Për sa i përket strukturës së tyre, formulat frazeologjike të bashkëbisedimit përbëhen nga shumë fjalë, si p.sh., *Natën e mirë! Ditën e mirë! Mirë se erdhe! Me shëndet...!, Si në shtëpinë tuaj! Të lumshin duart! etj.*, ndryshe nga formulat e tjera të bashkëbisedimit që përbëhen nga një fjalë e vetme, e parme apo e prejardhur, si p.sh., *alo, gëzuar, mirëdita, faleminderit.* Në të dyja rastet, dmth., si formulat shumëfjalëshe të bashkëbisedimit, ashtu edhe ato njëfjalëshe të bashkëbisedimit kanë strukturë dhe vlerë fjalie, por, për arsye të strukturës shumëfjalëshe do të përjashtojmë nga studimi ynë formulat njëfjalëshe.

Këtu është momenti për të përmendur se shumica e formulave frazeologjike të bashkëbisedimit janë eliptike dhe në këtë variant ato përdoren më shumë se në variantin e fjalisë së plotë, por mbeten me vlerë fjalie, si p.sh., *natën e mirë vs ju uroj natën e mirë, ose ju uroj një natë të mirë.*

Tiparet frazeologjike të formulave frazeologjike

Tiparet frazeologjike të formulave frazeologjike të bashkëbisedimit në mënyrë të përmbledhur janë:

- Polileksikaliteti
- Kufizimi leksikor
- Kufizimi situacionor

Moskompozicionaliti pragmatik
Kufizimi morfo-sintaksor
Ngurosjë prozodike
Vlerë fjalie
Memorizimi dhe riprodhimi njësi të gatshme
Figurshmëria për një pjesë të tyre dhe moskompozicionaliteti semantik i tyre

6. 8. Kolokacionet e kufizuara frazeologjike

Historiku i termit kolokacion

Studimi i kolokacioneve mund të shkojë deri te vepra e H. E. Palmer dhe e A. S. Hornby në Japoni në vitet 1930 “*Second Interim Report on English Collocations*”. Cowie & Howarth (1996) mendojnë se Palmer-it dhe Hornby-it duhet t’u atribuohet e drejta se ishin të parët që përdorën kolokacionet në një kuptim të përafërt me atë që përdoret sot. Palmer (1933, i cituar te Cowie 1998) e përkufizon kombinimin prej dy fjalësh si “një kolokacion” i cili “është një varg prej dy ose më shumë fjalësh që duhet të mësohet si një e tërë integrale dhe jo e nxjerrë nga pjesët përbërëse”.

Megjithatë, në përgjithësi është pranuar se fjala *kolokacion* si term teknik për herë të parë është përdorur nga John Rubert Firth (1951) në artikullin e tij “*Modes of meaning*” për të emërtuar dukurinë e elementeve leksikore që zakonisht bashkëgjenden pranë njëri-tjetrit. Firth e shikon kolokacionin si përcaktues të kuptimit dhe termi përdoret si një nga nivelet e kuptimit. Ai dallon “kuptimet nëpërmjet kolokacionit” nga “trajtimi konceptor ose ideor i kuptimit të fjalëve” dhe nga “kuptimi kontekstual”. Përkufizimi i Firth-it se “Kolokacioni i një fjale apo i një “pjesë” nuk duhet parë si një pranëvënie e thjeshtë, por bëhet fjalë për një tërheje reciproke” tregon se elementet përbërëse të kolokacionit presin apo tërheqin njëri-tjetrin reciprokisht. Edhe pse ky kriter zbatohet për kolokacione interesante si *dogs bark*” (*qentë lehin*) dhe *sound asleep*” (*lit. gjumë i shëndoshë, për gjumë i thellë*), ai zbatohet edhe për kombinime , si p.sh., “*eat apple*” (*ha mollë*), të cilat ndodh që të bashkëgjenden në të njëjtin kontekst shumë shpesh.

Idetë e tij mbi lidhjet midis fjalëve dhe gramatikës kanë frymëzuar shumë gjuhëtarë midis të cilëve janë edhe John Sinclair, Michael Holliday etj. Sinclair (1991) nuk adopton ndonjë përkufizim kryekëput të ndryshëm për nocionin e kolokacionit, por insiston në kriterin e tipit statistikor. Halliday (1994), nëpërmjet një qasjeje funksionale, interesohet për strukturat e gjuhës. Ai studion se si afinitet leksikore, kolokacionet, marrin pjesë në kohezionin tekstual. Howarth (1996) konstaton se “Leksikologët neofirthianë janë intersuar së pari, jo për të klasifikuar tipat e kolokacioneve, por për dukurinë e kolokacionit në vetvete dhe për atë që ai sjell në kuptimin gjuhësor si një e tërë”. Ky qëndrim mbështetet në kritere statistikore të trashëguara nga një konceptim kontekstualist i kuptimit tek i cili kolokacionet marrin pjesë nëpërmjet funksionit koheziv që sigurojnë në gji të teksteve. Meqë klasifikimi përbën një prioritet në axhendën e studimeve frazeologjike, analistët i janë kthyer frazeologjisë ruse interesimi kryesor i së cilës është “vendosja e kritereve për përshkrimin e saktë të njësisive frazeologjike dhe të shkallëve të ndryshme të

ngurosjes”²²³, kështu që përkufizimi statistikor i kolokacioneve nuk e përjashton mundësinë e një klasifikimi mbi kriteret semantike, siç është tipologjia semantike e Cowie-t (1998), e cila ndan kolokacionet e hapura nga kolokacionet e kufizuara. Kategoria e parë përfshin bashkimet e fjalëve ku të dy përbërësit ruajnë kuptimin e tyre literal dhe lidhja e të cilëve është mjaft e lirë sa duket e pakufizuar, si p.sh., *shkruaj/ marr/ dërgoj një letër*. Kategoria e dytë përfshin bashkimet e fjalëve ku një nga përbërësit ruan kuptimin literal, ndërsa tjetri ka një kuptim të figurshëm. Në këtë rast, kuptimi i fjalës A i kufizon mundësitë kombinuere të elementit B, si p.sh., *plumb i rëndë, mjaltë i ëmbël, akull i ftohtë, pendë i lehtë, duar thatë, gjumë i rëndë, grua e rëndë, thyej rekordin, pres rrogën, pres ditën e punës, pres ditën e dasmës, kaloj klasën, ra linja, ra sahati, mori dita/nata, marr rrugën, marr trenin/ autobusin/ avionin, korr fitore/ suksese, shuaj etjen/ urinë, marr provimin/ klasën/ shkollën etj.*

Historiku i konceptit kolokacion

Duhet bërë dallimi midis historisë së konceptit të kolokacionit dhe historisë së termit kolokacion. Koncepti i kolokacionit, i përshkruar provizorisht si bashkëgjendje leksikore e privilegjuar e dy elementeve gjuhësorë, shkon deri te Charles Bally (1909) i cili kishte vënë re ekzistencën e kolokacioneve në veprën e tij “*Traité de stylistique française*”. Bally i cilëson kolokacionet si “*grupime të zakonshme*” (*groupements usuels*) apo “*seri frazeologjike*” (*series phraseologiques*). Kemi një grupim të zakonshëm apo një seri frazeologjike kur elementet e grupit ruajnë autonominë e tyre, duke lënë të shfaqet një afinitet i dukshëm i cili i afron në mënyrë të tillë që tërësia paraqet konture të qarta dhe jep përshtypjen e grupimit “*tashmë të hasur*” (*déjà-vu*), si p.sh., *grièvement blessé (i plagosur rëndë), gravement malade (i sëmurë rëndë), désirer ardemment (dëshiroj me entuziazëm), aimer éperdument (dashuroj marrëzisht), intimement lié (i lidhur intimisht), refuser catégoriquement (refuzoj kategorimatikisht)*. Bally arriti në këtë konceptim nëpërmjet mësimdhënies së frëngjishtes si gjuhë e huaj.

Disa specialistë konsiderojnë si pararendës të konceptit të kolokacionit gjermanistin Porzig (1934) i cili, në veprën e tij “*Wesenhafte Bedeutungsbeziehungen*”⁶³, trajton lidhjet sintagmatike nga pikëpamja semantike dhe flet për “*lidhje semantike të brendshme*” (*inherent semantic relation*) ose Coseriu (1967), i cili, duke u nisur nga artikulli i Porzig-ut, krijoi termin “*solidaritete leksikore*” (*solidarites lexicales*) për të folur për implikimet sintagmatike midis fjalëve.

Autorë të tjerë kanë ofruar emërtime të ndryshme në literaturën gjuhësore për termin kolokacion. Kështu, Vinogradov (1947) i quan kolokacionet “*kombinime frazeologjike*” (*frazeologičeskie sočetanija*), Amosova (1963) “*frazema*”, J.Thomai (1981) “*Njësi frazeologjike më të motivueshme*”, ndërsa Mel’čuk (1998), përveç termit kolokacion, përdor edhe termin “*gjysmë-frazemë*” (*semiphraseme*), apo Cowie (1994) i cili, përveç termit kolokacion, përdor edhe termin “*lidhje të orientuara*”

²²³ Howarth, P.A. (1996): *Phraseology in English Academic Writing. Some implications for language learning and dictionary making*. Tübingen.

(*orientated relations*). Meqë termi kolokacion është më i përhapur, ne do ta parapëlqejmë kundrejt termave të tjerë.

Etimologjia e termit kolokacion dhe llojet e kolokacioneve

Etimologjikisht, termi kolokacion vjen nga fjala latine *collocate-us*, pjesore e *collocāre*, që do të thotë “*vendos krah për krah*” dhe që e ka prejardhjen nga *col-* (*con-*) “*bashkë*” + *locāre* “*vendos*”.

Trajtimi i parë i kolokacioneve lidhet me pikëpamjen e Firth-it se elementet përbërëse të kolokacioneve tërheqin njëri-tjetrin reciprokisht. Ai është një trajtim sasior dhe rrjedh nga përshkrimi statistikor i korpusit gjuhësor. Ai tregon shfaqjen ose të shpeshtë, ose statistikisht domethënëse (duke mbajtur parasysh shpeshtësinë e ponderuar)²²⁴ të dy njësive leksikore të dhëna në një kontekst pak a shumë të ngushtë. Ky kuptim përfaqësohet nga Halliday, Sinclair etj. Halliday (1994) i shikon si një lidhje të bashkëgjendjes lineare midis elementeve leksikore të cilat gjenden bashkë. Sipas Sinclair (1991), kolokacionet janë gjendja e dy ose më shumë fjalëve brenda një hapësire të shkurtër të njëra-tjetrës në një tekst.

Trajtimi i dytë i kolokacioneve, në thelb cilësor, mund të përkufizohet si “*bashkëgjendje leksikore e kufizuar*”. Siç e shpjegon Steinlin (2003), interesi që gjejmë në këtë tip bashkëgjendjeje lidhet më shumë me detyrimin që ushtrohet në përdorimin e leksikut sesa me shpeshtësinë e tyre, sepse bëhet fjalë për njohje leksikore, të një veçorie të leksikut. Ky trajtim përqafohet nga Vinogradov, Amosova, Hausmann, Mel’čuk etj. Sipas Hausmann (1984), kombinimet binare të fjalëve përbëhen nga fjalë me aftësi kombinuere të kufizuar dhe përbëhen nga një bazë që është e pavarur semantikisht dhe nga një kolokativ që ka nevojë për bazën për të marrë kuptimin e tij të plotë, si p.sh., *ravaler sa colere* (lit. *kapërdij inatin*).

Të dy trajtimet kanë një kuptim të ndryshëm për konceptin e kolokacionit. Trajtimi i parë konsiderohet “i gjerë” dhe mbështetet në kriteret statistikore, ndërsa trajtimi i dytë karakterizohet si “i ngushtë” dhe mbështetet në kriteret semantike.

Por, shpeshtësia nuk mund të përbëjë kriterin karakterizues të kolokacioneve, sepse ndodh që një kolokacion të jetë i disponueshëm pa qenë i shpeshtë në përdorim. Nga ana tjetër, një lidhje e lirë mund të jetë shumë e shpeshtë për shkak të realiteti jashtëgjuhësor, si p.sh., *blej bukë*.

Klasifikimit të gjerë - të ngushtë të kolokacioneve, do t’i shtojmë dallimin e bazuar në tipologjinë semantike të Cowie-t (1998), e cila dallon kolokacionet e hapura nga kolokacionet e kufizuara. Grupi i kolokacioneve të kufizuara të tipologjisë semantike të Cowie-t përputhet me grupin e ngushtë të kolokacioneve të klasifikimit të gjerë - të ngushtë, ndërsa kolokacionet e hapura të Cowie-t nuk përputhen plotësisht me kolokacionet e trajtimit të gjerë, sepse në kolokacionet e hapura bëjnë pjesë ato kolokacione të trajtimit të gjerë që kanë tërheqje reciproke, por edhe të tjera që nuk janë të shpeshta, por që kanë tërheqje reciproke, si p.sh., *ndez/ i fryj/ shuaj qiririn vs hap/ shfrytëzoj/ mbyll një gurore*.

Megjithatë, që prej disa vitesh, në bashkësinë e leksikologëve dhe të leksikografëve, duket se kolokacionet e kufizuara të Cowie-t parapëlqehen në shkallë

²²⁴ Blumenthal, P. & Hausmann, F. J. (2006). Présentation. In Peter Blumenthal & Franz J. Hausmann (eds.), *Langue française : collocations, corpus, dictionnaires* 150.

të gjerë²²⁵. Përkufizimi i këtyre kolokacioneve e ka burimin në studimet teorike në leksikologji (Cruse, 1986) dhe në leksikografi (Hausmann, 1989). Koncepti kryesor në këtë trajtim është funksioni leksikor, një lidhje semantike e privilegjuar midis dy elementeve leksikore në të cilën një element ruan kuptimin e tij kryesor, ndërsa tjetri ka një kuptim të figurshëm me përdorim të kufizuar.

Përkufizime të llojeve të ndryshme të kolokacioneve

Termi kolokacion përdoret nga autorë të ndryshëm ose i specifikuar si “kolokacion i hapur” vs “kolokacion i kufizuar”, dmth i shoqëruar me termat specifikues “i hapur” dhe “i kufizuar”, ose i paspecifikuar, thjesht si kolokacion që nënkupton të gjitha kolokacionet. Por, edhe kur përdoret si i paspecifikuar, thjesht si kolokacion, ai mund të nënkuptojë ose kolokacionet e hapura ose kolokacionet e kufizuara, në varësi të konceptit të autorëve të ndryshëm për kolokacionet si afinitete leksikore.

Disa autorë e përdorin termin kolokacion për të nënkuptuar kolokacionet në kuptimin statistikor apo në kuptimin e gjerë (kolokacionet e hapura):

Firth (1951) i ka përkufizuar kolokacionet si shoqëria që fjalët mbajnë. Halliday (1966) i shikon si një lidhje të bashkëgjendjes lineare midis elementeve leksikore të cilat gjenden bashkë. Sipas Sinclair (1991), kolokacionet janë gjendja e dy ose më shumë fjalëve brenda një hapësire të shkurtër të njëra-tjetrës në një tekst. Sipas Hoey (1991), kolokacionet janë lidhja e një elementi leksikor me elemente që shfaqen bashkë me një probabilitet më të madh se të rastësishëm në kontekstin tekstor. Biber (2004), i përkufizon kolokacionet si sekuencat më të shpeshta dhe të zakonshme leksikore në një regjistër.

Sipas Benson (1985), kolokacionet janë një grup fjalësh që ndeshen në mënyrë të përsëritshme në gjuhë. Moon (1998) e përdor termin kolokacion për të përshkruar “bashkëndodhje të thjeshta elementesh”. Sipas Kilgarriff (1992) kolokacionet janë një grup prej dy ose më shumë fjalësh të cilat gjenden në afërsi të njëra-tjetrës shumë më shpesh sesa mund të parashikohej, duke marrë parasysh shpeshësinë e ndeshjesh së secilës fjalë veç e veç. Sipas Dubois (1994), kolokacionet janë “bashkimet e zakonshme të një fjale me fjalë të tjera në gji të thënies”.

Wikipedia në versionin frëngjisht jep këtë përkufizim për kolokacionet si “një bashkëgjendje e privilegjuar, një bashkim i zakonshëm i një fjale me një tjetër në gji të fjalisë, një lidhje fjalësh e cila, edhe pse s’është e ngurosur, nuk është as e rastit, si p.sh., *voix suave (zë i ëmbël)*, *entraîneur des conséquences (mbart pasojë)*.”

Disa autorë, edhe pse përqendrohen te kolokacionet e kufizuara si pjesë e frazeologjisë, bëjnë dallimin midis kolokacioneve të hapura dhe kolokacioneve të kufizuara.

Cowie et al (1983) i ndajnë kolokacionet në kolokacione të hapura dhe në kolokacione të kufizuara. Në kolokacionet e hapura elementet përbërëse “kombinohen lirshëm” dhe përdoren “në një kuptim të zakonshëm literal”, ndërsa “kolokacionet e kufizuara lejojnë ndryshime leksikore në një farë shkalle” dhe një element i tyre “ka

²²⁵ Tutin, A. & Grossmann F. (2002). “Collocations regulieres et irregulieres : esquisse de typologie du phenomene collocatif”, *Revue française de Linguistique appliquee*. Lexique : recherches actuelles, vol. VII.

një kuptim të figurshëm që nuk gjendet jashtë këtij konteksti të kufizuar”, ndërsa tjetri shfaqet në “një kuptim familjar, literal”.

Fiedler (2007) në përkufizimin që jep për kolokacionet si “Kolokacioni mund të përkufizohet si një kombinim fjalësh të cilat mund të vihen re në afërsi të ngushtë njëra me tjetrën në ligjërim” dallon dy lloje: kolokacionet e hapura që “janë kombinime të zakonshme elementesh të përdorura në kuptimet e tyre literale dhe lirisht të zëvendësueshme” dhe kolokacione të kufizuara që “kanë një përbërës të përdorur në një kuptim të specializuar apo të figurshëm”.

Autorët e mëposhtëm përqendrohen vetëm te kolokacionet e kufizuara si pjesë e frazeologjisë së gjuhës.

Aisenstadt (1979) në dallimin që bën midis sintagmave të lira të gjuhës të cilat i quan “kombinime të lira fjalësh” (kufizimet e zëvendësimit të të cilave kushtëzohen nga kuptimi) dhe sintagmave të qëndrueshme të gjuhës, ku te të fundit, përveç idiomave (“një njësi semantike”), dallon edhe ato që ai i quan kolokacione të kufizuara (kombinime përbërësit e të cilave “përdoren në një nga kuptimet e tyre të rregullta, jo idiomatike, duke ndjekur disa modele strukturore, dhe të kufizuara në zëvendësueshmërinë e tyre jo vetëm nga valenca e tyre gramatikore dhe semantike....por edhe nga përdorimi”).

Sipas Farrokh (2012), kolokacioni i kufizuar është më i limituar në zgjedhjen e elementeve përbërës dhe zakonisht ka një përbërës të përdorur në një kontekst të specializuar, si p.sh., *perform a task (përbush një detyrë)*.

Dobrovol'skij & Piirainen (2005) i përkufizojnë kolokacionet e kufizuara si kombinim fjalësh në të cilin një nga elementet ka kuptim të specializuar dhe që zakonisht bashkëgjendet me elementin tjetër.

Sipas Bentivogli & Pianta (2000) kolokacioni i kufizuar është një sekuencë fjalësh që bashkëgjenden zakonisht dhe kuptimi i së cilës përfitohet në mënyrë kompozicionale. Kolokacionet e kufizuara kanë një lloj kohezioni semantik që i atribuohet kryesisht përdorimit dhe, megjithatë, e kufizojnë në mënyrë të konsiderueshme zëvendësimin e fjalëve përbërëse.

Disa autorë përdorin thjesht termin kolokacion për t’iu referuar kolokacioneve të kufizuara.

Në një studim të hershëm të tij në lidhje me vendin e kolokacioneve dhe të idiomave në fjalorë për studentët e huaj, Cowie (1981) jep përkufizimin e mëposhtëm për kolokacionin: “Kolokacioni është një njësi e përbërë (composite unit) e cila mundëson zëvendësimin e elementeve për të paktën një prej përbërësve të saj (kuptimi i elementit tjetër mbetet konstant)”. Sipas vlerësimeve të Cowie-it mbi kolokacionet kuptojmë se bëhet fjalë për kolokacionet e kufizuara. Autorët largohen nga përkufizimi i kolokacioneve si bashkëndodhje të shpeshta të fjalëve dhe i përkufizojnë si marrëdhënie varësie.

Hausmann (1985) përdor thjesht termin kolokacion për t’iu referuar atyre që ne do t’i quajmë kolokacione të kufizuara.

Igor Mel’čuk në “*Collocations dans le dictionnaire*” (2003) thekson se “gjysmë-frazema është kolokacion. Një nga përbërësit e tij, le të themi A, përzgjidhet lirshëm, për kuptimin e saj. Përbërësi tjetër, dmth., B, përzgjidhet në funksion të së parës”.

Përkufizimi i këtyre kolokacioneve e ka burimin në studimet teorike në leksikologji (Cruse, 1986) dhe në leksikografi (Hausmann, 1989). Koncepti kryesor

në këtë trajtim është funksioni leksikor, një lidhje semantike e privilegjuar midis dy elementeve leksikore në të cilën një element ruan kuptimin e tij kryesor, ndërsa tjetri ka një kuptim të specializuar me përdorim të kufizuar.

Ne do të ruajmë ndarjen e Cowie-t (1983) në kolokacione të kufizuara dhe në kolokacione të hapura dhe do të konsiderojmë si objekt të studimit tonë të mëtejshëm kolokacione të kufizuara.

Përbërja e kolokacioneve të kufizuara

Kolokacionet e kufizuara përbëhen nga një element i pavarur semantikisht, baza, dhe nga një element semantikisht i varur, kolokativi.

Baza është një fjalë që folësi e zgjedh lirshëm, sepse mund të përkufizohet, të përkthehet dhe të mësohet pa kolokativin. Kolokativi është një fjalë që folësi e përzgjedh në funksion të bazës, sepse nuk mund të përkufizohet, të përkthehet apo të mësohet pa bazën. Ndërkohë që baza përzgjidhet vetëm për kuptimin e saj, kolokativi përzgjidhet edhe në varësi të bazës. Për rrjedhojë lidhja semantike midis dy elementeve konsiderohet si e nënrenditur apo hierarkike. Kjo do të thotë që baza ka kuptim të pavarur dhe se ky përcaktim është i njëkahshëm. Edhe folësi i huaj më i përparuar në zotërimin e gjuhës mund të gjendet në një situatë të vërtetë ankthi ku, duke e njohur bazën, e ka shumë të vështirë të gjejë kolokativin, ndërkohë që e kundërta është më e mundshme. Kështu, baza *terren* mund të parashikohet duke u nisur nga *i thyer*, por kolokativi *i thyer* nuk është i mundshëm duke u nisur nga baza *terren*.

Në hierarkinë bazë-kolokativ folësi përparon nga baza për të mbërritur te kolokativi dhe jo anasjelltas. Kjo përbën një realitet psikologjik që mund të vihet re në ligjërim, veçanërisht nga ana e një folësi të huaj të gjuhës.

Për sa i përket klasës së fjalëve që përfaqëson baza, Hausmann (1985) sqaron se rasti tipik i bazës do të ishte emri, sepse “emrat shprehin objektet dhe dukuritë e botës për të cilat njerëzit gjejnë diçka për të thënë”, ndërsa “foljet dhe mbiemrat do të ishin të mundshëm të shërbenin si fjalë-baza vetëm në kombinim me ndajfolje”, si p. sh., *mjaltë i ëmbël etj.*

Emertimi i gjymtyrëve të kolokacionit të kufizuar si bazë dhe si kolokativ

Robert Galisson (1965) është nga studiuesit e parë që analizoit kolokacionet e kufizuara duke emërtuar pjesët e tyre në një (=bazë) dhe në satelit (=kolokativ). Nga vepra e Galisson-it u frymëzua Hausmann (1979) i cili përshkruan kolokacionin e kufizuar si të përbërë nga një bazë dhe nga një kolokativ. Por paralelisht me Galisson u zhvillua edhe një mendim tjetër, ai i Igor Mel’čuk -ut (1962) i cili, edhe ai, dallon te kolokacioni i kufizuar bazën e cila zgjidhet lirshëm për kuptimin e saj dhe kolokativin i cili zgjidhet në funksion të bazës.

Hausmann (1994) vendos një dallim midis dy përbërësve të kolokacionit të kufizuar. Ai quan bazë fjalën me “varësi të vogël semiotaksike” dhe kolokativ fjalën me “varësi të fortë semiotaksike”. Varësia e fortë semiotaksike e kolokativit bën që, në disa raste, të jetë e nevojshme t’i drejtohem bazës për të mundësuar formulimin e kolokativit. Si mund të përkufizojmë *korr* pa shembullin e emrave me të cilët kjo folje shfaqet në mënyrë të parapëlqyer, si *fitore* apo *sukses*? Për rrjedhojë, mund të themi se kolokacioni i kufizuar karakterizohet si “lidhje e orientuar”.

Numri i bazave te kolokacionet e kufizuara

Kategoria e kolokacioneve të kufizuara konsiderohet si më e diskutueshme, por edhe më interesante. Vinogradov (1947, i cituar nga Cowie 1998) argumenton se ka një element të figurshëm që e lidh një fjalë tjetër të veçantë apo një grup tjetër fjalësh për të ndërtuar një “kombinim frazeologjik”. P.sh., në kolokacionet e mëposhtme: *meet the needs/the demands/the requirements/the necessity* (lit. *takoj nevojat, kërkesat*), folja *meet* është elementi që është përdorur në mënyrë të figurshme dhe është grupi i fjalëve *the needs, the demands, the requirements, the necessity*, që përcakton kuptimin e figurshëm të foljes *meet*. Folja është e lidhur frazeologjikisht me këtë grup fjalësh. Amosova (1963 e cituar nga Cowie 1998), nga ana e saj flet për kombinim frazeologjik kur kuptimi i lidhur ka një fjalë të vetme përcaktuese, si p.sh., *teeth* në *grind one's teeth* (lit. *bluaj dhëmbët*), *shrug* në *shrug one's shoulders* (ngre supet). Vinogradov dhe Amosova nuk kanë rënë dakord për zonën e mjegullt ku bënin pjesë kombinime të tilla si *meet the needs* dhe *grind one's teeth*. Ashtu si Vinogradov, edhe Cowie (1981) e zgjeron numrin e bazave që lidhen me të njëjtin kolokativ. Për të “Kolokacioni është një njësi e përbërë (composite unit) e cila mundëson zëvendësimin e elementeve për të paktën një prej përbërësve të saj (kuptimi i elementit tjetër mbetet konstant)”. Edhe shumë kërkues nuk janë pajtuar me Amosovën mbi këtë çështje. P.sh., Arnold (1973) argumenton se “edhe pse ka më shumë se një fjalë përcaktuese, grupi vazhdon të jetë i kufizuar, jo nëpërmjet bashkëgjendjes së thjeshtë, por nëpërmjet përdorimit konvencional”. Megjithatë, “*frazema*” e Amosovës duhet të konsiderohet si prototipi i kolokacionit të kufizuar, sepse kërkon që kuptimi i kolokativit të përcaktohet nga një fjalë-bazë e vetme si në *grind one's teeth* or *jog somebody's memory*. Por, megjithatë, sot frazeologët e kanë hedhur rrjetën më gjerë se Amosova, madje edhe se Vinogradov për të kapur të gjitha shprehjet që ndihen si problematike për nxënësit dhe folësit e gjuhës së huaj edhe pse nuk janë të kufizuara në mënyrë shumë të dukshme.

Ndërkohë që kufizimi i grupeve leksikore përdoret për të përforcuar rastin për status kolokacionor në frazeologji, zëvendësimi relativisht i lirshëm ndihet sikur e dobëson atë. Sipas Cowie (1983) “Në shprehje me më shumë variante leksikore si në *cardinal error/sin/virtue/grace* (*gabim, mëkat, virtyt, hijeshi themelore*), kolokacionet e kufizuara shihen më shumë si “kolokacione të hapura” apo si “lidhje të lira”.

Pyetja që shtrohet është se sa e kufizuar duhet të jetë “përzgjedhja e kufizuar” dhe se sa variacion leksikor duhet lejuar para se të argumentohet se kuptimi i kolokativit është i “pavarur” sesa i përcaktuar nga baza e tij. Përgjigjja nuk është e lehtë për t’u dhënë. Sa më të pakta të jenë lidhjet ku hyjnë fjalë të caktuara, aq më e madhe është varësia e përdorimit të tyre nga fjala (fjalët) bazë. Sa më i plotë dhe i qartë të jetë kuptimi i figurshëm i një fjale dhe sa më të rralla të jenë në përdorimin e përditshëm këto fjalë, aq më i plotë dhe i qartë është kuptimi i prejardhur prej tyre: *korr fitore/ sukses; dal fitimtar/ faqebardhë*.

Kolokacionet që memorizohen mbi bazën e varësisë leksikore (dhe jo mbi bazën e frekuencës dhe të përzgjedhjes reciproke) do të përbëjnë gamën dhe kufirin e kolokacioneve të kufizuara të cilat, si thekson edhe Peppard (2007), mundësohen vetëm kur ka shumë pak fjalë që bashkëgjenden me një fjalë specifike.

Natyra e kolokativit dhe llojet e kolokacioneve të kufizuara

Elementi me përdorim të kufizuar (kolokativi) i kolokacioneve të kufizuara është konsideruar se ka natyrë të figurshme.

Kështu, Vinogradov (1947, i cituar nga Cowie (ed) 1998) argumenton se ka një element të figurshëm që e lidh një fjalë tjetër të veçantë apo një grup tjetër fjalësh për të ndërtuar një “*kombinim frazeologjik*”. P.sh., në kolokacionet e mëposhtme: *meet the needs/the demands/the requirements/the necessity*, folja *meet* është elementi që është përdorur në mënyrë të figurshme.

Cowie (1983) sqaron se në kolokacionet e kufizuara “...njëra fjalë ...ka një kuptim të figurshëm që nuk gjendet jashtë këtij konteksti të limituar ” *to jog somebody’s memory* (lit. *godas kujtesën*).

Thomai (1981) në “njësitë frazeologjike më të motivueshme” (kolokacionet e kufizuara, sipas emërtimit tonë) dallon se njëra fjalë (folje, sipas tij) përdoret me kuptim të figurshëm, si p.sh., *bëj durim, jap shpresë etj.*

Autorë të tjerë nuk e konsiderojnë të domosdoshëm që kolokativi të ketë vetëm natyrë të figurshme. Rëndësi ka të jetë i kufizuar në përdorimin e tij në një apo në pak lidhje të tjera.

Kështu, Aisenstadt (1979) dallon kuptimin “e specializuar” apo “teknik” si një nga tri kuptimet e përbërësve të kolokacioneve të kufizuara, si p.sh., *shrug one’s shoulders*.

Cowie & Howarth (1996) pretendojnë se kolokacioni i kufizuar është “një kombinim fjalësh në të cilin një element ka një kuptim të specializuar të përcaktuar nga elementi tjetër”.

Ndërsa Fiedler (2007) sqaron se “kolokacionet e kufizuara kanë një element që përdoret në një kuptim të specializuar apo të të figurshëm”

Poulsen (2005) thekson se “shprehjet literale mund të mos jenë më pak të sanksionuara se ato të figurshme”, si p.sh., *zjarr bubulak, borë i bardhë vs dashuri e verbër, drill a hole* (lit. *hap një vrimë*) etj.

Përveç dy kuptimeve të mësipërme të kolokativit, Aisenstadt (1979) dallon edhe një kuptim të tretë të dobësuar (“të gramatikalizuar” apo të “deleksikalizuar”, sipas tij) si një nga tre kuptimet e përbërësve të kolokacioneve të kufizuara, si p.sh., *give a laugh* (jap një të qeshur), *have a laugh* (bëj një të qeshur). Këto shprehjet e fundit ne i kemi përfshirë te perifrazat me folje të desemantizuar.

Firth (1951) dhe Amosova (1963, e cituar nga Cowie (ed) 1998) nuk e theksojnë këtë tregues, por ne e gjejmë në shembujt që ata ofrojnë, si p.sh., *dogs bark* (qentë lehin) dhe *shrug one’s shoulders* (ngre shpatullat) respektivisht.

Për sa i përket natyrës së kolokativit do të bashkohemi me qëndrimin e Vinogradov-it, të Cowie-t dhe të Thomait të cilët sqarojnë se në kolokacionet e kufizuara njëra fjalë duhet të ketë kuptim të figurshëm që nuk gjendet jashtë këtij konteksti të limituar ose që gjendet në shumë pak kontekste, përndryshe lidhja shumëfjalëshe nuk do të përbënte objekt studimi të frazeologjisë e cila e studion objektin e vet për natyrën e tij semantike.

Natyra frazeologjike e kolokacioneve të kufizuara

Jo të gjitha kolokacionet e kufizuara janë frazeologjike. Do të konsiderojmë si frazeologjike ato kolokacione të kufizuara që përcaktohen mbi bazën e kriterit

semantik (Cowie, Hausmann etj.), dmth., që karakterizohen nga kuptimi i mbartur, i figurshëm i një përbërësi i cili “nuk gjendet jashtë këtij konteksti të kufizuar”, ndërsa përbërësi tjetër shfaqet në “një kuptim familjar, literal”²²⁶. Janë pikërisht këto kolokacione të kufizuara që përbëjnë objekt studimi të frazeologjisë sonë, të cilat në vazhdim do të emërtohen ***kolokacione të kufizuara frazeologjike***, shkurt ***kolokacione frazeologjike***.

Natyra frazeologjike e kolokacioneve të kufizuara frazeologjike lidhet me plotësimin e kushtit kryesor të frazeologjizimit të strukturës, që është mbartja e kuptimit apo mosreferencialiteti literal i cili shfaqet në njëren gjymtyrë të tyre, të kolokativit, i cili ka fituar një kuptim të mbartur të figurshëm.

Kolokacionet e kufizuara frazeologjike plotësojnë edhe kushtin e nevojshëm të kufizimit leksikor sipas të cilit të paktën një prej përbërësve të tyre (kolokativit) është pothuajse i kufizuar në zëvendësueshmërinë e tij. Kufizimi i kolokativit të kolokacionet e kufizuara frazeologjike shkaktohet nga varësia apo kushtëzimi i tij nga baza, sepse “kolokacionet janë kombinime të pikërisht dy leksemave ... ku përzgjedhja e njëres varet (apo është e kufizuar) nga tjetra”²²⁷. Për më tepër, kolokativit nuk mund të përdoret me një numër të pakufizuar bazash.

Por kolokacionet e kufizuara frazeologjike janë kategoria frazeologjike më pak e ngurosur e cila karakterizohet vetëm nga kuptimi i mbartur i figurshëm i njëres gjymtyrë dhe në kontinuumin frazeologjik shtrihen në skajin e kundërt me idiomat si njësitë më opake të frazeologjisë.

Kufiri dhe identifikimi i kolokacioneve të kufizuara frazeologjike

Për të përcaktuar kufirin e kolokacioneve të kufizuara frazeologjike do të nisemi nga dy prej kritereve të përgjithshme të përcaktimit të frazemave. I pari është kriteri i mosreferencialitetit literal i cili përbën një kusht të nevojshëm për frazemat, sepse të gjitha frazemat përdoren në një kuptim tërësisht apo pjesërisht të mbartur. Mbi bazën e këtij kushti të nevojshëm për kolokacionet e kufizuara frazeologjike, nuk konsiderohen si frazeologjike lidhjet e qëndrueshme, si p.sh. *pus artezian, macja mjaullin, zjarr bubulak* pavarësisht se lidhja asociative unike e fjalës *artezian* e kufizuar vetëm me fjalën *pus* të *pus artezian* nuk ndryshon nga ajo e fjalës *i thyer* që kufizohet vetëm me fjalën *moshë* të kolokacionit të kufizuar frazeologjik *moshë e thyer*. Ato do të konsiderohen si kolokacione të kufizuara jofrazeologjike.

I dyti është kriteri i kufizimit leksikor. Edhe ky kriter përbën kusht të nevojshëm, sepse përbërësit e frazemave përdoren në kontekste (kuazi-)unike, ndryshe nga përbërësit e lidhjeve të lira që përdoren në mënyrë të pakufizuar. Mbi bazën e këtij kushti tjetër të nevojshëm për kolokacionet e kufizuara frazeologjike, nuk do të konsiderohen si frazeologjike sintagmat me kuptim pjesërisht të figurshëm, si p.sh., *qëndis një letër, qëndis një pusullë, qëndis një mesazh, qëndis nja dy fjalë etj.*, sepse fjala me kuptim të figurshëm “*qëndis*” hyn në lidhje të pakufizuara fjalësh.

²²⁶ Cowie, A. P. (1981). The treatment of collocations and idioms in learners' dictionaries. Applied Linguistics 2(3).

²²⁷ Heid, U. (1994), “On Ways Words Work Together - Topics in Lexical combinatorics”. In EURALEX'94 Proceedings. Vrije Universiteit Amsterdam.

Tipat e kolokacioneve të kufizuara frazeologjike

Në bazë të kriterëve të përcaktuara për kolokacionet e kufizuara frazeologjike, do të dallonim dy tipa kolokacionesh frazeologjike:

Kolokacione frazeologjike të mirëfillta dhe frazema të ndryshme me natyrë kolokacionore. Kolokacionet e kufizuara të mirëfillta plotësojnë vetëm kriteret e kolokacioneve dhe, për rrjedhojë, janë vetëm kolokacione, ndërsa frazemat me natyrë kolokacionore plotësojnë edhe kriteret e tjera, tipike për kategori të tjera frazeologjike si p.sh., për frazeotermat, idiomat dhe perifrazat. Janë kolokacione në lidhje me strukturën e tyre, por janë edhe frazeoterma, idioma apo perifraza për tiparet që i bëjnë të përfshihen në këto kategori të tjera frazeologjike.

Në grupin e kolokacione frazeologjike të mirëfillta do të dallonim dy raste:

Rasti tipik kur kuptimi i kolokatimit përcaktohet nga një fjalë-bazë e vetme, si p.sh., *bukë thatë, duar thatë, gjumë i rëndë, grua e rëndë, marr provimin, marr një ilaç, moshë e thyer, në mesjetën e thellë, pastroj paratë, pres ditën e dasmës, terren i thyer, thyej notën në sjellje, thyej rekordin, ul dushin, vras kohën, zë vendin e parë, bie goma, bie nata/dita, bie linja, mjaltë i ëmbël, borë i bardhë etj.*

Rasti kufi kur kuptimi i kolokatimit përcaktohet nga pak baza, si p.sh., *hap probleme/ telashe, hije/ pamje e rëndë, i bie ziles/ borisë, kalit durimin/ vullnetin, korr fitore/ suksese, laj kredinë/ huan/ borxhin, marr autobusin/ trenin/ aeroplanin, marr klasën/ vitin, marr një çmim/ kupën, më zë inati/ zemërimi, më zë shiu/ bora/ breshëri, pres rrogën/ ditën e punës, shuaj etjen/ urinë, thyej ligjin, rregulloren, zë me gurë/ me shkop/ me dru, merr dita/ nata etj.*

Në grupin e frazemave me strukturë kolokacionore do të dallojmë tri nëngrupe: frazeotermat me strukturë kolokacionore, idiomat me strukturë kolokacionore dhe perifrazat me strukturë kolokacionore. Kjo ndodh sepse, përveç tipareve të përbashkëta që kanë të gjitha kolokacionet frazeologjike si kufizimi leksikor, kuptimi i figurshëm dhe përdorimi i njëres fjalë në funksion të tjetres, në disa kolokacione frazeologjike vihen re edhe tipare të tjera frazeologjike si kufizimi morfo-sintaksor dhe moskompozicionaliteti semantik që e përforcojnë dhe që e ngrenë në një shkallë më të lartë natyrën frazeologjike të këtyre kolokacioneve, aq sa është e arsyeshme dhe e mjaftueshme për t'i grupuar këto kolokacione frazeologjike në kategori të tjera frazeologjike. Të tilla janë rastet, si p.sh., *çelëz anglez, çelës kopil, kafe turke etj.*, që karakterizohen nga kufizimi sintaksor dhe që do t'i përfshijmë në kategorinë frazeologjike të frazeotermave, rastet si p.sh., *jetë qeni, fjalë burri, gjellë qensh etj.*, që karakterizohen nga kufizimi morfo-sintaksor dhe që do t'i përfshijmë në kategorinë frazeologjike të idiomave dhe rastet, si p.sh., *bëj durim, kam shpresë, jap të drejtë etj.*, që karakterizohen nga kompozicionaliteti i pjesshëm dhe që do t'i përfshijmë në kategorinë frazeologjike të perifrazave me folje të desemantizuar. Nëngrupin e perifrazave e veçon nga kolokacionet e tjera edhe Mel'čuk (1998) i cili përbërësve-folje të cilave u referohet si "*folje të lehta*" (*light verbs*). Tërësia e tipareve të këtyre nëngrupeve trajtohen në kuadrin e kategorive frazeologjike të frazeotermave, të idiomave dhe të perifrazave me folje të desemantizuar respektivisht, për arsye të tipareve suplementare të mësipërme që ato fitojnë.

Tipare frazeologjike të kolokacioneve të kufizuara frazeologjike:

Tipari binar i kolokacioneve të kufizuara frazeologjike

Kolokacionet frazeologjike janë bashkime dy fjalësh emërtuese prej të cilave njëra (baza) ka kuptim të pavarur, ndërsa tjetra (kolokativi) ka kuptim të varur nga e para.

Disimetria e përbërësve të kolokacioneve të kufizuara frazeologjike

Përbërësit e kolokacioneve frazeologjike nuk kanë të njëjtin status. Sipas Hausmann (1984), “Në kolokacione, statusi i dy partnerëve të kombinuar nuk është i njëjtë”. “Një element është autonom (baza), ai ka kuptimin e tij të zakonshëm. Tjetri (kolokativi) varet nga i pari i cili ruan kuptimin e tij të zakonshëm”. “Përbërësit e kolokacionit janë të renditur në mënyrë hierarkike: baza është e pavarur semantikisht, ndërsa kolokativi ka nevojë për bazën që të fitojë kuptimin e tij të plotë”.

Transparenca semantike e kolokacioneve të kufizuara frazeologjike

Kolokacionet frazeologjike mund të interpretohen lehtësisht nga folësi, sepse realizimi semantik i elementeve është i deduktueshëm, transparent, të paktën në analizë. Çdo përbërës përbën një kontribut të pavarur në kuptimin e gjithë kolokacionit frazeologjike, ose siç e shtron Cruse (1986), “çdo përbërës leksikor është gjithashtu edhe një përbërës semantik”. Jens Bahns (1993) pohon se një nga tiparet karakteristike të kolokacioneve frazeologjike është se “kuptimi i tyre pasqyron kuptimin e pjesëve të tyre përbërëse”. Kuptimi i gjithë kombinimit mund të nxirret nga kuptimet e pjesëve të tij, pavarësisht nga fakti se një element mund të jetë i përdorur figurativisht, si p.sh., *thyej rekordin, moshë e thyer, vras kohën etj.* Folësi i gjuhës mund ta kuptojë kuptimin e gjithë kombinimit pavarësisht nga fakti se tiparet semantike të elementeve nuk përputhen, një fakt që na bën të përdorim kuptimin e figurshëm të elementit për të nxjerrë kuptimin.

Kufizimi i përzgjedhjes leksikore

Kolokacionet frazeologjike përbëhen nga një element i pavarur semantikisht, baza, dhe nga një element semantikisht i varur, kolokativi. Baza është një fjalë që folësi e zgjedh lirshëm, ndërsa kolokativi është një fjalë që folësi e përzgjedh në funksion të bazës. Në kolokacionet frazeologjike kolokativi lidhet vetëm me një apo me shumë pak fjalë të tjera që bashkëgjenden me këtë fjalë specifike (kolokativin).

Mosparashikueshmëria formale e përbërësve

Cruse dhe Hausmann nënvizojnë se kolokacionet frazeologjike mund të interpretohen lehtësisht nga folësi, edhe pse forma e tyre **nuk** është e parashikueshme, dmth., se kuptimi i përbërësve është transparent, të paktën në analizë, ndërsa përdorimi i tyre (i kolokativit) është vështirë të parashikohet. Nga të dy përbërësit e kolokacioneve frazeologjike, vetëm kolokativi është i paparashikueshëm, sepse baza mund të parashikohet duke pasur si pikënisje kolokativin, për arsye se “kolokativi përfshin kuptimin e bazës”²²⁸, si p.sh., *thyej rekordin*. Këtu, baza *rekord* mund të parashikohet duke u nisur nga *thyej*, por kolokativi *thyej* nuk është i mundshëm duke

²²⁸ Tutin, A. & Grossmann F. (2002). vep. e cit.

u nisur nga baza *rekord*. Për rrjedhojë, mund të themi se kolokacionet frazeologjike janë gjysmë të parashikueshme.

Dy fjalë shënuese

Këtu do të përjashtojmë “koligacionet”, term i introduktuar nga Firth (1951) për të treguar të ashtuquajturat “kolokacione gramatikore”, të cilat (koligacionet) Benson (1985) i ka përkufizuar si “një sintagmë që përbëhet nga një fjalë dominuese (emër, mbiemër, folje) dhe nga një parafjalë ...” dhe do të do të pranojmë vetëm për kolokacionet leksikore, të cilat, siç thotë Sinclair (1991) janë të vetmet që meritojnë emërtimin kolokacione, të përbëra nga dy fjalë shënuese. Këtë e ka vënë re edhe Tutin (2009) kur thotë se “Kolokacionet janë bashkime që vënë në lojë dy elemente gjuhësore me kuptim të plotë”.

Kompozicionaliteti

Duke folur për rastet tipike dhe duke lënë mënjanë rastet periferike, do të thoshim se ajo që i karakterizon kolokacionet frazeologjike është se kuptimet e përbërësve të tyre janë transparente dhe se kuptimi i tyre është kompozicional.

Mel’čuk (2008) e shpall kategorimatikisht se kolokacioni (frazeologjik) është semantikisht kompozicional, ndërsa Bentivogli & Pianta (2002) e përkufizojnë “kolokacionin e kufizuar” si “një sekuencë fjalësh të cilat bashkëgjenden zakonisht dhe kuptimi i së cilës mund të përftohet në mënyrë kompozicionale”.

Memorizimi dhe riprodhimi si njësi gjysmë e gatshme

Baza nuk mund ta parashikojë kolokativin, por e preferon këtë kolokativ (kur lind nevoja e përdorimit (të kuptimit) të tij) jo vetëm nga kuptimi, por edhe nga përdorimi për arsye të një konvencioni që është krijuar në brendësi të komunitetit gjuhësor, ndërsa kolokativi e parashikon (gjithnjë) bazën dhe, për rrjedhojë, krijohet një sekuencë e memorizuar e cila është produkt i parafabrikuar i gjuhës²²⁹. Gjatë përdorimit të kolokacionit frazeologjik, folësi nuk e krijon lirshëm atë, por e riprodhon përmendësh.

Lidhje e zakonshme, por jo detyrueshme e shpeshtë

Kolokacioni frazeologjik është një lidhje e zakonshme midis dy fjalëve, por jo detyrueshme e shpeshtë. Ajo që ka rëndësi është që të jetë e disponueshme. Shpeshtësia nuk përbën kusht as për kolokacionet e hapura as për kolokacionet e kufizuara frazeologjike, madje as për dallimin midis tyre. Tipari i shpeshtësisë bën që të mbeten jashtë grupit të kolokacioneve të hapura ato kolokacione që kanë tipare semantike të përbashkëta dhe tërheqje reciproke, por që nuk janë të shpeshta. Për rrjedhojë, shpeshtësia nuk përbën tipar të mjaftueshëm. Shpeshtësia mund të na bëjë të konsiderojmë kolokacion të hapur edhe emrat e personave të dëgjuar politikë të vendit dhe të huaj (emra dhe mbiemrat e përveçëm) si, p.sh., *Sali Berisha* (kryeministër aktual i vendit), *Fatos Nano* (figurë e shquar politike e vendit), të cilat nuk përbëjnë veçse segmente të përsëritura²³⁰. Halliday (1966) ka arritur në konkluzionin se lidhja në kolokacione nuk bazohet thjesht në shpeshtësi, por në probabilitet. Kolokacioni

²²⁹ Hausmann, F. J. (1984), *Wortschatzlernen ist Kollokationslernen. Zum Lehren und Lernen französischer Wortverbindungen. Praxis des neusprachlichen Unterrichts* 31.

²³⁰ Mejri, S. (2008). "Constructions à verbes supports, collocations et locutions verbales". In MOGORRON HUERTA Pedro, MEJRI Salah, (eds), *Las construcciones verbo-nominales libres y fijas. Aproximación contrastiva y traductológica*. Universidad de Alicante.

është një lidhje ku fjalët bashkëgjenden “me një probabilitet më të madh se të rastësishëm”²³¹.

Kuptim-përdorimi

Ekzistenca e kolokacioneve të kufizuara frazeologjike rrjedh nga përdorimi i tyre²³², sepse baza nuk mund ta parashikojë kolokativin, por e preferon këtë kolokativ (kur lind nevoja e përdorimit (të kuptimit) të tij), ndërsa kolokativi e parashikon bazën jo vetëm nga kuptimi, por edhe nga përdorimi për arsye të një konvencioni që është krijuar në brendësi të komunitetit gjuhësor. Edhe sipas Aisenstadt (1979) kolokacionet e kufizuara frazeologjike janë kombinime përbërësit e të cilave “përdoren në një nga kuptimet e tyre të rregullta, jo idiomatike, duke ndjekur disa modele strukturore, dhe të kufizuara në zëvendësueshmërinë e tyre jo vetëm nga valenca e tyre gramatikore dhe semantike...por edhe nga përdorimi”.

Mosprodhueshmëria

Përgjithësisht kolokacionet e kufizuara frazeologjike janë pak produktive: shpesh ato krijojnë seri të limituara, dmth., lidhen me pak baza, si p.sh., *kalit durimin/ vullnetin, korr fitore/ suksese, laj kredinë/ huan/ borxhin*, por në shumë raste ato janë unike, dmth., lidhen me një bazë të vetme, si p.sh., *gjumë i rëndë, grua e rëndë, moshë e thyer*. Kapërcimi i kufirit të serive të limituara do të na çonte në lidhje të lira.

Mospërkthyeshmëria

Kolokacionet e kufizuara frazeologjike janë karakteristike për një gjuhë të caktuar dhe janë pjesë e kulturës së një gjuhe. Mund të ekzistojnë shprehje të ngjashme edhe në gjuhë të tjera, por ka të ngjarë që të përbëhen nga fjalë të ndryshme, dmth., që një kolokacion i kufizuar frazeologjik në një gjuhë shpesh nuk ka barasvlerës (leksikor) në gjuhë të tjera. Për rrjedhojë, shpesh ato nuk mund të përkthehen literalisht në gjuhë të tjera. Në shembujt e mëposhtëm, kuptimi i kolokativit mund të mos jetë i dukshëm duke u nisur nga kuptimi i parë i fjalës për një të huaj gjuha e nënës së të cilit nuk përdor të njëjtën metaforë, si p.sh., *un chaud partizan* (lit. *partizan i ngrohtë*, për *partizan i vendosur*), *une peur bleue* (lit. *frikë blu*, për *frikë e madhe*), *high wind* (lit. *erë e lartë*, për *erë e fortë*), *a green worker* (lit. *punëtor i gjelbër*, për *punëtor pa përvojë*), *ψιλή κούβέρτα* (lit. *bisedë e hollë*, për *bisedë jo thelbësore*, për *çështje jo thelbësore*), *laj kredinë/ huan/ borxhin* (për *shlyej*), *korr fitore suksese* (për *arrij*) etj.

Mosleksikalizimi

Siç e theksuam edhe më lart, kolokacionet e kufizuara frazeologjike janë struktura të memorizuara, por që në fakt nuk mund të konsiderohen si të leksikalizuara. Ato hyjnë në ligjërim si dy fjalë semantike, njëra me kuptim të pavarur dhe tjetra me kuptim të varur nga e para, por tërësisht transparent.

Struktura e kolokacioneve të kufizuara frazeologjike

Kolokacioni i kufizuar frazeologjik ka karakter binar: ai përbëhet nga një element autosemantik (baza) me kuptim të pavarur dhe nga një element sinsemantik

²³¹ Hoey, M. (1991). *Patterns of Lexis in Text*. Oxford: Oxford University Press.

²³² Frath, P. & Gledhill C. (2005): “Free-Range Clusters or Frozen Chunks? Reference as a Defining Criterion for Linguistic Units,” in *Recherches anglaises et Nordaméricaines*, vol. 38.

(kolokativi) me kuptim të varur, zgjedhja e të cilit bëhet në varësi të të parit, dmth., statusi i përbërësve nuk është i barabartë.

Kjo pasqyrohet në strukturat e mëposhtme:

Folje + emër-kundrinor, si p.sh., *thyej rekordin, pres ditën e dasmës.*

Emër + mbiemër, si p.sh., *gjumë i rëndë, moshë e thyer, hije/ pamje e rëndë.*

Emër-kryefjalë + folje, si p.sh., *bie goma, ra linja, mori dita/nata.*

Ndajfolje + mbiemër, si p.sh., *mjaltë i ëmbël, sterrë i zi, plumb i rëndë, pendë i lehtë.*

Folje + mbiemër, si p.sh., *dal fitimtar, dal faqebardhë.*

Emër + ndajfolje, si p.sh., *bukë thatë, duar thatë.*

Përkufizimi i propozuar për kolokacionet e kufizuara frazeologjike

Kolokacionet e kufizuara frazeologjike janë frazema apo lidhje shumëfjalëshe të qëndrueshme frazeologjike njëra gjymtyrë e të cilave ka kuptim të figurshëm dhe përdoret në varësi të tjetrës e cila përdoret literalisht dhe në mënyrë të pavarur, si p.sh., *bukë thatë, dredh muhabetin/ përgjigjen, duar thatë, bie goma, gjumë i rëndë, grua e rëndë, hap probleme/ telashe, hije/ pamje e rëndë, i bie ziles/ borisë, kalit durimin/ vullnetin, korr duartrokitje, korr fitore/ suksese, laj kredinë/ huan/ borxhin, marr autobusin/ trenin/ aeroplanin, marr klasën / vitin, marr provimin, marr një çmim/ kupën, marr një ilaç, më zë inati/ zemërimi, më zë korrenti, më zë shiu/ bora/ breshëri, moshë e thyer, ndrydh ndjenjat, në mesjetën e thellë, ngacmoj kujtesën, ngre këngë, pastroj paratë, pres ditën e dasmës, pres faturën, pres një biletë, pres pazarin/ çmimin, pres rrogën/ ditën e punës, pres sikuracionin, rezultat i shtrënguar, shuaj etjen/ urinë, shuaj kureshtjen, terren i thyer, thur këngë/ poezi, thyej notën në sjellje, thyej ligjin/ rregulloren, thyej rekordin, tokë e rëndë, ul dushin, ushqime të ashpra, zë me gurë/ me shkop/ me dru, zë vendin (e parë etj.), zonë/ fshat i thellë, dashuri e verbër (edhe: *blind love (angl.), amour aveugle (fr.), τυφλή αγάπη (gr.), e vërteta lakurige (edhe: naked truth (angl.), la verite nue (fr.), η γυμνή αλήθεια (gr.), vras kohën (edhe: tuer le temps (fr.), kill the time (angl.), σκοτώνω το χρόνο (gr.), mjaltë i ëmbël, flakë i kuq, borë i bardhë etj.**

Shembuj ilustrues gjejmë edhe në anglishte, si p.sh., *high wind (lit.erë e lartë, për erë e fortë), dry wine (lit.verë e thatë, për verë e athët), a green worker (lit.punëtor i gjelbër, për punëtor pa përvojë), sound sleep (lit.gjumë i shëndoshë, për gjumë i thellë), meet a demand (lit.takoj një kërkesë, për plotësoj një kërkesë) etj., në frëngjishte si p.sh., *un chaud partizan (lit.partizan i ngrohtë, për partizan i vendosur), percer le secret (lit.shpoj sekretin, për zbuloj sekretin), rompre le silence (lit.thyej qetësinë, për prish qetësinë), briser des chaussures (lit.thyej këpucët, për hap këpucët), une colère noire (lit.zemërim i zi, për zemërim i madh), une peur bleue (lit.frikë blu, për frikë e madhe), ivre mort (lit.i dehur i vdekur, për shumë i dehur), ose në greqishte, si p.sh., *ψιλή κουβέντα (lit.bisedë e hollë, për bisedë jo thelbësore, për çështje jo thelbësore), τραβώ το καζανάκι (lit.tërheq kazanin e WC, për zbraz kazanin e WC) etj***

Së fundi, do të duhet të saktësojmë se “kolokacionet nuk duhet të ngatërrohen me nocionin e *segmentit të përsëritur (segment répété)* i cili përdoret shpesh në statistikat leksikore. Arsyeja është se segmenti i përsëritur mund të jetë kolokacion, por jo çdo kolokacion mund të jetë segment i përsëritur. Segmenti i përsëritur është

një segment që mund të varet nga idiosingrazi të veçanta, nga veçanësi stilistikore apo thjesht nga fakte ligjërimore tipike për një gjini të të folurit²³³, si p.sh., *Sali Berisha* (kryeministër aktual i Shqipërisë), *Fatos Nano* (figurë e shquar politike e vendit), *festa e pavarësisë* etj.

Dallime midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe idiomave:

Dallimi i kolokacioneve të kufizuara frazeologjike nga idiomat me figurshmëri të plotë

Dallimet kryesore midis kolokacioneve frazeologjike dhe idiomave me figurshmëri të plotë janë:

-Përbërësit e idiomave janë jotransparentë semantikisht dhe struktura është jokompozicionale. Është e pamundur që kuptimi i gjithë strukturës të interpretohet si shumë e kuptimeve të përbërësve.

-Idiomat përbëjnë një tërësi të vetme semantike, “sepse kanë kuptim dhe për zgjidhen nga folësi si një e tërë”²³⁴. Për rrjedhojë, idiomat përbëjnë njësi leksikore, ndërsa kolokacionet frazeologjike nuk përbëjnë njësi të leksikalizuara.

-Idiomat janë të koduara në gjuhë, por nuk kanë bazë (për rrjedhojë, as kolokativ), ndërsa kolokacionet frazeologjike përbëhen nga një element të përdorur në mënyrë të pavarur (baza) dhe një element i cili përdoret në varësi të të parit (kolokativi).

-Përveç kufizimit leksikor që karakterizon edhe kolokacionet frazeologjike, idiomat karakterizohen edhe nga ngurosjë morfo-sintaksore, sepse përbërësit-pjesë të ndryshueshme të ligjëratës kanë paradigmë formale të kufizuar dhe nuk pësojnë të gjitha modifikimet sintaksore.

-Idiomat mund të parashikohen formalisht, sepse përbëhen nga realizime leksikore të parashikuara. Kështu, lidhja në idiomën *me kuç e me maç* është më e fortë se në kolokacionin e kufizuar frazeologjik *korr fitore*. Atëherë, për kolokacionet e kufizuara frazeologjike mund të themi se janë gjysmë të parashikueshëm. Ato parashikohen vetëm me pikënisje kolokativin.

Si konkluzion mund të themi se tiparet dalluese janë aq shumë sa, me të drejtë Nuccorini (1988) pranon se “kolokacionet e kufizuara frazeologjike nuk janë idiomatike”, ndërsa idiomat mund të kenë natyrë kolokacionore, siç është rasti i idiomave të pjesshme që do të shohim më poshtë.

Dallimi i kolokacioneve të kufizuara frazeologjike nga idiomat me figurshmëri të pjesshme

Idiomat me figurshmëri të pjesshme janë shumë më afër kolokacioneve të kufizuara frazeologjike se idiomat me figurshmëri të plotë, sepse kanë shumë ngjashmëri midis tyre, si p.sh., transparenca e kuptimit të përbërësve, kompozicionaliteti, mosleksikalizimi, mosparashikueshmëria dhe lidhja kolokacionore e strukturës. Ajo që i dallon nga kolokacionet e kufizuara frazeologjike është ngurosjë morfo-sintaksore, si p.sh., *jetë qeni*, *humbas trenin* etj., gjë që përbën një nga kriteret dalluese të idiomave dhe që do të thotë se nuk janë thjesht kolokacione frazeologjike. Kolokativi në idiomat me figurshmëri të pjesshme

²³³ Mejri, S. (2008). vep. e cit.

²³⁴ Blumenthal, P. & Hausmann, F. J. (2006). vep. e cit.

zakonisht ka funksion përcaktori e vlerë mbiemërore²³⁵, si p.sh., *jetë qeni = jetë e keqe*.

Dallime midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe frazeotermave

Kolokacionet e kufizuara frazeologjike të ndërtuara me emër + mbiemër tregojnë tipizim ose cilësim. Ato janë më afër frazeotermave (përbëjnë grupin e tretë të frazeotermave) sesa thjesht kolokacione të kufizuara frazeologjike. Kolokacionet e kufizuara frazeologjike që tregojnë tipizim ose cilësim, ruajnë kufizimin kolokacionor që i bashkon me kolokacionet frazeologjike të mirëfillta, por dallohen nga kolokacionet frazeologjike të mirëfillta nga tiparet e tipizimit ose të cilësimit të cilat karakterizojnë edhe njësi të tjera shumëfjalëshe që janë më pak të figurshme, apo aspak të figurshme, por që të gjitha së bashku mund të përbëjnë një kategori më vete frazeologjike, frazeotermat. Ato përbëjnë grupin e tretë të frazeotermave dhe mund të quhen frazeoterma me strukturë kolokacionore.

-Kategoria e frazeotermave, ku përfshihen edhe frazeotermat me strukturë kolokacionore, dallohet nga kolokacionet frazeologjike të mirëfillta nga ngurosjat sintaksore që i karakterizon. Kolokacionet e kufizuara frazeologjike mund të modifikohen, si p.sh., *Mosha e tij është shumë e thyer. Ai ka një moshë më të thyer se unë*, ndërsa frazeotermat nuk mund të modifikohen, si p.sh., *Kjo luftë është e ftohtë, por pa pasoja. Kjo natë është shumë e bardhë. Ky dënim është shumë kapital*. Nuk mund të themi: *ky çelës është anglez*, por *ky çelës është çelës anglez*.

- Kategoria e frazeotermave, ku përfshihen edhe frazeotermat me strukturë kolokacionore, dallohet nga kolokacionet frazeologjike të mirëfillta, sepse kanë tendencë të perceptohen si njësi referenciale. Ato janë tipizuese, sepse mbiemrat shërbejnë për të treguar një lloj të caktuar të emrit që shoqërojnë dhe të dy së bashku krijojnë një referent të vetëm, si p.sh., *një kryq i thyer* është një lloj kryqi, ndërsa kolokacionet frazeologjike të mirëfillta nuk janë tipizuese, ato janë cilësuese, si p.sh., *moshë e thyer, dashuri e verbër* etj.

Dallime midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe perifrazave me folje të desemantizuar

Perifrazat me folje të desemantizuar ngjajnë me kolokacionet e kufizuara frazeologjike, sepse edhe perifrazat ashtu si dhe kolokacionet e kufizuara frazeologjike kanë natyrë kolokacionore. Edhe te perifrazat zgjedhja e foljes përcaktohet më shumë leksikalisht sesa semantikisht. P.sh., te kolokacioni frazeologjik *korr fitore*, baza *fitore* përzgjidhet në mënyrë të pavarur apo lirshëm nga folësi dhe përdoret në mënyrë të pavarur nga fjala me të cilën lidhet, ndërsa kolokativi *korr* nuk përzgjidhet lirshëm nga folësi, por përdoret në varësi të fjalës me të cilën lidhet.

Te perifraza: *kam uri*, baza *uri* përzgjidhet në mënyrë të pavarur apo lirshëm nga folësi dhe përdoret në mënyrë të pavarur nga fjala me të cilën lidhet, ndërsa kolokativi *kam* nuk përzgjidhet lirshëm nga folësi për kuptimin e tij, por nga baza dhe përdoret në varësi të fjalës me të cilën lidhet.

²³⁵ Thomai, J. (1999). vep. e cit.

Por midis tyre ekzistojnë disa dallime të cilat lidhen me tipare të tjera më qendrore që i bëjnë këto dy grupe të përfshihen në kategori frazeologjike më vete.

-Dallimi kryesor është mostransparenca kuptimore e foljes te perifrazat, sepse folja te perifrazat është pak a shumë e desemantizuar.

-Një dallim tjetër është mosparashikueshmëria e përzgjedhjes së përbërësve. Ndërsa për kolokacionet e kufizuara frazeologjike mund të themi se janë gjysmë të parashikueshme, sepse parashikohen vetëm me pikënisje kolokativin, për perifrazat mund të themi se janë të paparashikueshme, sepse nuk mund të parashikohen as me pikënisje kolokativin i cili është i desemantizuar.

-Tipari tjetër dallues i perifrazës është kompozicionaliteti i pjesëshëm i perifrazës. Në perifrazë folja nuk i shton asnjë kuptim emrit me të cilin lidhet, sepse është e desemantizuar. Për rrjedhojë, shumica e kuptimeve të fjalëve që hyjnë në perifrazë nuk është shumë e thjeshtë aritmetike.

Si konkluzion, mund të themi se sa më i plotë dhe i qartë të jetë kuptimi i foljes, me sa më pak baza të lidhet folja, sa më pak e shpeshtë të jetë folja dhe sa më konkretë të jenë emrat-bazë, aq më afër kolokacioneve të kufizuara frazeologjike sesa perifrazave jemi, dmth., kemi kryesisht kolokacione të kufizuara kur:

-kuptimi i foljes është më i plotë dhe më i qartë

-kolokativi lidhet me një apo me shumë pak baza

-folja nuk është e shpeshtë kundrejt të zakonshmeve që karakterizojnë foljet e perifrazave

-bazat-emra janë kryesisht konkretë.

Domethënë, shprehja *marr masa është* më afër perifrazës me folje të desemantizuar se kolokacioneve të kufizuara frazeologjike.

Dallime midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe binomeve të pakthyeshme

Binomet e pakthyeshme frazeologjike kanë disa karakteristika të përbashkëta me kolokacionet e kufizuara frazeologjike, si p.sh., karakteri binar dhe transparenca semantike e përbërësve, por ato dallohen nga kolokacionet e kufizuara frazeologjike nga:

-Natyra jokolokacionore, sepse nuk shfaqet asnjë element dominues dhe i spikatshëm si bazë dhe të dy elementet kanë rëndësi të njëjtë.

-Pakthyeshmëria e rendit. Elementet përbërës të binomeve janë me rend të pakthyeshëm ndryshe nga sa mund të ndodhë te kolokacionet frazeologjike, si p.sh., *shëndoshë e mirë vs terren i thyer-shumë i thyer ky terreni*, për arsye theksimi, apo *korrr fitore – fitoret që korrrën vitin e kaluar*, në fjali lidhore, etj.

Dallime midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe kolokacioneve të hapura

Disa nga ngjashmëritë kryesore midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe kolokacioneve të hapura janë karakteri binar i tyre, transparenca e përbërësve dhe kompozicionaliteti semantik.

Si dallime midis tyre mund të përmendim:

-Një dallim midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe kolokacioneve të hapura është disimetria e përbërësve të kolokacioneve të kufizuara frazeologjike.

Kolokacioni i kufizuar frazeologjik përbëhet nga një element autosemantik (baza) dhe nga një element sinsemantik (kolokativi) përzgjedhja e të cilit bëhet në funksion të bazës, ndërsa kolokacioni i hapur përbëhet nga dy elemente autosemantike që lidhen midis tyre nëpërmjet tërheqjes reciproke, si p.sh., *thyej rekordin vs shkruaj një letër*.

-Një dallim tjetër është kufizimi i përzgjedhjes leksikore të kolokacionet e kufizuara frazeologjike ku njëra fjalë (kolokativi) lidhet vetëm me një apo me shumë pak fjalë të tjera (baza), ndërsa në kolokacionin e hapur mund të zëvendësohet lirshëm nga elemente të tjera në varësi të kuptimit dhe të tërheqjes reciproke, si p.sh., *shkruaj/ dërgoj/ marr një letër/ një telegram/ një email* etj. Pra gama e fjalëve që hyjnë në kolokacionet e hapura është më e madhe se ajo që hyn në kolokacionet e kufizuara frazeologjike.

-Dallime të tjera janë kuptim-përdorimi dhe mosparashikueshmëria. Në kolokacionin e kufizuar frazeologjik baza nuk mund të parashikojë kolokativin, por e preferon këtë kolokativ (kur lind nevoja e përdorimit (të kuptimit) të tij), ndërsa kolokativi e parashikon (gjithnjë) bazën dhe e zgjedh jo vetëm nga kuptimi por edhe nga përdorimi. Për rrjedhojë, mund të themi se kolokacionet e kufizuara frazeologjike janë gjysmë të parashikueshme, ndërsa kolokacionet e hapura janë të paparashikueshme. Në kolokacionet e hapura asnjëra prej gjymtyrëve nuk e parashikon tjetrën, sepse nuk përbëjnë bazë dhe kolokativ, por e zgjedhin njëra tjetrën (vetëm) semantikisht, dmth sipas nevojës së kuptimit (nga folësi). Kjo do të thotë se zëvendësimi i fjalëve të kolokacionet e hapura me fjalë të tjera kushtëzohet vetëm nga kuptimi, ndërsa të kolokacionet e kufizuara frazeologjike jo vetëm nga kuptimi, por edhe nga përdorimi.

-Një dallim tjetër lidhet me shkëlqjen e rregullave të gjuhës. Kolokacionet e hapura ndërtohen sipas rregullave standarde të gjuhës, ndërsa kolokacionet e kufizuara frazeologjike shkelin rregullin e lidhjeve paradigmatic, sepse kolokativi është i kufizuar në lidhjet e tij vetëm me një ose me shumë pak fjalë të tjera.

Dallimi midis kolokacioneve të hapura dhe lidhjeve të lira

Të dyja kategoritë përbëjnë lidhje të lira, sepse pjesët përbërëse të të dyja kategorive zgjidhen dhe përdoren në mënyrë të pavarur sipas nevojave të folësit, pra bëhet fjalë vetëm për varësi semantike sipas rregullave të gjuhës.

Por çfarë e bën kombinimin e fjalëve *shkruaj një letër* të jetë kolokacion i hapur ndërsa *lag letrën, zhubros letrën* të jetë lidhje e lirë?. Çfarë e bën fjalën *letër* të jetë më shpesh kundrinor i foljes *shkruaj* sesa i foljeve *lag, zhubros* etj.?

Dallimi midis tyre është se *shkruaj* është intrinsek (i brendshëm) në natyrën e fjalës *letër* dhe anasjelltas, dmth., që të dyja fjalët kanë bazë semantike referenciale reciproke dhe, për rrjedhojë, kanë tërheqje reciproke, presin njëra-tjetrën. Kjo bën që kombinimi *shkruaj një letër* të jetë tipik kundrejt *lag, zhubros një letër*.

Dallime midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe lidhjeve të lira

Dallimi midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe lidhjeve të lira në masën më të madhe është i njëjtë me dallimin midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe kolokacioneve të hapura. Në vija të përgjithshme, lidhjet e lira ashtu si kolokacionet e hapura ndjekin rregullat e përgjithshme të gjuhës si dhe të semantikës, dmth., elementet përbërëse të lidhjeve të lira nuk kanë asnjë kuptim

specifik, por përdoren në mënyrë të pavarur në aksin sintagmatik, nuk kanë asnjë lidhje të veçantë, por hyjnë në lidhje të pakufizuara në aksin paradigmatic, si dhe nuk kanë moskompozicionalitet semantik. I vetmi ndryshim midis tyre është ai i përmendur në dallimin midis kolokacioneve të hapura dhe lidhjeve të lira, dmth., që kolokacionet e hapura kanë tërheqje reciproke për arsye të bazës semantike referenciale reciproke, ndërsa lidhjet e lira jo.

Në mënyrë të përmbledhur mund të theksojmë se dallimet kryesore midis kolokacioneve të kufizuara frazeologjike dhe lidhjeve të lira lidhen me kufizimin leksikor, me disimetrinë, me kuptim-përdorimin, me parashikueshmërinë dhe përgjithësisht me figurshmërinë që karakterizojnë kolokacionet e kufizuara frazeologjike.

KREU VII

KRAHASIM I IDIOMAVE TË FUSHAVE KRYESORE LEKSIKORE TË SHQIPES DHE TË GREQISHTES

7. 1. Idiomat greko-shqiptare në kuadrin e paraleleve idiomatike ballkanike

Frazemat janë të përhapura në çdo gjuhë, por frazemat e krijuara në një gjuhë të caktuar nuk mbeten të izoluara brenda kësaj gjuhe. Ato udhëtojnë nga një gjuhë në të tjerat në sajë të marrëdhënieve midis popujve dhe gjuhëve. Kjo ndodh ngaqë, gjatë këtyre marrëdhënieve shumëshekullore, popujt e ndryshëm kanë këmbyer jo vetëm të mira materiale, por edhe vlera kulturore. Me kulturë duhet të kuptojmë njohuritë, besimet, zakonet, moralin, artin, ligjet etj. të përfuara nga njeriu si pjesëtar i shoqërisë. “Kultura mund të konsiderohet si shuma e të gjitha ideve mbi botën (duke përfshirë edhe idetë imagjinare, mitologjike etj.) të cilat janë karakteristike për një komunitet të caktuar”²³⁶.

Një formë e veçantë e shprehjes së kulturës është edhe gjuha, sidomos frazeologjia, brenda së cilës dallohen kryesisht **idiomat**. Nëse gjuha konsiderohet si mbartëse e kulturës, idiomat konsiderohen si elita e gjuhës. Nga kjo pikëpamje idiomat përbëjnë elementet më tipike të gjuhës dhe e bëjnë gjuhën më të gjallë dhe më piktoreske.

Çdo gjuhë ka idiomat e veta të cilat janë regjistruar ngjarjet historike, zakonet dhe traditat, realitetet e veçanta të kulturës kombëtare si dhe specifika e mentalitetit të popullit. Disa idioma mund të përdoren në mënyrë më universale se disa të tjera dhe mund të përkthehen më lehtë, ose kuptimi i tyre metaforik mund të nxirret më lehtë.

Ky këmbim kulture ka ndodhur në një shkallë të konsiderueshme midis popujve të vendeve me afërsi gjeografike dhe me kushte të përafërta historiko-shoqërore dhe natyrore, dhe me kontakte shoqërore, por edhe letrare. Një trevë e tillë është edhe Ballkani që është një pikë takimi e popujve dhe gjuhëve të ndryshme midis të cilave edhe shqipja dhe greqishtja. Për rrjedhojë, meqë idiomat përbëjnë elementet më karakteristike të fjalorit të një gjuhe, ekzistenca e paraleleve idiomatike²³⁷ midis dy apo më shumë gjuhëve paraqet interes të veçantë.

Në studimin tonë jemi kufizuar vetëm te krahasimi i idiomave, sepse idiomat përbëjnë pjesën qendrore të frazeologjisë në kuptimin e ngushtë dhe një nga prototipat e frazeologjisë në kuptimin e gjerë si më të ngurosuarat së bashku me proverbat.

Ndryshe nga proverbat një pjesë e të cilave kanë kuptim literal, idiomat karakterizohen të gjitha nga figurshmëria dhe, për rrjedhojë, e përfaqësojnë më thellësisht anën e figurshme të gjuhës si mbartëse të kulturës së bashkësisë gjuhësore që i ka krijuar dhe i që i përdor.

Idiomat hyjnë në pjesën më të përdorshme të frazemave jo vetëm nga pikëpamja e vlerësimit emocional të situatave, por edhe nga pikëpamja e mbushjes së zbrazëtive të leksikut.

Në këtë studim jemi përqendruar vetëm te krahasimi i idiomave midis gjuhës shqipe dhe gjuhës greke për arsyt e mëposhtme:

²³⁶ Piirainen, E. (2008). vep. e cit.

²³⁷ Në këtë përdorim termi *idiomatik* lidhet me idiomat dhe jo me idiomaticitetin apo me tërësinë e frazemave.

Arsyeja e parë është sepse shqipja dhe greqishtja janë dy gjuhë fqinje dhe me kulturë të ngjashme vëllimi idiomatik i të cilave përfshihet edhe në paralelet idiomatike ballkanike të kurorëzuara të “Fjalori frazeologjik ballkanik”, sepse, siç thekson Thomai et al. (1999), “Bashkësia gjuhësore ballkanike”, e krijuar në një truall historikisht të lashtë të bashkëjetesës së disa popujve indoevropianë, pasqyrohet në frazeologji edhe me paralele idiomatike të njëjta a të ngjashme ndërmjet gjuhëve”.

Një arsye tjetër lidhet me ekzistencën e një historiku krahasues dygjuhësh midis shqipes dhe greqishtes, si p.sh., Fliatouras (Φλιάτουρας, gr.) (2001); Dhima (2004), ndërkohë që krahasimi i shtuar prej nesh do të kontribuojë në plotësimin e pazllit idiomatik dygjuhësh.

7. 2. Prejardhja e idiomave greko-shqiptare

Në lidhje me prejardhjen e paraleleve idiomatike ballkanike dhe, rrjedhimisht edhe të paraleleve idiomatike greko-shqiptare, janë të pranueshme dy mundësi formimi²³⁸:

a) Ato mund jenë formuar brendapërbrenda gjuhëve, në mënyrë të pavarur e paralelisht me gjuhët e tjera, ashtu siç formohen edhe kategori të tjera leksiko-logjike si grupet sinonimike, antonimike etj

b) Ka gjithashtu mundësi të jenë formuar në një gjuhë në përputhje me gjedhen e një gjuhe tjetër si kalke idiomatike nëpërmjet huazimit. E përbashkët mbetet ideja mbi të cilën mbështetet kuptimi idiomatik i togfjalëshit. “Në fushën e analogjive del se e përbashkëta shprehet më shumë te pikënisja e ndërtimit semantik të njësisë idiomatike gjuhësore dhe të proverbave, gjëzave etj., ku në shumicën e rasteve shërben po ai nocion, po ajo ide në popuj të ndryshëm të Ballkanit (madje edhe jashtë Ballkanit)”²³⁹.

Mundësia e parë, thekson Chioti, ka forcë të vogël interpretuese, sepse janë të njohura marrëdhëniet e ngushta historike, socio-politike dhe gjuhësore midis popujve të Ballkanit, dmth., nuk janë të veçuar nga njëri-tjetri sa të mendohet për zhvillime paralele dhe të pavarura. Zakonisht huazimi i detyrohet bashkëjetesës së gjatë të gjuhëve në të njëjtat treva ose ekzistencës së dygjuhësisë, ndikimit të të një gjuhe të dallueshme (në fushën e fesë, të letërsisë, të shkencës etj.) (2010).

Siç përmend Setatos (Σεράτος, gr.) (1990), bashkëjetesa, kontakti dhe marrëdhëniet e larmishme midis dy ose më shumë gjuhëve përbëjnë premisat e njohura të dukurisë së interferimit dhe veçanërisht të huazimit të elementeve gjuhësore midis tyre.

Ky fakt shpjegon vështirësitë e veçanta që paraqiten në studimin e ndërmarrë kur kërkohet drejtimi i huazimit, sepse atëherë kërkohet njohje e plotë e evolucioni historik të gjuhëve në kontakt, gjë që rrallë vihet re, meqë ekzistojnë vështirësi objektive, p.sh., nga mungesa e të dhënave.

Për rrjedhojë, disa herë është e vështirë të dallojmë nëse një idiomë është rezultat e procesit të brendshëm apo huazim nga gjuhë të tjera. Në këtë rast duhet të studiohet a)nëse në historinë kulturore dhe shpirtërore të komunitetit gjuhësor ekzistojnë kushtet që lejojnë lindjen e shprehjes, b)nëse mënyra e veçantë e

²³⁸ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

²³⁹ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

përballimit të gjërave që pasqyrohet në këtë idiomë është e ndjeshme edhe në sektorë të tjerë të krijimtarisë gjuhësore dhe c) nëse idioma ekziston edhe në dialekte²⁴⁰.

Rrugët e huazimit të idiomave në zonën ballkanike duket se janë të shumta dhe konkretisht është e mundur që, siç thekson edhe Fliatouras (2001), një paralele idiomatike ballkanike:

Të jenë formuar në turqishte dhe të kenë kaluar në gjuhët ballkanike.

Të jenë formuar në greqishte dhe të kenë kaluar në gjuhët ballkanike.

Të jenë formuar në greqishte dhe të kenë kaluar në gjuhët ballkanike nëpërmjet latinishtes.

Të jenë formuar në latinishtes dhe të kenë kaluar në gjuhët ballkanike.

Të jenë formuar në një gjuhë neolatine dhe të kenë kaluar në gjuhët ballkanike.

Nga sa më lart rezulton se rrugët më të rëndësishme të huazimit të idiomave në zonën ballkanike janë greqishtja dhe, sidomos, turqishtja. Kjo i detyrohet kontaktit të ngushtë dhe bashkëjetesës së popujve të Ballkanit ku “këto dy gjuhë ishin zakonisht gjuha e dytë dhe e tretë e popujve të Ballkanit”²⁴¹ si rezultat i “zhvendosjes së popullsisë baritore, grupeve profesionale dhe njohjes së greqishtes si gjuhë dominuese dhe të turqishtes si gjuhë e pushtuesit nga popullatat e mëdha”²⁴².

Në lidhje me turqishten Lloshi & Thomai (1967) sugjerojnë se “fjalët turke janë treguese, që pritej të na çonin drejt burimit turk të këtyre njësive frazeologjike, porse nga ana tjetër, duke qenë se, siç dihet, turqishtja depërtoi mjaft në gjuhët e popujve të Ballkanit, elementet leksikore të turqishtes nuk duhen marrë gjithnjë si tregues të sigurt të burimit turk për tipat e frazeologjisë; të asimiluar plotësisht nga pikëpamja gjuhësore, këto elemente janë shfrytëzuar si të ishin elemente vetjake për të ndërtuar njësi frazeologjike tipash të ndryshëm brendapërbrenda kësaj apo asaj gjuhe”. Megjithatë, kjo i mbetet etimologjisë për ta saktësuar, dmth., se prejardhja dhe interpretimi i idiomave ballkanike duhet të bëhet me kujdes dhe veças për çdo idiomë në bazë të dëshmimeve të shkruara dhe të dhënave historike.

7. 3. Niveli i përkimeve të idiomave greko-shqiptare

Për sa i përket paraleleve idiomatike greko-shqiptare, ato përkojnë në të dy llojet e idiomave:

1) Në idiomat me formim normal, të formuara nga “shndërrimi i figurshëm i togfjalëshit të lirë në togfjalësh frazeologjik”²⁴³, si p.sh., *i doli për hundësh - του βγήκε από τη μύτη, ngre krye - σηκώνω κεφάλι, i ra hunda - του έπεσε η μύτη, i pret gjuha - η γλώσσα του κόβει, i kthej kurrizin - γυρίζω τα νότα, më hëngri veshët - μου έφαγε τ' αυτιά, do të të fus nën dhe - θα σε βάλω στο χώμα.*

2) Në idiomat me formim jo normal. “Karakteristikë është se në çdo rast kuptimi i tyre i mundshëm është vetëm ai frazeologjik. Ndërtime të tilla nuk ndeshen në gjuhë si togfjalësha të lirë, meqënëse atëherë nuk do të kishin kuptim”²⁴⁴, si p.sh., *s'ia pret*

²⁴⁰ Χιώτη, Α. (2010). vep. e cit.

²⁴¹ Φλιάτουρας, Α. (2001). Ελληνοαλβανικά φρασεολογικά ισογλώσσα με βάση τα μέλη και όργανα του ανθρώπινου σώματος, μια μικρή συμβολή, ALBANOHELLENICA, 2.

²⁴² Συμεωνίδης, Χ. (1990). Ιστορικοσυγκριτική γραμματική των ινδοευρωπαϊκών γλωσσών Θεσσαλονίκη: Κυριακίδης.

²⁴³ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

²⁴⁴ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

koka - δεν του κόφτετι το κεφάλι, *ha dru* - τρώγω ζόλο, *mos e prish gojën* - μη χαλάς το στόμα σου, *doli nga fjala* - βγήκε από το λόγο του.

Si në anën kuptimore edhe në pikëpamje të ndërtimit formal, analogjitë në njësitë frazeologjike mund të gjurmohen edhe në tipat ekzistues në të dyja gjuhët²⁴⁵:

Tipi kryesor është ai foljor, si p.sh., *vë në (ndër) mend* - βάζω στο νου μου, *jar fjalën* - δίνω το λόγο μου

Tipa të tjerë janë tipi emëror, tipi mbiemëror dhe tipi ndajfoljor, si p.sh., *kalë jeshil* - πράσινα άλογα, *(njeri) i hurit dhe i litarit* - (άνθρωπος) του σκοινιού και του παλουκιού, *me gjysmë goje* - με μισό στόμα, *me shpirt ndër dhëmbë* - με τη ψυχή στο στόμα.

Një tip i veçantë është edhe formimi i idiomave me strukturë krahasuese ku idiomat e ruajnë idenë e krahasimit, të shprehur ose jo gjuhësisht, si p.sh., *shkoi si qeni në vreshtë* që i përgjigjet në greqishte *πάει σαν το σκυλί στ'αμπέλι*, *m'u bë akrep/rrodhe* që i përgjigjet në greqishte *μου έγινε κολλιτσιδά*.

Situatën e paraleleve idiomatike ballkanike studiuesit e kanë vënë re që në fillimet e shekullit të kaluar dhe me to janë marrë një sërë studiuesish shqiptarë e të huaj të cilët kanë sjellë një kontribut të çmuar në ndriçimin e shumë problemeve që lidhen me ballkanizmat në fushën e frazeologjisë

Studimi i parë sistematik u bë me veprën e Papahagit (1908). Sigurisht që edhe para tij kishte punime që krahasonin idiomat sipas çifteve të gjuhëve, p.sh., rumanisht-shqip (Densusianu, 1901) apo greqisht-bullgarisht (Matof, 1893). Por Papahagi propozoi krahasimin midis katër gjuhëve, dmth., të rumanishtes, të shqipes, të greqishtes se re dhe të bullgarishtes. Ka edhe punime të tjera që vijojnë me publikimin e librit të Sandfeld (1930), të Lloshit & Thomait (1967) etj., të cilat i kanë dhënë një shtysë gjuhësisë ballkanike.

Produkti praktik i këtyre përpjekjeve është botimi i Fjalorit frazeologjik ballkanik (1999) në parathënie të të cilit pohohet se “siç dihet, që nga K. Sandfeld e, më pas, P. Papahagi, E. Cabej etj., është pohuar se ka një “bashkësi gjuhësore ballkanike”, e krijuar në një trevë historikisht të lashtë të bashkëjetesës së popujve, pra, që i kanë shtuar afritë gjuhësore tipologjike edhe me ndikime të ndërsjella. Në frazeologji kjo afri është llogaritur deri në 400-500 njësi, por e vërteta është se e kalon dhjetëfishin”, dmth., pretendohet për 4000-5000 njësi.

7. 3. 1. Idiomat me emra të pjesëve dhe të organeve të trupit të njeriut në shqipe dhe greqishte

Të ndikuar nga prurja e mësipërme teoriko-praktike në lidhje me idiomat ballkanike, hulumtues të tjerë e kanë përqendruar studimin e tyre në krahasime dygjuhëshe greko-shqiptare nëpërmjet fushave të caktuara leksikore.

Një fushë të veçantë leksikore ndërmori të studiojë Fliatouras (2001), i cili ka konstatuar një numër të konsiderueshëm idiomash të ndërtuara mbi bazën e emrave të pjesëve dhe të organeve të trupit të njeriut “nga të cilët janë përzgjedhur ata kryesorët: veshi, gjuha, dhëmbi, zemra, koka, syri, hunda, këmba, goja, dora”.

Sipas Fliatouras, një nga grupet më të shpeshta të idiomave janë ato që lidhen me pjesët dhe organet e trupit të njeriut. Kjo gjë është më se e natyrshme, sepse pjesët

²⁴⁵ Thomai, J. (1981). vep. e cit.

e trupit nga një anë kontribuojnë në përmbushjen e ndjenjave dhe të nevojave bazë të organizmit dhe nga ana tjetër përbëjnë pjesë të pandashme të entitetit biologjik dhe të funksionimit të njeriut. Kjo gjë justifikon edhe faktin se fjalët e kësaj fushe leksikore i përkasin të të ashtuquajturit fjalor bazë dhe se midis gjuhëve vihet re zhvillimi paralele i idiomave ekuivalente që lidhen me to, si p.sh., ανοίγω τα αφτιά μου = hap veshët, μου έφαγε τα αφτιά = më hëngri veshët, έχει μακριά γλώσσα = e ka gjuhën të gjatë, του λύθηκε η γλώσσα = iu zgjidh gjuha, έδειξε τα δόντια του = i tregoi dhëmbët, με νόχια και με δόντια = me thonj e me dhëmbë, βάζω το χέρι στην καρδιά = vë dorën në zemër, δεν έχει καρδιά = nuk ka zemër, δε σηκώνει κεφάλι = s'ngre kokë, είναι μεγάλο κεφάλι = është kokë e madhe, ανοίγω τα μάτια = hap sytë, βγάζω τα μάτια μου = nxjerr sytë, δε βλέπει πέρα από τη μύτη του = nyk sheh më larg se hunda e vet/ përtej hundës së vet, δεν κατεβάζει τη μύτη του = s'e ul hundën, πατώ πόδι = ngul këmbë, σηκώνομαι στα πόδια = çohem në këmbë, άλλαξε πλοσσωπο = ndërroi fytyrë, άνθρωπος με δύο πρόσωπα = njeri me dy fytyra, ανοίγω το στόμα = hap gojën, έχει (ένα) στόμα φτυάρι = e ka gojën lopatë, άλλαξε χέρι = ndërroi dorë, απλώνω το χέρι = ndej/shtrij/zgjat dorën, etj (2001).

Përveç paraqitjes së ekzistencës së paraleleve idiomatike me emra të pjesëve dhe organeve të trupit, autori (Fliatouras) i kushton rëndësi edhe prejardhjes së tyre. “Për sa i përket interpretimit, ai u bë në kuadrin e bashkësisë gjuhësore ballkanike dhe të ndikimit turk”. Sipas autorit, interpretimi i ndikimit të veçantë të turqishtes “rezulton nga teza e Symeonidis-it (1997) se shumë idioma ballkanike dhe madje ato që lidhen me pjesë dhe organe të trupit të njeriut mbështeten në modele idiomatike turke. Mbi bazën e kësaj vërejtjeje dhe të materialit në artikullin e Symeonidis-it, mund të bëjmë këto korrespondime midis turqishtes, greqishtes dhe shqipes: ... turq. dili çözülmek = gr. λύνεται η γλώσσα μου = shq. m'u zgjidh gjuha; ... turq. gözünü açmak = gr. Ανοίγω τα μάτια σε κάποιον = shq. i hap sytë dikujt; ... turq. göz atmak = gr. ρίχνω ένα μάτι = shq. hedh një sy; ... turq. burnunu sokmak = gr. χωνω τη μύτη μου = shq. fut hundët etj.

Në konkluzionet e trajtimit të fushës së tij leksikore, Fliatouras ka vënë re se “grumbullimi i materialit u bë me kujdes, sepse në literaturën gjuhësore shpesh vihet re dukuria që disa idioma që paraqiten si korrespondues në greqishte dhe në shqipe ose **nuk lidhen midis tyre**, ose **nuk ekzistojnë në një nga të dy gjuhët**”, siç janë rastet e mëposhtme që ne kemi konstatuar në Fjalorin frazeologjik ballkanik: *δε μου κάνει το χέρι për s'më bën dora, *του κάνει με το χέρι për ia bën me dorë, *έμεινε με τα χέρια στον κόρφο për mbeti me duar në gjë, *με το χέρι στο περίστροφο për me dorën në koburë, *τραβώ χέρι për heq dorë, *του έδωσε τα χέρια për i dha duart, *έκανε πόδια për ka bërë këmbë, *δε μου κάνουν τα πόδια për nuk më bëjnë këmbët, *έστρειψε το πόδι për e drodhi këmbën, *τα κρύβει τα πόδια për i fsheh këmbët etj.,

7. 3. 2. Idiomat me emra kafshësh në shqipe dhe greqishte

Përveç idiomave të ndërtuara me emra që shënojnë pjesë dhe organe të trupit të njeriut, një vend të konsiderueshëm në shqipe dhe greqishte zenë edhe idiomat që ndërtohen mbi bazën e emrave që tregojnë kafshë. Idiomat e ndërtuara me emra që tregojnë kafshë janë studiuar nga Dhima (2004) në artikullin e tij “Shprehje frazeologjike të shqipes dhe të greqishtes që ndërtohen me emra kafshësh” (Locutions phraséologiques de l'albanais et du grec ayant à la base les noms d'animaux, fr.). Në

këtë punim Dhima thekson se populli shqiptar dhe ai grek kanë mjaft pika takimi në historinë e tyre, një mënyrë jetese thuhet të njëjtë si edhe kushte pune dhe natyrore pak a shumë të njëjta. Në të dyja anët e kufirit në hapësira jo pak të gjera ekzistojnë të njëjtat kafshë të buta e të egra. Jeta e njerëzve ka qenë dhe është e lidhur me këto kafshë si një burim i rëndësishëm jetese. Këto kushte të përbashkëta të jetës materiale si dhe marrëdhëniet ekonomiko-kulturore kanë sjellë ngjashmëri midis shqipes dhe greqishtes në fushën e frazeologjisë në përgjithësi dhe në ato frazeologji që lidhen me emra kafshësh. Shumica e frazeologjizmave ndërtohen me emrat e kafshëve më të njohura të buta e të egra me të cilat njeriu kishte të bënte më shumë në jetën e përditshme, si: *buall, derr, dele, ka, kalë, gjel, kokosh, lepur, lopë, mace, mi, mushkë, peshk, plesht, pelë, pulë, qen, qyqe, etj.* dhe më pak krijohen me emra kafshësh më të rralla ose që nuk ekzistojnë fare në këto treva, si: *ari, arushë, deve, krokodil, luan, tigër etj.*

Autori i mësipërm pohon se në korpusin e materialeve të tij janë përfshirë të gjitha njësitë që kanë në bazë një emër gjallese që tregon kafshë të butë shtëpiake, kafshë të egër pylli, shpendë të buta e të egra, insekte të ndryshme, peshq etj., duke u bazuar kryesisht në Fjalorin frazeologjik ballkanik (sidomos për korpusin në gjuhën greke), në FGJSSH (1980) si dhe në Fjalorin frazeologjik të J. Thomait (1999). Shumica e njësive kanë fjalë bosht një emër që tregon gjallesë, kurse një pjesë e vogël, rreth një e katërta e përmbajnë një emër të tillë, po kanë si fjalë bosht folje ose një fjalë tjetër.

Shumica e frazeologjizmave që kanë në bazë një emër kafshe të shqipes dhe të greqishtes kanë të njëjtën përbërje semantike, leksikore dhe strukturore, si p.sh., shq. *E zë demin për brirësh* = gr. *Πιάνει το ταύρο από τα κέρατα*, shq. *Ta pjek peshkun në buzë* = gr. *Σου ψένει το ψάρι στα χείλη etj.*

Pak prej këtyre frazeologjizmave kanë ndryshime të vogla nga njëra gjuhë në tjetrën. Në një pjesë të tyre emrit të kafshës në frazeologjinë shqipe i përgjigjet një emër tjetër që nuk shënon kafshë në greqisht, p.sh. idiomës shqipe *m'u bë akrep* i përgjigjet në greqisht *μ'ου έγινε κολλιτσίδα*.

Është vënë në dukje se një tip idiomë me të cilat shqipja gjen analogji me gjuhë të tjera të Ballkanit është ai që ruan idenë e krahasimit, shpeshherë të shprehur edhe gjuhësisht me lidhëzën *si*, si p.sh., shq. *(Rri) si mi i lagur* = gr. *(Κάθεται) σαν βρεγμένη γάτα*, shq. *(Mbeti) si peshku në zall* = gr. *(Εμεινε) σαν το ψάρι έξω από το νερό etj.*

Por në vijim të përfundimeve të Dhimës për idiomat e ndërtuara me emra kafshësh në shqipe dhe në greqishte shtojmë dyshimin se ka apo jo kaq shumë përkime midis idiomave me emra kafshësh. Për verifikimin e ekzistencës së shumë idiomave greke të paraqitura si kalke idiomatike në Fjalorin frazeologjik ballkanik iu drejtua fjalorëve të të dy gjuhëve, sidomos atij të greqishtes, dhe konstatoam se shumë idioma të kalkuara të greqishtes të paraqitura në Fjalorin frazeologjik ballkanik nuk përbëjnë përkime reale të idiomave të shqipes, si p.sh., **πλένει το κεφάλι του γαϊδάρου*, **του γεννάει κι'ο πετεινός*, **το ζητά σαν τη χελώνα το καπφί*, **σαν το γουρούνι στο κλουβί*, **κάθεται σαν το βρεγμένο ποντικό etj.*

7. 3. 3. Idiomat me emra frutash dhe perimesh në shqipe dhe greqishte

Në vazhdim të krahasimit të idiomave greko-shqiptare po ndërmarrim studimin krahasues të idiomave të një fushe tjetër leksikore, asaj me emra të frutave dhe

perimeve midis shqipes dhe greqishtes. Gjatë studimit krahasues të këtyre idiomave do të përqendrohemi në mënyrë të hollësishme në mundësinë e korrespondimit kuptimor të tyre.

Edhe në fushën leksikore me emra të fruta-perimeve, si në fushat e tjera me emra të pjesëve dhe organeve të trupit të njeriut dhe me emra kafshësh, emrat e fruta-perimeve kanë ngarkesë të mjaftueshme kulturore në të dyja gjuhët për të ndërmarrë një studim krahasues.

Frutat, dhe kryesisht perimet, kanë qenë dhe janë burim i rëndësishëm jetese si dhe një nga elementet kryesore të kuzhinës për të dy popujt. Ato kanë qenë pjesë e aktivitetit të përditshëm tregtar të një pjese të mirë të popullsisë të të dy vendeve që në kohët e lashta deri më sot. Kjo justifikon faktin se fjalët e kësaj fushe leksikore i përkasin të të ashtuquajturit fjalor bazë të gjuhës. Shumica e idiomave ndërtohen me emrat më të njohura të frutave dhe perimeve me të cilat njeriu kishte të bënte më shumë në jetën e përditshme, si p.s.h., *arra-καρύδι*, *dardha-αχλάδι*, *fiku-σύκο*, *molla-μήλο*, *rrushi-σταφύλι*, *bathët-κουκιά*, *hudhra-σκόρδο*, *lakra-λάχανα* etj. dhe aspak me emrat e frutave jo karakteristike të traditës bujqësore të këtyre vendeve, si p.sh., *ananasi-ανανάς*, *avokadi-αβοκάντο*, *kivi-ακτινίδι*.

Qëllimi i studimit tonë është të shikohet nëse ka apo jo idioma paralele midis idiomave me emra frutash dhe perimesh të shqipes dhe të greqishtes. Pikënisje për studimin tonë u bë përfshirja e shumicës dërmuese të këtyre fjalëve në idioma, dmth., ngarkesa e tyre kulturore, dhe afërsia kulturore dhe gjeografike midis popujve që mbartin këto gjuhë. Metoda e përdorur është nxjerrja e idiomave me fjalë të fushës së fruta-perimeve nga fjalorë shpjegues dhe nga fjalorë frazeologjikë të të dy gjuhëve dhe përqsja kuptimore midis tyre. Me idioma me fjalë përbërëse emra frutash dhe perimesh do të kuptojmë ato shprehje ku të paktën një përbërës është një emër frutash apo perimesh.

Të dhënat dhe përpunimi i tyre.

Fusha leksikore e emrave të fruta-perimeve përfshin 50 fjalë: 28 fjalë frutash dhe 22 fjalë perimesh në shqipe dhe po aq në greqishte. Shumica prej tyre përfshihen në ndërtimin e idiomave, si p.s.h., *arra-καρύδι*, *dardha-αχλάδι*, *gështenja-κάστανο*, *molla-μήλο*, *bathët-κουκιά*, *domatja-ντομάτα*, *kungulli-κολοκύθι*, *preshi-πράσο* etj. Ndërsa disa nuk hyjnë në përbërjen e idiomave në asnjë gjuhë. Të tilla janë 11 emra frutash dhe 8 emra perimesh, si p.s.h., *bajamja-αμόγδαλο*, *hurmajja-ουρμάς*, *bamja-μπάμια*, *patëllxhane-μελιτζάνα*, *bizelet-μπιζέλια*, *lulelakër-κουνουπίδι*, *spinaki-σπανάκι*, apo emrat e frutave jo karakteristike të traditës bujqësore të këtyre vendeve që u përmendën më sipër.

Në shqipe, idiomat me emra frutash janë rreth 80, me emra perimesh rreth 60, ndërsa në greqishte ka rreth 20 idioma me emra frutash dhe rreth 15 me emra perimesh.

Për gjuhën shqipe, fjalët e përfshira në më shumë idioma janë ferra në shprehje si: *çau ferrën (dushkun)*, *ferra e nisi*, *ferra e grisi*, *hodhi një gur në ferrë*, *hedh kripë në ferra*, *i hynë ferrat*, *e mori ferra fjalën*, *e mori ferra uratën*, *nuk i ngjitej (nuk e kapte) ferra askund (asgjekund, gjëkund)*, *lakra në shprehje si: e bëri lakër diçka, u bë lakër, hyri nëpër lakra, i ka rënë shiu në lakra, i dolën (iu zbuluan) lakrat lakrorit*, *dardha në shprehje si: ka rënë në dardhë, I doli dardhë diçka, do t'i dalin dardhat dikujt, është rrëzuar (një herë) nga dardha dikush, kërkon dardha (thana, thanëza,*

rrush) në shënëndre (në dimër), arra në shprehje si: *arrë fyçkë, arrë në gojë, i marr (i ha) arrat dikujt, s'i mban goja arra dikujt, të thyen arrën në dorë, thyej arra kot, bathë në shprehje si: i humbi batha, u ngopa me bathë, siç duken (siç tregojnë) bathët, s'i ka bathët mirë (të mbara)*. Për greqishten, fjalët e përfshira në më shumë idioma janë κάστανο (gështenjë) në shprehje si: *δεν χαρίζω κάστανα, βγάζω τα κάστανα από τη φωτιά, δεν τρέχει κάστανο*, dhe λάχανα (lakra) në shprehje si: *σιγά/σπουδαία τα λάχανα, τρώω κάποιον λάχανο*. Fjala më e përdorur në idiomat për shqipen është ferra e përfshirë në 19 shprehje, ndërsa për greqishten është fjala κάστανο (gështenja) e përfshirë në tri shprehje.

Disa fjalë përbëjnë elemente idiomash në një gjuhë, por jo te tjetra. Kështu, përfshihen në idioma të shqipes, por jo të greqishtes, fjalët ferra, limoni, mani, elbi, tërshëra, ndërsa në idioma të greqishtes, por jo të shqipes, përfshihen fjalët βερίκοκο (kajsia), πεπόνι (pjepri), κεράσι (qershija), ρόιδο (shega), φακές (thjerrëzat). Kështu, kemi idioma me limon, si p.sh., *limon i shtrydhur, nuk hahet as me limon dikush, s'priset dasma për një limon*, por jo me λεμόνι (limon) në greqishte. Po ashtu kemi me ρόδι (shegë), si p.sh., *τα κάνω ρόιδο, σπάει το ρόδι*, por jo me shegë në shqipe.

Numri i fjalëve të përfshira në idioma është i njëjtë në të dy gjuhët, por shqipja ka rreth katër herë më shumë idioma. Këtu është për t'u theksuar se shumë idioma janë formuar jo nga emrat e frutave, por nga pemët e tyre, si p.sh., *është rrëzuar (një herë) nga dardha dikush: e ka pësuar një herë dhe ka vënë mend, την κούνησα την αχλαδιά: είχα σεξουαλική επαφή*.

Nga përqasja kuptimore që iu bë idiomave me përbërës të njëjtat fjalë të fushës së fruta-perimeve, rezultoi se ka shumë pak paralele idiomatike. E tillë është shprehja *mollë sherri - το μήλον τής Έριδος*, në shqipe dhe në greqishte respektivisht, apo e *zunë me domate dikë - παίρνω με τις ντομάτες (κάποιον)*, ndaj *bykun nga gruri (nga egjra) - ξεχωρίζω την ήρα από το σιτάρι, i të cilat*, megjithëse kanë të njëjtin modelim konceptor, kanë përbërës të ndryshëm leksikorë, si p.sh., në vend të përbërësve *zë* dhe *byku*, kemi *παίρνω* dhe *ήρα* në të dy gjuhët respektivisht, ose e *kapën (e zunë, e gjetën) me presh në dorë (me duar në presh) - πιάνω/τσακώνω (κάποιον) στα πράσα dhe te i nxjerr gështenjat (nga zjarri) me duart e të tjerëve - βγάζω τα κάστανα από τη φωτιά*, të cilat, megjithëse kanë të njëjtin modelim konceptor, kanë modelim të ndryshëm strukturor.

Veçanësia e idiomave që studiojmë shprehet edhe në ndërtimet e ndryshme gjuhësore që karakterizojnë një gjuhë, por që nuk gjenden, apo janë të rralla, në gjuhën tjetër. Kështu, shumë idioma të shqipes ndërtohen duke ruajtur idenë e krahasimit dhe duke e shprehur atë edhe gjuhësisht me lidhëzën *si*. Midis tyre mund të përmendim idiomat: *si fiku me arrën, si pjergulla në fik të bardhë, si kokërr molle, si rrushi e koshi, shkoi (u vra) si qeni në rrush, humbi si fasulja në vegsh, ra si pula ne grurë, kakaris si pula pa grurë, është hapur si vaji në lakra, sikur qeni qepën të hajë!* Në këtë tip shqipja nuk ka analogji tipologjike me greqishten brenda fushës leksikore që studiojmë.

Ndryshe nga grupi i idiomave të shqipes, në greqishte vëmë re edhe një model të veçantë organizimi të idiomave, atë me elips. Në shumë idioma mungon folja *jam*, gjë që e bën më të kondensuar mendimin. Të tilla janë idioma: *μάπα το καρπούζι, σπουδαία τα λάχανα, σιγά τα λάχανα σκόρδο ο ένας, κρεμμύδι ο άλλος*.

Si përfundim mund të themi se ka shumë pak idioma të ndërtuara me të njëjtat fjalë nga fusha e frutave dhe e perimeve që korrespondojnë midis tyre. Kjo nxjerr në pah edhe problemin e përkthimit të idiomave i cili mbetet të zgjidhet jashtë fushës frazeologjike, me njësi njëfjalëshe ose me perifrazime. Shumë nga këto mospërkime janë paraqitur si përkime idiomatike në Fjalorin frazeologjik ballkanik, si p.sh., **καρύδι στο στόμα për arrë në gojë, *είναι στη ρίζα της αχλαδιάς për është në rrëzë të dardhës, *έπεσε από τη σοκιά për ra (zbriti, u rrëzua) nga fiku*²⁴⁶. Këto “përkime” idiomatike mbështeten në kalke të painstitucionalizuara për gjuhën e atdheut mëmë (greqishtja letrare). Shprehjet idiomatike të kalkuara tingëllojnë si të huaja për grekët që banojnë në kufijtë e shtetit grek dhe kryesisht larg Epirit që përbën brez kontakti të shqipes me greqishten; ato nuk ruajnë dhe as bartin tek lexuesi (grek) kuptimin e shprehjes idiomatike burimore, i cili, siç dihet, nuk është i njëjtë me shumën e kuptimeve të përbërësve leksikorë të saj. Në këto raste “kemi të bëjmë thjesht me *pasojat e kontaktit intensiv dhe asimetric të shqipes me greqishten* në territore ku folësit e këtyre dy gjuhëve takoheshin e takohen përditë e ku, qyshkur pakica kombëtare greke u përfshi në kufijtë politikë të shtetit shqiptar dhe mbeti e izoluar nga trangu amë për mbi gjysmë shekulli, shqipja ka qenë gjuhë dominante dhe ka lënë gjurmë të shumta në të folmet greke të trojeve në jug të Shqipërisë. Frazeologjia nuk mund të bënte përjashtim nga ky proces”²⁴⁷.

Ndonjë “përkim” idiomatik, si p.sh., *janë bathët të numëruara = μετρημένα κουκιά* çon në miq të rremë semantikë, siç ndodh në Fjalorin frazeologjik ballkanik, sepse, edhe pse të dyja shprehjet kanë përbërje të njëjtë leksikore, ato kanë kuptime të ndryshme, dmth., *janë bathët të numëruara* përdoret për mundësi ekonomike të kufizuara të dikujt, ndërsa *μετρημένα κουκιά* përdoret për përlllogaritje të saktë të gjërave në një situatë të caktuar. Miq të rremë semantikë gjejmë edhe në idiomat e fushave të tjera leksikore, si p.sh., *e hëngri me sy = *τον έφαγε με το μάτι, i ka hapur syrin = *του έχει ανοίξει τα μάτια*, sepse *τον έφαγε με το μάτι* ka kuptimin “*e shikoj dike me ngulm*”, ndërsa *τον έχει ανοίξει τα μάτια* ka kuptimin “*ndihmoj dikë të shikojë të vërtetën*” të cilat nuk janë korresponduesit kuptimorë të idiomave shqipe *e hëngri me sy* dhe *i ka hapur syrin*.

Si konkluzion i përgjithshëm mbi përkimet greko-shqiptare mund të themi se **nuk duhet të jenë aq shumë sa pretendohet në Fjalorin frazeologjik ballkanik**. Për këtë vlerësim mbështetemi në mospërkimet idiomatike të fushës me emra të fruta-perimeve, të cilat paraqiten si përkime idiomatike në Fjalorin frazeologjik ballkanik, si p.sh., **καρύδι στο στόμα për arrë në gojë, *είναι στη ρίζα της αχλαδιάς për është në rrëzë të dardhës, *έπεσε από τη σοκιά për ra (zbriti, u rrëzua) nga fiku etj.*, në rastet e mospërkimeve brenda fushës me emra kafshësh të Dhimës, si p.sh., **πλένει το κεφάλι του γαϊδάρου për i lan kokën gomarit, *του γεννάει κι'ο πετεινός për i pjell edhe këndesi, *το ζητά σαν τη χελώνα το καπρί (e kërkon) si breshka gozhdën, *σαν το γουρούνι στο κλουβί si derri në kotec (thark, *κάθεται σαν το βρεγμένο ποντικό për*

²⁴⁶ Thomai, J. et al. (1999). vep. e cit.

²⁴⁷ Qirjazi, D. (2010). Rrugë të çelura e shtigje të pashkelura: I pari fjalor frazeologjik ballkanik, hartuar në drejtimin e akad. Jani Thomai. Në: Akademiku J. Thomai në 75-vjetorin e lindjes, Korçë.

(rri) si mi i lagur etj., në vlerësimet teorike të Fliatouras sipas të cilit disa idioma që paraqiten si korrespondues në greqishte dhe në shqipe nuk ekzistojnë në një nga të dy gjuhët, siç janë disa nga rastet që ne kemi konstatuar në Fjalorin frazeologjik ballkanik: *δε μου κάνει το χέρι për s'më bën dora, *του κάνει με το χέρι për ia bën me dorë, *έμεινε με τα χέρια στον κόρφο për mbeti me duar në gj, *με το χέρι στο περίστροφο për me dorën në kobure, *τραβώ χέρι për heq dorë, *του έδωσε τα χέρια për i dha duart, *έκανε πόδια për ka bërë këmbë, *δε μου κάνουν τα πόδια për nuk më bëjnë këmbët, *έστρεψε το πόδι për e drodhi këmbën, *τα κρύβει τα πόδια për i fsheh këmbët etj., të cilat nuk ekzistojnë në greqishten letrare, si dhe mbi gjykimin e Qirjazit se përkthimi fjalë për fjalë i një shprehjeje idiomatike krijon vështirësi kuptimore, gjë gjë që duket në rastin e shembujve që janë të kapshëm në zonat e kontaktit të gjuhëve, por që bëhen gjithnjë e më pa kuptim sa më shumë largohemi nga brezat e kontaktit dhe tingëllojnë si të huaja për grekët që banojnë në qytetet e mëdha dhe gjithsesi larg zonës së Epirit, si dhe shembujve të sjellë nëpërmjet kalkeve të painstitucionalizuara, të konstatuara prej tij, si p.sh., sot për sot *σήμερα για σήμερα, tani për tani *τώρα για τώρα, brenda për brenda *μέσα για μέσα, nuk pi ujë [diçka] *δεν πίνει νερό, s'më rrihet në një vend *δε μου κάθεται σ' ένα τόπο, s'i bëhet vonë *δεν του πάει αργά, jap zemër *δίνω καρδιά, marr zemër *παίρνω καρδιά, nuk ha shqip *δεν τρώει αλβανικά, më vjen keq *μου ρχεται κακά, etj.

Në “idiomat gjegjëse” greke vihen re ndryshime jo vetëm në nivel leksikor, por edhe në nivel stilistik, si p.sh., pagëzimi i zjarrit libr. = η βάφτιση (to βάφτισμα) της φωτιάς e përdorur në vend të to βάπτισμα του πυρός, por edhe në nivel fonetik, si p.sh., η βάφτιση (to βάφτισμα) της φωτιάς e përdorur në vend të to **βάπτισμα** του πυρός, në nivel morfologjik, si p.sh., fole grerëzash = φωλιά σφηκών e përdorur në vend të **σφηκοφωλιά**, në nivel morfo-sitaksor, si p.sh., i ra në dorë = του έπεσε στο χέρι e përdorur në vend të του έπεσε **στα χέρια**, por edhe ndryshime në topikën e elementëve të idiomave gjatë kalimit nga njëra gjuhë në tjetrën, si p.sh., iu muar goja = του πάρθηκε το στόμα e përdorur në vend të μπερδεύτηκε/σκόνταψε η γλώσσα **του**), si dhe në trajtën gramatikore, si p.sh., ka gjetur tenxherja kapakun = έχει βρει ο τέντζερης (η κατσαρόλα) το καπάκι του (της) e përdorur në vend të **βρήκε** ο τέντζερης το καπάκι) (shih edhe Qirjazi, 2010).

Lënda e renditur më lart vërteton edhe një herë se ekuivalencat e shprehjeve idiomatike në dy a më shumë gjuhë nuk përftohen nga përkthimi fjalë për fjalë i tyre. Megjithatë, në kushte të caktuara, kur përgjithësohen fillimisht në brezin e kontaktit të gjuhëve, kalket idiomatike bëhen pjesë e gjuhës së përditshme të personave bilingë, por nuk kanë prirjen të marrin një shtrirje më të gjerë, tej kufijve gjeografikë të zonës ku ndërkalen gjuhët.

Mbetet të ndërmerren të tjera studime të hollësishme krahasuese si të rastit të idiomave të fushës leksikore me emra të frutave dhe perimeve për të parë nivelin real të përkimeve idiomatike greko-shqiptare.

7. 4. Arsye përputhjeje dhe mospërputhjeje së idiomave greko-shqiptare
Zhvillimi i idiomave të njëjta brenda të dyja gjuhëve, ashtu si dhe midis gjuhëve të tjera, i detyrohet perceptimeve dhe zakoneve të njëjta që kanë të dy popujt për botën dhe shoqërinë. Kjo ka ardhur nga bashkëjetesa shumëshekullore gjatë së cilës të dy popujt kanë shkëmbyer jo vetëm të mira materiale, por edhe vlera kulturore, nga kushtet e ngjashme natyrore dhe nga mënyra e jetesës.

Në këtë përshtatje, dmth., në përthithjen e idiomave paralele nga të dyja gjuhët, kanë kontribuar edhe ngjashmëritë gjuhësore, si p.sh., rendi i lirë në ndërtimin e fjalisë në të dyja gjuhët, mosdetyrimi i përdorimit të kryefjalës nga të dyja gjuhët si dhe fakti se të dyja janë gjuhë flektive.

Në përfundim të këtij trajtimi mund të themi se shumë idioma të shqipes nuk kanë paralele në greqishte dhe anasjelltas, jo për arsye të veçanësive kulturore apo kombëtare, por për faktin se gjuhët e ndryshme ndjekin rrugë të ndryshme në lidhje me rinterpretimin semantik. Me gjithë afritë midis dy popujve si popuj me kultura të përafërta dhe me marrëdhënie të konsiderueshme, midis dy vendeve si vende fqinje dhe midis dy gjuhëve si gjuhë me struktura të përafërta, spikat origjinaliteti i secilës bashkësi gjuhësore në konceptimin e realitetit. Këto idioma përbëjnë një zhvillim origjinal dhe të paparashikueshëm të gjuhës. Kjo bën që idiomat e gjuhëve në studim të jenë specifike për çdo kulturë. Çdo gjuhë ka stilin e vet gjuhësor që Humboldt e ka quajtur vizioni mbi botën. Çdo sistem gjuhësor përfshin brenda vetes një analizë të botës së jashtme, një analizë që është e tij dhe që është e ndryshme nga ajo e gjuhës tjetër. Folësit e lindur të gjuhëve të ndryshme e shikojnë botën nga këndvështrimi i tyre dhe shikojnë diçka speciale, të paparë nga një komb tjetër. Çdo gjuhë është formuar brenda një peizazhi të përcaktuar dhe që varet nga një përvojë e dallueshme dhe e papërsëritshme.

KREU VIII FRAZELOGJIA SI DISIPLINË MË VETE DHE KUFIJTË E SHTRIRJES SË SAJ

Mendimet se ku duhet vendosur frazeologjia nuk janë të njëjta. Disa studiues nuk e perceptojnë frazeologjinë si një disiplinë më vete, por e paraqesin si një nënndarje të leksikologjisë, e cila merret me studimin e lidhjeve të fjalëve sesa me fjalë të vetme. Nga ana tjetër, ka studiues që e konsiderojnë frazeologjinë si një disiplinë të pavarur.

Themelet teorike për analizën funksionale dhe semantike të njësive frazeologjike në kuadër të leksikologjisë u hodhën nga Bréal dhe nga Bally. Mendimet e para teorike mbi njësitë frazeologjike u ndërmorën në semantikë. Në një kapitull kushtuar “Historisë së fjalëve”, Bréal (1897) deklaronte: “Po të konsideronte vetëm fjalët ai që do të bënte historinë e ndryshimit të fjalëve, do të rrezikonte të linte t’i shpëtonin një pjesë e fakteve, ose do të rrezikonte t’i shpjegonte gabim. Gjuha nuk përbëhet vetëm nga fjalët: ajo përbëhet nga grupe fjalësh dhe nga fjali”.

Edhe gjuhëtari zviceran Bally nuk e konsideronte të nevojshme ta përcaktonte frazeologjinë si një disiplinë të veçantë. Ai e përfshin atë në strukturën e shkencës leksikologjike dhe njësitë frazeologjike i studioi kryesisht në aspektin stilistik, sepse “Bally mendon se thelbi i frazeologjizmit qëndron në natyrën e tij semantike”²⁴⁸

Arsyeja e studimit të frazemave nga leksikologjia është kuptimi i tyre i ri – kuptim i gjithë strukturës së qëndrueshme, dmth., si barasvlerës i fjalës, ose kuptimi i një përbërësi të saj. Në lidhje me kuptimin e ri të gjithë strukturës së qëndrueshme Thomai (2006) thekson se “te njësia frazeologjike gjithë togu frazeologjik shënon një koncept të vetëm. [...] P.sh., te togfjalëshi frazeologjik *kokë e madhe* “*njeri i shquar, i zoti dhe i zgjuar*” synimi nuk është të shënohet realja *kokë* dhe cilësia e saj *e madhe*, po të emërtohet një njeri sipas një tipari që ka.[...] Ky tipar është edhe një nga arsyet kryesore që njësitë frazeologjike studiohen, bashkë me leksikon, në leksikologji”.

Zhvillimi i frazeologjisë si disiplinë më vete u nxit nga kërkimet ruse mbi ndryshimet leksikore dhe semantike dhe të shfaqjeve frazeologjike të grupeve të fjalëve, si dhe nga interpretimi i grupit të fjalëve si një kategori sintaksore që funksionon si një fjalë e vetme. Si shkencë gjuhësore e pavarur frazeologjia u përvijua për herë të parë në shekullin XX nga shkencëtari rus Vinogradov i cili përcaktoi objektin, strukturën dhe vëllimin e shkencës frazeologjike. Siç thekson Cowie (1998), tradita ruse meriton nderim të veçantë për sanksionimin e frazeologjisë si një disiplinë më vete.

R. Eckert (1976) konstaton se frazeologjia nuk është më një zonë marxhinale e kërkimit gjuhësor, por është zhvendosur në zonën qendrore të teorisë së gjuhës. Me gjithë përplasjet shkencore për shumë probleme qendrore të saj ajo përbën një specialitet të pavarur që 1)studion një zonë relativisht të pavarur të gjuhës dhe për më tepër 2)disponon objekt të saj kërkimi si dhe 3)metodat e saj kërkimore dhe përshkruese. Si rrjedhojë e tendencave të reja që vihen re vitet e fundit në kërkimet frazeologjike, Eckert shikon faktin se frazeologjia del gjithnjë edhe më shumë nga

²⁴⁸ Συμεωνίδης, X. (2000). Εισαγωγή στην ελληνική φρασεολογία. Κώδικας, Θεσσαλονίκη.

kufijtë e sundimit të leksikologjisë, sepse dukuritë shoqërore pasqyrohen më dukshëm në frazeologji sesa në leksikologji: kjo va vlerë të veçantë kryesisht të frazeologjizmat e komunikimit.

Tashmë, studimet kanë arritur në një nivel të tillë, sa mund të thuhet, si pohon Thomai, se frazeologjia është formuar si disiplinë gjuhësore, me objektin, me lëndën e me metodat e veta²⁴⁹.

Por akoma edhe sot autorët janë të ndarë midis atyre që e etiketojnë frazeologjinë si një disiplinë të veçantë (shih González Rey, 2002) dhe atyre që e katalogojnë thjesht si një dukuri leksikologjike (shih Hausmann, 1997).

Sot, në ish republikën sovjetike kërkimet frazeologjike studiohen si disiplinë e pavarur gjuhësore, ndërsa në kërkimet gjermanofone frazeologjia konsiderohet si degë e leksikologjisë (shih Fleischer, 1982).

Në vijim të rrugës së nisur nga Vinogradov dhe të pasuar nga Eckert, Cowie, Thomai etj. si dhe të bazuar në studimet tona të thelluara në fushën e frazeologjisë dhe të konstatimeve të bëra, mendojmë se frazeologjia është formuar si disiplinë gjuhësore, me objektin, me lëndën e me metodat e veta” (shih Thomai, 1999). Pas përfshirjes për një kohë të gjatë në leksikologji, frazeologjia po i nënshtrohet procesit të ndarjes si një disiplinë më vete. Si arsye ndarjeje të frazeologjisë nga leksikologjia do të propozonim arsyet e mëposhtme:

Frazeologjia përbën disiplinë më vete, sepse ka objektin e saj të kërkimit, metodat dhe lëndën e saj.

Ndërsa leksikologjia studion fjalët dhe kuptimin e tyre, frazeologjia studion lidhjet e qëndrueshme që karakterizohen nga forma dhe struktura sintaksore, kuptimi i së cilave është i ndryshëm nga shumica e thjeshtë e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse. P.sh., *çelës anglez* nuk është një çelës çfarëdo i prodhuar në Angli apo me prejardhje nga Anglia, por është një çelës i caktuar “*me nofulla që hapen e mbyllen sipas nevojës*”, pavarësisht nga vendi i prejardhjes së tij.

Nëse frazemat do të konsideroheshin vëllezër të barasvlershëm të fjalëve dhe për rrjedhojë do të kishin të njëjtën sjellje, nuk do të nevojitej disiplina e veçantë e frazeologjisë. Por nuk ndodh kështu dhe kjo është arsyeja që frazeologjia po konturohet si disiplinë më vete. Frazemat mund të jenë edhe kategori sintaksore me vlerë sintagme, apo me vlerë fjalie dhe jo vetëm me vlerë fjale. Kuptimi i fjalëve në lidhjet e qëndrueshme është i kushtëzuar, ndryshe nga kuptimi i fjalëve në lidhjet e lira, të cilat janë të lira të përdoren në një numër të pakufizuar lidhjesh me këtë kuptim.

Akoma, po të mos flitej për kuptim të mbartur të frazemave, atëherë sintagmat e qëndrueshme do të studioheshin vetëm për llogari të lidhjes së veçantë sintaksore dhe atëherë s’do të ishte e nevojshme t’i studionte një degë tjetër, si p.sh., frazeologjia, por do t’i studionte vetë sintaksa ashtu siç thamë pak më lart se në qoftë se frazemat do të ishin vëllezër të barasvlershëm të fjalëve dhe që do të kishin të njëjtën sjellje, do t’i studionte vetë leksikologjia dhe nuk do të nevojitej frazeologjia. Por thelbi i frazemave qëndron në natyrën e tyre të veçantë semasiologjike, prandaj për këtë

²⁴⁹ Thomai, J. (1999). vep. e cit.

natyrë të tyre kuptimore si dhe për qëndrueshmërinë e tyre strukturore, ato duhet të studiohen më vete, nga një disiplinë e veçantë siç është frazeologjia.

Si rezultat i ndarjes së frazeologjisë jo vetëm nga leksikologjia, por edhe nga sintaksa, dhe i përvijimit të saj si një disiplinë më vete, për të përcaktuar qartë caqet e shtrirjes së frazeologjisë si disiplinë gjuhësore, mund të themi se “fillojnë atje ku fjalori takon sintaksën, sapo të jenë kapërcyer kufijtë e fjalës”²⁵⁰. Mëvetësimi i frazeologjisë “mundëson hapësira më të mëdha kundrimi, fillimin e interpretimit, si dhe kërkon trajtime shkencore të çështjeve të pashtjelluara, ashtu si kërkon rimarrje për disa aspekte të studimeve, përjasje a plotësime”²⁵¹.

Rëndësia e frazeologjisë së një discipline e pavarur provohet edhe nga publikimi i fjalorëve të specializuar (Cowie et al. 1983; Sinclair & Moon 1995; Thomai, 1999), nga projektet kërkimore që i kushtohen frazeologjisë së gjuhëve të veçanta (H. Burger et al. 2007; Corpas Pastor 1996; Savin 2010) si dhe nga numri në rritje i konferencave ndërkombëtare që mbahen në lidhje me këtë temë.

Si përfundim themi se frazemat duhet të studiohen nga një disiplinë më vete dhe jo nga leksikologjia, sepse leksikologjia studion fjalët dhe kuptimet e tyre, ndërsa frazeologjia studion lidhjet e qëndrueshme të fjalëve dhe kuptimin tërësisht apo pjesërisht të mbartur dhe të kushtëzuar nga përdorimi brenda këtyre lidhjeve.

²⁵⁰ Savin, P. (2010). Phraseology as an autonomous linguistic discipline'Current state of the topic in Romanian linguistics. *Libri. Linguistic and Literary Broad Research and Innovation*. Volume 1, Issue 1.

²⁵¹ Memisha, V. (2006). vep. e cit.

KREU IX LIDHJA E FRAZELOGJISË ME DISIPLINAT E TJERA

Ndërsa fillimisht frazeologjia konsiderohej si një fushë relativisht anësore, sot ajo zë një vend qendror midis një numri të madh disiplinash dhe mund të themi se frazeologjia lidhet me të gjitha disiplinat gjuhësore. Justifikimi ynë për këtë qëndrim është sepse bëhet fjalë për një fakt gjuhësor që lidhet me fjalët ashtu si për të gjitha disiplinat e tjera gjuhësore. Meqë ngurosjë e ka pikënisjen të fjalët për t'u instaluar të fjalët, është e natyrshme që trajtimi i saj përfshin fjalët²⁵².

Dy nga disiplinat kryesore gjuhësore me të cilat lidhet frazeologjia janë semantika dhe sintaksa. Frazeologjia lidhet me semantikën, sepse frazemat, si objekt i studimit të frazeologjisë, studiohen në radhë të parë për natyrën e tyre semasiologjike e cila përbën edhe thelbin e tyre. Lidhja e frazeologjisë me sintaksën justifikohet nga fakti se frazemat e gjuhës kanë formë dhe strukturë sintaksore me marrëdhënie të caktuar sintaksore ashtu si sintagmat e lira të gjuhës.

Lista e disiplinave gjuhësore që lidhen me frazeologjinë mund të shtohet lehtësisht:

Frazeologjia lidhet me morfologjinë, sepse frazemat të cilat përbëhen nga të paktën dy fjalë përbëjnë strukturë të hapur ku vetë fjalët në shumë raste lakohen dhe zgjedhohen dhe marrin trajta të ndryshme morfologjike.

Frazeologjia lidhet me fonologjinë, sepse fonemat të cilat i studion fonologjia, nuk mund të ekzistojnë jashtë fjalëve të cilat nga ana e tyre hyjnë në përbërje të frazemave.

Frazeologjia lidhet me psikolinguistikën, sepse shumica e frazemave janë rezultat i metaforës konceptore, i koncepteve që ka njeriu për botën në të cilën jeton dhe të cilat i lejojnë njeriut prodhimin dhe të kuptuarit edhe të shprehjeve të ngurosurat si pjesë e gjuhës.

Frazeologjia lidhet me leksikografinë, sepse, përveç regjistrimit dhe studimit të fjalëve të gjuhës, në objektin e leksikografisë përfshihen edhe frazemat si njësi të gatshme të gjuhës, të para nga pikëpamja e formës dhe e domethënies së tyre.

Frazeologjia lidhet edhe me stilistikën, sepse ekspresiviteti që përbën një nga objektet e studimit të stilistikës, karakterizon shumicën e frazemave.

Etimologjia na ndihmon jo vetëm në zbulimin e prejardhjes së fjalëve, por edhe në zbulimin e prejardhjes së shumë frazemave dhe në justifikimin e formave të tyre që nuk lidhen me gjendjen aktuale të gjuhës, por me faza të mëparshme të zhvillimit të saj.

Sociolinguistika studion midis të tjerave përdorimin e frazemave sipas grupeve shoqërore në aktin gjuhësor.

Gjuhësia krahasuese studion dhe zbulon grupet e ngjashme apo të ndryshme në gjuhë të ndryshme dhe lidhjen e mundshme midis tyre.

Përkthimi në objektin e punës së tij merr përsipër jo vetëm përkthimin e fjalëve nga një gjuhë në një tjetër, por edhe përkthimin e frazemave me apo pa vlerë fjale.

²⁵² Mejri, S. (1997). *Le Figement lexical – Descriptions linguistiques et structuration sémantique*. Tunis: Publications de la Faculté des Lettres de la Manouba.

Ndërsa në bashkëpunim me leksikologjinë dhe leksikografinë, përkthimi kujdeset edhe për regjistrimin dhe përkthimin e frazemave në fjalorë të ndryshëm dygjuhësh.

Pragmatika merr parasysh funksionimin dhe përdorimin jo vetëm të fjalëve, por edhe të frazemave në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Etnolinguistika studion në mënyrë krahasuese shfaqjet e kulturës së popujve të ndryshëm, midis të cilave edhe të frazemave si krijime tipike të një gjuhe dhe të një populli të caktuar.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj, por edhe e gjuhës amtare, përfshin në objektin e saj edhe frazemave.

Përveç se me disiplinat gjuhësore, frazeologjia lidhet edhe me disiplina të tjera fqinje të gjuhësisë, si p.sh., me folklorin, me etnografinë, por edhe me informatikën etj

Frazeologjia lidhet me folklorin, sepse proverbat si shprehje të ngurosur, përveç aspektit të ngurosur gjuhësor, mbajnë edhe vulën e mençurisë dhe të krijimtarisë anonime popullore si shprehje të mençura që studiohen nga folklori, dhe konkretisht nga paremiologjia si degë e folklorit.

Frazeologjia lidhet me etnografinë, sepse zakonet dhe ritet e ndryshme na ndihmojnë në zbulimin e kuptimit të shumë shprehjeve të ngurosur.

Si rezultat i zhvillimeve të shumta informatike të viteve të fundit, frazeologjia merr rëndësi të veçantë dhe lidhet ngushtë edhe me informatikën dhe kryesisht me përpilimin e fjalorëve elektronikë një- apo dygjuhësh ku një vend të veçantë zë edhe përfshirja e shprehjeve të ngurosur.

Përveç se është disiplinë më vete, përveç se lidhet me shumë disiplina të tjera gjuhësore dhe jo gjuhësore, frazeologjia ka edhe natyrë ndërdisiplinore, sepse objekti i saj i studimit përfshin semantikën, sintaksën, morfologjinë dhe stilistikën e fjalëve. Siç thekson Mel'čuk (1995), "frazeologjia duhet të merret me gjithçka, gjë që e bën atë kaq të vështirë, por kaq tërheqëse".

PËRFUNDIME

1. Përveç frazeologjisë në kuptimin e ngushtë ekziston edhe një lloj tjetër frazeologjie që ne pranojmë dhe të cilën e propozojmë edhe për gjuhën shqipe. Ajo është **frazeologjia në kuptimin e gjerë** e cila nuk e përjashton frazeologjinë në kuptimin e ngushtë, por e përfshin atë si një nga kategoritë e saj kryesore. Me frazeologji në kuptimin e gjerë do të kuptojmë frazeologjinë që studion frazemat deri në nivel fjalie, siç janë proverbat dhe formulat frazeologjike të bashkëbisedimit, në të cilën përfshihen edhe frazemat me vlerë fjale.

2. Një përfundim tjetër lidhet me kriterin përcaktues të frazeologjisë në kuptimin e gjerë. Kriteri përcaktues që propozojmë për frazeologjinë në kuptimin e gjerë është **mosreferencialiteti literal**, që do të thotë se përbërësit e strukturës e kanë humbur kuptimin literal dhe se struktura frazeologjike ka kuptim të mbartur. Kjo lidhet me nevojën dhe arsyen e studimit të veçantë të frazemave. Ato studiohen për kuptimin e tyre, por ky kuptim është kushtëzuar dhe i kufizuar brenda një lidhjeje të caktuar të qëndrueshme sintaksore. Thelbi i frazemave qëndron në natyrën e tyre semantike dhe kjo ka bërë që ato fillimisht të studiohen në kuadrin e leksikologjisë.

3. Përfundimi tjetër për frazeologjinë në kuptimin e gjerë, dhe jo vetëm për frazeologjinë në kuptimin e gjerë, por edhe për frazeologjinë në kuptimin e ngushtë, lidhet me strukturën shumëfjalëshe të frazemave. Nga pikëpamja e numrit të fjalëve të përfshira në frazema dhe e lidhjeve midis tyre, objekti i studimit të frazeologjisë në kuptimin e gjerë janë lidhje shumëfjalëshe të qëndrueshme **-sintagma apo fjali**.

Rëndësinë e sintagmës në hulumtimet tona frazeologjike e shohim në zbulimin e shumë rasteve të tjera njësisish shumëfjalëshe të qëndrueshme, si p.sh., *pas shpine, në tym, me spec, me bisht etj.* të shprehura me sintagmë parafjalore ose *e piu, e qau, i dhashë një (në kokë) etj.* të shprehura me sintagma njëri përbërës i së cilave është përemër apo numëror dhe që duhen pranuar si frazema.

4. Përfundimi tjetër lidhet me numrin e mjaftueshëm të fjalëve me kuptim të mbartur brenda strukturës së qëndrueshme frazeologjike. Siç kemi theksuar thelbi i frazemave qëndron në natyrën e tyre semantike. Ato studiohen për kuptimin e mbartur të fjalëve përbërëse, i cili është i kushtëzuar dhe i kufizuar brenda këtyre lidhjeve të qëndrueshme sintaksore. Për rrjedhojë, nuk ka rëndësi se sa fjalë me kuptim të mbartur ekzistojnë brenda një frazeme; **edhe një fjalë e vetme me kuptim të mbartur** e devijon kuptimin e lidhjes shumëfjalëshe nga strukturë e lirë në strukturë të qëndrueshme, si p.sh., *jetë qeni, thyej rekordin, mjaltë i ëmbël, pendë i lehtë, çelës anglez etj.*

5. Rrjedhojë e përfundimit të mëparshëm është përfundimi i radhës që është ndarja e parë e frazemave në **tri grupime kryesore frazeologjike** në bazë të vlerës së njësisë gjuhësore që frazemat përfaqësojnë: frazema me vlerë fjale, si p.sh., *i kthej krahët, i fërkoj krahët, s'e mbyll gojën, s'lë dy gurë bashkë*, frazema me vlerë sintagme, si p.sh., *jetë qeni, thyej rekordin, akull i ftohtë, çelës anglez etj.*, dhe frazema me vlerë fjalie, si p.sh., *natën e mire, ikën macja luajnë minjtë etj.*

6. Rrjedhojë e përfundimit të mësipërm është përfundimi tjetër që lidhet me **moskompozicionalitetin semantik** i cili nuk është kriter përcaktues për të gjitha frazemat, sepse në frazemat vetëm me një përbërës me kuptim të mbartur, kuptimi i këtij përbërësi, edhe pse jo literal, është tërësisht transparent, të paktën në analizë,

dhe, për rrjedhojë, kuptimi i gjithë strukturës është shumë e thjeshtë aritmetike e kuptimeve të përbërësve - kuptimit literal të një përbërësi plus kuptimin e figurshëm ose thjesht të mbartur të përbërësit tjetër, dmth., është kompozicional, si p.sh., *mjaltë i ëmbël, borë i bardhë, jetë qeni, thyej rekordin etj*

7. Rrjedhojë e dukshme e kompozicionalitetit semantik të disa frazemave si shumë e thjeshtë aritmetike e kuptimeve të përbërësve është mosleksikalizimi i strukturës së qëndrueshme të këtyre frazemave, dmth., struktura e qëndrueshme nuk përbën një njësi të vetme semantike dhe, për rrjedhojë, nuk përbën as njësi të leksikalizuar, dmth., **nuk është barasvlerës i fjalës**, si p.sh., *jetë qeni, sjellje kalamanjsh, thyej rekordin, borë i bardhë etj.*

8. Si term për njësinë bazë të frazeologjinë shqipe në kuptimin e gjerë të cilën po studiojmë ne propozojmë termin **frazemë**.

9. Kriteret e ngurosjes së frazemës janë të shumta, por specialistët e fushës vërtiten rreth një serie nocionesh qendrore si: polileksikaliteti, figurshmëria, kufizimi morfo-sintaksor, moskompozicionaliteti, kufizimi leksikor, mosreferencialiteti literal, memorizimi, konvencionalizimi dhe institucionalizimi midis të cilave ne do të veçonim si parësore polileksikalitetin, figurshmërinë, kufizimin morfo-sintaksor, moskompozicionalitetin, kufizimin leksikor dhe mosreferencialitetin literal me të cilat edhe do të operojmë. Ka edhe kritere të tjera ndihmëse, më pak të përgjithshme si: gjurmë të gramatikës së vjetër, pamundësia e përkthimit në gjuhë të tjera, barasvlershmëria me fjalën, leksikalizimi etj.

10. Tri kushtet e nevojshme për përcaktimin e frazemave për të cilat folëm më lart- polikesikaliteti, mosreferencialiteti literal dhe kufizimi leksikor-, janë të nevojshme për një **përkufizim** logjik të frazemës. Në bazë të këtyre kritereve, frazemat mund t'i përkufizojmë si lidhje shumëfjalëshe (sintagma apo fjali) të qëndrueshme kuptimi i të cilave është i ndryshëm nga shuma e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse ose të cilat karakterizohen nga mbartja e plotë apo e pjesshme e kuptimit.

Përkufizimi për frazeologjinë në kuptimin e gjerë i propozuar nga ne do të jetë:

1)Frazeologjia merret me studimin e frazemave, dmth., të lidhjeve shumëfjalëshe (sintagma apo fjali) të qëndrueshme kuptimi i të cilave është i ndryshëm nga shuma e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse ose të cilat karakterizohen nga mbartja e plotë apo e pjesshme e kuptimit.

2)Frazeologjia është tërësia e frazemave apo e shprehjeve të ngurosura të gjuhës.

11. Jo të gjitha kriteret zbatohen në të gjitha frazemat dhe jo të gjitha frazemat paraqesin të njëjtat veçori. Shumë kritere janë të njëjtë për shumë kategori, prandaj në dallimin e kategorive të ndryshme marrin parasysh kriteret dhe veçoritë e ndryshme dominuese. Në bazë të kritereve dhe të veçorive të ndryshme dominuese, frazemat i ndajmë në disa kategori. Kështu, brenda tri grupimeve të frazemave të krijuara mbi bazën e vlerës së njësisë gjuhësore që përfaqëson secili prej tyre (frazema me vlerë fjale, frazema me vlerë sintagme, frazema me vlerë fjalie) dallojmë tetë nëngrupime të cilat do t'i quajmë kategori frazeologjike. **Kategoritë frazeologjike** të cilat kemi dalluar për gjuhën shqipe janë idiomat, perifrazat me folje të desemantizuar, frazeotermat, binomet e pakthyeshme frazeologjike, lokucionet gramatikore,

proverbat, formulat frazeologjike të bashkëbisedimit dhe kolokacionet e kufizuara frazeologjike.

Do të quajmë **idioma** lidhjet shumëfjalëshe të qëndrueshme me kuptim të figurshëm dhe me kufizim morfo-sintaksor, kuptimi i së cilave nuk është shumë e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse apo frazemë me kuptim të figurshëm dhe me kufizim morfo-sintaksor, si p.sh., *i kthej krahët, i fërkoj krahët, vret miza, s'e mbyll gojën, s'lë dy gurë bashkë etj.* Me sa shohim nga përkufizimi dhe nga shembujt, ajo që ne quajmë kategori frazeologjike të idiomave janë pothuajse njësitë frazeologjike në kuptimin e ngushtë që ne njohim për shqipen. Preferojmë termin idiomë për këtë kategori të veçantë të frazeologjisë në kuptimin e gjerë, sepse vëllimi idiomatik i propozuar prej nesh nuk është plotësisht i njëjtë me vëllimin frazeologjik që mbulojnë njësitë frazeologjike të njohura deri tani në shqipe, si p.sh., *rreth e rrotull, fund e krye, ditë për ditë etj.*, të cilat nuk kanë figurshmëri dhe të cilat ne i përfshijmë në një kategori tjetër frazeologjike, *binomet*, apo *bëj durim, jap shpresë etj* të cilat, edhe pse kanë një farë figurshmërie, ne i përfshijmë te *perifrazat me folje të desemantizuar*, sepse nuk karakterizohen nga kufizimi morfo-sintaksor që karakterizon idiomat.

Do të quajmë **proverba** lidhjet shumëfjalëshe të qëndrueshme me vlerë fjalie, përgjithësisht metaforike, që shprehin një të vërtetë të përgjithshme dhe që përmbajnë një këshillë apo mësim të urtësisë popullore në formën e një morali, kuptimi i së cilave nuk është shumë e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse. Niveli kryesor i frazeologjizmit të proverbave lidhet me mbartjen e kuptimit apo me mosreferencialitetin literal i cili shfaqet me moskompozicionalitetin semantik për proverbat e figurshëm dhe me moskompozicionalitetin **në nivel pragmatik** për proverbat literalë. Përcaktimi i proverbave nga veçoria e përgjithësimi bën që proverbat literalë, edhe pse “semantikisht dhe sintaktikisht janë 100% kompozicionalë”, “të jenë jokompozicionalë nga pikëpamja e funksionit pragmatik”, sepse, si rezultat i përgjithësimi proverbial, fitohet një kuptim i shtuar i cili është konkluzioni i shprehur nga përgjithësimi proverbial.

Do të quajmë **kolokacione të kufizuara** frazeologjike frazemat apo lidhjet shumëfjalëshe të qëndrueshme frazeologjike njëra gjymtyrë e të cilave ka kuptim të figurshëm dhe përdoret në varësi të tjetrës e cila përdoret literalisht dhe në mënyrë të pavarur.

12. Përfundimi tjetër lidhet me përkimet idiomatike midis idiomave të shqipes dhe të greqishtes të mbështetura në rezultatet e krahasimit të idiomave të fushës leksikore me emra të pjesëve dhe të organeve të trupit të njeriut, me emra kafshësh dhe me emra frutash dhe perimesh.

Pjesa dërrmuese e idiomave me përbërës emrat e fruta-perimeve dhe një pjesë e mirë e atyre me përbërës emra të pjesëve dhe organeve të trupit të njeriut dhe me përbërës emra kafshësh, janë specifike për secilën gjuhë dhe nuk përkojnë midis tyre. Paraqitja e pasaktë e shumë prej tyre si gjegjëse të idiomave të shqipes në Fjalorin frazeologjik ballkanik, dmth., si kalke të painstitucionalizuara në gjuhën letrare greke, mund të na çojë në përfundimin se paralelet e përgjithshme idiomatike **midis shqipes dhe greqishtes nuk duhet të jenë aq shumë sa pretendohet në fjalorin frazeologjik ballkanik.**

13. Në vijim të rrugës së nisur nga Vinogradov dhe të pasuar nga Eckert, Cowie, Thomai etj. si dhe të bazuar në studimet tona të thelluara në fushën e frazeologjisë dhe

të konstatimeve të bëra, mendojmë se frazeologjia është formuar si **disiplinë** gjuhësore, me objektin, me lëndën e me metodat e veta” (shih Thomai, 1999).

PROPOZIME

Në bazë të përfundimeve të arritura, bëjmë propozimet e mëposhtme:

T'i jepet më shumë rëndësi përfshirjes së dukurisë frazeologjike në librat e gjuhës shqipe me qëllim që folësit e shqipes të njohin më mirë veçanësitë e gjuhës amtare.

T'i kushtohet më shumë rëndësi mësimdhënies të frazeologjisë në kuptimin e gjerë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, sepse shprehjet frazeologjike lidhen me veçanësitë e gjuhës shqipe, gjë që do t'i ndihmonte studentët e gjuhëve të huaja gjatë kalimit nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj dhe anasjelltas.

T'i jepet më shumë rëndësi dhe më shumë hapësirë përfshirjes së dukurisë frazeologjike në metodat e mësimin të gjuhës shqipe nga të huajt me qëllim zotërimin më të mirë dhe më elegant të shqipes prej tyre, sepse të flasësh një gjuhë do të thotë ta flasësh atë në mënyrë frazeologjike.

Të bëhen përpjekje për unifikimin e terminologjisë frazeologjike midis gjuhëve ashtu siç është arritur në fusha të tjera gjuhësore.

Të ndërmerren studime të tjera krahasuese në fusha të tjera leksikore sipas modelit të krahasimit të idiomave me emra frutash dhe perimesh, për të parë nivelin real të përkimeve idiomatike greko-shqiptare.

Të ndërmerret hartimi i një fjalori dygjuhësh frazeologjik shqip-greqisht dhe anasjelltas.

Është detyrë e etimologjisë të vërtetojë shkallën e ndikimit të frazeologjisë ballkanike nga turqishtja kundrejt ndikimeve të ndërsjella midis gjuhëve ballkanike.

Studimet kryesore frazeologjike i përkasin planit sinkronik, ndërsa në planin diakronik mbetet ende për të bërë, sidomos për sa u përket problemeve që lidhen me etimologjinë.

Ndërkohë që frazemat janë po aq të rëndësishme sa lidhjet e lira, mbetet për të analizuar dhe matur nëpërmjet një korpusi të caktuar përqindjen që këto frazema zënë kundrejt lidhjeve të lira.

BIBLIOGRAFI

- A.Sh.Sh.(Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë). (1983). Fjalë të urta të popullit shqiptar. Tiranë.
- Agani, H. (1975). Ç'shoh të diskutueshme në "Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme" të S. Floqit, Fjala. Prishtinë.
- Aijmer, K. (1996) *Conversational Routines in English: Convention and Creativity*, London: Longman.
- Aisenstadt, E. (1979): Collocability restrictions in dictionaries. In: Hartmann, R.R.K. (ed.): *Dictionaries and their Users*. Exeter Linguistic Studies.
- Alexander, R. (1978). "Fixed expressions in English: a linguistic, psycholinguistic, sociolinguistic and didactic study". *Anglistik & englischunterricht* 6.
- Alonso Ramos, M. (1998). *Etude sémantico-syntaxique des constructions à verbe support*. Ph.D. thesis, Université de Montréal, Montreal, Canada.
- Alonso Ramos, M. (2001). *Constructions a verbe support dans les langues SOV*. *Bulletin de la Societe de linguistique de Paris*, t. XCVI, fasc.1.
- Amosova, N. N. (1963). *Osnovy Anglijskoj Frazelogii*, Leningrad: Nauka.
- Annelies H.-B. (2007). *Psycholinguistic aspects of phraseology: European tradition*.
- Burger, H., D. Dobrovol'skij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) (2007) *Phraseology: An International Handbook of Contemporary Research*, vols 1 & 2. Berlin: Mouton de Gruyter.
- Anscombe, J.C. (2003). *Les proverbes sont-ils des expressions figées? Cahiers de lexicologie* 1.
- Anscombe, J.C., 1986, "Article zéro, termes de masse et représentations d'événements en français contemporain", *Recherches linguistiques*, XI, sous la direction de G. David et G. Kleiber, Paris : Klincksieck, pp. 5-34.
- Anscombe, J.C. (2006). "Les proverbes : un figement du deuxième type?". *Linx* 53.
- Arewa, E.O. & Dundes, A. (1964): *Proverbs and the ethnography of speaking folklore*. Në: *American Anthropologist* 66.
- Aristote. (1991). *Rhetorique*, livre II. Texte établi et traduit par C.-E. RUELLE. VANHEMELRYCK, B. TIMMERMANS. Paris : Le Livre de Poche.
- Aristotle. (1953). *Aristotle's Poetics and Rhetoric*. New York: Dent. [337 BC].
- Arnaud, P. (1992). *La connaissance des proverbes français par les locuteurs natifs et leur sélection didactique*, *Cahiers de lexicologie*, 60.
- Arnold, I.V. (1973): *The English Word*. Moscow Vuisshaya Shkola.
- Arsentyeva, E. (2005). *Interlanguage Relations of English and Russian Phraseological Units*, (Kazan,Russia and Warsaw, Poland).
- Bahns, J. (1993). *Lexical collocations: A contrastive view*. *ELT Journal* 47 (1).
- Bakir, Murtadah J. (1999). "Ordering principles in conjoined lexical pairs". *Linguistic Research* 4.
- Bally Ch. (1909). *Traité de stylistique française*. Paris : Klincksieck.
- Bally, Ch. (1965). *Linguistique générale et linguistique française*, Berne. Editions Francke.
- Baranov, A.N & /Dobrovol'skij, D. (1996): *Cognitive modeling of actual meaning in the field of phraseology*. Në: *Journal of Pragmatics* 25.
- Bárdosi, V. (1999). "Entre fil d'Ariane et tonneau des Danaïdes. Problèmes de classification des phrasèmes français". *Revue d'Études Françaises*, no 4.
- Barley, N. (1972): *A structural approach to the proverb and maxim with special reference to the Anglo-Saxon corpus*. In: *Proverbium* 20.
- Benson, M. 1985. *Collocations and idioms*. In *Dictionaries, lexicography and language learning*. Oxford: Pergamon Press.

- Bentivogli, L. & Pianta, E. (2002). Detecting Hidden Multiwords in Bilingual Dictionaries. In Anna Braasch and Claus Povlsen (eds.) Proceedings of the Tenth EURALEX International Congress, EURALEX 2002, Copenhagen: Center for Sprogteknologi, II,
- Biber, D. (1999). Lexical bundles in conversation and academic prose. In Hasselgård, H. & S. Oksefjell (eds.) *Out of Corpora: Studies in Honour of Stig Johansson*. Amsterdam: Rodopi.
- Biber, D. (2004). If you look at . . .: Lexical bundles in university teaching and textbooks. *Applied Linguistics* 25.
- Blumenthal, P. & Hausmann, F. J. (2006). Présentation. In Peter Blumenthal & Franz J. Hausmann (eds.), *Langue française : collocations, corpus, dictionnaires* 150.
- Bobrow, S. & Bell, S. (1973). On Catching on to Idiomatic Expressions. *Memory & Cognition* 1.
- Bréal, M. (1897). *Essai de sémantique*. Hachette, Paris.
- Bulka, N. (1958). Frazelogjia shqipe (lokucionet) në gjuhën e Naim Frashërit “Histori e Shqipërisë”. Në: *Buletin iu Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore, Tiranë*.
- Burger H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (2007). Phraseology: Subject area, terminology and research topics. Në: Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) *Phraseology: An International Handbook of Contemporary Research*, vols 1 & 2. Berlin: Mouton de Gruyter.
- Burger, H. (1973) *Idiomatik des Deutschen*, Tübingen: Max Niemeyer
- Burger, H. (1998) *Phraseologie: Eine Einführung am Beispiel des Deutschen*, Berlin: Erich Schmidt.
- Burger, H. (2007). Semantic aspects of phrasemes. Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) *Phraseology: An International Handbook of Contemporary Research*, vols 1 & 2. Berlin: Mouton de Gruyter.
- Burger, H., Buhofer, A. & Sialm, A. (1982). *Handbuch der Phraseologie*, Berlin.
- Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N.R. Norrick (eds.) (2007). *Phraseology: an International Handbook of Contemporary Research*. Berlin & New York: Mouton de Gruyter.
- Burger, Harald. (1998). *Phraseologie. Eine Einführung am Beispiel des Deutschen*, Berlin : Schmidt.
- Butt, M & Geuder, W. 2001. On the (semi)lexical status of light verbs. In Norbert Corver and Henk van Riemsdijk, editors, *Semi-lexical Categories*, volume 59 of *Studies in Generative Grammar*, pages 323– 370. Mouton de Gruyter.
- Butt, M. (2003). *The Light Verb Jungle*. Harvard Working Papers in Linguistics 9
- Butt, M. 1995. *The structure of complex predicates in Urdu*. Ph.D. thesis, Stanford University.
- Bybee J. L. (2007). From usage to grammar: the mind’s response to repetition. *Language* 82.
- Cacciari, C. and Tabossi, P. 1988. The comprehension of idioms. *Journal of Memory and Language* 2.
- Cain, K. & Oakhill, J. & Lemmon, K. (2005). The Relation Between Children’s Reading Comprehension Level and Their Comprehension of Idioms. *Journal of Experimental Child Psychology*, 90.
- Casares, J. (1950). *La locución, la frase proverbial, el refrán y el modismo*, in *Introducción a la lexicografía moderna*, Madrid, Aguirre, 1950.
- Çeliku, M. (1962). *Togfjalësha të qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme (sipas materialeve të të folmeve të Shqipërisë së Mesme)*. Studime filologjike, nr 2, Tiranë.

- Çeliku, M. (1975). Lokucionet parafjalore në gjuhën letrare shqipe. Në: Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II. Tiranë.
- Čermák, F. (1974). “Viceslovní pojmenování typu verbum – substantivum v cestine”. Në: Slovo Slovesnost 35.
- Charteris-Black, J. (2002). Secondlanguage proficiency: a comparative study of Malay and English. *Applied Linguistics* 23/1.
- Chernuisheva, I. I. (1964), *Die Phraseologie der gegenwärtigen deutschen Sprache* (Moscow: Vuisshaya Shkola).
- Cinková, Silvie; Kolářová, Veronika. 2005. Nouns as Components of Support Verb Constructions in the Prague Dependency Treebank. In Šimková, Mária (ed.), *Insight into Slovak and Czech Corpus Linguistics*, pp. 113–139. Veda Bratislava, Slovakia.
- Cipo, K. (1949). *Gramatika shqipe*. Tiranë.
- Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary. (3d edn, 2001). London: HarperCollins.
- Collins English Dictionary (2003), 6th edition. London & Glasgow: HarperCollins.
- Colson, J.-P. (2008). Cross-linguistic phraseological studies: An overview. Granger, S. & Meunier, F. *Phraseology -An interdisciplinary perspective*. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia.
- Conenna, M. (1998). Le proverbe degré ultime du figement ? In : *Le figement lexical*, Actes des Premières Rencontres Linguistiques Méditerranéennes (Tunis, 17-19 sept. 1998), S. MEJRI, G. GROSS, A. CLASS, T. BACCOUCHE (eds.)
- Connena, M. (1988), « Sur un lexique-grammaire comparé de proverbes » in *Langages* 90.
- Connena, M. (2000): “Structure syntaxique des proverbes français et italiens”, en *Langages*, 139.
- Connena, M. (2002). Sur l’historique des proverbes. In : *Collage. Studi in memoria di Franca Caldari Bevilacqua*, a cura di G. MAIELLO e R. STAJANO, pp. 35-51, Salerno/Milano : Oedipus.
- Cooper, W. E. and J. R. Ross (1975). "World order". Në: R. E. Grossman, L. J. San, and J. J. Vance (eds). *Papers from the Parasession on Functionalism*. Chicago: Chicago Linguistic Society.
- Corpas-Pastor, G. (1996): *Manual de Fraseología española*. Madrid.
- Coseriu, E. (1966). « Structure lexicale et enseignement du vocabulaire », in : *Actes du 1er colloque international de linguistique appliquée*, Nancy.
- Coseriu, E. (1967), *Lexikalische Solidaritäten*. *Poetica* 1,3.
- Cobuild Dictionary of Idioms (1995), Collins Cobuild. Harper Collins Publishers, London.
- Coulmas, F. (ed.) (1981): *Conversational routine. Explorations in standardized communication situations and prepatterned speech*. The Hague.
- Cowie A., Mackin R. & McCaig I. R. (1983). *Oxford Dictionary of Current Idiomatic English*, Vol. 2 - English Idioms, Oxford : Oxford University Press.
- Cowie, A P. (1998) 'Introduction'. Në: Anthony P. Cowie (ed.) *Phraseology: Theory, Analysis, and Applications*, (Oxford Studies in Lexicography and Lexicology) Oxford: Oxford University Press.
- Cowie, A. P. & Howarth, P. (1996). Phraseological competence and written proficiency. In G. M. Blue & R. Mitchell (eds.), *Language and education*, 11. Clevedon: Multilingual Matters.
- Cowie, A. P. (1981). The treatment of collocations and idioms in learner’s dictionaries. Në: *Applied Linguistics*, 2(3), Oxford University Press, Oxford.

- Cowie, A. P. (1988). Stable and creative aspects of vocabulary use. In Carter, R. & M. J. McCarthy (eds.) *Vocabulary and Language Teaching*. London: Longman.
- Cowie, A. P. (1994). Phraseology. In Asher, R. E. (ed.). *The Encyclopedia of Language and Linguistics*, Oxford: Oxford University Press.
- Cowie, A. P. (1998) *Phraseology: Theory, Analysis, and Applications*, (Oxford Studies in Lexicography and Lexicology) Oxford: Oxford University Press.
- Cowie, A. P. (1998a). Phraseological dictionaries: Some East-West comparisons. In Cowie, A. P. (ed.) *Phraseology: Theory, Analysis and Applications*, 209–228. Oxford: Oxford University Press.
- Cowie, A. P. (2001): *Speech formulae in English: problems of analysis and dictionary treatment*. Në: Van der Meer, G./Ter Meulen, A. (eds.): *Making Sense: from Lexeme to Discourse*. Groningen
- Cowie, A. P. & Mackin, R. & McCaig, I.R.. (1993). *Oxford dictionary of English idioms*, Oxford University Press.
- Cowie, A., R. Mackin & I.R. McCaig (1983). *Oxford Dictionary of Current Idiomatic English*. Oxford: Oxford University Press.
- Croft, W. & D. A. Cruse (2004). *Cognitive Linguistics*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Cruse, D. (1991) *Lexical Semantics*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Cruse, D. (2000) *Meaning in Language. An Introduction to Semantics and Pragmatics*. Oxford: Oxford University Press.
- Danlos, L. 1992. *Support Verb Constructions: Linguistic Properties, Representation, Translation*.
- Deignan, A., D. Gabrys & Solska. (1997). *Teaching English metaphors using cross-linguistic awareness-raising activities*. *ELT Journal* 51/4.
- Delplanque, C. (1999). *Le statut phraseologique des composés économiques allemands*. Në: *Les cahiers du CIEL*. Paris.
- Demiraj, Sh. (1970). *Rreth ndajfoljësimit (adverbializimit) të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë + emër*. Në: *Studime filologjike*, nr 1, Tiranë.
- Densusianu, O. (1901). *Histoire de la langue roumaine I*. Paris.
- Dhima, Th. (2004). *Locutions phraséologiques de l'albanais et du grec ayant à la base les noms d'animaux*. Në: *IX congrès international d'études sud-est européennes*. Tiranë. (Artikull i pabotuar)
- Dhima, Th. (2007). *Probleme të njësive sintaksore (Togfjalëshi dhe sintagma)*, *Studime filologjike* nr.3-4, Tiranë.
- Dictionnaire de linguistique*. (1973). Paris.
- Dobos, C. (1991). *Leíró kifejezések az orosz jogi szaknyelvben [Descriptive expressions in the Russian legal language]*. Ph.D. thesis, University of Debrecen, Debrecen, Hungary.
- Dobrovol'skij, D. & E. Piirainen (2005). *Figurative Language: Cross-Cultural and Cross-Linguistic Perspectives*. Amsterdam: Elsevier.
- Domi, M. (1985). *Disa çështje të lokucioneve*, *Studime filologjike*, nr.1, Tiranë.
- Dubois, J. & al. (1994) : *Dictionnaire de linguistique et des sciences du langage*, Larousse.
- Dubois, J. (1973). *Dictionnaire de linguistique*. Librairie Larousse, Paris.
- Dumitruseu, F. (1956). *Studii de gramatică*. București.
- Duro, A. (2001). *Terminologjia si sistem*. Panteon, Tiranë
- Farrokh, P. (2012). *Raising Awareness of Collocation in ESL/EFL Classrooms*. Në: *Journal of studies in education*, vol.2, no3.

- Fauconnier, G. & M. Turner (2002). *The Way We Think: Conceptual Blending and the Mind's Hidden Complexities*. New York, NY: Basic Books.
- Fazly, A. (2007). *Automatic Acquisition of Lexical Knowledge about Multiword Predicates*.
- Fedoruk, G. (1954). *Sovremjennij Ruskij Jazyk. Leksika*. Moskva.
- Fenk-Oczlon, G. (1989). Word frequency and word order in freezes. *Linguistics* 27.
- Feyaerts, K. (2007). *Dutch phraseology*. Granger, S. & Meunier, F. *Phraseology -An interdisciplinary perspective*. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia.
- Fiala P. & Habert B. (1989). La langue de bois en éclat : les défigements dans les titres de presse quotidienne, in *Mots*, 21,
- Fiedler, S. (2007). *English phraseology*. Gunter Narr Verlag, Tübingen
- Firth, J. R. (1951). "Modes of Meaning", in Firth, J. R. (ed.) (1957). *Papers in linguistics*. Oxford: Oxford University Press.
- Fjalor i shqipes së sotme. (1984). Tiranë.
- Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980). Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë.
- Fjalori i gjuhës shqipe. (1954). Instituti i Shkencave. Sekcioni i Gjuhës dhe Letërsisë. Tiranë.
- Fjalori i shqipes së sotme. (1984). Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë.
- Fjalori i shqipes së sotme. (2002). Akademia e Shkencave. Botimet TOENA, Tiranë.
- Floqi, S. (1968). Cështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme, *Studime filologjike nr.1*, Tiranë.
- Fonagy I. (1982): *Situation et signification*, Amsterdam-Philadelphia, John Benjamins.
- Fontenelle, T. (1994). «What on earth are collocations? », *English today: the international review of the English language*, Cambridge, England, 1994, oct, 10:4 (40)
- Fraser, B. (1970). Idioms within a transformational grammar. *Foundations of Language* 6(1).
- Fraht, P. & Gledhill C. (2005): "Free-Range Clusters or Frozen Chunks? Reference as a Defining Criterion for Linguistic Units," in *Recherches anglaises et Nordaméricaines*, vol. 38.
- Frege, G. (1892): 'Über Sinn und Bedeutung', in P. Geach and M. Black (eds.), *Translations from the Philosophical Writings of Gottlob Frege*, 1952, Oxford:Blackwell.
- Gaatone, D. (1997). La locution: Analyse interne et analyse globale. In Martins-Baltar, M. (ed.) *La locution entre langue et usages*, 165–177. Fontenay-Saint Cloud: ENS éditions.
- Gaatone, D., 1981, "Les 'locutions verbales' : pour quoi faire?", *SHYXH_URPDQH*, 16, 1-2,
- Gabrovsek, D. 2003. "On the Concept of Cline in English Phraseology". *Vestnik, DTJK*, Vol. 37, No. 1-2.
- Galisson R. (1971 [1965]). *Inventaire thématique et syntagmatique du français fondamental*. Paris : Hachette-Larousse, Coll. *Le Français dans le Monde/ BELC*, 82.
- Gautier, L. (2004). Terme, phraseoterme, phraseme:questions de delimitations en langue specialisee. Në: Jatlaoui, Hedi, et al.(Eds). *Le continuum en linguistique*. Sousse.

- Gazdić-Alerić, T. (2009). The Phraseology of the Croatian Political Substyle. <http://www.suedslavistik-online.de/01/gazdic-aleric.pdf>.
- Gibbs, R. 1986. 'Skating on thin ice: literal meaning and understanding idioms in conversation.' *Discourse Processes* 9.
- Gibbs, R. W. (1980) Spilling the beans on understanding and memory for idioms in conversation. *Memory and Cognition* 8.
- Gibbs, R. W. (1995): "Idiomaticity and human cognition", tek M. Evereaert, E. –J. van der Linden, A. Schenk and R. Schreuder, "Idioms: Structural and Psychological Perspectives", Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.
- Gibbs, R.W. (1993). «Why idioms are not dead metaphors». In C. Cacciari & P. Tabossi (Eds.), *Idioms: Processing, structure and interpretation*. New Jersey: Lawrence Erlbaum Associates.
- Gil, D. (1988). "Freezes, prosodic theory, and the Modularity of grammar". *Wiener Linguistische Gazette. Supplement Beiheft*.
- Giry-Schneider, J., 1991a, "L'article zéro dans le lexique-grammaire des noms prédicatifs", */DQJDJHV*, 102.
- Giry-Schneider, Jacqueline. 1987. *Les prédicats nominaux en français. Les phrases simples à verbe support*, Genève: Droz.
- Gjoçaj, Z. (2001). *Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe*, Prishtinë.
- Gläser, R. (1980). Syntactico-semantic aspects of the phraseological unit. *Në: Zeitschrift für Anglistik und Amerikanistik*.
- Gläser, R. (1986a). *Phraseologie der englische Sprache*. Tübingen : Max Niemeyer.
- Gläser, R. (1986b). A plea for phraseo-stylistics. *Në: Kastovsky, D./Szwedek, A.: Linguistics across historical and geographical boundaries 1: Linguistic theory and historical linguistics*. Berlin.
- Gläser, R. (1988) The grading of idiomaticity as a presupposition for a taxonomy of idioms. In Hüllen, Werner & Schulze, Rainer (Eds.) *Understanding the Lexicon*, Tübingen: Max Niemeyer.
- Gläser, R. (1998). The stylistic potential of phraseological units in the light of genre analysis. In Cowie A.P. (ed.). *Phraseology. Theory, Analysis, and Applications*, 125–143. Oxford University Press: Oxford.
- Gledhill, C. (2008). *Le signe et le syntagme : entre phraséologie et lexico-grammaire. Une synthèse du modèle systémique fonctionnel de Michael Halliday et de la théorie sémiotique de Charles S. Peirce*. HDR, Université de Bretagne occidentale, Director David Banks.
- Gorgis, D. T. (1999). "World order and word order in Iraqi Arabic with special reference to English". *Adab Al-Rafidayn*. 31, 1-15. Mosul Univ.
- Gramatica limbii romina I.* (1966). București.
- Gramatika e gjuhës shqipe 1* (2002). Botimi i Akedemisë së Shkencave, Tiranë.
- Grammaire Larousse.* (1937). Paris.
- Grand Larousse de la langues francaise.* (1971). Paris.
- Granger, S. & Paquot, M. (2008). *Disentangling the phraseological web*, Granger, S. & Meunier, F. *Phraseology -An interdisciplinary perspective*. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia.
- Great Soviet Encyclopedia. (1979): <file:///E:/Frazelogji%20dhe%20Metafore/New%20Folder%20UNITE%20PHRASEOLOGIQUE/Phraseology.htm>
- Gréciano, G. (1983). *Signification et dénotation en allemand. La sémantique des expressions idiomatiques*. Klincksieck, Paris.

- Gréciano, G. (1983). Signification et dénotation en allemand. La sémantique des expressions idiomatiques. Klincksieck, Paris.
- Grefenstette, G. & Teufel, S. Corpus-based method for automatic identification of support verbs for nominalizations, Proceedings of the seventh conference on European chapter of the Association for Computational Linguistics, March 27-31, 1995, Dublin, Ireland
- Greimas, A. J.(1960). « Idiotismes, proverbes, dictons », n°: Cahiers de lexicologie 2.
- Guiraud, P.(1961). Les locutions françaises, Paris, PUF, « Que sais-je ? ».
- Gries, S. (2008). Phraseology and linguistic theory: A brief survey. Granger, S. & Meunier, F. Phraseology -An interdisciplinary perspective. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia.
- Grimshaw, J. & Mester, A.(1988). Light verbs and theta-marking. Linguistic Inquiry. University of North Carolina at Chapel.
- Gross, M. (1981). Les bases empiriques de la notion de prédicat sémantique. Langages.
- Gross, G. (1996). Les expressions figées en français. Noms composés et autres locutions. Ophrys, Paris.
- Gross, G. 2005. Verbes supports : Nouvel état des lieux. In Gaston Gross & Sylvie Pontonx
- Gross, M. (1982): Une classification des phrases “figées” du français. N°: Revue québécoise de linguistique 11, 2.
- Gross, M. (1985), « Sur les déterminants dans les expressions figées »,
- Gross, M. (1988). « Les limites de la phrase figée », in : Langages 90.
- Gross, M. 1981. Les Bases Empiriques de la Notion de Prédicat Sémantique. Langages 63, 7-52.
- Gross, M. 1988. Les limites de la phrase figée. Langages 90.
- Gross, M., 1975, Méthodes en syntaxe, Hermann, Paris.
- Guiraud, P. (1961). Les locutions françaises, Paris, PUF, « Que sais-je ? ».
- Häcki-Buhof, A. (2007). Psycholinguistic aspects of phraseology: European tradition
- Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) Phraseology: An International Handbook of Contemporary Research, vols 1 & 2. Berlin: Mouton de Gruyter.
- Halliday, M. A. K. (1966). Lexis as a linguistic level. In Bazell, C. E., J. C. Catford, M. A. K. Halliday & R. H. Robins (eds.) In Memory of John Firth, 148–162. London: Longman.
- Halliday, M. A. K. (1994). An introduction to functional grammar. London, New York, Sydney, Auckland: Arnold.
- Han, H. (1988). “Light verbs and raising.” Language research, 24.
- Hausmann F.-J. (1989). «Le dictionnaire de collocations», in : Hausmann F.-J. et al. (eds.), Wörterbücher : ein internationales Handbuch zur Lexicographie. Berlin : De Gruyter.
- Hausmann, F. J. (1984), Wortschatzlernen ist Kollokationslernen. Zum Lehren und Lernen französischer Wortverbindungen. Praxis des neusprachlichen Unterrichts 31.
- Hausmann, F. J. (1985), Kollokationen im deutschen Wörterbuch. Ein Beitrag zur Theorie des lexikographischen Beispiels. In : Bergenholtz, Henning / Mugdan, Joachim (éds.), Lexikographie und Grammatik. Tübingen.
- Hausmann, F.J. (1979) : « Un dictionnaire des collocations est-il possible? », Travaux de linguistique et de littérature.
- Hausmann, F.J. (1989): Le dictionnaire de collocations. N°: Hausmann, F.J. et al. (eds.): Wörterbücher/Dictionaries/Dictionnaires. 1st vol. Berlin.

- Hausmann, F.J. (1994), *Le souhaitable et le possible. La microstructure du TLF. Le français moderne* 62 (2).
- Hausmann, F.J. (1997). « Tout est idiomatique dans les langues », in : Martins-Baltar, Michel (éd.), *Langages, La Locution entre langues et usages*, Fontenay Saint-Cloud, ENS editions.
- Hausmann, F.J. (2006). *Presentation: collocations, corpus, dictionaries. Nė: Langue française. Tübingen: Niemeyer.*
- Hausmann, F.J., Reichmann, O., Wiegand, H.E. & Zgusta, L. (Hrsg.) (1989–1991). *Wörterbücher. Ein internationales Handbuch zur Lexikographie. Berlin : De Gruyter.*
- Heid U. (1994), “On Ways Words Work Together - Topics in Lexical combinatorics”. In *EURALEX’94 Proceedings. Vrije Universiteit Amsterdam.*
- Hockett, C.F. (1956) : « Idiom Formation », For Roman Jakobson, Halle, M. et al. [eds], *The Hague. Mouton.*
- Hoey, M. (1991). *Patterns of Lexis in Text. Oxford: Oxford University Press.*
- Hook, P. E. (1974). *The Compound Verb in Hindi. Center for South and Southeast Asian Studies: The University of Michigan.*
- Howarth, P. (1998). *Phraseology and second language proficiency. Applied Linguistics* 19(1).
- Howarth, P.A. (1996): *Phraseology in English Academic Writing. Some implications for language learning and dictionary making. Tübingen.*
- Hristea, T. (1977). *Contribuții la studiul etimologic al frazeologiei românești moderne, în Limba română*, anul XXVI, nr. 6. București: Editura Academiei.
- Hysa, E. (1970). *Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe. Nė: Studime filologjike, nr3, Tiranë.*
- Ifill, T. (2002). *Seeking the Nature of Idioms: A Study in Idiomatic Structure. Haveford College.*
- Jackendoff, R. (1997). *The Architecture of the Language Faculty. Cambridge, MA: The MIT Press.*
- Jackendoff, R., 1990, *Semantics structures, Cambridge : MIT Press*
- Jespersen, O. 1968 (1924). *The philosophy of grammar. London : George Allen & Unwin.*
- Karimi-Doostan G. 1997. *Light Verb Constructions in Persian. PhD thesis, University of Essex.*
- Katz, J.J. & Postal, P.M. (1963): *Semantic interpretation of idioms and sentences containing them. In: MIT Research Laboratory of Electronics: Quarterly Progress Report 70.*
- Kilgarriff, A. (1992). *Polysemy, dissertation, University of Sussex.*
- Kleiber, G. (1989). *Sur la définition du proverbe. In Gertrud Gréciano (ed.), Europhras 88. Strasbourg: Université des Sciences Humaines.*
- Kleiber, G. (2000). *Sur le sens des proverbes, Langages, 139, Larousse.*
- Kleiber, G. (2005). *Petite sémantique des proverbes avec une vue spéciale sur leur statut de dénomination. In Almela, R., E. Ramón Trives & G. Wotjak (eds.) Fraseología contrastiva con ejemplos tomados del alemán, español, francés e italiano, 19–38. Murcia: Universidad de Murcia.*
- Klein, J.-R. (2007) « Le figement dans les proverbes et les expressions verbales : un débat qui n’est pas encore... figé », in : Conde Tarrío, Germán (éd.), *Nouveaux apports à l’étude des expressions figées / Nuevas aportaciones al estudio de las expresiones fijas. – Cortil-Wodon: E.M.E. et Intercommunications.*
- Kövecses, Z. & Szabó, P. (1996): *Idioms: A view from cognitive semantics. Nė: Applied Linguistics* 17.

- Krenn, B. & G. Erbach (1994). Idioms and support verb constructions. In Nerbonne, J., K. Netter & C. Pollard (eds.) *German in Head Driven Phrase Structure Grammar*, 297–340. Stanford, CA: CSLI Publications.
- Kunin, A.V. (1970): *Anglijskaja frazeologija. Teoreticeskij kurs*. Moscow : Vyssaja Skola
- Kunin, A.V. (1984 [1955]): *English-Russian phraseological dictionary*. 4th Edition, Revised and enlarged. Moscow.
- Kuroda, S. Y. (1973). *Where Epistemology, Style and Grammar Meet: A Case Study from the Japanese*. Në: Kiparski, P. and Anderson, S. (eds.), *A Festschrift for Morris Halle*. New York.
- Lacavalla, C. (2007). *Lexique-grammaire des proverbes en Quand/Quando*. Thèse, Università degli studi di Bari.
- Lakoff, G. & Johnson, M. (1980). *Metaphors We Live By*, Chicago, London.
- Lakoff, G. (1990). The invariance hypothesis: Is abstract reason based on image schemas? *Cognitive Linguistics* 1(1).
- Lakoff, G. (1993): *The contemporary theory of metaphor*. Në: Ortony, A. (ed.): *Metaphor and thought*. Cambridge.
- Lakoff, G. 1987. *Women, fire and dangerous things. What categories tell us about the mind*. Chicago: University of Chicago Press.
- Lakoff, G. & Turner, M. (1989). *More than cool reason: A field guide to poetic metaphor*. Chicago.
- Lamiroy, B. (2008). *Les expressions figées : À la recherche d'une définition*. <http://www.ling.arts.kuleuven.be/franitalco/papers/Lamiroy2008.pdf>
Langages, n°79, pp. 89-117.
- Langer, S (2004). *A Formal Specification of Support Verb Constructions*. in *SemantikimLexikon*. Langer, S. and Schnorbusch, D. [Eds.]. Tübingen.
- Langlotz, A. (2006), *Idiomatic Creativity: A Cognitive Linguistic Model of Idiom-Representations and Idiom-Variation in English*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam.
- Lapore E., Ranchhod E. & Yannacopoulou A. (2008). *Syntactic variation of support verb constructions*. *Lingvisticae Investigationes*, 31(2).
- Lazard, G. (1982). “Le morphème ra en persan et les relations actancielles”. *Bulletin de la Societe Linguistique de Paris*, 77/1, 177-208.
- LDOCE: *Longman Dictionary of Contemporary English*. (2003). Harlow: Longman.
- LDOCE: *Longman Dictionary of English Idioms*. (1979). London: Longman.
- Leclère, R. (1971). “Remarques sur les substantifs opérateurs”, *Langue française* 11.
- Leisi, E. (1947). *Die tautologischen Wortpaare in Caxtons Eneydos*. Zurich.
- Leroi, M.-V. (2004), *Le traitement automatique et lexicographique des locutions verbales figées en français*, Mémoire de recherche, Université Paris III, Sorbonne nouvelle ILPGA.
- Lexicon.
- Libben G. (1998). *Semantic transparency in the processing of compounds: consequences for representation*
- Lloshi, Xh. & Thomai, J. (1967). *Paralele frazeologjike të shqipës me gjuhë të tjera të Ballkanit*. Në: *Studime Filologjike*. Tiranë.
- Loelene, H. O. & Maureen, D. (2003). *Idiom Comprehension in Childhood: An Assessment Tool and Age Norms*. *Brain and Language*, 87.
- Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics*, (2002). Person Education.
- Lubensky S. (1995). *Russian-English Dictionary of Idioms*. N.Y.

- Makkai, A. (1972), *Idiom Structure in English*, The Hague: Mouton.
- Malkiel, Y. (1959): *Studies in irreversible binomials*. Nė: *Lingua* 8.
- Marantz, A. (1984) *On the Nature of Grammatical Relations*. Cambridge: MIT Press.
- Matof. (1893). *Гръско-български студии*, Sbornik, IX. Sofia.
- Mejri, S (2008). "Constructions à verbes supports, collocations et locutions verbales". Nė: MOGORRON HUERTA Pedro, MEJRI Salah, (eds), *Las construcciones verbo-nominales libres y fijas. Aproximación contrastiva y traductológica*. Universidad de Alicante.
- Mejri, S. (1994) *Sequences figées et expressions de l-intensité. Essai de description sémantique*. *Cahiers de lexicologie* 65.
- Mejri, S. (1997). *Le Figement lexical – Descriptions linguistiques et structuration sémantique*. Tunis: Publications de la Faculté des Lettres de la Manouba.
- Mejri, S. (1998). «Structuration sémantique et variation des sequences figées». In S. Mejri, A. Clas, G. Gross & T. Bacchouche (éds), *Le figement lexical, Préactes des premières Rencontres Linguistiques Méditerranéennes* (Tunis, 17-19 Septembre 1998), Tunis: Université de Tunis I/CERES.
- Mejri, S. (2001a), «La structuration sémantique des énoncés proverbiaux», *L'information grammaticale*, N°88, Paris.
- Mejri, S. (2008). «Inférence et structuration des énoncés proverbiaux». In Des topoï à la théorie des stéréotypes en passant par la polyphonie et l'argumentation dans la langue. LEEMAN Danielle, (ed.).
- Mel'čuk, I. (1962). *Ob algoritme sintaksičeskogo analiza jazykovyx tekstov. Obščie principy i nekotorye itogi. Mašinnyj perevod i prikladnaja lingvistika*, 7, 45-87.
- Mel'čuk, I. (1995). *Phrasemes in language and phraseology in linguistics*. Nė: Everaert, M., E.J. Van der Linden & A. Schenk (eds.). *Idioms: Structural and Psychological Perspectives*, 167–232. Hillsdale: Lawrence Erlbaum Associates.
- Mel'čuk, I. (1998). *Collocations and Lexical Functions*. In: A.P. Cowie (ed.), *Phraseology. Theory, Analysis, and Applications*, Oxford: Clarendon Press.
- Mel'čuk, I. (2003): *Collocations dans le dictionnaire*. Nė: Szende, Th. (ed.), *Les écarts culturels dans les dictionnaires bilingues*. Paris.
- Mel'čuk, I. (2008) *Phraséologie dans la langue et dans le dictionnaire. Repères & Applications* (VI), XXIVe Journées Pédagogiques sur l'Enseignement du Français en Espagne, Barcelone, 3-5 septembre 2007.
- Memisha, V. (2006). *Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike*. Nė, *Studime filologjike*. Nr. 3 - 4.
- Memushi, R. (2004). *Hyrje në gjuhësi*. Dituria, Tiranë.
- Michaux, C. « Le proverbe : nom ou phrase ? », *Actes du 11 Congreso Internacional de Paremiologia* (Gordoue, mai 1998), *Paremia*, n° 8.
- Mieder, W. (1985b): *Popular views of the proverb*. Nė: *Proverbium* 2
- Mieder, W. (2007). *Proverbs as cultural units or items of folklore*. In Burger, H., D.
- Milner, G. M. (1969). "Quadrupartite structures", *Proverbium*, 14.
- Molotkov A. I., ed. (1967), *Frazeologičeskij slovar' russkogo jazyka*. Sovetskaja enciklopedija Moskva.
- Montreynaud, F., Pierron, A., Suzzoni, F. (1989), *Dictionnaire de proverbes et dictons*, Robert, Paris.
- Moon, R. (1998). *Fixed Expressions and Idioms in English. A Corpus-based Approach*. Oxford: Clarendon Press.
- Náray-Szabó, M. (2002). *Quelques remarques sur la définition du phrasème*, *Revue d'études françaises* 7.
- Nicolas, T. 1995. *Semantics of idiom modification*. In Everaert et al. (1995),

- Nordahl, H. (1999): Proverbes sans verbe: Petite étude syntaxico-rhétorique sur les proverbes à ellipse verbale. Nē: Boysen, G./Moestrup, J. (eds.): Études de linguistique et de littérature dédiées à Morten Nøjgaard. Odense.
- Norrick, N.R. (2007). Proverbs as sat phrases. In Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) *Phraseology. An International Handbook of Contemporary Research*, Vol. 1. Berlin: de Gruyter.
- Nouveau Petit Robert (2000). Dictionnaire alphabétique et analogique de la langue française. Paris : Dictionnaires Le Robert..
- Nouveau Petit Robert (2001). Dictionnaires Le Robert, Paris.
- Nuccorini, S. (1988): The treatment of metaphorical and idiomatic expressions in learners' dictionaries. Nē: M. Snell-Hornby (ed.): ZüriLEX '86 Proceedings. Tübingen Franke Verlag.
- Nunberg, G, Sag, I and Wasow, T. 1994. Idioms. *Language*, 70(3).
- OALD: Oxford Advanced Learner's Dictionary of Current English (1995), Oxford University Press.
- OALD: Oxford Advanced Learner's Dictionary of Current English (2000), Oxford University Press.
- Obelkevich, J. (1987), "Proverbs in social history", in P. Burke and R. Porter (eds.), *The Social History of Language*, Cambridge: Cambridge University Press.
- ODCIE2: Oxford Dictionary of Current Idiomatic English, Vol.2 (1983). English Idioms, Oxford University Press.
- OED: Oxford English Dictionary. (1989). 2nd edition, prepared by J.A. Simpson and E. S. C. Weiner, 20 vols, Oxford, OUP.
- Oyharçabal, Bernard. 2006. "Basque light verb constructions", in J. I. Hualde and J. Lakarra (eds.) *A Festschrift for Larry Trask*, University of the Basque Country, Bilbao.
- Palmer, H. E. (1933), "Second Interim Report on English Collocations".Tokyo: Kaitakusha.
- Papahagi, P. (1908). *Parallele Ausdrücke und Redensarten im Rumänischen, Albanischen, Neugriechischen und Bulgarischen*. Jahresbericht des Instituts für Rumänische Sprache zu Leipzig.
- Pazos Breaña J. M. & Pamies Bertrán. (2008). Combined statistical and grammatical criteria for the retrieval of phraseological units in an electronic corpus. In Meunier, F. & S. Granger (eds.) *Phraseology in Foreign Language Learning and Teaching*. Amsterdam: John Benjamins.
- Pecman, M. (2004). L'enjeu de la classi(cation en phraseologie, EUROPHRAS, 26-29 aout 2004, Universite de Bale, Suisse, Baltmannsweiler, Schneider Hohengehren Verlag.
- Peppard, J. (2007) 'Exploring the Relationship between Word-Association and Learners' Lexical Development'. Assignment Bank (www) http://www.cels.bham.ac.uk/resources/essays/Peppard_Mod_2.pdf
- Përnaska, R. (1972) Dikutim për kumtesën e S. Floqit, Studime filologjike nr.1, Tiranë.
- Phuc, D. H. (2010, May). A study on metaphor and simile in English idioms and Vietnamese equivalents.
- Piirainen, E. (2007). Phrasemes from a cultural semiotic perspective. Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) *Phraseology: An International Handbook of Contemporary Research*, vols 1 & 2. Berlin: Mouton de Gruyter.

- Piirainen, E. (2008). *Figurative phraseology and culture*. Granger, S. & Meunier, F. *Phraseology -An interdisciplinary perspective*. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia
- Porzig, W. (1934). *Wesenhafte Bedeutungsbeziehungen*. *Beiträge zur Geschichte der deutschen Sprache und Literatur* 58.
- Pottier, B. (1969). *Introduction à l'étude des structures grammaticales fondamentales*, Nancy, Publications linguistiques de la Faculté des Lettres et des Sciences Humaines de Nancy I.
- Poulsen, S. (2005). *Collocations as a language resource. A Functional and cognitive study in English phraseology*. Unpublished PhD. Institute of Language and Communication, University of Southern Denmark.
- Poutsma, H. (1926). *A grammar of Late Modern English, part II, section II*. Groningen: P. Noordhoff.
- Prifti, S. (1962). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Proost, K. (2007). *Paradigmatic relations of phrasemes*. Burger, H., D. Dobrovolskij, P. Kühn & N. R. Norrick (eds.) *Phraseology: An International Handbook of Contemporary Research*, vols 1 & 2. Berlin: Mouton de Gruyter.
- Qirjazi, Dh. (2010). *Rrugë të çelura e shtigje të pashkelura: I pari fjalor frazeologjik ballkanik, hartuar në drejtimin e akad. Jani Thomai*. Një: Akademiku J. Thomai në 75-vjetorin e lindjes, Korçë.
- Renouf, A. & J. M. Sinclair (1991). *Collocational frameworks in English*. In Aijmer, K. & B. Altenberg (eds.) *English Corpus Linguistics*, 128–143. London: Longman.
- Rey, A & Chantreau, S. (2007). *Dictionnaire des expressions et des locutions. Les usuels du Robert*.
- Rey, A. (1977). *Le lexique : images et modèle*, Colin, Paris, chapitre 8 : « Les limites du lexique ».
- Rey, A. (1985). « Les implications théoriques d'un dictionnaire phraséologique », *Actes du colloque international « La locution »*, Université McGill, Montréal, 15-16 octobre 1984, in : *Le moyen français* 14-15.
- Richard, M. (2005). *Aproximación a un estudio del refrán. El refranero español de contenido metalingüístico (tesis doctoral)*, Departamento de Lingüística General y Lengua Española, Facultad de Filosofía y Letras, Universidad de Navarra, España.
- Riehemann, S. (2001). *A Constructional Approach to Idioms and Word Formation*, PhD thesis, Stanford University.
- Romero-Méndez, Rodrigo. 2007. *Spanish Light Verb Constructions: Co-predication with Syntactically Formed Complex Predicates*. State University of New York at Buffalo.
- Roos, E. (2001): *Idiom und Idiomatik: Ein sprachliches Phänomen im Lichte der kognitiven Linguistik und Gestalttheorie*. Aachen.
- Rowe, R. C. (2004). *Rumor has it- a tale of idioms*. DDT Vol.9, No.10.
- Rrota, J. (1942). *Sintaksi i Shqipes*. Shkodër.
- Ruwet, N. (1983). « Du bon usage des expressions idiomatiques dans l'argumentation en syntaxe générative », *në : Revue québécoise de linguistique* 13-1.
- Sabban, A. (2007). *Culture-boundness and problems of cross-cultural phraseology*.
- Sadock, J. M. (1972), 'Speech act idioms', in P. M. Peranteau, J. N. Levi, and G. C. Phares (eds.), *Papers from the Eighth Regional Meeting of the Chicago Linguistic Society*, 329-39.
- Sag, I., T. Baldwin, F. Bond, A. Copestake & D. Flickinger (2002). *Multi-word expressions: A pain in the neck for NLP*. In *Proceedings of the Third International*

- Conference on Intelligent Text Processing and Computational Linguistics (CICLING 2002), Mexico City.
- Sa'ied, I. Sa'ied (1979). Binomials in Iraqi Arabic with Reference to English. Mosul University: Unpublished M.A. Thesis.
- Samardzic, T. & Merlo, P.(2010). Cross-Lingual Variation of Light Verb Constructions: Using Parallel Corpora and Automatic Alignment for Linguistic Research. Nē: Proceedings of the 2010 Workshop on NLP and Linguistics: Finding the Common Ground, pp. 52-60. ACL, Uppsala
- Samvelian, P. & Danlos, L. & Sagot, B. (2011). "On the predictability of light verbs", 30th International Conference on Lexis and Grammar, Nicosia.
- Sandfeld, K. (1930). Linguistique balkanique. Paris.
- Saussure F. (de) (1916). Cours de linguistique générale. Payot, Paris
- Savin, P. (2010). Phraseology as an autonomous linguistic discipline 'Current state of the topic in Romanian linguistics. Libri. Linguistic and Literary Broad Research and Innovation. Volume 1, Issue 1.
- Schapira, C. (1999). Les stéréotypes en français. Proverbes et autres formules. Paris : Ophrys.
- Schapira, C., 1997, La maxime et le discours d'autorité, Paris, Sedes.
- Schapira, Ch. (2000). Proverbe, proverbialisation et déproverbialisation, Langages, no 139.
- Schmidlin, R. (2007). Phraseological expressions in German standard Varieties. Granger, S. & Meunier, F. Phraseology -An interdisciplinary perspective. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia.
- Sheperi, I.D. (1927). Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe. Vlorë
- Simpson, R., & Mendis, D. (2003). A corpus-based study of idioms in academic Speech. TESOL Quarterly, 37(3).
- Sinclair, J. & Moon, R. (eds.) (1995): Collins Cobuild Dictionary of idioms. London.
- Sinclair, J. (1991). Corpus, concordance, collocation, Oxford, Oxford University Press.
- Sinclair, J. (2008). The phrase, the whole phrase, and nothing but the phrase. Granger, S. & Meunier, F. Phraseology -An interdisciplinary perspective. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia.
- Sinclair, J. (ed.) (1987). Looking Up. An Account of the COBUILD Project in Lexical Computing. London: Collins Cobuild.
- Smirnitsky A. I. (1959). Russian – English Dictionar. 3rd Edition edition . E. P. Dutton and Company.
- Smith, L.P. (1925). Words and Idioms. London: Constable.
- Stefi, J. (1970). Leksikologjia shqipe. Tiranë.
- Steinlin, J. (2003). Generer des collocations. Memoire de DEA sous la direction de S.Kahane. Paris: Universite de Paris VII.
- Stevenson, S., Fazly, A., and North, R. (2004). Statistical measures of the semi-productivity of light verb constructions. In Proceedings of the ACL 2004 Workshop on Multiword Expressions: Integrating Processing, pages 1–8, Barcelona, Spain.
- structure of language. University of California Press, Berkeley & Los Angeles.
- Svensson, M. H. (2002). Critères de figement et conditions nécessaires et suffisantes. Romansk Forum 16(2).
- Svensson, M. H. (2004). Critères de figement. L'identification des expressions figées en français contemporain. PhD dissertation, Umeå University.
- Sweet, H. 1899. The Practical Study of Languages: A Guide for Teachers and Learners. London: Dent.

- Swinney, D. & A. Cutler (1979) The access and processing of idiomatic expressions. *Journal of Verbal Learning and Verbal Behaviour* 18.
- Tallgren-Tuulio, O.J. (1932) : « Locutions figurées calquées et non calquées. Essai de classification pour une série de langues littéraires », *Mémoires de la Société Néophilologique de Helsinki*, vol. 9.
- Tarasevitch, M. (1991) *Soviet phraseology: Problems in the analysis and teaching of idioms. Linguistics and language pedagogy: the state of the art.* Georgetown University Press, USA.
- Taylor, A. (1962): *The proverb and index to "the proverb"*. Copenhagen.
- The Great Soviet Encyclopedia. (1979) <file:///E:/Frazeologji%20dhe%20Metafore/New%20Folder%20UNITE%20PHRASEOLOGIQUE/Phraseology.htm>
- Thomai, J. & Lloshi, Xh. & Hristovo, R. & Qirjazati, K. & Melonashi, A. (1999). *Fjalor frazeologjik ballkanik*, Dituria, Tiranë.
- Thomai, J. (1981). *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Thomai, J. (1999). *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Thomai, J. (2006). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Botimet Toena, Tiranë.
- Toffol, M. (2011). *An English-Spanish contrastive analysis of culturally loaded phraseological units containing kinship terms*. Master. Madrid. Toronto: University of Toronto. Ph.D. thesis.
- Tutin, A. & Grossmann F. (2002). "Collocations regulieres et irregulieres :esquisse de typologie du phenomene collocatif", *Revue francaise de Linguistique appliquee*. *Lexique: recherches actuelles*, vol. VII.
- Tutin, A. (2009). *Semantique – Modelisation des associations lexicales - UFR des Sciences du Langage*, Universite Stendhal Grenoble 3.
- Vincze, V & Csirik, J. (2010). *Hungarian corpus of light verb constructions*. In *Proceedings of the 23rd International Conference on Computational Linguistics*. Beijing, China.
- Vincze, V. (2011). *Semi-Compositional Noun + VerbConstructions: Theoretical Questions and Computational Linguistic Analyses*. PhD thesis. University of Szeged
- Vinogradov V. V. (1947). 'Ob osnovnyx tipach frazeologičeskix edijic v sovremennom russskom jazyke'. In: V. V. Vinogradov, *Izbrannyje trudy: leksikologija i leksikografija*. Moskva: Nauka.
- Vivanco, V.(2008). *On the Distinction between Proverbs and Idioms*. Retrieved December, 4, 2008 from http://www.Linua-jip.De/pdf/Linguaa-JIP-Research.distinction_between_proverbs_idioms.pdf.
- Weinreich, U. (1969). *Problems in the analysis of idioms. Substance and structure of language*. University of California Press, Berkeley & Los Angeles.
- Whiting, B.J. (1932): *The nature of the proverb*. Nė: *Harvard Studies and Notes in Philology and Literature*, 14
- Wittenberg, E. & M.M. Pi-nango (forthc.). *Processing Light Verb Constructions*. *The Mental*
- Wray, A. (2002). *Formulaic Language and the Lexicon*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Xhuvani, A. (1980 [1921]). *Mbi thjeshtësin' e gjuhës*. Aleksandër Xhuvani, vepra 1. Tiranë.
- Yorio, C. (1980). *Conventionalized language forms and the development of communicative*
- Yorio, C. (1989). *Idiomaticity as an indicator of second language proficiency*. Nė: *Hylytenstam, K./Obler, L. (eds.): Bilingualism across the lifespan*. Cambridge, 55–72.

- Zemlyakova, K. On the issue of basic types of phraseological units in the Russian and the English languages.
<file:///G:/aaaaa%20materiale%20ne%20word%203/Types%20of%20phraseological%20units%20in%20the%20Russian%20and%20the%20English%20languages.%20%20patjeter.htm>
- Zuluaga, A. (1980). *Introducción al estudio de las expresiones fijas*. Frankfurt: Peter Lang.
- Λεξικό γλωσσολογικών όρων http://www.greek-language.gr/greekLang/modern_greek/tools/lexica/glossology/show.html?id=261
- Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής (1998). Θεσσαλονίκη: Ινστιτούτο Νεοελληνικών Σπουδών ΑΠΘ, [Ίδρυμα Μανόλη Τριανταφυλλίδη].
- Λεξικό της νέας Ελληνικής γλώσσας. (2002). Αθήνα: Κέντρο Λεξικολογίας. [Μπαμπινιώτης, Γ.]
- Λουκάτος, Δ. (1992). *Εισαγωγή στην ελληνική λαογραφία*. Αθήνα: ΜΙΕΤ. [1977].
- Παπαζαχαρίου (Ζάχος), Ε. (1999). *Λεξικό της Ελληνικής αργκό (Λεξικό της πιάτσας)*. Αθήνα: Κάκτος.
- Σετάτος, Μ. (1990). «Ελληνική και τουρκική (μερικές περιπτώσεις δανεισμού)». *Μελέτες για την ελληνική γλώσσα. Πρακτικά της 10ης συνάντησης του Τομέα Γλωσσολογίας της Φιλοσοφικής Σχολής του Α.Π.Θ., 9-11 Μαΐου 1989*, Θεσσαλονίκη: Κυριακίδης, 129-139.
- Συμεωνίδης, Χ. (1997). «Türkisch-griechische phraseologische Isoglossen anhand von Bezeichnungen für menschliche Körperteile und Organe». *Zeitschrift für Balkanologie*. Wiesbaden: Harrassowitz.
- Συμεωνίδης, Χ. (2000). *Εισαγωγή στην ελληνική φραζεολογία*. Κώδικας, Θεσσαλονίκη.
- Φλιάτουρας, Α. (2001). *Ελληνοαλβανικά φρασεολογικά ισσόγλωσσα με βάση τα μέλη και όργανα του ανθρώπινου σώματος, μια μικρή συμβολή*, ALBANOHELLENICA 2.
- Χιώτη, Α. (2010). *Οι παγιωμένες εκφράσεις της νέας Ελληνικής: Ιστορική διάσταση, ταξινόμηση και στερεοτυπικότητα*. Διδακτορική διατριβή. Θεσσαλονίκη.

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

Teza: “Rreth frazeologjisë së shqipes krahasuar me greqishten”

Fusha: Kërkime gjuhësore.

Abstrakt: Përveç frazeologjisë në kuptimin e ngushtë ekziston edhe një lloj tjetër frazeologjie të cilën ne e pranojmë dhe e propozojmë edhe për gjuhën shqipe. Ajo është frazeologjia në kuptimin e gjerë e cila nuk e përjashton frazeologjinë në kuptimin e ngushtë, por e përfshin atë. Me frazeologji në kuptimin e gjerë do të kuptojmë frazeologjinë që studion frazemat deri në nivel fjalie, siç janë proverbat dhe formulat e bashkëbisedimit. Kriteri përcaktues është mosreferencialiteti literal, që do të thotë se struktura frazeologjike ka kuptim të mbartur ose se të paktën një nga përbërësit e strukturës e ka humbur kuptimin literal.

Do të quajmë frazeologjike ato lidhje të qëndrueshme, -sintagma ose fjali-, kuptimi i të cilave është i ndryshëm nga shuma e kuptimeve literale të fjalëve përbërëse.

Njësia bazë e frazeologjisë në kuptimin e gjerë do të jetë frazema, ndërsa kategoritë e veçanta frazeologjike do të jenë idiomat, perifrazat me folje të desemantizuar, frazeotermat, binomet e pakthyeshme frazeologjike, lokucionet gramatikore, proverbat, formulat frazeologjike të bashkëbisedimit dhe kolokacionet e kufizuara frazeologjike.

Pas një studimi krahasues të idiomave të fushave kryesore leksikore midis shqipes dhe greqishtes rezulton se midis këtyre dy gjuhëve nuk ka aq shumë përkime idiomatike sa pretendohet në Fjalorin frazeologjik ballkanik, pavarësisht se ato janë gjuhë fqinje me kulturë të ngjashme dhe me marrëdhënie shumëshkulllore.

Fjalë kyç: Frazeologji, frazemë, idiomë, proverb, kolokacion, ngurosje, sintagmë e qëndrueshme, lidhje fjalësh me vlerë fjalie.

FACULTY OF HISTORY AND FILOLOGY

Thesis: “On the phraseology of Albanian language in comparison with the phraseology of Greek language”

Field: Linguistic research.

Abstract: Besides phraseology in the narrow sense there is also another phraseology that we accept and propose for the Albanian language as well. It is phraseology in the broad sense which does not exclude phraseology in the narrow sense, but which includes it. By phraseology in the broad sense we mean the phraseology that studies sentence-level phrasemes, such as proverbs and formulae of conversation. Their determining criterion is literal non-referentiality which means that the phraseological structure has a transferred meaning or that at least one of the components of the structure has lost its literal meaning.

We will call phraseological those stable word-combinations, -phrases or sentences-, whose meaning is different from the sum of the literal meanings of the constituent words.

The basic unit of phraseology in the broad sense will be phraseme, whereas the specific phraseological categories are idioms, light verb constructions, phraseoterm, irreversible phraseological binomial, grammatical locutions, proverbs, phraseological formulae of conversation and phraseological restricted collocations.

After a comparative study of idioms from the main lexical fields between Albanian and Greek languages it results that between these two languages there are not so many idiomatic parallels as they pretend to be in the Idiomatic Balkan Dictionary, although they are neighbouring languages with similar culture and age-long relationship.

Key words: Phraseology, phraseme, idiom, proverb, collocation, fixedness, stable phrase, sentence-level word combination.